
ALTERNATIVA

9-12
1990



SHOQATA MIGJENI KULTURNO
KULTURORE DRUŠTVO
SHQIPTARE ALBANCEV

Narodna in univerzitetna knjižnica
LJUBLJANA

LUBJANË
LJUBLJANA

Pse u vonua Alternativa?

403668

Alternativën e ngritën atdhetarët, ata e finansuan, ata e mbajtën gjallë. Shqiptarët, prej Zagrebi e Lubjane deri në Detroit, Nju Jork e Melburn. Alternativa e mbaroi denjësisht misionin e vet duke i dhënë udhë mendimit të lirë shqiptarë, atëherë kur shtypi ynë në Kosovë i nënshtrohej kontrollit të rreptë policor. Tashti bënë edhe pa *Alternativën por Alternativa* megjithatë nuk bënë pa ju-lexues të nderuar. Prandaj qe, i mblodhëm të gjitha forcat që ta keni në duar edhe njëherë *Alternativën.* Erdhi një kohë kur gati të gjithë ia kthyen shpinën *Alternativës* të cilën mezi e gjente njeriu fshehurazi, për ta lexuar të fotokopjuar dhe për ta shpërndarë. Erdhi një kohë kur *Alternativa* nuk kishte me çka të shtypej, ngase askush nuk ia ktheu borxhet, por sidoqoftë, *Alternativa* është, ekziston, Ajo ende mendon për Ju!

REDAKSIA

I nderuari lexues,
në kohën kur dinamika e ngjarjeve dhe ndryshimeve qensore në Evropën lindore e zuri të papërgatitur kombin shqiptarë edhe një herë, e udhëtarët (shqipëtarë) në stacionin, jo të fundit, me çaklat e tyre nuk po munden me u kyçur në trenin e shpejtë që shpie për Evropë, u vonuam edhe ne. Edhe kësaj radhe u kërkuan, edhe po kërkohen, fajtorët diku jashtë nesh, si zakonisht. Në veri, përtej Karpateve, këtej Karpateve, pas kodrës, këtej kodrës, e kurrsesi të pajtohemi me fatin se FAJTOR jemi NE.
E verteta është e hidhur, andaj edhe dhemb shumë.
U vonuam për arsyera e dobësi interne, duke u ngutur që në trenin e shpejtë që po shkonte për Evropë të futemi, cili përpara tjetrit e me shumë çakla (të ndrydhura nëpër valixhet e dëmtuara) e të cilat në Evropë më nuk përdorën, për të zënë vënd në klasin e parë. Treni iku! Kur do të vijë tjetri ? A do të vijë? Kah do të shkoj? Nëpër Serbi? Nëpër Selanik... nëpër Janinë... Brindis? Kah...?
Lufta në Gji çrregulloi shumë çka! Nga Bullgaria na erdhi një befasi e këndshme, ajo të cilën Shqipëria nuk e bëri kur doli nga Pakti i Warshavës. Pse nuk e bëri? Pse nuk e bënë sot? Pse në i d e o l o g j i n ë Marksiste-Leniniste nuk u martua me Marxin çifut po me Leninin sllav e me Stalinin si kumbar malazias?
Trenat vijnë e shkojnë. Ne po ngelemi. Koha po kalon si uji nën urë. Vije nata, bije ora, ditët shkojnë e ne mbetemi: Ne u vonuam pse na penguan pikërisht shqiptarët. Këtu ndër ne. Ata të cilët donin që me tërë ato plaçka të futen në klasin e parë të trenit që shpiente diku tjetër. Jo për Evropë. Ne do të flasim diç më tepër lidhur me këtë në numrat e ardhshëm.
Do të flasim edhe më konkretisht. Edhe për dinar-patriotët' do të shkruajmë. Për ata të cilët në emër të popullit, e kinse për popull, e rrezikuan SHKSH «MIGJENI», dhe ilegalisht a legalisht i shkaktuan dëme të mëdha materiale. Nuk do të jemi revistë që denoncon, do të jemi revistë kulturore e shkencore me shkrime të cilat nuk u janë të afërta shqiptarëve, por edhe do të flasim për dobësitë e atyre që shiten shtrenjtë. Në ilegalitet!

Kabineti i S u l l t a n i t – JO! Jo, ngase treni i fundit «Ballkan–Expres» për Stamboll, iku që këtej. Më nuk do të udhtojmë me këtë lidhje të mbrapshtë pas vitit të mbrapshtë. Andaj, i f t o j m ë të gjithë ata të cilët mendojnë se për ATA është fjala, e ne njihemi tanimë mirë, që të kryejnë obligimet e tyre të papërmbushura ndaj «Migjenit» të cilin aq shumë e «donin»!
Trimat o vrasin o të falin!

Lubjanë,
07.shkurt 1991

«MIGJENI»

Ilirët

Emil Nack

Zona qendrore e trungut ilir në kohën e bronzit shtrihej në hapësiren e Sudete-es dhe në Gjermaninë lindore, me Lausitz-in si qender. Në këtë truall u zbulua një mënyrë e re e varrimit. Kremacioni i kufomave tanime ishte përhapur në shumicën e fiseve. Mirëpo, këtu hirin e vendosnin në vazo (urna të hirit) dhe i varrosnin në truall të rrafshtë. Gërmimet kanë zbuluar qindra e mijëra varre në një shtrirje të madhe hapësinore. Urna e hirit ishte e rrethuar edhe me një numër të madh urnash të cilat me siguri i ishin destinuar të vdekurit për marrjen e ushqimit dhe pijës. Zakoni i ri i varrimit duhej të ishte një ndryshim në botëkuptimin dhe pikëpamjet e atëhershme dhe si kusht paraprak duhet të këtë pasur vazhdimin e jetës pas vdekjës. Urnat për nga cilësia dhe llojllojshmëria e formës së tyre dëshmojnë një zhvillim të lartë të mjeshtrisë së artizanatit të qeramikës. Veçanërisht bijnë në sy Urnat me gunga. Kjo mënyrë e re e varrimit tërë kësaj kulture i dha emrin »*Urnen Felder Kultur*«. Në vazhdim të shekujve të ardhëshëm, Ilirët u tërhoqen nga zona qendrore Gjermane dhe zbritën drejt jugut, supozohet se ata ishin të detyruar apo ndoshta vet përpiqeshin që të arrinin në jug për shkak të tokës pjellore për të cilen ata kishin mësuar përmes lidhjeve tregtare. Ata dolen në zonën alpine, krijuan këtu kulturën e ashtuquajtur *Halltstatt* dhe kaluan ne përendim ku kufizoheshin me Keltët. Në bredhje e sipër arritën në bregun lindor të Adriatikut dhe në veripërendim të Gadishullit ballkanik u qetësuan. Gjuha e tyre, ilirshtja, vazhdon të jetoje në gjuhën shqipe. Grupet e vogla ilire, që shpesh përmblidhen me emrin Mesap, lundruan Adriatikun drejt Italisë jugore dhe u vendosën në Pulje dhe Kalabri. Fisi me i njohur Ilir *Venetët* ishin vendosur në verilindje të luginës së lumit Po, ku edhe sot emri i provincës Venetia dhe qyteti lagune në Venedik përkujtojnë emrin e ardhësve të parë. Edhe qyteti fqinjë Tergesta (Triesta) mbanë një emër Ilir. Mbi trollin Ilir kaloir nje tregti shumë e gjërë me qelibar dhe lëkurë, me jugun; dhe me gjësende të bronzit me veriun e varfër nga metalet.

Koment

Emil Nack në këtë libër bënë fjalë për Gjermanët e vjetër që nga koha e paleolitit, pra 10000 vjet para erës sonë e deri në kohën e Karlit të Madh, në fillim të shekullit IX (viti 814). Në këtë kontekst ai shqyrton edhe kontaktet e gjermanëve me popujt tjerë, afritë, ngjajshmëritë, ndikimet dhe marrëdhëniet. Si fqinjë përmend Italët, Keltët, Ilirët dhe Sllavët. Fjala është për vitin 1800 deri 800 para Krishtit. Në fillim studimit i qaset nga ana gjuhësore duke nxjerr në shesh ngjajshmëritë leksikore dhe semantike si edhe ato gramatikore. Duke numruar gjuhët që marrin pjesë në familjet Indo-Evropiane Nack thotë: Das Illyrische auf das das Albanische zurueckgeht.

Artikulli është marr nga libri »Germanen Laender und Voelker der Germanen« i botuar me 1958 dhe i ribotuar me 1977 në Wien. Përveç këtij libri E. Nack ka botuar edhe këto libra: »Laend und volk der alten Roemer 1959, e ribotuar me 1966 në Wien sëbashku me Wilchelm Wagner (vendi dhe popujt e romakëve të vjetër).

Libri tjetër: Gotter, helden und Daemonen (Perëndi, herojne dhe demonë) mitologji egjiptase, greke dhe gjermane 1968 Wien.

Hellas – Land und Volk der alten Griechen. (Helenët – vendi dhe popujt e grekëve të vjetër etj.

Librat e lartëpërmendur janë botuar në shtëpinë botuese Weberrenter Wien – Heilderberg.

Përktheu: **Naser Aliu**
Gjermani

Pjesemarrja e shqiptarëve në Betejën e Kosovës (1389)

Dr. Muhamet Pirraku

Shkurtimi: Hulumtimet albanistike interdisciplinare vërtetojnë se në Betejën e Kosovës më 1389, u flijua Theodor II Muzaka dhe Millosh Nikollë Kopiliqi, kurse heroizëm të madh tregoi Dhimitër Jonima. Ishte i pranishëm edhe Gjergji II Strazimir Balsha dhe me gjasë Leka I Dukagjini dhe Gjon Kastrioti.

Motivet për Betejën e Kosovës të qershorit 1389 ishin të lidhura me aspiratat në rritje të mbretërisë së re osmane-turke (dhe muslimane) që plotësisht të forconte pushtetin okupues në brëndi të Ballkanit, ku kishte filluar shthurja me shpejtësi e mbretërive feudale bizantine romako-greke dhe nemanjiqase sllavo-serbe dhe ku kishin lëshuar bazë themelet e shteteve feudale nacionale në mundësi të disa krahinave dhe të disa popujve ballkanikë[1]. Këto organizme shtetërore nacionale në mundësi më me fuqi u paraqitën në viset e banuare me albanofonë[2]. Bujaria shqiptare, ish-çefalitë dhe pari e popullsive blegotore vendëse (ish-çellnikët), sikurse edhe ruajtësit e kishave dhe të manastireve (ish-vojvodët) dhe ish-princat shqiptarë të periudhës bizantine dhe nemanjiase, përnjëherë pas paraqitjes së osmanëve-turqve në Dyer të Ballkanit, mbrojtjen e territoreve të tyre e mbështeten në krahinarët dhe sundimtarët të popujt fqinjë[3], me të cilët në shumë raste ishin në lidhje miqësie e farefisnie të gjakut[4]. Thënë simbolikisht, varra e parë kanceroze e përbashkët shqiptaro-sllave të cilën ua hapi

[1] Gjerësisht, Joseph von *Hammer, Geschichte des Osmanischen Reiches, Ester band 1300–1453,* Pest, 1827; Konstantin Jireček, *Istorija Srba I,* Beograd, 1952; Filip Hiti, *Istorija Arapa,* Sarajevo, 1973; Istorija naroda Jugoslavije, Beograd, 1953; *Historia e popullit shqiptar I,* Prishtinë, 1969.

[2] Gjerësisht, D. Giovanni Musachio, Breve Memoria de li discendenti de nostra casa Musachi (1510), në *Leka,* nr. 3, Shkodër, 1930; Charles Hopf, *Croniques gréco-romanes (Breve memoria de li discendenti de nostra Casa Musachi),* Berlin, 1873; Alba Lima (Milan Šufflay), *Kostadin Balšić (1392–1402). Historijski roman u tri dijela,* Zagreb, 1920; M. Shifflay, *Serbët dhe shqiptarët,* Prishtinë, 1968; Stanoje Stanojević, *Naši vladari,* Beograd, 1927.

[3] Gjerësisht, Nikola Jorga, *Geschichte des Osmanischen Reiches,* Gotha, 1908; K. Jireček-J. Radonić. *Istorija Srba II (Kulturna istorija),* Beograd, 1952; Stojan Novaković, *Serbi i Turci XIV i XV veka,* Beograd, 1960; A. Majkov, *Istorija Srpskog naroda,* Beograd, 1876; Gliša Elezović, *Turski spomenici,* knjiga I, Beograd, 1940.

[4] Gjerësisht, *Il regno de gli Slavi hoggi corrottamente detti Schiavoni. Historia di don Mavro Orbini Ravseo Abate Melitense (Dalmatia, Croatia, Bosna, Servia, Rassia, Begaria),* In Pesaro, M.DCI (1601); Ludovici Cervarii Tuberonis. Patrici Rhacusani Abatis divi iacobi, *De Turcarum origine, moribus geflis Comentarius, Florentise a pund Antonium Patauinium,* 1590; Giacomo di Pietro Luccari, Ristretto de gli annali di Rausa, Venetia, 1604; Paul Jos. Šafārik's, Geschichte des *Serbischen schriftthums aus dessen hanschriftlichen nachlasse Herausgegeben fon Josef Jireček III,* Prag, 1865; V. Ćorović, Histoire des états balcaniques jusqu' á 1924. par N. Jorga, Paris 1925, *Arhiv za Arbanašku starinu, jezik i etnografiju* III, 1–2, Beograd 1926; P. Jovanović, *Malesija XV knjiga »Naselja i poreklo stanovništva«,* SEZ, XXVII tom, *AASJE* II (1924), Beograd, 1925; A. V. Solovjev, Povelja kralja Milutina barskoj porodici Žarkovića (1319), *AASJE III,* 1–2, Beograd 1925; V. Popović, Nešto iz tradicije o Matarugama i Dakovićima na Grahovu, *AASJE III,* 1–2, Beograd 1926; Sima Qirkoviq, Pasqyrë e marrëdhënieve serbo-shqiptare prej ardhjes së silavëve deri në fund të shek. XVIII, *Përparimi,* 7–8, Prishtinë 1955; Nr. 2, Prishtinë 1956.

pushtuesi osman-turk është therrja e të krishterëve nga Maqedonia dhe Shqipëria në Maricë, më 1371, ku së bashku me ushtarët më elitë ranë Uglesha dhe Vukashini nga dera e Mërnjavqeviqëve dhe dhespoti (sundimtari) i Vlorës, Aleksandri[5].

Pas katastrofës në Maricë pjesa më e madhe e principatave në arealin e Mbretërisë së Car Dushanit (u helmua më 1355), të banuara me albanofonë, sllavofonë dhe grekofonë e pranuan flamurin e Sulltan Muratit I[6]. Deri në Betejën e Kosovës pavarësinë e ruajti vetëm sundimtari i Bosnës, Tvrtko, dhe kohëpaskohe Balshaj në pjesën Veriore të trevave albanofone të sotme dhe në Zetën mesjetare[7]. Pushtuesi i ri, aziatik, pjesës së okupuar të Ballkanit iu kërcënua në shumë drejtime: në aspektin politik, ekonomik, kulturor-fetar dhe me rreziqe të tjera të karakterit etnik dhe nacional[8]. Frika nga ajo robëri e gjithanshme i detyroi bujarët, vojdodët, çefalitë, princat dhe krahinarët e tjerë të ndryshëm dhe mbretin Tvrtko në viset e gërmadhes së mbretërisë së Dushanit që për një kohë relative të shkurtër të lenin anash ngatërresat dhe aspiratat e ndërsjella separatiste, për nevoja të mbrojtjes së përbashkët dhe të ruajtjes së pavarësisë së krahinave dhe të principatave të tyre[9].

Iniciativën për krijimin e frontit të përbashkët të krishterë ballkanikë dhe me gjerë kundër robërisë osmane-turke në Ballkan e mori *katunari* ynë[10], prelepnicasi anamoravas, Lazar Pribezi (Pribaci), më vonë i njohur si Greblanoviq ose Hrebelanoviq, i cili me anë të martesës me qikën e knjazit Vratko (Bratko) të Krushevcit dhe me ndihmën e kishës ortodokse u bë drejtues dhe knjaz i Maçvës dhe Sremit[11]. Shikuar nga perspektive e pas

[5] Shih, *Historia e popullit shqiptar I,* Prishtinë 1969, 221.

[6] Sülejman Külçe, *Osmanli tarihinde. Arnavutluk,* Izmir 1944, 38–40.

[7] Shih, Salih Trako, Pretkosovski događaji u Hešt bihištu Idrisa Bitlisa, *Prilozi za orijentalnu filologiju XX–XXI/1970– 71,* Sarajevo, 1974, 190.

[8] Pjesa e dytë e shek. XIV dhe pjesa e parë e shek. XV paraqet kohën e paraqitjes së filleve të kulturës nacionale të popujve ballkanik. Gjerësisht, Adrien Balbi, *Atlas ethnographique du globe, ou Clasification des peuples, anciens et modernes D'après leurs Languès,* Paris, 1826; R.K. Rask, *Vergleichungstafeln der Euröpëischen Stamm- Sprachen und Süd-West-Asiatischer,* Halle, 1822; *Postanak i razvoj srpske nacije (Neki metodološko-teorijski problemi u izučavanju postanka i razvoja srpske nacije),* Beograd, 1979; Ivan Gjuretić, *Sumrak Vizantije (Vreme Jovana VIII Paleologa),* Beograd, 1984; Muhamet Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare deri nëLidhjen e Prizrenit,* Prishtinë, 1989.

[9] Shih, Lovro Mihačevoć, *Crtice iz Albaneške povijesti,* Sarajevo, 1912, 45–46; M. Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët,* Prishtinë, 1968, 132–134; S. Novaković, *Srbi i Turci XIV i XV veka,* fq. 154–334; Stanlej Len Pul, *Istorija Turske carevine,* Niš, 1890, 31–32.

[10] »Pra, plotësisht është e mundshme ojo qe thotë historiani dubrovnikas Lukari se knjazi serb Lazari është paraprakisht *katunar,* e është e njohur se edhe mbreti bullgar Aseni kishte prejardhje vllehe« (Milenko S. Filipović, Struktura i organizacija srednjovekovnog katuna, *Simpozijum o srednjovekovnom katunu održan 24. i 25. novembra 1961. g.,* Sarajevo, 1963, 80).

Për Prejardhjen jo tësaktë sllave të Lazarit, shih edhe: S. Stanojević, *Naši vladari,* 38; T. Maretić, *Naša narodna epika,* Beograd, 1966, 184–185; R. Mihaljčić, *Kraj srpskog carstva,* Beograd, 1975, 217–221.

Sipas K. Jireqekut, emrat e të krishterëve: Dmitar, Djordje, Ilija, Ivan, Lazar, Marin, Nikola, Stjepko, Tudor etj. »janë emra shumë të shpesht në ish-viset e hershme bizantine, në Maqedoni dhe te shqiptarët« *(Istorija Srba,* Četvrta sveska, Beograd, 1925, 8).

[11] V. Kuprešanin, *Nemanjići i Mrnjavčevići,* Beograd, 1953, 103; Dr. Stanoje Stanojević, *Naši vladari,* 38; R. Mihaljčić, *Laraz Hrebeljanović. Istoria. Kult. Predanje,* Beograd, 1984, 13–96.

Betejës së Kosovës, Lazari, me gjasë, aleatët më besnikë kundër osmanëve i gjeti në radhët e popullit shqiptar, ndönëse në qershor të vitit 1389, së paku letrarisht, pati edhe njësi aleatë nga Bosna dhe Hercegovina, por edhe vullnetarë dhe mercenarë nga popujt e tjerë të Ballkanit dhe të Evropës. Nga kjo, sipas konstatimit të Zh. M. Romanoviqit, del se *»në Kosovë nuk luftoi vetëm serbi me turkun, por* (luftoi) *Evropa e civilizuar me Azinë e egër«*[12].

Literatura burimore dhe tradita për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës është e pasur dhe e larmishme. Mund të thuhet se të gjitha burimet, e tërë literatura burimore historiografike, e tërë tradita popullore e Ballkanit dhe e Azisë, e cila flet për Betejën e Kosovës, bënë fjalë edhe për pjesëmarrjen e shqiptarëve në atë ngjarje të themi historike. Me përqasje interdisciplinare shkencore, me identifikacimin e personaliteteve historike pjesëmarrës në të ashtuquajturën *»Darka e Princave«* në Krushevc, në Kërshendella (Bozhiç) të vitit 1388, ose në *»Kishën e Samadrexhes«*, në darkën e natës së Betejës së Kosovës, mund të shihet se midis atyre shtatë deri dymbëdhjetë princave dhe bujarëve të besatuar, më se paku katër ose gjashtë mund të identifikohen me personalitete historike shqiptare: *Theodorin II Muzaka, Gjergjin II Strazimir Balshën, Milosh Nikollë Kopiliqin, Dhimitër Jonimen,* por ka indikacione se aty ishin edhe *Gjon Kastrioti* dhe *Leka I Dukagjini.*[13]

Pjesëmarrja kaq e gjerë e bujarëve shqiptarë në koalicionin e të krishterëve, që mund të dokumentohet lehtë dhe qartë, ishte rezultat nga rreziku i drejtpërdrejt nga depërtimi dhe përforcimi i robërisë osmane-turke në viset e banuara me albanofonë[14]. Hulumtimet interdisciplinare historike, etnografike, folkloristike e gjuhësore tregojnë se të thuash të gjithë martirët e të krishterë, historikisht ende të paidentifikuar, tradita popullore i vendos në viset e Dardanisë antike, të Shqipërisë dhe të Epirit[15], përkatësisht në

[12] Ž. M. Romanović, *Biografija i državnićka radnja Vuka Brankovića i Miloša Obilića,* Beograd, 1891, 4.

[13] Gjerësisht, dr. Muhamet Pirraku, *Pjesëmarrja e shqiptarëve dhe roli i Milosh Nikollë Kopiliqit në Betejën e Kosovës.* Studim monografik në dorëshkrim, Prishtinë, 1980.

[14] Gjerësisht, D. Giovani Musachio, *Breve Memoria de li discendenti de nostra casa Musachi (1510);* J. v. Hammer, *Historia turskog (osmanskog) carstva I,* Zagreb, 1979, 72–76; Th. Lavallés, Histoire de la Turqui, Leipzig, 1859, 212–213; S. Len-Pul, *Turska carevina,* Niš, 1890, 31–35; S. Gopčević, *Gornja Albanija i njena Liga,* N. Sad, 1893, 17; M. Edith Durham, *Twenty years of Balkan tangle,* G.P. Putnam's sons (First published in 1920), 16; M. E. Durham, *The burden of the Balkans,* London, Edinburgh, Dublin and New York, 38–39; N. Jorga, *Geschichte des Osmanischen Reiches.* Erster band bis 1451, Gotha, 1908, 236–262.

[15] Gjerësisht, V. Čajkanović, Motivi arnautske pesme o boju na Kosovu, *AASJE,I,* 1–2, 66–77; T. R. Djordjević, Beleške o narodnoj poeziji. Gde su stanovali Miloš Obilić i Ljutica Bogdan, *Zbornik radova XIV,* Beograd, 1951, 167–172; T. Čubelić, *Epske narodne pjesme. Šesto izdanje,* Zagreb, 1970, 60–73; T. Vukanović, *Srpske narodne epske pesme,* Vranje, 1972; T. Maretić, *Naša narodna epika,* Beograd, 1966, 145–231; V. Djurić, *Antologija narodnih junačkih pesama (Osmo izdanje),* Beograd, 1977, 34–47; S. Matić, *Novi ogledi o našem narodnom epu,* N. Sad, 1972; Dr. Henryka Czajka, Halle, Zajedničko i specifično u kosovskom ciklusu kod južnoslovenskih naroda, *Rad XIV kongresa Saveza udruženja folklorista Jugoslavije u Prizrenu 1967,* Beograd, 1974; Sh. Pllana, Epika popullore shqiptare mbi Luftën e Kosovës (1389), *Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj,* 2, Prishtinë, 1976, 112–126; A. Çetta, Edhe nji motërzim i kangës popullore shqiptare mbi Luftën e Kosovës, *Gjurmime albanologjike,* 1, Prishtinë, 1962, 263–275.

viset të cilat u islamizuan në masë të madhe deri në fillim të shekullit XVII[16].

Në koalicionin e të krishterëve nën udhëheqjen e krahinarëve dhe princave autoritativë, të cilët, sipas *Ahmedijes* (1390)[17], *Astrabadijes* (1398)[18] e të tjerëve, përbënin *»te pafetë dhe të krishterët të cilët gjenden në Perëndim«,* nuk është e mundur të mos shihen edhe shqiptarët. Kjo aq më parë kur dihet se në kronikat dhe historitë osmane të mëvonshme shqiptarët trajtohen si pjesëmarrës në koalicionin e të krishterëve. Shembulli vjen: te *Jahshi Fakihu* (para vitit 1413)[19], *Shukrullahu* (1458)[20], *Enveri* (1464)[21], *Uruçi* (1467)[22], *Anonimit të Jedrenës* (1490–1512)[23], *Ashik – Pashazade* (rreth 1484)[24], *Neshria* (para 1493)[25], *Bitlisi* (1505)[26], *Kemal – Pashazades* (para 1510)[27], *Mehmet Çelebi – Nishanxhia* (1561)[28], Sa'adeddini *(1575)*[29],

[16] Gjerësisht, M. Pirraku, O islamizaciji i ulozi islama u integraciji albanske narodnosti, *Dituri islame,* Prishtinë, nr. 15–16 dhe 17/1990; O religiji stanovništva Kosova i susednih oblasti nastanjenih Albancima u XVI I XVII veku. Kumtesë në *Sesionin shkencor të Shoqatës së etnografëve të Serbisë,* Suboticë, 19–21 prill 1990. U botua, shqip, pa fusnota, në »*Rilindja.*« Prishtinë, 20, IV. 1990.

[17] Gjerësisht, Aleksander Olesinski, Turski izvori o Kosovskom boju, pokušaj kritičke analize njihova saržaja i uzajamne konsekutivne veze, *Glasnik SUD XIV,* Skoplje, 1935 (Mëtutje: A. Olesinski, *Turski izvori),* 60–61; Selami Pulaha, *Lufta ehqiptaro-turke në shekullin XV,* Tiranë, 1968, 28–29.

[18] Gjerësisht, Fehim Bajra ktarević, Jedan savremeni persiski izvor o bici na Kosovu, *Prilozi za OFJ, J. N,* Sarajevo, 1953 (Mëtutje: F. Bajraktarević, *Jedan savremeni persiski izvor),* 5–18.

[19] Vepra e Jahshi Fakihut nuk është gjetur, por Ashik Pashazade në veprën e tij, më 1484, ka konstatuar se e ka përfillur J. Fakihun (A. Olesinski, *Turski izvori,* 75). Para Ashik Pashazadës në J. Fakihun është mbështetur edhe Uruçi, në veprën e vitit 1467 (S. Pulaha, Lufta shqiptaro-turke, 42).

[20] Gjerësisht, A. Olesinski, *Turski izvori,* 73 S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 31–32.

[21] Mihail Guboglu – Mustafa Mehmet, *Cronici turceçti privind tarile romane,* vol. I (Sec. XV – mijlocul sec XVIII, Bucureçti, 1966 (Mëtutje M. Guboglu-M. Mehmet, *Cronici turceçti),* 38–39; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 33– 38.

[22] Gjerësisht, Franz Babinger, *Die Frühosmanischen Jahrbüch des Urudsch* (Nach den Handschrifften zur Oxford und Cambridge erstamals herausgegeben und singeleitet), Hanover, 1925, 18–29; A. Olesinski, Turski izvori, 67–70; M. Goboglu-M. Mehmet, *Cronici turceçti,* 48–50; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 42–43.

[23] A. Olesinski, *Turski izvori,* 78–79; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 53–54.

[24] *Açik Paça Zade Tarihi* (...), Istanbul, 1332 (1863), 61–66; Dr. Richard F. Kreutel, *Osmanische Geschichtsschreiber,* Band 3, Verlag Styria. Graz. Wien. Köln, p. v. b., 93–95; A. Olesinski, *Turski izvori,* 75–87; M. Guboglu-M. Mehmet, Cronici turceçti, 83; S. Pulaha, *Lufta shqiptaroturke,* 62–66.

[25] Gjerësisht, F. R. Unat – M. A. Köymen, *Kitâb-i cihan-nüma. Neçri tarihi, I. Cilt,* Ankara, 1949, 260–309; Behrnauer-Berlić, *Pripovijesti pisalaca turske povjesnice Nešria, Idrisa i Sadudina o bitci na Marici 1364. po porodu Hristovu – Berichte der osmanischen Geschichtschreiber Neçchri, Idris Bidlisi und Chodscha Sa'duddin über die Schlacht an der Marizza im J. 1364 n.* Chr., 4–89; A. Olesinski, Turski izvori, 79–82; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 74–90; G. Elezović, *Ogledalo sveta ili istorija Mehmeda Nešrije,* Beograd, 1957, 45–70.

[26] Gjerësisht, M. Guboglu-M. Mehmet, *Cronici turceçti,* 154–155; S. Trako, *Pretkosovski događaji i Hešt bihištu,* 170–202; S. Trako, Bitka na Kosovu 1389. godine u Istoriji Idrisa Bitlisija, *Prilozi za OF* (POF), XIV–XV, 1964– 65, Sarajevo, 1969 (Mëtutje, S. Trako, *Bitka na Kosovu),* 330–351; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 183.

[27] Shih, S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 125–140.

[28] *Po aty,* 244–245.

[29] Gjerësisht, M. Guboglu-M. Mehmet, *Cronici turceşti* 300–303; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 247–255; A. Olesnicki, *Turski izvori,* 86–89.

Mehmed ibni Mehmedi[30], Mustafë Ahmed – Alia *(1599)*[31], Solakzades *(para 1657)*[32], Evlija Çelebia *(1660), i cili në Kosovë, më 1389, i pa shtatë krala, d.m.th. shtatë kombësi: serbët, shqiptarët, rumunët, hungarezët, bullgarët, kroatët dhe boshnjakët*[33]. *Të dhëna të ngjashme ka lenë edhe selanikasi* Munexhib Basha *(para 1672)*[34] *etj.*

Dikush ka për të thënë se kronikët dhe historianët osmanë e ndoqën njëri tjetrin, se kanë përfillur dhe i kanë përshkruar të dhënat e paraardhësve. Kjo është e saktë, por po aq e saktë është edhe e dhëna se çdo njëri solli diçka të re, njohuri të reja, për Betejën e Kosovës. Së fundi, në këtë stil vepruan edhe kronikët dhe historianët evropianë të kësaj periudhe, të Humanizmit dhe të Renesansës.

Shqiptarët nuk është e mundur të mos shihen në koalicionin e të krishterëve nën Lazarin edhe në informacionin e rusit Ignjati *(korrik 1389), në ato të monahut të* Sen Denisit *(1395), në korespondecën midis* Tvrtkos *dhe komunës së* Firontinës *e gjetkë*[35]. *Pjesëmarrja e shqiptarëve në koalicionin e të krishterëve përmendet edhe te* anonimi i Zorasë[36], *por kjo shihet edhe nga konstatimet e* M. K. Ostrovicës *(1491)*[37]. *Në kronikën e* Gjon *dhe* Konstatin Muzakës *(1510) në mënyrë decidive është konstatuar se me Lazarin në fushëbetejë u masakruan* Theodori II Muzaka, *qeveritar i Shqipërisë së Mesme e Jugore, me dhjetëra bujarë shqiptarë nga viset e tjera*[38].

Shqiptarët duhet të shihen edhe në dardanët dhe maqedonët e priftit janjevaso-ulqinak, Martin Segonit, *përkatësisht te* Petançiqi *(1522) dhe* Kuripeshiqi *(1530)*[39], *mandej në kronikën osmane të botuar në gjuhën gjermane qysh më 1550*[40]. *Gjithashtu shqiptarët duhet të indentifikohen me ilirët, tribalët, dardanët e maqedonët të cilët përbënin forca të caktuara në koalicionin e të krishterëve, të përmendur nga shumë veprimtarë shqiptarë e dalmatinë latinistë, e italianistë humanistë nga shekulli XV–XVII, sepse ata shqiptarët akoma i quanin me emra të vjetër krahinor ose etnik të*

[30] M. Guboglu-M. Mehmet, *Cronici tirceşti,* 399–400.

[31] Gjerësisht, M. Guboglu-M. Mehmet, *Cronici turceşti,* 338–339; A. Olesnicki, Turski izvori, 92–95; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 274–279.

[32] Gjerësisht, A. Olesnicki, *Turski izvori,* 95; S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 294–297.

[33] Gjerësisht, *Putopis,* Sarajevo, 1973, 269–282.

[34] S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke,* 312–313.

[35] Gjerësisht, Č. Mijatović, Boj na Kosovu po Kronici kaludjera San-Deniskog, *Spomenik SKA X,* Beograd, 1891, 13–18; J. Mišković, *Kosovska bitka 15. juna 1389. godine,* Beograd, 1933; S. M. Ćirković, *Srednjovekovna srpska država (Izabrani izvori),* Beograd, 1959; S. Novaković, *Turci i Srbi XIV i XV veka,* Beograd, 1960.

[36] Richard F. Kreutel, *Leben und taten der Türkischen maiser,* Graz-Wien-Këln, p. v. b. 28–29.

[37] Gjerësisht, Renate Lachman, *Memoiren eines janitscheren oder Türkische chronik,* Graz-Wien-Këln, p. v. b., 24–82; M. K. Ostrovica, *Turska hronika janičara,* Banjaluka, p. v. b., 7–53.

[38] Gjerësisht te Ch. Hopf, *Chroniques Gréco-romanes(...),* Berlin, 1973, 305–314.

[39] Gjerësisht, Felice Petantio, *De itineribus in Turciam Libellus,* M. D. XXII; D. Kniewald, Feliks Petančić 1502 o putevima kojima valja napasti Turke, *Vesnik Vojnog muzeja,* Beograd, 1958, 25–53; Benedict Curipeschitz, *Itinerarium der Botschaftsreise des Josef von Lamberg und Niclas Jurischitz durch Bosnien, Serbien, Bulgarien nach Konstantinopol 1530,* Insbruck, 1910, 42–53; B. Kuripešoć, *Putopis kroz Bosnu, Srbiju, Bugarsku i Rumeliju 1530,* Sarajevo, 1950, 15–33.

[40] Shih, *Türckischer nation von Türcken ssebs beschrieben. Girabi Tevarichi, Chronic oder Zaitbuch der Försten Osmonischen Stammens(...) 1555,* Franckfurt, 1595, 9–10.

albanofonëve[41]*. Fjala është për shqiptarët e Dardanisë antike dhe Maqedonisë antike dhe të viseve të Shqipërisë së Mesme deri në Adriatik*[42].

Së këndejmi, e arsyeshme është që shqiptarët të shihen në koalicionin e Lazarit dhe pikërisht në »koalicionin e të gjithë njerzëve« *të Kosovës dhe të viseve përreth* »të aftë për armë«, *e që i përmend humanisti me prejardhje shqiptare* Petar Lukari[43] *dhe historiani dubrovnikas, humanisti* Mavro Orbini[44]*. Gjithashtu shqiptarët duhet të shihen në koalicionin e romejëve (bizantinëve) të* Dimitrije Kidonit[45], Halkondilit, Dukes[46], mandej në koalicionin e të krishterëve sipas *Francesco Sansovinit* (1571)[47], *Joan Cuspinianit* (1673)[48].

Historiani anglez nga fillimi i shek. XVII, *Richard Knolles (1610), i liruar nga frazeologjia e një humanisti, në mënyrë decidive ka thenë se, krahas të tjerëve, në Kosovë në koalicionin e Lazarit, pati edhe princa nga Shqipëria*[49]*. Së fundi, historiografia e përgjithshme moderne në shqiptarët ka parë aleatët e rëndësishëm të cilët patën ndikim të madh në tërë rrjedhën e përgatitjes dhe në vet epilogun e luftës. Shqiptarët në Kosovë e ndajtën fatin me serbët e tubuar rreth Lazarit, kurse historikisht dihet se strategët të cilët komanduan me njësitë nga Rashka, Bosna dhe Kroacia shpëtuan duke mos u lëshuar në betejë, duke ikur nga fushëbeteja ose duke tradhëtuar*[50]*. Sipas historianit frëng nga fillimi i shekullit XIX,* M. H. Lemaire *(Lëmer, 1821), në koalicionin e të krishterëve nën udhëheqjen e Lazarit pati njësi hungareze, rumune, dalmatine, tribale dhe njësi* »të shqiptarëve të panënshtruar nga

[41] Gjerësisht, Marinus Beciccemus Scodrenis, *Panygericus,* Brixia, MDIV, fol. CIII; M: Barletius, *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis,* Romae, p. v. b.; M. Barletius, *De Obsidione Scodrensi, ad serenissimum Leonardum*(...), Venetiae, 1504; L. C. Tuberonis, *De Turcarum origine, moribus, rebus geflis Comentarius,* Patauinium, 1590; M. Orbini, *II regno de gli Slavi(...),* Pesaro, 1601; G. P. Lucari, *Ristreto de gli annali di Rausa,* Venetia, 1604.

[42] Gjerësisht si nën shënimin 41; Shih, F. Petantio, *De itineribus in Turciam,* Petro Bogdano Macadone, *Cuneus Prophetarum de Christo salvatore mund(...),* Patavii, M.DC.LXXXV; Dh. S. Shteriqi, Nga e ka prejardhjen kopja e vetme që njihet prej librit të Buzukut, *Mbi Barletin dhe shkrime të tjera,* Tiranë, 1979, 139.

[43] G. P. Luccari, *Ritretto de gli annali di Rausa,* 67–69.

[44] Gjerësisht, M. Orbini, *Istoriografija počatija imena slavi i razširenja naroda slavjanskoga,* Sanktpiterburg, 1722, 248–261; M. Orbini, *II regno de gli slavi hoggi corrottamente detti Schiavoni(...),* Pesaro, 1601, 243–318.

[45] Shih, S. Ćirković, Dimitrije Kidon o Kosovskom boju, *Zbornik RVI,* 1–2, Beograd, 1971; Istorija srpskog naroda, Beograd, 1982, 44; R. Mihaljčić, *Lazar Hrebeljanović,* 120.

[46] Leonici Chalcondylae Atheniensis, *De origine et rebus gestis Turcorum, Libri Decem(...),* Basieae per 10 AN nem Oporinum, 1556; L. Ch. Atheniensis, *Historiarum Libri X Interprete Conrado Clausero Tigenino Cum Annalibus Sultanorum(...),* Parisiis, M. DC. L.; *L'Histoire de La decadence de 'empire Grec'et establissement de celvy des Turcs; Comprise en dix liures, par Nikolas Chalcondyle,* Athenien, A Paris, M. D. LXXVII.

Kronikën e Johan Mihail Dukës nuk e kam pasur në duar. Pjesërisht më është e njohur nga veprat mbi Betejën e Kosovës.

[47] M. Francesco Sansouino, *Gl'Annali overo le vite de'principi et signori della sasa Othomana(...),* In Venetia, MDLXX, 13–15.

[48] Joanne Cuspiniano, *De Turcorum origine, Religione, ac immaniffima corm in Christanos tyranide,* Lugduni Batavorum ex officina Joanis Maire, 1673, 53–54.

[49] Richard Knolles, *Generall Historie of the Turkes(...),* Oxford, 1610, 198–201.

[50] Për këtë ka të dhënë te të gjithë humanistët dubrovnikas të shekujve XVI–XVII, dhe në traditën popullore, por edhe në shumë dokumente të proveniencës kishtare serbe të shekullit XV–XVIII. Për këtë flasin edhe shumë vepra historiografike.

turqit« *(et de ceux d'entre les Albanais qui n'avaient pas été subjugués), kurse Muratin I e vrau* »një shqiptar i plagosur« *(un Albanais blessé)*[51].

Shqiptarët si aleatë të Lazarit i pa dhe atyre u kushtoi kujdes të merituar historiani famëmadh Joseph von Hammer *(1827). Sipas tij mu strategu ushtarak i krishterë Joka, përkatësisht Jorgji në kronikat osmane ishte shqiptari* Gjon *(Ivan)* Kastrioti, *dhe si kishte propozuar që osmanët të sulmoheshin ditën e jo natën, siç kishte planifikuar Lazari*[52]. *Francezi romantik bashkëkohës i Hammerit.* A. de Lamartin *e përpunoi akoma atë tezë dhe sipas tij në Betejën e Kosovës ishin shqiptarët (nga Veriu) dhe epirotët (nga Jugu), që do të thotë gegët dhe toskët. Lamartini vënte në spikamë se ushtria e të krishterëve ishte* »logoruar në shkrepat e maleve të Shqipërisë« *(sur les escarpements des montagnes d l'Albanie)*[53].

Të dhëna identike kanë sjellur edhe historianët e kohës së Lamartinit, Th. Lavallés *dhe* Th. D'Oksza[54]. A. F. Gilferding *ka konstatuar se shqiptarët në Kosovë i ka udhëhëqur* Ivan Kastrioti[55], *tezë kjo të cilën para tij e vuri në spikamë njohësi i mirë i kulturës dhe historisë shqiptare,* Hahn[56].

Mendoj se shqiptarët në Betejen e Kosovës duhet parë edhe midis »të krishterëve« *dhe* »serbëve« *në shkrimet, gjenealogjitë dhe në anuaret serbe të shekullit XIV–XVIII*[57], *sepse është fakt i pranuar se jo vetëm veprimtarët e kishës serbe por edhe veprimtarët e kishave të tjera, shqiptarët e besimit ortodoks të provenices serbe, sikurse edhe vllehët dhe të tjerët që i përkisnin këtij besimi, përkatësisht kishëje, u trajtuan për serbë*[58].

Mirëpo, duhet të vihet në pah se themeluesit e shkollës serbe antropogjeografike dhe të historiografisë moderne serbe në shekullin XIX, drejtpërdrejt

[51] *Histoire de L'empire de Turquie, depuis son origine jusqu'au 19 octobre 1821(...),* Par M. H. Lemaire, A Paris, 1821, 108, 109.

[52] J. v. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches,* 200–220; J. v. Hammer, *Historija turskog (osmanskog) carstva,* 1, Zagreb, 1979, 72–76.

[53] A. de Lamartine, *Histoire de la Turquie,* Vol. I, 154–168; Volume II, Paris, 1854, 126.

[54] Théophile Lavallés, *Histoire de la Turquie,* I, Leipzig, 1859, 212–213; Th. D'Cksza, *Histoire de l'empire ottoman(...), Constantinople, 1871.*

[55] *Aleksandar Gilferding,* Putovanje po Hercegovini, Bosni i Staroj Srbiji, Sarajevo, *1972, 216–218.*

[56] *Irbi-Maekenzi,* Putovanje po slovenskim zemljama Turske u Evropi, *Beograd, 1868, 153.*

[57] *Krahaso, S. Novaković,* Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka, *Beograd, 1912; Lj. Stojanović,* Stari srpski rodoslovi i letopisi, *Beograd–Sr. Karlovci, 1927; P. J. Šafarik,* Pamâtky drevniho pisemnictvi Jihoslavanuv, *Dil Predchozi(...), V Praze, 1851; P. J. Šafarik's,* Geschichte des Serbischen schriftthums, aus dessen handschriftlichen nachlasse(...) III, *Prag, 1865.*

[58] *Gjerësisht,* Onomastika e Kosovës. Simpozium i mbajtur më 25–27 shkurt 1977, *Prishtinë, 1979;* Reforma protestane dhe katolike. Kisha dhe historia e saj, *VII, Ferizaj–Zagreb, 1982.*

»Rol të rëndësishëm në jetën kulturore-politike të popullit serb pati kisha ortodokse serbe (...). Ajo me të vërtetë vepron qysh nga vitet e para të pushtetit turk(...). Kisha autokefale pravosllave serbe qysh në kohën e nemanidasve, siç kemi parë, ka pasur rëndësi dhe veti serbe. Ajo në kohën turke u zhvillua akoma në atë drejtim. Vepron në shumë mënyra(...). Në Mbretërinë Turke, si shtet shprehimisht fetar, feve të pranuara jomuslimane iu dhanë ingerenca mbi besimtarët e tyre jo vetëm të rëndësisë kulturor-fetar, por edhe politik. Ato lloje të privilegjave i kishte edhe Patrijarshija e Pejës nga viti 1557–1767« (Vasa Čubrilović, Osnovi preporoda Hrvata i Srba, JIČ, *1–4, Beograd, 1986, 60–61).*

ose tërthorazi kanë pranuar praninë e shqiptarëve pranë Lazarit në Kosovë, në qershor të vitit 1389. Shembulli vjen, D. K. Jovanoviq *pranonte se shqiptarët në Betejen e Kosovës i ka udhëhequr* Theodori II Muzaka *dhe* Gjergji II Balsha[59], *kurse identik me këtë vërtetonte edhe njohësi më i mirë i Betejës së Kosovës nga shekulli XIX,* J. Mishkoviq. *Ai nënvizonte se Balshaj ishte në Kosovë dhe se* »me dokumente autentike ndryshe nuk mund të thuhet«[60].

Për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës kanë shkruar edhe dhjetëra hulumtues nga vendet e ndryshme të Evropës aty nga fundi i shekullit XIX dhe gjatë shekullit tonë, sikur që janë: G. F. Hertsberg[61], Len-Pul[62], G. Gopçeviq[63], Nikola Jorga[64], Mis E. Durham[65], *e të tjerë. Mirëpo, bashkëkohësi i tyre, përfaqësuesi i shkollës antropogjeografike serbe,* Nika Zhupaniq *nuk pranonte pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës, por atë mendim të vetin, duke mos pasur dije se ç'po bënte, e hodhi vet, sepse sipas tij në Kosovë pranë Lazarit ishte* Gjergji II Strazimir Balsha[66]. *Duhet të vihet në spikamë edhe fakti se aty ku përmendet* Milosh Nikollë Kopiliqi – Obiliqi, *si pjesëmarrës në Betajën e Kosovës, duhet të shihen edhe shqiptarët vendës të Kosovës si pjesëmarrës në atë »katastrofë«.*

Pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës e pranon edhe historiografia moderne turke. Kjo mirë mund të shihet me tezat dhe konstatimet në veprat e gjeneralit *Xhevat Begu*[67], të *Jusuf Fehmisë*[68], të *Sylejman Kylçes*[69], të *Mustafë Gdaga-së*[70], të *Haki Uzunçarshilisë*[71] e të tjerëve. Këtë e pranon edhe historiografia shqiptare në kontinuitet nga periudha e Humanizmit dhe Renesansës, kurse si strateg shqiptarë në koalicion përmenden *Theodori II Muzaka, Gjergji II Strazimir Balsha, Dhimitër Jonima, Milosh Nikollë Kopiliqi* e të tjerë. Kjo dëshmohet edhe në veprat e *S. Frashërit*[72] e të *N. D. Nikajt*[73], *A. Gegës*[74], *Historia e Shqipërisë*[75], në veprën e *S. Polo-*

[59] *D. K. Jovanović,* O Arbanasima. Istorijska studija, *Beograd, 1880, 11–20.*

[60] *Gjerësisht, J. Mišković,* Kosovska bitka (15. juna 1389. godine. Na Petstogodišnjem pomenu u beogradskoj oficirskoj kasini, 15. juna 1889. godine; *Djeneral Jov. Mišković,* Kosovska bitka 15. juna 1389. godine, *Beograd, 1933.*

[61] *Dr. G. F. Hertzberg,* Geschichte der Byzantiner und des Osmanischen Reiches, bis gegen Ende der Sechstchnten Jahrhunderts, *Berlin, 1883, 504–507.*

[62] *Stanlej Len Pul,* Istorija Turske carevine, *31–35.*

[63] *Spiridon Gopčević,* Gornja Arbanija i njena Liga, *N. Sad, 1893, fq. 16–19.*

[64] *N. Jorga,* Geschichte der Osmanischen Reiches, *262–263.*

[65] *M. Edith Durham,* Twenty years of Balkan tangle, 16; *M. E. Durham, The burden of the Balkans,* 38–39.

[66] Dr. Niko Županić, Altserbien und die Albanesische Frage, Wien, 1912, 14–19.

[67] Djevat Bey, *Etat militaire Ottoman depuis la fondation de l'empire jusqu'a nos jours (...).* Tradruit du turc par Georges Macridès 1882.

[68] Youssouf Fehmi, *Histoire de La Turquie,* Paris, 1909, 23–24.

[69] Süleyman Külçe, *Osmanli Tarihinde. Arnavutluk,* Izmir, 1944, 40–41.

[70] Dr. Mustafa Kdağ, *Türkiye' nin iktisadi ve içtimai Tarihi,* C. I. 1243–1453, Ankara, 1959, 254–255.

[71] Prof. Ismail Haki Uzunçarşili, *Osmanli Tarihi I,* Ankara, 1947, fq. 92–100.

[72] S. Frashëri, *Kamus'al-a'lam, VI,* Constantinople, 1898, 4523.

[73] Ndoc Don Nikaj, *Historia e Shqypniis,* Bruksel, 1902, 60–79.

[74] Athanas Gegaj, *L'Albanie et l' Invasion Turque au XV. siécle,* Paris 1937, 37.

[75] *Historia e Shqipërisë I,* Tiranë, 1965; Historia e popullit shqiptar I, *Prishtinë, 1969, 222.*

s – A. Putos[76] dhe në një sërë studimesh shkencore[77].

Mirëpo, këtu duhet të vihet në pah se derisa në një pjesë të trashëgimisë historiografike jugosllave të para Luftës se Dytë Botërore drejtpërdrejt ose tërthorazi pranohet pjesëmarrja e shqiptarëve në Betejën e Kosovës[78], historiografia bashkëkohore serbe dhe jugosllave ose e hedhë poshtë ose nuk përmend fare pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës. Eshtë shkuar aq larg sa që të quhen fantastike të dhënat nga kronikat osmane për këtë çështje[79], kurse tashti po trumbetohet me tezat antishkencore se në Kosovë në periudhën e Betejës së Kosovës – nuk ka pasur shqiptarë?![80]. Por, këtu duhet të vihet në spikamë edhe fakti se dija historiografike serbe dhe jugosllave kurrë nuk e ka hedhur poshtë ose as nuk e ka komentuar ndryshe konstatimin e *Filip Mezjerit* nga para tetorit të vitit 1389, se *Murati I »plotësisht u thye në viset e Shqipërisë«* (es parties d'Albanie)[81]. Dihet se Mezjer aso kohe ishte në tokat e Greqisë së sotme, përfaqësues diplomatik i Francës. Dija historiografike serbe e jugosllave nuk e hodhi poshtë as konstatimin e *Evlija Çelebiut* nga viti 1660, se *»banorët e këtij qyteti* (Vushtrrisë-M. P.) *janë popullsi rumeliote* (vendëse-M. P.), *ata nuk dinë të flasin boshnjakçe* (kroatoserbisht-M. P.), *porse flasin shqip dhe turqisht«*[82]. (Kjo e dhënë është me rëndësi për shkak se flet për qytetin i cili në një pjesë të historiografisë serbe e jugosllave trajtohet si qendër administrative e Brankoviqëve dhe e Lazareviqëve (shek. XIV– XVI, e ishte në afërsi të fushëbetejës).

Nuk është tepër të rikujtohet se kurrë nuk është hedhur posht as konstatimi i *Tomë Raspasarit* nga data 6 prill dhe 22 korrik 1690, kur shkroi sa vijon: *»Il Patriarca de Rasiani che stalla in Ipek locode Albanesi Climenti«*, gjegjësisht *»mandati dal Mahmut Pascia di Pechia in Albania«*[83].

Në anën tjetër, një pjesë e konsiderueshme e historiografisë bashkëko-

[76] *Stefanaq Pollo et Arben Puto,* Histoire de L'Albanie des origines a nos jours, *Lyon, 1974, 66.*

[77] *Thoma Murzaku, Lufta shqiptaro-osmane e shek. XV, luftë e popullsisë së të gjitha krahinave shqiptare,* Simpoziumi për Skënderbeun (9–12. V. 1968), *Prishtinë, 1969, 126; S. Pulaha,* Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV. Burime osmane, *Tiranë, 1968.*

[78] *Shih, St. Stanojević,* Narodna enciklopedija srpsko- hrvatsko-slovenačka II, I-M. *O boju na Kosovu (B. Belić), fq. 395; G. Elezović, Jedna arnautska varijanta o boju na Kosovu,* AASJE I; *1–2, 60–66; Veselin Čajkanović, Motivi prve arnautske pesme o boju na Kosovu,* AASJE I, *1–2/1923, 68–77; T. R. Djordjević, Beleške o našoj narodnoj poeziji. Gde su stanovali Miloš Obilić i Ljutica Bogdan,* Zbornik radova XIV, *Beograd, 1951; T. Maretić,* Naša narodna epika, *Beograd, 1966.*

[79] *»Plotësisht fantastike janë të dhënat turke të mëvonshme sipas të cilave knjaz Lazarit i kanë ndihmuar bullgarët, shqiptarët, vllehet, hungarezet, gjermanët dhe çeket«* (Istorija naroda Jugoslavije I, *Beograd, 1953, 418). Ky konstatim i pashije është sjellur edhe në veprën e Vojislav Gjuriqit,* Antologija narodnih junačkih pesama (Osmo izdanje), *Beograd, 1977, 35).*

[80] *Shih, Dimitrije Bogdanović,* Razgovori o Kosovu, *Beograd, 1986; D. Bogdanović, Pitanje Kosova – pitanje časti,* Student. *Specijalni broj, Beograd, 27. 4. 1989, 43–45.*

[81] *Shih te Š. Ljubić,* Listine IV, *269;* Istorija naroda Jugoslavije I, *Beograd 1953, 419; R. Mihaljčić,* Lazar Hrebeljanović. Istorija. Kult. Predanje, *226; »Dashti mëshira e Zotit të pengohet shpata e Muratit të thënë, këtij viti ai plotësisht u mposht në viset e Shqipërisë. Edhe ai edhe djali i tij rënë në betejë, sikurse edhe më trimat nga ushtria e tij«* (Enciklopedija Jugoslavije V, *Zagreb, MSMLXII, 336).*

[82] *Shih,* Putopis, *Sarajevo, 1973, 276.*

[83] *Shih, Mita Kostić, Prilozi istoriji srpsko-arbanaškog ustanka 1689–1690. godine,* Arhiv za arbanašku starinu, jezik i etnografiju II *(1924), Beograd, 1925, 19–20.*

hore botërore shqiptarët gjithnjë i sheh aleatë të Lazarit. Kjo mund të shihet nga historiografia angleze[84], gjermane[85] dhe italiane[86]. Edhe historianët shqiptarë nga Kosove, gjithashtu, shqiptarët i shohin pjesëmarrës në Betejën e Kosovës dhe aleatë të Lazarit. Kjo mund të shihet nga punimet e *S. Rizës*[87], *S. Brestovcit*[88], *J. Drançollit*[89], *I. Rexhës*[90], *T. Abdylit*[91], *M. Pirrakut*[92]. Pjesëmarrja e shqiptarëve në këtë ngjarje reflektohet edhe në shumë punime folkloristike- etnografike, si te *Sh. Pllana*[93], *A. Çetta*[94], *L. Nosi*[95], *Gj. Shehu*[96] etj.

Për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës si bashkëluftëtarët më të sigurtë dhe më të sinqertë të Lazarit flet me mburrje tradita dhe këngët popullore serbe të mbledhura në kohën e Rilindjes Kombëtare Serbe, aty nga fundi i shekullit XVIII dhe gjatë shekullit XIX. Sipas një variante të këngës popullore serbe për Betejën e Kosovës, princ Lazari me shkrim i thirri bujarët dhe sundimtarët shqiptarë, të vinin në fushëbetejë për t'u marrë vesh me osmanllin definitivisht. Kështu, sipas këngës popullore serbe, Lazari *Librin e katër* (thirrjen) ia dërgoi *»Vendit Shqipëri / Në dorë Musë Shqiptarit«*, kurse me Librin e tetë e thirri *Ban Strahinjën* (Gjergjin II Strazimir Balshën). Në këngë thuhet: *»Porsa ushtrinë tabor e bëri / Qe ia behu Musë Shqiptari / Ai u prinë gjashtëmijë ushtarëve / Të gjithë kreshnikë, shqiptarë të idhtë«*[97].

Në një variant tjetër Lazari sundimtarin e Shkodrës e ftoi me *Librin*

[84] *Herbert Adams Gibbons,* The foundation of the Ottoman empire a history of the Osmanlis up to the death of Bayezid I 1300–1403, *Frank Cass Co. LDT, 1968, 168–178.*

[85] *Géorg Schreiber,* Sipahi. 400 Jahre Türkenzeit in Europa, *Tyrolia-Verlag, Innsbruck, Wien, München, 1975, 9.*

[86] *Arduino Cremonesi, La sfida turca contro gli Asburgo e Venezia, Arti Grafiche Friulane-Udine, 1976, 18–20.*

[87] *Disa të dhëna antroponimike e toponimike mbi popullsinë e Kosovës në shekujt XIV–XV në dritën e burimeve osmane,* Onomastika e Kosovës, *e cit., 156–157;* Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII. Administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore, *Prishtinë, 1982, fq. 16–19.*

[88] Marrëdhëniet shqiptare-serbo-malazeze (1830–1878), *Prishtinë, 1983, 13.*

[89] Raguzanët në Kosovë (Prej fundit të shekullit XIII deri nëvitin 1455), *Prishtinë, 1986, 18–22; Kosova më 1448 sipas kronikave dhe historive të moçme të Raguzës,* Kosova 17, *Prishtinë, 1988, 256.*

[90] Beteja e Kosovës në kronika-burime osmane të shekujve XV-XVI, *Gjurmime albanologjike SSGH,* 19–1989, Prishtinë, 1990. Punim i lexuar në sesionin shkencor në Prishtinë, më 19 maj 1989.

[91] Injektimi politik nacional serb i mitit të Kosovës, *Përparimi,* 3, Prishtinë, 1989. Punim i lexuar në sesionin shkencor, Prishtinë, 19 maj 1989.

[92] *Rjesëmarrja e shqiptarëve dhe roli i Milosh Nikollë Kopiliqit në Betejën e Kosovës.* Vepër monografike në dorëshkrim. E cituar; Ndihmesë për hartën arkeologjike të pjesës qëndrore të Kosovës, *Onomastika e Kosovës,* Prishtinë, 1979, 476–477, 526.

[93] Epika popullore shqiptare mbi Luftën e Kosovës (1389), *Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj.* Prishtinë, 2, 1976, 112–126.

[94] Edhe një motërzim i kangës popullore shqiptare mbi Luftën e Kosovës, *Gjurmime albanologjike 1,* Prishtinë, 1962, 263–275.

[95] Kânga e Luftës së Kosovës në vjetin 1389, *Kopshti letrar,* 2, Elbasan, 1918 *(Visaret e Kombit I,* Tiranë, 1937, 5–18).

[96] Disa të dhëna frënge mbi shqiptarët (shek. XIII–XVI), *Vjetari i Arkivit të Kosovës,* X–XI, Prishtinë, 1979, 290.

[97] »Tamam vojsku tabor učiniše, / Dok eto ti Muse Arbanasa / I on vodi šest hiljade vojske, / Sve junake, ljutog Arnauta« (Boj na Kosovu. *Srpska narodna pjesmarica u 8 pjesme.* Sarajevo, s. a., 13).

e tretë – »Personalisht kreshnikut Musë Shqiptarit«, kurse me *Librin e pestë »drejtë në Dukagjin / Në Prizren Lekë Kapedanit«.* Dhe, sipas këngës, kur Lazari arriti në Samadrexhë të Kosovës, aty e priti *Lekë Kapedani »që ësthë trim i njohur n'duele«,* kurse pranë e kishte edhe *»Musë Shkodrenin / qe i tuten turqit dhe latinët / E vise të tëra ka nënshtruar«*[98]. Një variant e këngës serbe për Betejën e Kosovës flet se Lazarit i kishin mbetur besnikë vetëm shqiptarët dhe trimat nga Kosova dhe viset përreth me *Musë Shqiptarin* e njësinë e tij përcjellëse: *»Dhe sulmoi Musë Shqiptari (Ai është xhaxha i Stefan Musiqit) /, Si u vërsul në Betejë të Kosovës / Me turqit nisi të pritet tmerrisht / Dhe me Te shqiptarët e idhtë / Shqiptarët njëmijë trima / Të gjithë kreshnik sikur zjarr i gjallë / Me turqit priteshin e vriteshin / Të gjithë në betejë trimërisht ranë«*[99].

Në variantët më të shumta të këngës popullore serbe për Betejën e Kosovës nuk është lënë në heshtje as vrasësi i Muratit I, *Milosh Vojvoda,* i cili Lazarit ia tërhoqi vërejtjen se *»Unë do ta dërgoj një trim / Vllamin Ivan Kosovçiqin / I cili çdo gjë më ka mësuar, / Nepër Fushën e gjerë t'Kosovës / Shqiptarëve tua qoj selamin / T'u tregojë dhe t'i thrretë / Le ta vështrojë ushtrinë e Muratit«*[100].

Këtu nuk është tepër të vihet në spikamë se krahas *Miloshit, Ivan Kosovçiqit* legjendar dhe *Milan Toplicës,* tradita serbe për viset e Dardanisë antike i lidh edhe të gjitha personalitetet e rëndësishme të cilat i përmend tradita serbe: *Jug Bogdanin, Stefan Musiqin, Vojnoviqët, Ognjen Rudnikun, Shain Vojvodën* dhe të *nëntë Jugoviqët* e paekzistueshem fare[101]. Realisht,

[98] ». . . Musa Skadranina, / Što ga s'boje Turci i Latini, / E krajine butun uzaptio« *(Boj na Kosovu na Vidovdan ili propast srpskog carstva godine 1389., Beograd,* s. a. 30, 67).

[99] »Pa udari Musa Arbanasa (To j'amidža Musića Stefana). Kako u boj na Kosovu pade, / S Turcima se ljuto tući stade, / I sa njima ljuti Arbanasi, / Arbanasa hiljadu momaka, / Sve junake kako vatre žive, / S Turcima se tukoše i biše, / Svi u boju ljutom izgiboše« *(Boj na Kosovu godine 1389. godine u narodnim pesmama,* Beograd 1889, 93.

[100] »Ja ću svog opravit' jednoga, / Pobratima Kosovčić Ivana / Koji mi se svačem naučio, / Po Kosovu polju širokome, / Arnautim' selam nazivati, / Nazivati i odazivati, / Nek uhodi Muratovu vojsku« *(Boj na Kosovu. Srpske narodne pesme,* Beograd, 1928, 7. Vargjet shqip i kam dhënë në shqipërim të lirë, vetëm si burime historiografike dhe jo si vlera artistike).

– Neko se negdje na nekoj pošti zdušno pobrinuo da poziv dobijem dan nakon oddržane svečanosti. Inače, veoma rado bih vam se pridružio i u Ljubljani i u Prištini, ili bilo gdje, zapravo svuda tamo, gdje se bije bitka za ravnopravnost i dostojanstvo meni zaista bratskog albanskog naroda i na Kosovu i u NR Albaniji.

Titograd, 24. 8. 1990.

Intervistën e bëri Dr. Resmije Kr'veziu

Violence, Terror and Deceits, an interview with Jevrem Brkovic, by Dr. Remsije Krieziu

Jevrem Brkovic, poet and writer, author of some forty books and lately a lively polemicist, had stood up against the nationalistic and expansionistic Serbian appetites already as President of the Association of Writers of Montenegro. He was the first to accuse, in a political essay in 1987, Slobodan Miloshevic of nationalistic plans to split Yugoslavia, as well as the first Montenegrin intelectual that publicly opposed the attempts to rob Montenegro of its federative rights and turn it into a Serbian province (pointing out that one should not forget the fact that Montenegro used to be one of the oldest independent states in the Balkans and the 27th in the world to be recognized as such). Here are some of his typical judgements as expressed in the interview given to the Alternativa.

– The former leaders of the Socialist Republic of Montenegro had made some rather reasonable and honorable statements concerning Kosovo and the Albanians before they were overthrown in the putsch by the Serbian nationalists. These statements did not irritate the Serbian people but they annoyed Miloshevic and his nationalistic camarilla. One of the reasons the former Montenegrin leadership was overthrown in such an infamous way and removed also from the federal institutions, were its »antiserbian« views. History will never forgive the members of this leadership their weakness but also the federal state of Yugoslavia is guilty to have allowed the fall of Montenegro as well as it allowed the terror in Kosovo to have taken place. We must understand that since the rise of Miloshevic to the leading position in Serbia, Yugoslavia, such as it was created after the last war, does not exist any more. The Albanians, on the other hand, must understand, that the Montenegrin people are hardly in any better situation.

– Such a general chaos as we are experiencing in this country, would not have been made possible if some Yugoslav politicians, as well as the former federal institutions, had not been acting so unintelligently and for such a long period in such a typical Chamberlainian fashion, bargaining with Miloshevic for the destiny of the Albanians in Kosovo, not knowing that also their destiny is at stake; if they had not been turning away their heads from the sight of the suffering of Kosovo, the dead, the wounded and absolutely humiliated people, completely deprived of their rights; if they had not allowed the myth of Kosovo to be abused.

– The nationalistic Serbian hegemonism is older than the State of Yugoslavia itself; it is a child born with the help of two midwives, namely Russia and France or rather the Russian orthodox fundamentalism and the French obsessive wish to assert their interests in the Balkans through Serbia. He who does not want to understand that the Albanians in Kosovo and the State of Albania are a real historical and biological fact, will burden his descendants with much more serious issues than the actual problems of Kosovo.

– It is a known fact that Montenegro has braved the Turkish, Austrian, Serbian and German occupations, always succeeding to reestablish its sovereignty; to anchor its fleet on its seas and its roots in its rocky land! Let us be explicit: we are witnessing another process of Serbian occupation! NO PASARA! The final aim of the actual Serbian agressor is also this time the Montenegrin Sea.

– Everything that has been recently born in Europe, is atrophied and degenerated in our country. Here, i.e. in the so-called Eastern Yugoslavia, we are witnessing a trend of running away from Europe, breaking away from it and bowing to the Russian Orthodox mysticism, used of course to realize the expansionist and nationalistic intentions.

– The way Serbia is acting in Kosovo promises no good; on the contrary, we see there the first sparks of a civil war which, it seems, would be wellcome by Miloshevic who must mask his failures, bluffs and obvious unsuccessful manoeuvres.

– If there happens to be a civil war in Yugoslavia, the European and the world opinion will not find Miloshevic guilty, nor the Serbian neobolshevism; the real culprits will be the writers Dobrica Cosic and Antonijo Isakovic, as well as the philosophers Mihailo Markovic and Ljubomir Tadic who volunteered to pull the Miloshevic's squeaking wagon of violence, but not only in Kosovo.

Do te më mposhtë vetëm vdekja

Shkruar nga Bujar Shtepani

Vitet shtatëdhjeta do të merren me rëndësi për kombin shqiptar, ishte koha kur historisë shqiptare do t'i shtoheshin ngjarje të mëdha që do të trondisin Evropën, si edhe figura njerëzish të shquar.

Kësaj plejade njerëzish të shquar i përkete edhe HASAN PRISHTINA i cili me veprimtarinë e vet atdhetare do t'shkelqente në mesin e luftëtarëve bashkëkohës.

HASAN PRISHTINA, u lind në Vuçiternë më 1873. Deri më 1906 njihej me mbiemrin Polaci, ndërsa pas atij viti, me që zgjidhet i Prishtinës vazhdoi të njihej si edhe sot me mbiemrin Prishtina e nganjëherë Vuçiterna. Origjina e familjes së tij ishte nga katundi Polac i Drenicës. Ai nuk qe bir feudali, pashai apo bajraktari, se nuk do të merrej kurrë me çështje pasurie por vetëm me çështjen e nderuar të Atdheut. Edhe atë pasuri që e trashëgoi kohë më pas e shpuri për të blerë armë për Kryengritjen e vitit 1912, për shkollat shqipe që hapi e të tjera.

Ai u lind, u edukua, u burrërua në një periudhë kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare kishte marrë përmasa shumë të gjëra dhe vendlindja e tij ishte një nga qendrat më kryesore të luftës për çlirim kombëtar. Luftërat e mëdha në kohën e LIDHJES SHQIPTARE të PRIZRENIT (1878) kundër vendimeve për coptimin e SHQIPËRISË, LIDHJA E PEJËS e të tjera, i ngjallën deshirën për të luftuar me armë në dorë, për të qenë pjestar i kuvendeve të mëdha të popullit ku vendosej për fatin e vendit. Shkollimin e parë e kreu në vendlindje, i ati duke parë zgjuarsinë e tij e dërgoi në Selanik në një gjimnaz ku mësoi frangjishten dhe kreu arsimin e mesëm.

Më pas Hasani shkoi në Stamboll të studjojë në fakultetin e drejtësisë-degën e doktrinave politiko- administrative. I paisur me një kulturë të gjërë Hasan Prishtina do të jepet menjëherë pas politikës bashkëkohore.

Pasioni për tu marrë me politikë dhe me lëvizjen kombëtare për çlirim burojnë prej lëvizjes së hershme të tij. Admironte Revolucionin Borgjez Francez të vitit 1789, admironte idetë e iluministëve dhe Rilindasve tanë të cilat i bëri për vete. Ideologjia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare vulosi shumë tipare, qellime të jetës e të karakterit të Hasan Prishtinës.

Temperamenti i gjallë do të shfaqej më parë edhe në veprimtarinë politike dhe atdhetare të tij. Kur ishte fjala për Atdheun ai nuk e përmbante vetën dhe s'i dilte njeri përpara.

Ishte i guximshëm, i pastër në shpirt, i brumosur me ndjenjën e lartë të drejtësisë, armik i hipokrizisë. Ende i ri në moshë Hasan Prishtina u fut shpejtë në radhën e luftëtarëve të revolucionit kombëtar. Ndonëse mbaroi shkëlqyeshëm fakultetin ai do të vazhdonte propagandimin e luftës për çlirim në të gjitha mjediset, sidomos në gjirin e rinisë.

Hasani do të shkruante artikuj në gazetat shqiptare të kohës, shkonte në klubet dhe shoqëritë patriotike dhe kontribonte gjallërisht për çështjen shqiptare.

Shtëpia e tij në Shkup ishte kthyer në një vatër të vërtetë të rinisë shqiptare dhe lëvizjes kombëtare. Shumë shpejt Hasan Prishtina u bë i njohur në skenën e politikës shqiptare të kohës. Ngjarjet e vitit 1908 dhe

kryengritja që shpërtheu në KOSOVE, deshmon për rolin e madh te Hasan Prishtinës në të.

Vendosja e kushtetutës bëri që në parlamentin osman të shkonin 25 deputetë shqiptarë, midis tyre ishte edhe Hasan PRISHTINA.

Ai shquhej për eloforencën e fjalës, forcën e mendimit, qartësinë e argumentimit e mbi të gjitha për guximin e rrallë.



(Fjalimi i Hasan Prishtinës në parlament)

»Lirisht në vendin tonë shpërdorimi i pushtetit
është bërë një gjë e zakonshme.
Prandaj kësaj detyre sado e vështirë qoftë,
do t'i kushtojmë vëmendjen e duhur.
Zotrinjë! Unë ngul këmbë dhe e përsëris se shumica
ka hyrë në një rrugë pa krye.
Dhe për të vërtetuar këtë po ju kujtoj se
ajo që e futi jetën politike t'shtetit në ngatrresa
dhe i shkaktoi dëme, mjerime të padrejtshme
ka qenë pushteti ekzekutiv që mbështetet në
partinë »BASHKIM E PËRPARIM«,

ajo që u bë shkaktare e një varg ngjarjesh si ato që shpërthyen në Tripoli, në Shqipërinë Çerepe e në Romë, Siri e tjera. Para këtyre fakteve kuptimplote nuk besoj që populli do të zgjedhë përsëri deputet të partisë »Bashkim e përparim«.

Veç kësaj kam bindje se megjithë që sot në partinë »Bashkim e përparim« ka nga pesë ose dhjetë deputetë. Në zgjedhjet e ardhshme dhe këtë mund të them me siguri, nuk do të ketë asnjë deputet shqiptar ose arab në radhët e tyre. Megjithqë as që shpresoj se do të mblidhet prapë dhoma e deputetve«.

(Fjala e deputetit turk)

E ç'del sikur mos të mblidhet zoti Hasan?

»Del se në këtë rast vendi do të hidhet në kryengritje dhe do të shpërthejë revolucioni. Dhe një ndër të parët, që do të marrë në dorë flamurin e revolucionit, ndoshta i pari ndër të parët, do të jem edhe unë«.

Personaliteti i fuqishëm i Hasan Prishtinës, bëri që rreth tij të krijojë një grup deputetësh, shqiptarë e të tjerë që formuan opozitën liberale që ishte kundërshtare e regjimit të xhonturqve. Në këtë kohë Hasani ishte edhe një luftëtar i palodhur për gjuhën dhe shkollën shqipe. Ai e çmonte këtë së tepërmi, se prej tyre varej zgjimi i ndërgjegjes kombëtare. Prandaj ai i urrente përqarjet krahinore, fetare, vëllavrasjet të cilat i kishte mbjellë tek populli ynë, armiku me ideologjinë e tij.

(Fjalët e Hasan Prishtinës)

»Unë s'kam menduar kurrë Gegë e Toskë, e as s'do të mendojë. Në sytë e mi çka janë gegët po ata janë toskët«.

Në vitin 1908 Hasani punoi për mbledhjen e atdhetarëve në Kongresin e Manastirit, si dhe propagandoi rëndësinë e përcaktimit të gjuhës shqipe. Ja ç'shkruan gazeta e Manastirit »Bashkimi i Kombit«, më 22 tetor 1909. »Zemra e tij qenka e përvëluar për kombin e vet dhe do ndihmuar atë në dituri dhe çdo gjë tjetër.

Gjithë kohën që ishte në Kosovë, i shtyrë nga dashuria për të mirën e vëllezërve të tij, në të shumtën e kohës e përdori duke udhtuar nëpër qytete dhe fshatra. Duke mbjellë farën e diturisë kombëtare në mes të vëllezërve të tij, ai hapi një shkollë në Moravë, një shkollë tjetër në Gjilan dhe një tjetër në Pozharan. Përveç këtyre ka gjetur pesë djem të varfër nga ato vise të cilët do t'i dërgojë në shkollën e ELBASANIT.

Hasan Prishtina kërkonte në parlament përdorimin e shkronjave latine për alfabetin e gjuhës shqipe. Vetë ky atdhetar i shquar dha për çdo muaj të ardhura për lulëzimin e shkollës shqipe. Zhvillimin e arsimit shqip, Hasan Prishtina e shihte të pa ndarë nga zhvillimi i kulturës kombëtare.

Atdhetari demokrat Hasan Prishtina, zhvillimin e arsimit kombëtar e ndante nga lufta me armë për çlirimin kombëtar. Kjo bindje e thellë gjeti shprehje në gjithë veprimtarinë politiko-atdhetare të tij. Si njeri, Hasan Prishtina nuk i ndanë fjalët nga veprat, mendimin nga aksioni. Ai shkruante në kujtimet e veta »Për t'i dhën fund politikës turke në çështjet e kulturës kombëtare, e për t'i siguruar disa privilegje politike në Shqipëri, nuk ka tjetër mjet veç me i fitue me një kryengritje të përgjithshme. I brumosur me ide përparimtare demokratike, Hasan Prishtina arriti të kuptojë rolin anti-kombëtar të fesë.

Ai thoshte se feja nuk ka asgjë me kombësinë, ai e përpunoi më tej mendimin e Rilindjes Kombëtare për arsimin dhe kulturën. Ai ishte i bindur kur thoshte se arsimi është shpirti i një kombi. Këtë ai e vuri në jetë duke ngritur shkolla anë e kënd vendit për përgatitjen e kuadrit arsimor, në organizimin e klubeve në mbrojtjen e alfabetit të Manastirit etj.

Emri i Hasan Prishtinës lidhet ngusht me emrin e shkollës normale të Elbasanit. Ai është një ndër themeluesit e saj. Në bankat e kësaj vatre të arsimit tonë, Hasan Prishtina do të dërgonte për të studjuar të rinjë nga Gjakova, Peja, Vuçiterna, Gjilani, Shkupi, Presheva e tjera vende.

Shkolla normale ishte i pari institucion shqiptar që do të përgatiste kuadrot mësimore aq të nevojshme për të përballuar nevojat e arsimit kombëtar qe sapo ishte ngritur. Për Hasan Prishtinën Normalja e Elbasanit sherbente edhe si shkollë e edukimit atdhetar të brezave të rinjë. Këtë vatër të shquar të arsimit, ai e quante si qendër e parë e vëllazërimit të rinisë shqiptare.

Ndërkohë veprimtaria e Hasan Prishtinës për arsimin kombëtar vazhdoi edhe në drejtimet tjera. Si deputet i Prishtinës dhe i qarqevë tjera të Kosovës, ai demaskoi me forcë në parlamentin osman paraqitjen arsimore antishqiptare të Perandorisë osmane në Shqipëri, si dhe vendimin e mbylljes së Normales më 1910. Me përpjekje të mëdha të Hasan Prishtinës kjo qendër e rëndësishme e arsimit dhe kulturës kombëtare mbahet hapur.

Kudo në Shqipëri dhe kolonitë jashtë Atdheut, përshendetën atdhetarin e pa epur që me guxim e vendosmëri arriti të korrë fitore mbi arbitraritetin e dhunën e kabinetit xhonturk. Në mënyrë të konceptuar pikëpamjet e Hasan Prishtinës mbi zhvillimin e arsimit kombëtar janë parashtruar në memorandumin e 9-të gushtit 1912, drejtuar parlamentit osman. Ai formoi platformën e kërkesave politike, arsimore e kulturore për katër vilajetet shqiptare.

Ky ishte një kontribut shumë i rëndësishëm për historinë e popullit tonë, gjë që i hedhë poshtë mendimet e gabuara, të shtrembëruara të përhapura për kryengritjen në atë kohë nga qarqet shoviniste të vendeve fqinje.

Shpallja e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912 e gëzoi pa masë Hasan Prishtinën, kurse coptimi i Shqipërisë në konferencën e ambasadorve në Londër më 1913 e hidhëroi pa masë. Gjysma e tokave shqiptare u përdorën për tu zgjidhur kontraditat mes fuqive të mëdha dhe synimeve grabitqare të shteteve shoviniste ballkanike. Përveq kësaj tragjedie e rëndë mbi kombin tonë, Hasan Prishtina u indijua thellë prej masakrave shkombëtarizuese ndaj shqiptarëve. I detyruar nga rrethanat politike të kohës, Hasan Prishtina shkon në Vjenë, ku nuk i shkëputë kontaktet me lëvizjen patriotike. Në kushtet e mbarimit të luftës së Parë Botërore dhe rrezikut të coptimit të Shqipërisë. Populli ynë qëndroi vigjilent për ta ruajtur të pa prekur pavarësinë teritoriale të shtetit dhe shtoi përpjekjet për bashkimin e tokave që ishin coptuar më 1913.

Për realizimin e këtyre objektivave të larta në Shkodër, më 7 Nëntor 1918 formohet »KOMITETI I MBROJTJES KOMBËTARE TË KOSOVËS«. Në krye të tij ishte atdhetari i shquar HOXHË KADRI PRISHTINA. Hasani megjithse u zgjodh antar, në mungesë u bë bashkëpunëtor

i ngushtë i Hoxhë Kadriut. dhe që të dy këta njerëz të mëdhenj të mendimit e aksionit qëndruan në lartësinë e detyrave të kohës. Më 18. janar 1918 në Paris organizohet Konferenca e Paqes, ku »Komiteti i Kosovës« zgjedh Hasan Prishtinën si kryetar të delegacionit të tij duke e çmuar si diplomat të aftë e politikan të mprehtë. Por padrejtësia dhe cinizmi i fuqive imperialiste dhe shteteve shoviniste ndaj Shqipërisë vazhdonin në mënyrë të paskrupullt.

Në letrën e Hasan Prishtinës, që i drejtonte nga Roma Hoxhë Kadriut ndër të tjera, me hidhërim shkruante: »E mjera Kosovë, ajo e ndershmja Kosovë, nuk ka lejuar që të ketë delegatë edhe në çastin kur është shkruar fati i gjithë botës. Pra për shkak të ambicjes, po tolerohet të ndodhet në Paris. Megjithatë populli shqiptar me bijt e vet më të mirë, nuk e përfilli qëndrimin arrogant të fuqive të mëdha shoviniste dhe tradhtisë kombëtare. Por u organizua me forcat e veta në luftën çlirimtare antiimperialiste e antishoviniste që u kurorëzua me sukses në Luftën e VLORËS, betejat e Koplikut dhe të Dibrës«.

Hasan Prishtina përshëndeti vendimet e drejta të Kongresit te Lushnjes në janar më 1920. Tani ai njihej si një nga atdhetarët më konsekuent dhe i pa përkulur. Më 5 prill ai u zgjodh deputet i Dibrës në këshillin kombëtar.

Lufta e madhe për demokratizimin e jetës social-politike të vendit, transformimet ekonomiko-shoqërore në dobi të popullit dhe Atdheut, mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve jashtë kufijve të 1913-tës, dhe të atyre që ndodheshin kudo në botë, përbëjnë një nga aspektet e luftës së Hasan Prishtinës në parlament.

Kjo luftë do të karakterizohet nga një principialitet i lartë, aq sa lejojnë rrethanat konkrete sociale historike të realitetit shqiptar të kohës si dhe botëkuptimi i tij prej demokrati. Fjalimet dhe diskutimet e tij ruajnë vlera të mëdha historike dokumentare. Ato shpalosin para syve tonë një njeri të madh, një luftëtar të përparimit e demokracisë që jetën ia fali vetëm popullit dhe qytetërimit të tij, megjithëse kundër tij reaksioni i mbrendshëm dhe tradhtia komplotonin dhe intrigonin në bashkëpunim me shovinistët e reaksionin e jashtëm.

Hasan Prishtina në luftën e madhe për demokraci e jetë më të mirë për popullin nuk u gjend vetëm. Përkrah tij do të qëndronin njerëz të tillë të shquar si FAN NOLI, LUIGJ GURAKUQI, BAJRAM CURRI, ZIJA DIBRA, HOXHË KADRI PRISHTINA. Ata i bashkonte ideali i njejtë, ideali i shejtë i demokracisë, ideali i Lirisë dhe i ruajtjes së saj. Shokë armësh e idealesh, ata do të luftonin pa kompromis për mbrojtjen e pavarësisë së shtetit shqiptar, për përparimin e jetës e popullit.

Ardhja në fuqi e kabinetit të kryesuar nga Hasan Prishtina ishte një fitore e madhe në historinë e shtetit shqiptar të atyre viteve. Qeveria e kryeministrit Prishtina qe një grusht për tradhtarët si Ahmet Zogu e reaksioni i jashtëm. Pozitat e shëndosha që kishte ajo në popull, përbërjen e saj më njerëz të devotshëm demokratë të pa lëkundur e atdhetar konsekuent, ishin me rëndësi për mbarëvajtjen e punëve në të mirë të lulëzimit të kombit.

(Fjalët e Hasan Prishtinës)

»Tu u mbështetur atdhedashurisë së popullit, e për t'mos lënë vendin

në atë anarki që kishin krijuar dy kriza njëra pas tjetrës, e mora mbi vete këtë barrë të rëndë. Kabinetin e menduem me e formue me njerëz të zotë të punës në menyrë që të pëlqehej prej këshillit të naltë, si dhe prej tanë popullit shqiptar. Dhe për fat të keq ka fillu mirë detyrën një fuqi misterioze, e cila vetë të mirën e atdheut nuk deshiron.

Qeveria ima sado që kishte drejtësinë në anë të saj, edhe ligjin dhe mjaftë fuqi në dorë, duke marr parasysh nerin e i ineresin a Atdheut gjeti më të arsyeshme të japë dorëheqje.«

Ndonëse kundërshtimi i forcave të reaksionit të vendit ishte i fortë, Hasan Prishtina dhe atdhetarët e qeverisë së tij në këshillin kombëtar mbledhur nën bajonetat e tradhtarit të shitur Ahmet Zogu, do të deklaronin me trimëri:

Shqiptarit nuk mund t'ia lidhë gojën jo dyfeku po as topi. Në shenjë protesti Hasan Prishtina burrë shteti largohet nga parlamenti dhe fillon jetën ilegale të luftëtarit konsekuent që ndiqet nga tradhtia e poshtër, por pa hequr dorë nga luftërat kundër fundrrinave të kombit, forcave reaksionare zogiste. Politika antipopullore e gjeti një paknaqësi dhe kundërshtim të plotë të popullit shqiptar, i cili u hodh në luftë të hapur, luftë që mori përpjestime të gjëra.

Pas dështimit të Revolucionit Demokratik 1924, Hasan Prishtina nuk stepet para terrorit zogist i cili e denoi me vdekje. Ai nuk e pushoi veprimtarinë e tij për çlirim, denon masakrat kundër shqiptarëve dhe dëbimet në masë prej tokave të tyre stërgjyshore.

I ndodhur jashtë Atdheut, i ndjekur këmba këmbës nga agjentët dhe vrasësit e paguar, Hasan Prishtina nuk u lodh së luftuari, nuk u tremb nga kërcënimet, shantazhet e atentatet e shumta.

Ndonëse në gjendje të keqe financiare ai u përpoq pa pushim për Atdheun, për KOSOVËN e dashur. Kudo që shkoi në Vjenë, Paris, Selanik ai u ndodh në mesin e bashkëatdhetarëve të ndershëm e patriotë të cilët e pritën me dashuri dhe respekt, si njeri të thjeshtë që i fali Shqipërisë gjithçka pati, edhe jetën.

(Fjalët e Hasan Prishtinës)

»Akuzat, shpifjet, kërcënimet e rreziqet nuk më kanë friguar
deri sot. Ata që në luftëtarët e mi do të jenë të sigurtë
se nuk do t'i frigojnë as mbas sodit.
Unë kam një rrugë të caktuar pra në jetë, atë
kam shkelë, atë do të shkeli deri në vdekje.
Rrugën e indipendencës ma të plotë të tanë Shqipnisë.
Rrugën e tradhtisë as nuk e kam shkelë, as nuk do
ta shkeli kurrë, edhe pse disave sot u kanda me më qujt
publikisht tradhtar. Nëqoftëse kta kanë ngulë sytë në
personin tem, t'ju kujtojë se unë s'trembem prej shpifjeve
të tyre dhe s'do të ndrrojë rrugë, i diktoj qartas se
kanë gabu adresë.
Nderin tem si njeri e si shqiptar e çmój, e sa me kreni

nuk e lë të përlyhet me shpifje. Mue në idenë teme patritike nuk ka mujt, as nuk do të muj me më shtrue ari i tanë botës as nyja e tanë anmiqve. Ka me m'shtrue vetëm vdekja«.

Hasan Prishtina si bir i denjë i popullit, luftoi deri në fund pa u përkulur, ndërkohë që në fundin e tradhtisë ia kishin rrembyer atdheut jetën e demokratëve të tjerë si BAJRAM CURRIT e LUIGJ GURAKUQIT.

Hasan Prishtina nuk ligshtohet, përndryshe do t'i bënte qefin reaksionit. Pothuaj i vetëm pa familje, se gruaja trime IGBALL PRISHTINA që e kuptoi idealin e tij dhe e ndoqi pas si luftëtare e pa epur, vdiq në Paris duke e lënë vetëm me idealet dhe ëndrrat e guximshme. Megjithëse i moshuar Hasan Prishtina mbeti i ri në shpirt e në zemër i pa përkulur. Ate s'e gënjeu asgjë, as propaganda as mashtrimi. Kishte mbetur po ai shpirt i bukur, i pathyeshëm atdhetar, revolucionar që si dikur i deklaronte parlamentit osman, se do të ishte i pari ndër të parët që do të rrokte pushkën e do të bashkohej me revolucionin në Shqipëri. Dhe tani nuk terhiqej përpara asgjëje. Do ta mposhtë vetëm vdekja.

Sa e sa herë ky burrë i shquar, ky bir Kosove u ndodh përballë vdekjes. Gjashtë herë u denua me vdekje nga xhonturqit, nga tradhtari Esad Pashë Toptani, nga kralët e Beogradit tre herë, nga satrapi Zog tri herë.

Dy herë Hasan Prishtina gati sa nuk dha jetën në pozita atentatesh, derisa të vinte 14 gushti 1933, ku shtatë plumba tradhtie ia shuan jetën HASAN PRISHTINËS.

Ai u kishte shpëtuar katër atentateve tjerë, falë dashurisë e respektit, mbrojtjes së atdhetarëve të vërtetë. Vdekja e kobshme e Hasan Prishtinës u prit me hidhërim në mbarë shqiptarët. Varrimi i tij në Selanik më 16 gusht 1933, ku morën pjesë shqiptarë të mërguar, patriotë demokratë si dhe revolucinarë e përparimtarë grekë, u kthye në një demostratë të fuqishme demokratike. Puntorë skraparllinjë të mërguar në Selanik me kurora në duar në krye të kortezhit, ishin jo vetëm nismëtarë të kësaj ceremonie lamtumirëse, por edhe shprehje e gjallë e dashurisë së popullit shqiptar për birin e vet, atdhetarin e shquar, demokratin e paepur, burrin e shtetit që mbeti dëshmor i luftës për pavarësinë e vërtetë e demokracinë e masave, të cilin e mposhti vetëm vdekja mizore e sjellë prapa krahëve tradhtisht.

HASAN PRISHTINA qëndroi gjithmonë në krahun më të përparuar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në fillim si një patriot i flaktë, më vonë si një demokrat i madh dhe diplomat me pikëpamje radikale revolucionare. Jeta dhe vepra e tij pasqyrojnë një rrugë të vështirë po heroike në të cilën kaloi kombi shqiptar në ato vite. Historia shqiptare e ka çmuar lartë dhe e kanë cilësuar si një patriot të madh.

Hasan Prishtina, realizimin e kërkesave të drejta që qonte kah rritja dhe zhvillimi i traditave kombëtare i quante si hapa të mëdhenjë nga indipendenca e jonë.

* * *

Kryengritja e përgjithshme antiosmane e vitit 1922 që përfshinte mbarë trojet shqiptare pati si udhëheqës politik kryesor HASAN PRISHTINËN.

Shpërthimi i saj tronditi përfundimisht themelet e sundimit shekullor osman në Shqipëri. Ngjarjet e kësaj kryengritje Ai do t'i përshkruaj me realizëm të thellë në broshurën »NJË SHKURTIM KUJTIMESH MBI KRYENGRITJEN SHQIPTARE TË VITIT 1912« të cilën e botoi në Shkodër në vitin 1922.

Kujtimi dhe vepra e HASAN PRISHTINËS nuk do të harrohet kurrë, ato këndohen në këngët e popullit anembanë, ato gjallërojnë në vargjet e poetëve!

(Vargjet e poetit)

Po të pret *Lulkuqja* në rrafshnaltë,
Mbi gadishull, po të pret e kuqe gjak.
Dhe në këtë pritje po e shtjellon baladën
Për atë që s'arritet kurrë.
E po bëre diç tjetër, shumë më tepër
Diell se sa lule e më tepër fjalë.
Shumë më tepër flamuj, shpend fluturak
Legjendë shumë më tepër deshirë.
Ngjyrën e vet, po e skuq qiellin.
Po e përflakë agimin.
Oh, po të pret lulkuqja në rrafshnaltë,
Mbi gadishull po të pret e kuqe gjak!

FUND

Shkruar më 21. 4. 1989, Drenicë

Kultura shqiptare i perket qyteterimit Evropian

Halil Matoshi

Një kulturë e vjetër, ndër më të vjetrat në zanfillë, e pasur dhe burimore në përmbajtje, qytetëruese dhe humane në thelbin e saj, maksimalisht tolerante në rrafshin integrues dhe në gërshetimin me kulturat tjera; paganiste me lashtësinë e vet burimore- ilire, e bartur me tërë vitalitetin në doket dhe zakonet (sado të asimiluara) shqiptare, perëndimore në rrafshin e modernitetit; biblike në relacionin e pushtetit të së drejtës dhe marëdhënieve ndërnjerëzore, me disa niansa të konfesionit musliman; e bukur dhe e madhërishme, por njëkohësisht e dhembshme dhe tragjike, në rrafshin ideoestetik; e ndjekur, e djegur dhe e nënshtruar inkuizicionit romak e bizantin, otoman e serbosllav...

E dëmkosur dhe e plagosur nga flaka e luftrave të parreshtura në tërë hapësirën e vet integrale, e përdhosur, e dënuar dhe e copëzuar mistershëm nga sundimi-nga nata e pushtetit...

E huaj dhe halë në sy në elaboratet shfaruese serbe, pak e njohur në evropën e diplomacive dhelpërake, që nën ndikimin e rusisë cariste dhe serbisë synonte çpërbërjen dhe zhbërjen e qenies së saj e sakatuar nga pamendësia komuniste: kjo është kultura shqiptare dhe hapësira e saj e gjymtuar...

E censuruar, e karantinuar dhe e burgosur nga njëmendësia bolshevike, nga monopoli narcisoid i pushtetit njëpartiak: kjo është kultura shqiptare. E sot kur kërkohen rrugë të reja për shpërthim, sprova të reja për gjallërim, cila është hapësira gjithëshqiptare kulturore, kush dhe pse e rudhë atë dhe çfarë është përspektiva e saj?

Hapësira kulturore gjithshqiptare, padyshim është një trup me një shpirt dhe buron, rritet, ec, rrjedh e zhvillohet nga një trung, me të njëjtat rrënjë; ilire në zanafillë, sado që në periudha të ndryshme e gjëjmë pa pamjen e saj të bukur; të gjymtuar si një torzo në errësirën e barbarizmit, si dje ashtu edhe sot, kulturë e qytetërimit perëndimor, sado që në rrethana gjithherë jostabile të truallit ku i ka rrënjët, për shkak të presioneve uragane të hegjemonive përreth dhe trukeve diplomatike evropiane, pa një themelatë të fortë juridike-shtetërore, është injoruar dhe shtypur vazhdimisht; është vënë pa të drejtë në margjina të qytetërimit evropian, madje shpesh edhe është mallkuar dhe fyer: si anadollake, lindore, e vlerës më të ultë qytetëruese etj.

Por, kultura shqiptare e materializuar në fortesën e truallit ilir, nuk u zhbë asesi, ngase për mrekulli e ruajti dheu i truallit që e lindi dhe sot ia shfaq Evropës në dritë të diellit, qoftë përmes zbulimeve unikate arkeologjike, qoftë në formën e saj grafike, të shkruar apo të bartur brez pas brezi, si letërsi gojore, si etnos dhe etos me vlerë koherente. Se kultura shqiptare, në të gjitha relacionet e veta i përket qytetërimit perëndimor (pos ndonjë dhënie-marrje të natyrshme nga kultura e lindjes), dëshmitë janë të hershme e të bollshme, por në këtë rast mjafton të zihet në gojë Mesjeta, kur artistët shqiptarë, humanistët e zotë si *Onufri i Neokastrës,* pikturat

e tij, në njëren anë dhe figura e shquar e *Pal Engjëllit,* në anën tjetër, na mundësojnë të kuptojmë siç thotë *Dr. Engjëll Sedaj, se bota shqiptare jo vetëm që nuk ishte e shkëputur nga idetë më përparimtare të kohës, por edhe jepte kontributin e vet.* Vetëm duke pasur parasysh ekzistimin e Universitetit të Durrësit që në shekullin e XII, si *studio generale,* siç e ka dëshmuar nga dokumentet arkivore studiuesi ynë *Jahja Drançolli.* Pas pushtimit turk, një plejadë e njerëzve të ditur ikën në Itali, si *Martin Segoni, Marin Barleti, Marin Beçikemi, Gjon* dhe *Gjin Gazuli, Leonik Tomeu, Mikel Maruli.* etj.

Pastaj edhe jeta dhe lufta e Kryetrimit shqiptarë, *Skënderbeut,* kundër turqëve, me tipare karakteristike të qenies popullore shqiptare, në fakt, inkuadrohet në luftën e përbashkët të popujve evropianë kundër sulmeve aziatike. Në vija të trasha, thotë Dr. Sedaj, për këta artistë e humanistë të mesjetës shqiptare, mund të thuhet se në punë ideore ata mbronin traditën e zhvillimit kulturor evropian para sulmeve barbare. Me një fjalë, artistët dhe mendimtarët shqiptarë që në zanafillë kanë mbrojtur qytetërimin evroperëndimorë. Duhet të potencohet veçanërisht *Pjetër Bogdani* që veprat i shkruante në shqip dhe italisht, që i botoheshin dhe ribotoheshin në Romë e Padovë, gjithku në truallin e Evropës. Duke bërë kështu një këcim nëpër periudha të ndryshme të qeniesimit shqiptarë, duhet përmendur *Aleksandër Moisiu* që fascionontе publikun skenik gjithandej nëpër Evropë. Atë që vulosi Moisiu, vazhduan *Xhon* e *Xhim Belushi,* si dhe dhjetëra artistë kulminantë, mjeshtër të mëdhenjë që krijojnë nëpër botë, si piktorët *Gjelosh Gjokaj* e *Daut Berisha,* aktori *Bekim Fehmiu,* mendimtari *Sami Repishti,* poeti e prozatori *Martin Camaj,* deri të artistët më të rinjë të diasporës shqiptare, *Skënder Sherifi, Valter Dëshpali, Neriman Kamberi, Lale Vula* etj.

Totalitarizmi neobolshevik ia ka marrë të drejtën burimore kulturës shqiptare që në mënyrë të denjë, sot, të prezentohet në arenën ndërkombëtare, pasiqë e ka ndarë hapësiren kulturore gjithshqipëtare në regjione e provinca, e ka derdhur dhunshëm potencialin krijues të trupit kulturor shqiptar në të gjitha kontinentet, pra ndodh kështu, pasiqë kombi ynë jeton në tri shtete në territoret e veta natyrore (Shqipëri, Greqi, dhe Jugosllavi) dhe në diasporën shqiptare, prej Vienës deri në Zelandë të re; ndërkaq, vetëm nën pushtetin totalitar jugosllav, hapësira kulturore shqiptare është parcializuar në katër njësi, duke pasur si qëllim dhe synim të mbramë, rudhjën dhe tjetërsimin e një tërësie, duke ia marr të drejtën e pacënueshme interkomunikative, në mënyrë arbitrare, për t'i theksuar dhe trilluar pastaj dallimet dhe specifikat e imponuara brenda të njëjtës kulturë, brenda një, të vetmes dhe të pandashmës kulturë shqiptare. Anatemat mbi kulturën shqiptare vijnë e bëhen më të ashpra dhe e cenojnë atë gjërë në prak të zhbërjes, vaçanërisht gjatë këtyre 45 vjetëve të mbretërisë së pamendësisë bolshevike. Mënyrat barbare të shkatërrimit te të mirave kulturore shqiptare nisin mënjëherë pas vendosjës së »pushteteve popullore« në lindje, kur edhe rrënohen ndërtesat më të bukura të mjeshtrave popullorë, nën pretekst se janë prona borgjeze, shtëpi bejlerësh e agallarësh, për ta shkatërruar kështu harmoninë arqitektonike të qyteteve; duke ngrehur mbi këtë harmoni godina »socialiste«; varrosën pamëshirshëm gjetjet arkeologjike, për ta fshirë kujtesën e popullit (ndodhë që ndonjë zbulim arkeologjik

i natyrës ilire të valorizohet sipas vlerësimeve të Komiteteve partiake si ndonjë »vepër armiqësore« kundër partisë dhe shtetit!) Digjen dokumentet, librat po madje edhe njerëzit-autorët e këtyre veprave. Kështu teoria dhe praktika Staliniane nuk duronte arte nacionale si fryt të shpirtit dhe mendjës së një populli, ngase duhej rikrijuar një botë e RE-revolucionare dhe anacionale që më shumë i ngjanë xhamit, betonite hekurit se sa qeniesisë dhe fytyrës së një kombi. Duhej krijuar një art i ri, i zhveshur nga ndjenjat kombëtare, duhej art për psikologjinë e masave histerike, plot patetizëm dhe plot bojë të kuqe, një art i ri me faqe »socialiste«, me punë vullnetare! Duhej krijuar kombi socialist, që artificialisht, dhunshëm e pashpirtëshëm nga kulturat nacionale të krijonte konglomerate të pashije, të paftyra, emblema të frikshme që para totemizmit të tyre të kuq të përkulen njerëzit, masat... Arti dhe kultura duhej përshtatur luftës klasore (luftës së përgjakshme për pushtet-ashpërsimit të kësaj lufte nën firmën e ashpërsimit të luftës klasore). *Diktatura e proletariatit* duhej ta bënte valorizimin e vlerave të artit, ta jashtëqes artin borgjez, dekandentë, ta përjashtojë subjektësinë krijuese, duke manipuluar me terminologji, çmendurake si *»intelegjenci e ndershme«, »shkencë borgjezë«, »sociologji borgjeze«, »metafizikë inerte«,* krejt derisa »partishmëria e artit« e ngulfati vetë artin, mendimin e lirë dhe autonom, mendimin tjetërfare, autonomitetin dhe qeniesimin e lirë të njeriut. Kur njeriut i kujtohen të gjitha këto, pyetja e parë që duhet bërë do të ishte: Sa libra duhet hedhur në bërllog? Sa tonelata letra duhet hedhur sëbashku me shkrimet me bojë të kuqe!?

Hapësira kulturore gjithshqiptare është e prerë, e censuruar shumfish, nga aspekti politik, ekonomik dhe social. Është cenuar hapësira e përbashkët informative, kulturore, komunikative. Këtë hapësirë kulturore e ka plagosur rëndë edhe një e keqe, pos më të ligës- ideologjisë komuniste; apetitet hegjemoniste të fqinjve ndaj shqiptarëve dhe truallit etnik të tyre, e për t'i sunduar, asimiluar, përndjekur madje edhe shfarosur fare, ata duhet privuar ngadalë nga çdo e mirë kulturore.

Popullit shqiptarë duheshe që gradualisht t'ia fshish kujtesën, duhej zhbërë kulturën materiale (shkatërrimin e ekonomisë) dhe shpirtërore (trojet shqiptare duhej mbajtur si varr dhe burg konstant). Pamundësia që shqiptarët ta formojnë shtetin e vet sovran, mbi gjysma e popullit tonë sot jeton në Diasporë (madje edhe vetë shteti i sotëm zyrtar është një shembëllesë e një diaspore!). Për t'i shfarosur shqiptarët, si etni dhe botë krejtësisht tjetër kundruall etnisë dhe botës sllave, është dashur, padyshim, shpërbërja e hapësirës integrale kulturore.

Në të vërtetë, kjo hapësirë, sado e vënë nën kontrollin e rreptë policorë-ushtarak, ekziston e pacenueshme në shpirtin dhe qeniesinë etnopsikologjike shqiptare, por është mbajtur nën çintegrim për synim aneksioniste dhe okupuese. Kujtoj se me 1981, shqiptarët e Kosovës paralajmëruan dhe i nisën të parët proceset demokratike në Lindje e më këtë filloi edhe lufta në rrafshin tjetër, lufta për subjektësi kombëtare në hapësirë integrale. Sado që masat represive u rritën, u rrit edhe rrezistanca, sado që kësaj hapësire kulturore i kanosej shkatërrimi, rritej ndjenja për vepra edhe më të mëdha në planin gjithkombëtar. Mure berlineze vëheshin jo vetëm midis Kosovës dhe Shqipërisë, por edhe midis Kosovës dhe viseve shqiptare në

Jugosllavi, mure të hekurta për ta pamundësuar komunikimin e ndërsjellë kulturor dhe njerëzor brenda të njejtit komb.

Dhuna komuniste për kulturën shqiptare ishte inkuzicion i vërtet, censura dhe autocensura nisën ta çfilisnin frymën e artit duke nxjerrë në dritë patetizëm, parollizëm dogmatik, hymnizime marroçe për individë, për partinë, për idhuj pa krena! Ndjekjet politike, anatemat dhe anatemimi i vetë autorëve, dënimet për delikte verbale, deri te likuidimi fizik i njerëzve të kulturës dhe arsimit nuk pushuan asnëherë. Burgimi gati tridhjetë vjetë i *Adem Demaqit,* romansierit dhe tregimtarit, qysh në moshë të re të talentuar, mund të thuhet se e ka dëmtuar rëndë prozën tonë, por edhe më tragjike është e dhëna se në Shqipëri ta zëmë deri vonë, shumë vonë, ose nuk është njohur fare veprimtaria e tij letrare e patriotike ose nuk ka guxuar askush ta përmend!? Me vrasjen e *Jusuf Gërvallës,* fatkeqit të *prerjes* komuniste, poezia shqipe humb një meteor serioz, ndër më të mirët të brezit të vet, pastaj vrasjet dhe burgimet e shumë krijuesëve si dhe ndjekja e shumë të tjerëve jashtë vendit, e lodhën dhe gati sa e këputen fare kulturën shqiptare. Në Jugosllavi, u hoqën me metoda zhdanoviane shumë autorë e krijime letrare-artistike nga planprogramet shkollore, e më këtë u sakatos mësimi mbi kulturën tonë. U fshinë nga këto programe që nga Naimi e deri te Kadare dhe u anatemuan shumë krijues kosovarë si: *Arif Demolli, Rushit Ramabaja, Teki Dërvishi, Adem Gashi, Sabit Rrustemi...* a s'i ngjanë kjo inkuzicionit më të tmerrshëm? Kosovës, regjimi komunist ia ka vrarë shumë poetë, i ka shuar shumë pena të stërholluara, gjë që nuk ka ndodhur askund në qytetërimin evropian. Mjafton vetëm t'i përmendim emrat e *Haki Tahës, Emrush Myftarit, Fazli Grajqevcit, Bajram Qerimit, Rexhep Elmazit, Jusuf Gërvallës, Nuhi Berishës, Enver Hadrit...*

Regjimi komunist i Tiranës në anën tjetër, sado që është përpjekur ta ruaj qenësinë e kulturës kombëtare, ia ka zënë frymën asaj me'izma dhe e ka ndrydhur fort me »çekanin dhe drapërin e punëtorisë«. Atë që Beogradi e ka bërë me thikë, duke e prerë këtë hapësirë kulturore, Tirana e ka mbytur në heshtje varri, në interes të »ruajtjes së pavarësisë« apo në interes të ruajtjes së pushtetit!? Anatema u vunë ndaj *Gjergj Fishtës,* po edhe ndaj *Lasgush Poradecit,* i cili kurrë nuk mundi të marr leksion nga Nëna Parti për të shkruar një vjershë për traktorin shqiptarë nën firmën »Enver Hoxha«. Një kohë qe aktuale edhe ndalesa ndaj *Koqo Kostës* e tashti sikur u aktualizua sërish rasti më tragjik, ai i *Kapllan Resulit,* i cili siç njohtojnë shumë të interesuar, qenka i katandisur diku në burgjet e Shqipërisë socialiste! Çdo diktaturë i ka qëllimet e çarta, prandaj as diktaura komuniste e Tiranës nuk skuqet fort edhe pse është shqiptare!

Shkundja e mykut gati gjysmëshekullor bolshevik është realitet, megjithë rrezistencat, kjo shkundje sigurisht se ia kthen dhe siguron primatin artit dhe kulturës, mbi të gjitha ia kthen lirinë e mendjës. Ia kthen duart e lira në stilin, formën dhe eksperimentin, krijon parakushte për zgjedhje të lirë dhe shumësi idesh. Parakusht për riintegrimin e hapësirës kulturore gjithshqiptare është vendosja e sovranitetit të popullit shqiptarë në këtë hapësirë, vendosja e demokracisë parlamentare dhe sistemit shumëpartiak; vetëm shqiptarët e bashkuar në Evropën e bashkuar mund të mbledhin

copat e shpirtit dhe trurit, të derdhura e të hargjuara në iluzionizëm ideologjik.

Mungesa e PROGRAMIT NACIONAL SHQIPTAR, si paradigmë unike gjithshqiptare, në kohën kur popujt e Evropës po e zgjidhin çështjen nacionale, është poaq mungesë e vizionit të qartë për një hapësirë unike gjithshqiptare kulturore. Flakja e ortodoksalizimit komunist dhe kthimi kah vetvetja, garanton rrjedhën normale të proceseve integruese. Ky program nacional, natyrisht do të duhej të jep përgjigje në shumë pyetje, trende e dilema aktuale: Çfarë do të jenë shqiptarët në Evropën e bashkuar? Cila do të jetë hapësira gjithshqiptare kulturore? Dhe, a mundët të rrojë shqiptari vetëm me Atdheun, pa Nënën Parti dhe pa idolatri, hi në sytë e masave!? Cili është shqiptari evropian e cili ai aziatik? Kah lindja me »diell të përgjakur« apo kah perandimi »i errët« . . .? E, nesër është vonë të tallemi me të gjitha marritë tona!

P.S.

Kjo është varianta e përpunuar dhe e plotësuar e punimit të paraqitur në tubimin gjithahqiptarë të Lubjanës, me rastin e përvjetorit të »Alternativës« Atëherë, shumëkush më sulmoi, humba disa simpatizerë, por fitova disa të tjerë. Sidoqoftë, vetëm *z. Gani Buçinca* atëbotë, m'u afrua e më tha: »Mirë e the, djalosh . . .« dhe ma shtriu dorën. Pastaj disa më thanë se me këtë paraqitje i »paskam rënë vetes në qafë«. Megjithatë, gjërat lëvizën, e unë mbeta gjallë, bile me kalimin e kohës po më verifikohen të gjitha ato që i thashë. Fatkeqësisht! Atëherë Ismail Kadare ende ishte oborrtarë. Çka do të më thoshin komunistët e mi po t'ua kritikoja edhe Kadarenë? Mund të haja shuplaka, mos më keq. Sot, thonë iku, Kadare, ia ktheu shpinën Nënës . . . Në vendet e »socializmit që erdhi nga të ftohtit« jetojnë vetëm engjujt(!)të gjithë dreqërit ikin! Mbesin engjujt e kaltër me yll në ballë! U qoftë pushteti, edhe një apo dhjetë vjet. Atdheu kurrë! Ai është edhe imi. Të drejtën në atdhe s'ka zot që ma merr.

Personazhet e këngëve popullore të Lidhjës Shqiptare të Prizrenit

Haxhi Muhaxheri

(Fragment nga një punim më i gjatë) ·

Në kohën e Lidhjës Shqiptare të Prizrenit, në masë më të madhe se kurdoherë më parë ka gëzuar respekt dhe trajtim liria e të shprehurit dhe mendimit në përgjithësi, si: publicistika, krijimtaria letrare, gojore, apologjia apo kritika historike, politike, kulturore, arsimore, shoqërore etj.

»Këngët popullore të periudhës së Rilindjës Kombëtare, të cilat kanë karakter lufarak dhe frymë liridashëse, shquhën për vlera të qëndrueshme letrare- artistike. Pos këngëve që i kushtohen periudhës së lavdishme të Skënderbeut, vend të posaçëm në poezinë tonë popullore zënë ato që shtjellojnë tematikën e zgjimit kombëtarë dhe të luftës së masave për çlirim nga sundimi i gjatë i Perandorisë Osmane. Duke filluar nga vitet e '30 të shekullit XIX, kur zë fill lëvizja e kulturës dhe Rilindjes sonë kombëtare, të cilës i prijnë luftërat e popullit kundër reformave të Tanzimatit, në kohën e Lidhjës Shqiptare të Prizrenit dhe deri të shpallja e Pavarësisë, këngët tona popullore u bënë dëshmi e sakrificave të mëdha të popullit dhe të heronjëve të tij. Të krijuara nga përjetuesit dhe pjesëmarrësit e drejtëpërdrejtë të ngjarjeve, më qëllim që të përcjellin porosinë e tyre në shtrirje kohore dhe territoriale, këngët tona i vëjnë në pah fitoret dhe humbjet; e shquajnë përkushtimin vetmohues të individëve të dalë nga masa që u kalitën në luftën e vazhdueshme kundër sunduesit të huaj.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, sidomos në kohën e Lidhjës Shqiptare të Prizrenit, këngët vëjnë në pah unitetin e popullit tonë, meqë në rrethana të tilla bëhëj me e qartë vetëdija kombëtare dhe qëllimi i luftës së tij. Poezia popullore me specifikën e saj bëhët zë i ndërgjegjës së masave për ngjarjet shoqërore historike të Rilindjës. Me frymën patriotike, me karakterin mobilizues, poezia popullore anticiponte sendërtimin e idealeve të Lëvizjës kombëtare dhe, krahas ideve iluministe të ideve të letërsisë së Rilindjës, i kontribuonte dukshëm zhvillimit të gjithmbarshëm të popullit tonë.

Duke filluar me këngën që shpreh revoltën dhe vendosmërinë e popullit shqiptar për luftë kundër pushtetit Osman, radhitën këngët të cilat paraqesin rrezistencën e popullit kundër masave të rrepta të autoriteteve turke që më anë të ekspeditave ushtarake shuajnë më gjak një varg përpjekjësh e kryengritjësh për liri që nga masakra e Manastirit e 30 korrikut 1930 kur u vra më të pabesë paria shqiptare. Mirëpo, këngët flasin se aspiratat dhe entuziazmi i popullit për liri nuk u shuen kurrë, /. . . se Shkodra t'venë e bani, / I erdhi hakut osmanlis' /. Dhe kështu këngë pas kënge, këndohën kryengritjet dhe luftërat e shqiptarëve kundër forcave osmane në të gjitha viset, në një përiudhë të gjatë më së tetëdhjetëvjetë.[1]

Në të gjitha këngët e atyre kohërave vend më parësor dhe me interes studimi zënë këngët tona popullore që janë krijuar dhe kënduar në kohën prej themelimit të Lidhjës Shqiptare të Prizrenit e gjerë në kohën e »çlidh-

jës« së saj, me rastin e ekspeditës famëkeqe të Dervish Pashës. Në këngët e krijuara në atë kohë janë ndritur dhe ngritur epitetet e personazheve të këngëve dhe udhëprijësit e popullit, por edhe janë kritikuar dhe bastardhuar lajkatarët e Lidhjës... të cilët herë-herë janë lidhur dhe i kanë përkrahur interesat e popullit e herë-herë ia kanë këthyer shpinën atij, duke u lidhur ngusht me interesat vetanake. Nga personazhet që në këngët tona popullore të asaj kohe paraqiten si lajkatarë apo negativ, kemi kryesisht krerët e shtresës së lartë, si: bejlerët, agallarët, pashallarët, bajraktarët etj., të cilët herë janë lidhur me popullin e herë më armikun për të fituar poste të larta apo siç shprehet populli: »Këthenin kokën kah fryente era!«...

Përsonazhet dhe kryepersonazhet e këtyre këngëve

Personazhet dhe kryepersonazhet të cilët kënga popullore e asaj kohe i ngritë për zgjuarsinë, mençurinë dhe trimërinë që kanë treguar ata me rastin e organizimit dhe udhëheqjës së masave në luftë kundër shtypjës së egër të osmanlinjëve, si: Abdyl Bej Frashëri, Ymer Agë Prizereni, Sulejman Vokshki, Isa Boletini, Mic Sokoli, Haxhi Zeka, Binak Alia, Ramadan Zaskoci, Sefë Kosharja, Smajl Hyseni, Sali Jaha, Islam Batusha, Rexhë Avdia, Jakup Ferri, Hysen Bajri, Avdi Syla nga Krasniqja (Nip i Binak Alisë), Smajl Mehmeti (Mik i familjës së Binak Alisë), Zeqir Osmani, Hysen Hajrizi dhe Rexhë Bajraktari nga Plloçica të cilët u vranë në luftën e Kosharës, Col Delia (Trim nga fshati Geghysen i Krasniqes), Mon Avdia (Trim nga Malësia e Gjakovës), Ahmet Zeneli apo Ahmet Vuthi (Trim nga Vuthajt i cili u dallua në mbrojtjën e Plavës dhe Gucisë nga coptimi me të cilat qytete mbreti i Turqisë dëshironte për t'i kënaqur lakmitë e Malit të Zi), Hajdar Feka (Trim nga Pepiqi i Rugovës), Alush Hoti (Trim nga Hoti i Kujt- Plavë), Ali Ibra (Udhëheqës i masës dhe bajraktar i Gashit), Smajl Hyseni (Luftar nga Bunjani), Demë Isufi (Luftetarë nga Vokshi), Rrushtem Pavata nga Strellci i Epërm të Deçanit, Ramë Feka (Kusheri dhe përcjellës i Haxhi Zekës), Nasuf Efendija nga rrethi i Kolonjës i cili i mbronte patriotët nga bejlerët, Sadri Rrustemi (Bajraktarë i Morinës, i biri i Rrustem Sadrisë), Avdyl Shala, Nezir Hajdari, Hasan Tahiri e Haxhi Bajrami (Luftëtarë nga Juniku), Rrustem Bajrami dhe Musë Tahiri (Nga Babajt e Bokës), Shaban Binaku (Bashkëluftetar i Sulejman Agës dhe bajraktar i Krasniqes) etj. Në këtë grup emrash futëm edhe ata që e perkrahnin dhe e ndihmonin Lidhjën Shqiptare të Prizrenit, idenë dhe qëllimet e Lidhjës... dhe ata që i mbronin krerët e lidhjës nga lajkatarët e asaj kohe apo të shprehemi më qartë: permendëm edhe emrat e atyre personave që kanë hyrë në këngët që janë krijuar dhe kënduar në kohën e Lidhjës Shqiptare të Prizrenit për veprimtarinë e tyre krahëdhënëse ndaj Lidhjës.

Ndërgjegja e masave në këto kënge

Letërsia popullore si krijimtari arstistike dhe formë e të shprehurit të mendimeve, synimeve dhe përjetimeve të masave, paraqet vlera mjaft të rëndësishme të kulturës shpirtërore të popullit. Rëndësi të posaçme kanë këngët e kësaj gjinie letrare të cilat i ka krijuar populli nga fronti i luftës për çlirim, e sidomos ato që trajtojnë temën historike-shoqërore, sepse paraqesin artistikisht ndërgjegjen e zgjuar të masave në periudha të caktuara dhe sjellin njohuri për aftësinë krijuese të talenteve të popullit.

Themi kështu ngase »këngët popullore frymëzohën nga realiteti dhe atë e transponojnë artistikisht duke e vlerësuar në bazë të këndit të vështrimit të ngjarjeve dhe situatave, i cili percaktohet nga veçoritë etnopsikologjike të popullit dhe nga fajtoret e brendshem dhe të jashtëm që ndikojnë varësishtë prej rrethanave historike, shoqërore, kulturore dhe politike. Sipas traditës këto quhën këngë historike, por prapësepraprë në radhë të parë janë formë e komunikimit artistik e mandej plotësim i dëshirave reale historike. Sepse, duke paraqitur botën e brendshme të njerëzve dhe duke e përsosur botën në përgjithësi me detaje artistike, poezia popullore ia këthen elementet frymëzimit realist historik, dëshmon të kaluarën apo ngjarjën më fjalën më të madhe dhe më të dëgjueshme-fjalën e artit«.[2]

Duke u lidhur me detyrat e mëdha politike të ditës, gjatë periudhës së Lidhjës Shqiptare të Prizrenit, levizja mendore mori një frymëzim të lartë e luftarak dhe kështu, letërsia popullore shqiptare e atyre viteve u ngrit në një shkallë mjaft të lartë artistike, e sidomos këngët popullore. Këto këngë me keqardhje pasqyronin dhëmbjën e njerëzve të thjeshtë për prapambetjën e atdheut të ndarë e të përçarë, zemrimin e tyre kunder synimeve dhe lakmisë grabitqare të shteteve fqinje dhe kundër tradhëtarëve dhe krereve të shtresave të larta që për lakmi e interesa të veta, nuk i mbronin interesat e popullit, por e lenin atë për t'ju nënshtruar demofilokracisë së kohës apo shtypjës së egër barbare të armiqëve të ngjyrave të ndryshme.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit është njëra ndër fazat më të rëndësishme të periudhës së Rilindjës Kombëtare për zhvillimin e epikës sonë popullore. Në një anë, ajo solli një sërë këngësh të reja qe u kendohen ngjarjeve dhe njerëzve, ndërsa në anën tjetër, ato u pasuruan më një sërë risishë të reja ideoestetika. Për ndryshim nga të mëparshmet, këngët e periudhës së Lidhjës . . . paraçesin në mënyre të pasaçme pjesmarrjën e masave kryengritëse nga të gjitha viset shqiptare, duke i përfshirë të gjitha shtresat që ishin të vetëdijshme që luftonin për mbrojtjën e interesave të popullit dhe të atdheut.

Aspekti etnopsikologjik kombëtarë në këtë rast i jep përmbajtje të re epikës sonë, meqë reflekton vërtetësinë jetësore të asaj periudhe, kur i madh e i vogël ishte ngritur në luftë për të fituar të drejtën për jetë të lirë dhe kushte të përshtatshme për zhvillimin e përgjithshem kombëtarë dhe individual të njeriut. Nga këngët e Lidhjës Shqiptare të Prizrenit kemi një galeri personazhesh me cilësi kronologjike individuale, por të shtrira në planin e gjërë kombëtarë«.[3]

Njëri ndër kryepersonazhet e Lidhjës Shqiptare të Prizrenit është *Abdyl Bej Frasheri,* i cili gjerë në vdekje i qëndroi besnik në sajë të punës vetmohuese çështjës së atdheut dhe në bazë të dashurisë së madhe që ushqente për të dhe njerëzit, ishte bërë figurë e njohur dhe e dashur edhe në vendet më të largëta. Kështu, populli në krahinën e Lumës me krenari i këndonte: »Ky Abdyl Bej Frashëri / Ç'u përpoq i varfëri, / Çkriu tri barrë flori, / Shtatë herë në Frengji«.[4]

Pos Abdyl Bej Frashërit, si personazh më i shpeshtë dhe heroik i këngëve popullore paraqitej edhe *Mic Sokoli* (Udhëheqës i kryengritësve nga fshati Bunaj i Krasniqes), i cili në luftën e Slivovës, në të cilën shqiptarët luftonin me heroziëm duke u përleshur trup me trup e fyt me fyt me armikun, u hodhë mbi grykën e topit dhe u vra duke e mbuluar atë me

trupin e tij. E kështu populli me dhembje i këndonte: »Mic Sokolin e vrau reja, / E vrau reja, e vrau moti, / E vrau Dervishi me gjyle topi«.[5]

Me rastin kur u vra Mic Sokoli, si udhëheqës i forcave kryengritëse në luftën e Shtimës dhe Slivovës, u vranë edhe 800 luftëtarë shqiptarë dhe 1800 ushtarë turq.

»Ymer Efenia, trim shqiptar, / Sulejmani ni komanar . . . Lidhën besën e pajtun gjaqe; / Me ven tonë s'ka pazarllaqe«.[6] janë këto vargje që këndoheshin më të madhe anë e kënd vendit me të cilat ngriteshin figurat eminente të popullit shqiptar dhe dy komandarëve të kryengritësve; Ymer Efendi Prizrenit, kryetar i »Qeverisë së përkohshme« të Lidhjës Shqiptare të Prizrenit, i cili nuk u ra në dorë turqve gjerë sa vdiq më 1866 në Ulqin«[8] dhe Sulejman Agë Vokshi që organizonte kryengritësit dhe luftonte përkrah tyre në ballë të frontit të luftës. Ndërsa vargjet: »Lidhen besen e pajtuen gjaqe / Me ven tonë s'ka pazarllaqe!« – më së miri e paraqesin mllefin e popullit ndaj Turqisë që bënte pazarllaqe dhe coptonte tokat shqiptare për t'i kënaqur shtetet fqinje: Malin e Zi, Sërbinë, Greqinë etj.

Edhe Binak Alia dhe Col Delia janë personazhë që kanë hyrë dhe mbetur në zemrat dhe këngët e popullit »Përmbi dri po flet Binaki«[9] dhe »Priti djemt e memleqetit«[10] Gjithashtu, këngët popullore të asaj kohe shquan edhe gjestin e Ramadan Zaskocit, i cili duke zbatuar vendimet e Komitetit të Lidhjës Shqiptare të Prizrenit, vrau më 27 gusht 1878 në Marash të Prizrenit telegrafistin e Mehmetali Pashë Magjarrit, gjatë misionit të tij famëkeq për zbatimin e vendimeve të Traktatit të Berlinit, vrasje kjo që i bëri jehonë të madhe rezistencës së pergjithshme të kryengritësve shqiptarë në qarqet ndërkombëtare. Kjo ngjarje në epikën tonë u këndua me një cikël këngësh që karakterizohen për vlerën e vaçant ideoestetike.

Edhe Ali Ibra mjaft shumë ka zënë vend në këngët popullore të krijuara në kohën dhe pas Lidhjës . . ., sepse ka qenë shumë i respektuar dhe i dashur nga masat popullore për trimërinë, guximin dhe mençurinë që e ka treguar duke i udhëhequr kryengritësit e Gashit dhe duke luftuar edhe vet përkrah tyre dhe kryetrimit të Krasniqes Mic Sokolit. Heroizmi i tij më së miri na paraqitet në këngën: »Shumë asqer po qet pampori«.[12]

Po në këtë mënyrë edhe Haxhi Zeka dhe Sefë Kosharja me veprimtaritë e tyre të larta dhe përparimtare të kohës, kanë fituar simpatinë e popullit i cili iu ka krijuar këngë lavdie dhe është mburrur me ta që kanë dalur nga gjiri i tij. Pra, si personazh të këngëve të kohës së Lidhjës . . ., veprimtaria e tyre është e lidhur ngusht me interesat e popullit për çfarë edhe bien therorë. I pari Haxhi Zeka i qendroi besnik popullit deri në fund të jetës kur u vra tradhtisht më 1902 nga Adem Zajmi, xhandar i Turqisë nga Gjakova, i cili u nxit dhe u pagua për këtë nga qarqet reaksionare serbe dhe turke, ndërsa të dytin Sefë Kosharja, për idealin dhe dashurinë e flaktë që ka ushqyër ndaj popullit, turqit e kanë varur dhe e kanë lënë tri ditë në litar me qellim për ta tmerruar popullin i cili vështirë tmerrohej, sepse ishte mësuar me vrasje të tilla ngase mbi kurrizin e tij ishin bërë edhe masakra më të mëdha. Kjo më së miri vërehet në këngën: »Haxhi Zeka dha kushtrimin«[13] në të cilën populli e paraqet Lidhjën Shqiptare të Pejës që u bë nën iniciativën e Haxhi Zekës. Mbledhja e parë e kësaj Lidhje është mbajtur më 1897, ndërsa e dyta, me emrin »Besa-Besë«, në janar të vitit 1899.

Sefë Kosharja ni burrë taman,
Kqyre burri çka ka thanë:
– Muhaxherët – o na i domë,
Se na i kena vllazën tonë!

(Muhaxherët jan'çue n'kamë)[14]

Në këtë këngë popullore paraqitet përkrahja që kanë fituar nga Sefë Kosharja, Muhaxherët shqiptarë të shpërngulur me dhunë nga qarqet reaksionare serbe më qëllim të serbizimit të trojeve shqiptare. Me presionin dhe dhunën e borgjezisë serbe gjatë vitit 1877–78 shpërnguleshin shumë shqiptarë nga rrethinat e Toplicës, Leskovcit, Prokuplës, Pusta Rekës etj., për ç'gjë patriotët e kohës dhe populli, shprehnin zëmrimin e tyre Kurse kënga »Sefë Kosharja i pari i fisit« paraqet dhe përshkruan varjën e Sefës nga autoritetet turke.

»– Sefë Kosharja i pari i fisit
Hije të paska maja e lisit!
– Hije m'ka, o djemt e mi,
Kam lanë shpirtin për Shqipni.« (Sefë Kosharja i pari fisit)[15].

Ka edhe shumë e shumë personazhe të cilët kanë hyrë në zemrën dhe këngët e popullit, këngë ato të cilat këndohën dhe ruajnë brez pas brezi në popull kujtimin dhe dashurinë për fytyrat eminente shqiptare të asaj kohe. Duke paraqitur heroizmin e »djemve të memleqetit«, bijve të atdheut, këngëtari popullor shquan edhe figurën e femrës shqiptare si pjesmarrëse në këto luftëra, bie fjala atë të nënës së Mic Sokolit dhe të motrës së Zhujë Selmanit.

Pak më ndryshe nga këto këngë këndohet Ali Pashë Gusia i cili na paraqitet herë si ndërmjetësues të Sulltani në favor të popullit shqiptar, herë si ngadhnjyes në luftëra, ku shquhet heroizmi i tij, sidomos në luftën e Nokshiqit kundër forcave të mëdha ushtarake malaziase të Kral Nikollës që i komandonte Mark Milani. Kurse në disa këngë vërejmë se figura e tij nuk është konsekuente lidhur me qështjën kombëtare, veçmas në rrethanat e reja pas thyerjës së forcave kryengritëse të Lidhjës Shqiptare të Prizrenit.


Kështu »Lidhja Shqiptare e Prizrenit u thye ushtarakisht, por populli ynë filloi të njihej dhe të veprojë si komb duke shtuar rrezistencën. Idetë e saj për autonomi dhe pavarësi frymëzuan veprimtarinë e mëtejme patriotike të popullit. Fryma patritoke e kësaj periudhe i pershkon këngët që paraqesin luftërat kundër Vesel Pashës, veprimtarinë e Haxhi Zekës më shokë gjatë organizimit të Lidhjës Shqiptare të Pejës dhe *kryengritjet e pandërprera deri në shpalljën e Pavarësisë«*.[16]

[1] Këngë popullore të Rilindjës Kombëtare fq. 5–6. Prishtinë 1978
[2] Poaty fq. 5.
[3] Poaty fq. 8.
[4] Historia e popullit shqiptar II, fq. 163, Prishtinë, 1969.
[5] Këngë popullore të Rilindjës Kombëtare, fq. 213, Prishtinë, 1978.
[6] Poaty fq. 220.
[7] Poaty fq. 35.
[8] Poaty fq. 35.
[9] Poaty fq. 173.
[10] Poaty fq. 171.
[11] Poaty fq. 21.
[12] Poaty fq. 235.
[13] Poaty fq. 257.
[14] Poaty fq. 206.

Në shqipëri nuk ka më pranga mendimi . . .

Intervistë: Dritëro Agolli

Me Dritëro AGOLLIN, poet dhe shkrimtar i shquar, ndër më të shquarit në letrat e sotme shqipe, kryetar i Lidhjes së shkrimtarëve të Shqipërisë, anëtar i KQ të PPSH-s, por mbi të gjitha »fshatar i jugut«, u takuam ditën e parë të mbërrijtjes në Shqipëri, në Kolokuiumin ndërkombëtar »Naim Frashëri dhe koha e tij«, që u mbajt në Tiranë më 19 e 20 tetor 1990, dhe u morëm vesh të shihemi sërish për një bisedë më të gjerë.



Pas disa ditësh e kërkova në Lidhjen e Shkrimtarëve. Eshtë në plenumin e partisë, më thanë. Në mbrëmje-asnjë fjalë për mbledhjën e plenumit, as në radio as në TVSH. Të nesërmen shtypi shqiptar asnjë fjalë për mbledhjën e plenumit. E kërkova sërish ditën e dytë në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe përsëri e njëjta përgjigje. Çfarë plenumi, u them, mjetet e informimit nuk e dhanë asnjë lajm për plenum. Mjetet tona të informimit-jo, tha me shaka bashkëbiseduesi, por për këtë mbrëmë njohtoi »Zëri i Amerikës«. Edhe te ne, i them po me shaka, TVP-ja informatat për ndodhitë rreth ndërtesës së vet dhe në Prishtinë, i merrte nga Tanjugu!?

Me Dritëro Agollin u takuam në mbrëmje, kur doli nga plenumi, dhe, për lexuesit e »Alternativës«, me të bëmë këtë bisedë:

ALTERNATIVA: Në këtë vit është folur shumë për demokratizimin e jetës e të marrëdhënieve shoqërore në Shqipëri. A ka filluar me të vërtetë dhe deri ku mund të shtrihet demokratizimi në Shqipëri?

D. Agolli: Procesi i demokratizimit në Shqipëri vjen gjithmonë e më shumë duke u thelluar. ai ka përfshirë të gjitha fushat e jetës së shoqërisë. Asnjëherë Shqipëria nuk ka zjerë e nuk ka vluar kaq shumë nga diskutimet e nga shprehjet e mendimeve të lira për politikën, kulturën, ekonominë, ideologjinë dhe gjithë konstitucionin shpirtëror. Mjaft parime e dogma të ngrira tani janë çarë dhe janë shkrirë. Në fushën e ekonomisë po çahet centralizimi fanatik dhe përqëndrimi i ngurosur, që frenonte prodhimin dhe gozhdonte në vend rendimentin e punës. Në ndërmarrjet ekonomike, në uzinat, në fabrikat, në qendrat e ndërtimit e në punishtet po hyn mekanizmi i ri ekonomik e vetëveprimi, që lejon fitimin, që i lë dorë të lirë punëtorit të veprojë më gjerë drejt stimulit material. Krahas kësaj gjen përkrahje përhapja e pronës private, çelen dyqane vetiake, kafene, pijetore e qendra shërbimi të tjera. Nga ana tjetër hapen sipërmarrje të përbashkëta me firma të huaja dhe ndërmerren gjithashtu ndërtime objektesh po me firma të huaja.

Ky proces demokratizimi nuk ecën vetëm në fushën ekonomike. Një fushë tjetër ku ndikon me forcë ky fenomen është ajo e veprimtarisë shoqërore dhe e legjislacionit. Po përmirësohen raportet e shtetit me qytetarët dhe po kthehet më tepër vëmendja në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu u hap ministria e drejtësisë dhe u vendos avokatura në mbrojtje të qytetarit. Qytetari që bie në fatkeqësi tani mbrohet nga avokati i tij. Avokati ka të drejtë të hyjë edhe gjatë hetuesisë, gjatë pyetjeve që i bëhen fatkeqit ende pa dalë në gjyq. Ligjet tani askush s'ka të drejtë t'i marrë nëpër këmbë.

Me legjislacionin e ri në zgjedhjet e Kuvendit Popullor nuk propozohet vetëm një kandidat për deputet, por dy dhe më shumë. Çdo organizatë masash apo shoqatë e njohur me ligj, si Fronti Demokratik, Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Rinisë, Bashkimi i Gruas, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, Bashkimi i Gazetarëve e të tjera kanë të drejtë të propozojnë kandidatët e tyre për deputetët në Kuvendin Popullor. Edhe individë të veçantë mund të paraqesin programin e tyre dhe të nxjerrin veten si kandidatë për deputetë. Kjo është një dukuri e rëndësishme e kohës në procesin

e demokratizimit të vendit, që do ta pasurojë jetën dhe do t'i japë liri të vërtetë mendimit në dobi të rritjes së personalitetit të njeriut.

Procesi i demokratizimit të vendit është shtrirë gjerësisht edhe në politikë dhe në ideologji. Shqipëria tani merr pjesë dhe do të marrë në të gjitha aktivitetet ndërkombëtare dhe në të gjitha organizmat që nga Sigurimi evropian, Helsinki e deri tek Evropa e bashkuar. Kjo është një hapja që e kërkon koha, që e kërkon vetë zhvillimi dhe modernizimi i Shqipërisë, përparimi dhe prosperiteti i saj. Në këtë kuptim justifikohen edhe kreditë dhe ndihmat që mund t'i marrim nga bota, të cilat dikur ishin të ndaluara nga kushtetuta. Tani ky ligj i kushtetutës po ndryshon. Por ne do të marrim ato kredi, atë ndihmë që nuk rrezikon pavarësinë e vendit. Në qoftë se dikush na vë kushte për kredi që janë në dëm të pavarësisë sigurisht që ne nuk jemi çmendur që t'i marrim! Mbi të gjitha ne vëmë pavarësinë dhe lirinë e Shqipërisë.

Në procesin e madh të demokartizimit të vendit hyn edhe lejimi i fesë dhe i institucioneve të saj. Ne udhëhiqemi në përgjithësi në problemet e fesë nga mendimi i rilindësve tanë të shek. XIX, se »feja e shqiptarit është shqiptaria«, por në veçanti duam të respektojmë edhe sentimentet e njerëzve. Nëse njerëzit duan të hapin xhami, kisha, tyrbe e teqe le të hapin. Nuk i ndalojmë. Njëzet e ca vjet më parë ne nxorëm një ligj që ndalonte fenë dhe institucionet e saj, e nxorëm nën presionin e rinisë, pasi ajo nuk donte as kisha as xhami. Atëherë në përgjithësi u shpejtuam, pasi nuk u moren parasysh ndjenjat e njerëzve, ndjenjat e popullit. Koha që është rregulluesi më i mirë e ndreqi këtë gabim.

Siç thashë, Shqipëria vlon nga mendimet dhe nga pluralizmi i këtyre mendimeve. Por duhet shtuar se në fillim të procesit të demokratizimit ka qenë shumë vështirë të thyeje disa parime që ishin kthyer në dogma. Për shembull heqja e pronës private, refuzimi i kredive, ndalimi i fesë, mos lejimi i avokaturës e të tjera ishin kthyer në parimet e socializmit, të kolektivitetit, ishin bërë dogma si të teologjisë, si të Kuranit apo Tallmudit, që po t'i prekje quhej hereti. Fshatarit nuk i lejohej as tokë, as bagëti private, qytetarit nuk i lejohej asnjë kioskë ku të shiste edhe dy fletore se quhej shkelje e parimeve të socializmit. Kjo ndrydhte personalitetin, mendimin dhe inisiativën e njeriut; kjo mbante në vend prodhimin; kjo varfëronte jetën. Doemos menjëherë pas revolucionit, Shqipëria doli e varfër dhe e rraskapitur. Asaj i duhej një rregull e një disiplinë; asaj i duhej një shtet i fortë dhe i centrlizuar, pasi populli ynë në 3.000 (trimijë) vjet e ekzistencës së tij nuk ka pasur shtet të fortë, gjithmonë ka qenë ose i pushtuar, ose me tokë të copëtuar, ose i kërcënuar nga armiqtë. Në gjysmë shekullin e fundit Shqipëria u bë shtet modern me ekonominë, politikën dhe kulturën e saj solide. Dhe kjo ishte një arritje e madhe. Por që të vinte kjo duheshin edhe shtërngime, edhe, si të thuash rreptësi dhe disiplinë. Tani erdhi një kohë që t'i rishikojmë disa gjëra të shkuara, disa rregulla e parime, që ishin bërë pengesë për të shkuar drejt progresit. Historia na mësoi...

ideatori i këtij procesi të demokratizimit është Ramiz Alia.

ALTERNATIVA: Për demokratizimin e jetës në Shqipëri u fillua të flitet pas ndryshimeve në Evropën Lindore. A do të thotë kjo se ky është një demokratizim i imponuar?

D. Agolli: Ndryshimet në procesin e demokratizimit të vendit te ne i solli koha. Ne ato i bëjmë sipas kushteve të vendit, sipas konstitucionit tonë shpirtëror, sipas historisë sonë, sipas psikologjisë sonë. Ato i bëjmë gradualisht, se me shoqërinë nuk bëhen eksperimente si në laboratorët e mjekësisë me minjtë. Shoqëria nuk është mi i bardhë që të bësh eksperiment. Doemos nga eksperienca e ndryshimeve në Evropën Lindore, edhe pse në disa raste e hidhur, ne diçka mësuam. Por esenca është jona. Ne kemi pasur zhvillime të ndryshme nga Evropa Lindore edhe para ngjarjeve të sotme. Por bota është një enë komunikuese. E kemi mësuar në lëndën e fizikës, këtë enë komunikuese, që kur ishim nxënës. Kjo enë komunikuese jep e merr. Natyrisht që edhe kjo jep mësime...

ALTERNATIVA: Në ç'raport qëndrojnë politika dhe letërsia në Shqipëri: cila i paraprin njëra- tjetrës?

D. Agolli: Letërsia ka marrë pjesë vetë në procesin e demokratizimit. Ajo duke kërkuar demokratizim, ka demokratizuar veten e saj. Edhe ajo në metodën e saj të të ashtuquajturit soc-realizëm hodhi poshtë shumë dogma dhe fitoi një mendim të ri për ta parë jetën më gjerë, për ta konceptuar atë në kompleks dhe në ndërlikim dhe jo në mënyrë maniheiste, jo në mënyrë të thjeshtësuar dhe bardhë e zi sipas llogarive të skematizmit. Letërsia e vërtetë dhe shkrimtarët e vërtetë edhe më parë nuk janë pajtuar me skematizmin e soc-realizmit, pasi i kanë thyer vazhdimisht dogmat.

ALTERNATIVA: Cilat ishin këto dogma?

D. Agolli: Dogma ishin bërë problemet e heroit të ashtuquajtur pozitiv, hero i mbushur më agjitacion, propagandë dhe didaktikë, që nuk ishte njeri, por hije njeriu. Dogma ishin bërë problemet e partishmërisë, çështjet e tipikës në art, çështjet e strukturave dhe formave letrare etj., etj.... Kurse në kohën e sotme nuk ka as heronj e personazhe tabu, as tema tabu dhe as probleme tabu. Shkrimtari rikrijon realitetin e sotëm e historik, ai e pasqyron njerinë dhe jetën e tij pa pranga mendimi, pa komandë dhe pa diktim nga dikush. Mjaft shkrimtarë dikur ilustronin ligjet e vendimet e shtetit. Në të vërtetë shkrimtari duhet të mos ilustrojë ligje, por ta mësojë shtetin si të drejtojë më mirë dhe ta detyrojë politikën për t'u bërë më humane. Shkrimtari nuk mund të jetojë jashtë historisë dhe politikës. Ai që pohon se qëndron jashtë politikës, gënjen dhe gënjen bile me gënjeshtra me bisht. Çështja është që letërsia nuk duhet të politizohet, të vulgarizohet me frazeologji politike. Shkrimtari në veprën e tij mbron diçka. Kjo diçka që unë mbroj nuk vjen nga qielli, por nga toka. Dhe në tokë është edhe historia, edhe politika. Edhe Homeri, edhe Shekspiri, edhe Servantesi, edhe Tolstoi kanë mbrojtur diçka, kanë pasur një ideal. A qëndron ideali jashtë historisë dhe politikës? Jo! Për derisa jetojmë në shoqëri, bashkëjetojmë me politikën. Kjo bashkëjetesë formon historinë. Historia nuk është koleksionere e fletëve, gurëve të çmuar dhe fluturave; ajo nuk bën herbariume. Në të mbetet vula e jetës së popujve, jetës ekonomike, politike, ideologjike, fetare, kulturore...

ALTERNATIVA: Kam përshtypjen se në Shqipëri është lënë pas dore çështja kombëtare dhe na duket se paska rënë shumë ndjenja kombëtare e qytetarëve shqiptarë?

D. Agolli: Sot në Shqipëri në plan të parë, edhe në procesin e demokratizimit, është çështja kombëtare, mbrojtja e interesave të vendit, ruajtja e identitetit nacional, patriotizmit dhe krenarisë kombëtare. Një Shqipëri progresive, një Shqipëri moderne rrit krenarinë dhe patriotizmin e gjithë shqiptarëve brenda kufijve të saj dhe jashtë kufijve kudo që janë. Doemos nëna nuk çmohet dhe nuk dashurohet nga pasuria. Nëna për fëmijen është nënë edhe të jetë veshur me zhele, fëmija atë nuk e shkëmben me asnjë grua të veshur me xhevahire.

ALTERNATIVA: Dëshira dhe gatishmëria e qytetarëve shqiptarë, sidomos e të rinjve, për të ikur jashtë Shqipërisë po më duket është për t'u shqetësuar?

D. Agolli: Kohët e fundit në Shqipëri ka pasur mjaft arratisje jashtë kufijve. Dihet që iken shumë përmes ambasadave. Ka edhe dëshira për të ikur jashtë, por kjo nuk do të thotë që në masë është dobësuar ndjenja kombëtare. Unë jam i bindur se ata që kanë ikur, sado të pashpirtë të kenë qenë, tani qajnë për gurët dhe drurët e Shqipërisë, për malet e lumenjtë e saj. Si thoshte Çajupi:

Mëmëdhe quhet toka,
Ku më ka rënur koka
Ku kam pasur nënë e atë,
Ku më njeh dhe guri i thatë.

Të papjekurit ose kuriozët, apo kërkuesit e avanturave i tërheq bota, i tërheqin rrugët nëpër Evropë, se duan të shohin së ç'bëhet andej, se i joshë e largëta dhe e ndaluara, se janë të dehur. Por zakonisht sarhoshët apo të dehurit, kur i del pija, merzitet dhe zë qanë. Edhe ata të mjerë të arratisur nga pija politiko-shoqërore tani u ka ikur e dehura dhe qajnë për atë vend ku i »njeh dhe guri i thatë«.

Nejse, procesi i demokratizimit edhe ikjen dhe udhëtimin jashtë Shqipërisë do ta bëjë si diçka të zakonshme dhe njerëzit sado të largohen nga vatra prindërore, përsëri pak hi dhe shpuzë prej asaj do të kenë në gjokset e tyre. Ndjenja kombëtare është si buka. Të hahet bukë, ha! Mua më flitet shqip, flas. Që në gjuhën shqipe është atdheu dhe atdhetarizmi...

E përsëris. Nuk është dobësuar ndjenja kombëtare. Në disa njerëz përkohësisht është turbulluar pasi kanë fryer erëra të forta. Do të pushojnë erërat e propagandave antishqiptare dhe liqeni i ndjenjës kombëtare do të kullohet...

ALTERNATIVA: Po ikja e Ismail Kadaresë?

D. Agolli: Ismail Kadareja është shkrimtarë i shquar i vendit tonë. Vepra e tij mbetet e gjallë dhe nuk futet në arkivë, por ai gaboi rëndë. Veprimi i tij nuk është në traditën e intelektualit të ri shqiptar. Ai nuk ishte i persekutuar, përkundrazi i nderuar mbi të nderuarit. Nuk është as disident, pasi nuk ka vuajtur. Ishte i lirë ta thoshte çdo mendim. U arratis, por me siguri do të pendohet, si shumë nga të arratisurit. Ungjilli thotë »Falua, o zot, se s'dinë ç'bëjnë«!

ALTERNATIVA: Çka mendoni për Kosovën? Kam përshtypjen se politika zyrtare e Shqipërirë çështjen e Kosovës e sheh si çështje të Jugosllavisë dhe ngurron të përzihet në këtë çështje?

D. Agolli: Çështja e Kosovës është çështja e familjes, e vëllait, e farefisit, e gjakut. Eshtë çështje e celulave dhe e indeve të një trupi. Një gisht t'i pritet një kosovari e ndjen gjithë trupi i Shqipërisë deri në Konispol. Shqipëria është një organizëm i gjallë. Nuk është një gur, që po ta ndash në dysh nuk del as gjak as lëng. Ajo është një qenie e gjallë që nuk jeton po t'ia ndash trupin në dysh, se i sakatohen organet, e vdes hemoragjia. Prandaj kur ngremë zërin në mbrojtje të Kosovës kundër egërsisë çnjerëzore dhe inkuizitore të shovinistëve serbë, neve na dhemb trupi ynë i rrezikuar nga hemoragjia. Një shqiptari që nuk i dhembset Kosova dhe nuk e ngre zërin në mbrojtje të saj, nuk e do trupin e tij, nuk e do shtatin e Shqipërisë hallemadhe. Nuk është këtu çështja se po të mbrosh Kosovën futesh në punët e brendëshme të Jugosllavisë. Përkundrazi Jugosllavia futet me thikë në dorë ne punët e brendëshme të Shqipërisë, pasi pret e grin një pjesë të trupit të saj. Andej është gjaku ynë, rreh pulësi i gjymtyrëve tanë, qysh mos na dhembë! Pse, prej guri qenkeshim ne, që të mos na dhembë asnjë gjymtyrë? Padrejtësitë e historisë ndaj tokës së Shqipërisë nuk na e shuan dhembjen dhe nuk na e paralizuan ndjenjen kombëtare. Ne duam dhe kërkojmë me zë të lartë deri në dhembje që Kosova të jetë e barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe urrejmë deri në terbim marrjen nëpër këmbë të nderit të asaj krahine me shqiptarë, me popull shqiptar jo me minoritarë shqiptarë. Eshtë popull që ka nxjerrë luftëtarë të lavdishëm dhe dijetarë, atdhetarë që nga Isa Buletini e deri te Rexhep Qosja; që ka nxjerrë poetë, shrkimtarë e artistë e historianë që janë krenaria e kombit tonë si Ali Podrimja, Din Mehmeti, Azem Shkreli, Jusuf Buxhovi, Nazmi Rrahmani, Adem Demaçi, Ali Aliu, Ibrahim Rugova, Ekrem Kryeziu, Zekeria Cana, Ali Hadri, Rexhep Ismaili, Idriz Ajeti e me radhë e me radhë-një pyll të tërë, pyll me drurë të mëdhenj e të drejtë që nuk ka çt'i bëjë asnjë sopatë, qoftë kjo elektrike apo e sofistikuar. Dhe më thënkan mua serbët: »pse ndërhyn në punët e brendëshme!« Qysh s'paskam të drejtë të ndërhyjë, kur serbët po ndërhyjnë me sopata në pyllin tim kombëtar, në thesarin më të madh? Si thotë një këngë:

Dale, bej, se kam një fjalë
Dale, bej, të ndez cigarë,

Se nuk jam çanak me dhallë,
Po jam bilbili me pallë!...

Unë nuk jam shovinist, por këta serbomëdhenjtë ta sjellin në maje të hundës dhe të detyrojnë të bëhesh shovinist. Nga inati i tyre mezi e mbaj veten për të mos u bërë shovinist...

ALTERNATIVA: Demonstratat në Kosovë filluan më 11 mars, vazhduan më 26 mars, pastaj me 1 e 2 prill 1981, ndërsa ju, sa më kujtohet, me 8 prill 1981 bëtë komentin e parë, d.m.th. pas komenteve të, pothajse, të gjitha agjensive botërore të lajmeve. Atbotë ju emisionin e lajmeve e fillonit me lajmin për prodhimin e vezëve... A nuk është kjo një vonesë e madhe?

D. Agolli: Ne faktet i verifikojmë shumë dhe me hollësi, pastaj flasim dhe shkruajmë në shtyp. Pozita jonë e kërkon që të jemi të saktë. Por kur flasim, flasim me zërin e plotë. Më 1981 për ngjarjet në Kosovë ne nuk kemi pasur asnjë lëkundje për të folur publikisht dhe për të shkruar në shtyp, se Kosova, siç, thashë, nuk ndahet nga kauza jonë. Dhe nuk folëm me vonesë... Punë ditësh... Duheshin përgatitje nga të gjitha anët. Për këtë asnjë keqkuptim dhe asnjë dyshim të mos ketë. Kosovën historia e ka futur në ndërgjegjen e Shqipërisë dhe kur zë vend në ndërgjegje rrallë se del prej andej. Ndërgjegja nuk është kuti, që të heqësh ç'të duash prej saj!...

ALTERNATIVA: Edhe për Adem Demaçin, më duket, është folur shumë vonë në Shqipëri?!

D. Agolli: Para disa vjetëve në kemi botur një tregim të Adem Demaçit. Këtë vit në revistën letrare »Nëntori« u botua romani i tij i fuqishëm »Gjarpijtë e gjakut«. Por ky roman njihej prej shumë kohësh në Shqipëri dhe të gjithë shkrimtarët dhe mjaft lexues të thjeshtë e kanë lexuar përmes botimeve të Prishtinës. Dhe A. Demaçi ka gëzuar që heret një respekt të madh edhe për krijimtarinë e tij, edhe për jetën e tij prej martiri. Për të është folur ngaherë. Në shtyp është shkruar më vonë. Edhe në Kosovë, me sa di unë, vonë është folur për figurën politike të tij. Për arsy që merren me mend ne nuk mund të flisnim para se të fliste Kosova. Si ta themi duhej të gjëmonte topi i Kosovës që ta dëgjonim...


ALTERNATIVA: Edhe disa fjalë për »Alternativën«?

D. Agolli: I uroj revistës suaj punë të mbaër. Eshtë një revistë që ngjallë mjaft interes. Tani ajo ka një përmirësim të ndjeshëm. Reviste është tribunë. Roli i tribunës është të bashkojë njerëzit rreth një ideali, rreth një qëllimi të madh. Shtypi është e shtëna e parë e lirisë.

Shemsi Reçica

MEGJITHATË, NË SHQIPËRI NUK PO NDODHË ASGJË...

Intervistë me mr. Llukman Halilin — 3. Nëntor, 1990



Zoti Llukman, Ju lutëm si do të prezentoheshi para lexuesëve te »Alternativës«?

Jam magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare, por para së gjithash gazetar i TVP-së, redaksisë së politikës së jashtme. Mirëpo, nga që me masat represive të Kuvendit serb u mbyll TVP-ja m' u desht që të rikualifikohem dhe tani jam korrespondent i agjensisë kroate të lajmeve HINA për Kosovë dhe Shqipëri si dhe raportues i radiostacionit të mirënjohur anglez BBC të Londrës, gjithashtu për Kosovë dhe Shqipëri me seli këtu në Pristhtinë.

Cili është profili Juaj politik?

Aktualisht nuk jam anëtar i asnjë partie politike. Me disa kolegë një kohë të gjatë mendojmë t'i qasemi punës për formimin e Partisë Liberale Shqiptare e cila do të dilte me koncepcion të qartë mbi opcionet për zgjedhjen e çështjës së Kosovës.

Si e vlerësoni Ju pozitën e Kosovës si subjekt politik ndërkombëtar?

Kosovën subjekt ndërkombëtar e bëri politika represive e Serbisë. Kësaj më së shumti i kontriboi shovenizmi serbomadh. Më pastaj pozita gjeostrategjike dhe së fundi proceset me të reja demokratike në Evropë të cilat qartë bëren me dije se në mes të Evropës nuk do të lejohet gjenocidi sllav ndaj popullit më të vjetër të Evropës.

Ngase pozita e tanishme e shqiptarëve është e njohur, çka mendoni Ju për të nesermën shqiptare?

Sigurisht e paramendoj më të lumtur. Por kujtimi mbi të sotmen shqipare do të bartet në shumë gjenerata, do të bartet në historinë e popullit tonë. Lumturinë e së nesërmes e paguam mjaft shtrenjtë; mbi 100 vitkima, aq herojnë nuk patëm as ne luftën e kaluar.

Çka mendoni Ju, ku është vendi i Shqiptarëve në proceset e integrimit Evropian?

Vendi i tyre është aty me Evropianët. Shqiptarët duhet patjetër dhe sigurisht do ta bëjnë këtë, do të integrohen në Bashkësinë Ekonomike Evropiane, por sa i përket integrimit në asociacionet e ndryshme ballkanike duhet pasur kujdes por edhe aty është i pashmangshëm bashkëpunimi rajonal.

Si e shihni Ju zoti Llukman, çështjën Shqiptare në Ballkan dhe Evropë pas bashkimit të Gjermanive?

Shoh se aludoni në bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Për një gjë të këtillë nuk janë krijuar rrethanat. Një gjë të këtillë nuk e dëshiron as

Shqipëria. Tirana paraqiti kërkesen për inkuadrim në Konferencën për Bashkëpunim dhe Siguri (Helsinki) e aty më sa dij unë flitet për pacenueshmërinë e kufijve dhe së dyti Evropa nuk do të ketë kufij, e tëra do të jetë e bashkuar, e në këtë kontekst edhe Kosova me Shqiperinë por edhe me Jugosllavinë dhe Evropën.

Para ca ditësh ishit në vizitë zyrtare në RP të Shqipërisë, çfarë po ndodhë atje dhe çfarë interesimi tregojnë ata lidhur me zgjedhjën e çështjës Shqiptare në Jugosllavi?

Interesimi i Shqiptarëve (të Shqipërisë) për Kosovën është shumë i madh por ata kanë probleme të mëdha, kan problem ekzistencën, atëherë humbet çdo interesim, ndërkaq pushteti komunist nuk ia doli të zgjidh asnjë problem në botë. Çështja Shqiptare është shumë problem i madh per të cilen komunistët vetëm mund të mendojnë por jo për zgjedhje por vetëm për konstatimin e faktit (realiteti).

Në Shqipëri nuk po ndodhë asgjë e kjo është më tragjikja. Isha atje edhe para gjashtë muajsh, asgjë nuk ka ndryshuar, flitet shumë e bëhet pak. Pushteti falenderuar Ramiz Alisë po bënë ca përpjekje për të ecur përpara por kjo nuk mjafton. Shqipëria është padyshim vendi më i varfër dhe më i pazhvilluar në Evropë dhe botë e çdo gjë arsyetohet me armiqtë e shumtë, që rrethonin Shqipërinë nga çdo anë, por këto 10 vitet e fundit nuk arsyetohen më asgjë.

Çka mendoni, a pritet se do të përfundoj koha e monopolit dhe diktaturës moniste – komuniste si dhe kur priten zgjedhjet e lira?

Ajo kohë ka perënduar edhe për Shqipërinë. Por më befason dhe pa masë më dëshpron fakti se këtë nuk don ta kuptojë udhëheqja shqiptare. Çfarë faji historik ka bërë populli shqiptar që më Kuben dhe Vijetnamin të mbetën *oazë* e së keqës botërore – sistemit të tejkaluar, të demoduar dhe në të gjitha sferat të kompromituar. Sistemi i këtillë u kompromitua si gjithëkund ashtu edhe në Shqipëri. Popullit Shqiptar, socializmi i këtillë i solli vetëm verfëri materiale dhe shpirtërore, si popull më i vjetër i Evropës, këtë më së paku e meritoi.

– Sa i përket zgjedhjeve të lira mendoj se edhe në Shqpëri ato do të mbahen vitin e ardhshëm. Ato askush s'mund t'i pengojë. Një gjë të këtillë nuk do ta lejoj Evropa. Edhe Tirana më në fund duhet ta kuptojë se ka perënduar monopoli komunist mbi të vërtetën.

A mendoni se Shqiptarët ishin dhe prapë bëhën viktimë (një pjesë e konsiderueshme e tyre) e ideologjisë e cila erdhi pikërisht prej atje prej nga edhe iu kanos rreziku permanent i zhdukjës biologjike të tyre? Njëherit atë ideologji, ajo pjesë e konsiderueshme e Shqiptarëve e proklamojnë dhe e propagandojnë edhe nga ato vende dhe pikërisht nga ato vende në të cilat nuk gjeti shprehje kjo ideologji, e këtyre u mundesoi dhe ju dha hapësirë që pikërishte aty, falenderuar demokracisë perëndimore, të sulmojnë të »zotin e shtëpisë« e të lansojnë ideologjinë e vet – vrasjës politike. Është kjo pyetje ca retorike, Ju lutëm për komentin Tuaj?

Komunizmi apo më mirë më thënë socializmi më çfarëdo ngjyra është pjellë *sllavo-çifute* (Marksi ishte çifut, vërjtje e redaksisë) nga i cili hoqën dorë se fundi edhe sllavët e më herët edhe çifutët. Më kujtohen kohët kur në Gjermani vepronte *»Fronti i Kuq«* i Jusuf Gërvallës dhe kërkonin strehim edhe mbrojtje nga Gjermanët të cilët më Kushtetutë e ndalonin të drejtën në punë antarëve të partisë komuniste. Ishte krejt kjo një lojë e shërbimeve informative me emigracionin shqiptar krejt në kurriz të Kosovarëve, ata e paguan më së shtrenjti e shumë edhe me kokë. Ishin kohë të iluzioneve, ashtu siç ishte iluzion edhe socializmi. Në vitin 1987–88 isha korrespondent i TVP-së në Gjenevë dhe pash se si krerët e emigracionit të ashtuquajtur marksistë- leninistë (të cilët as që e kanë lexuar Marksin, e mos të flas për Leninin) i ngritnin për Një Maj punëtorët tanë në demonstrata kundër siç thoshin »eksploatorëve zvicëran« e unë atë kohë si gazetar kisha të ardhura prej vetëm 200 DEM.

Socializmi kurr nuk pati predispozita për shumë shkaqe që të pranohet nga shqiptarët. Eshtë gjë e huaj për etnosin e popullit tonë, në kontradiktë me çdo gjë që është shqiptare, me kulturë, traditë dhe histori. Kisha thënë lirisht se sistemi i këtillë është në qenien e vetë thellë antishqiptar andaj shqiptarët kudo që janë si në Shqipëri, Kosovë, Perëndim dhe SHBA duhet ideologjinë e këtillë, për hir të mirëqenies kombëtare ta flakin njëhere e përgjithmonë, ndryshe është kjo tradhti ndaj çështjës kombëtare dhe mirëqenies së përgjithshme.

Zoti Llukman, a keni dëgjuar se SHKSH »MIGJENI« është duke bërë përgatitje intensive lidhur me mbajtjen e një Sesioni shkencor i cili do të mbahet në Lubjanë në fund të këtij viti me temën:
»Proceset e integrimit të Evropës
dhe çështja Shqiptare«
ku do të marin pjesë të gjitha Akademitë e Shkencave dhe të Arteve të të gjitha republikave të Jugosllavisë dhe shteteve fqinje Ballkanike e dijatarë të tjerë të njohur. Cili është komenti i Juaj lidhur me këtë?

Më gëzon kjo çështje, ngase shkenca është ajo me meritorja që percakton primesat e veprimit dhe të definimit të shumë problemeve, prandaj inisiativën e këtillë e përshëndes dhe ju uroj sukses.

A mendoni Ju se Shqiptarët kanë nevojë për një Komitet të shpëtimit kombëtarë?

Kurrsesi! Kurr më komitete, (bëjë shaka!) nuk ka nevojë për këtë ndoshta në rrethana të caktuara do të mund të vepronte ndonjë Këshill Shqiptar por vetëm në rrethana të caktuara kur mund të rrezikohet qenia shqipare.

Mendoni se çështja Shqiptare do të zgjidhet vetvetiu me zhvillimin e demokracisë apo . . .?

Çështja shqiptare është nocion i gjërë, unë flas për Kosovën, demokracinë duhet zhvilluar, ajo nuk zhvillohet vetvetiu. Ne kemi bërë me dije e po

bëjmë pa ndërprerë se zgjedhjen e problemit e shohim në rrugën e dialogut dhe bashkëjetesës.

Kur do të çlirohet Republika e Kosovës dhe me çfarë strategjie?

Shikoni, Republika e Kosovës për mua është nocion, është çështje emotivë për ne, por Republika nënkupton shumë elemente përcjellëse, nuk mjafton vetëm akti i shpalljës, ajo duhet zbatuar, ndryshe vijmë në situatë të Lituanisë, Estonisë, Letonisë dhe Gruzisë.

Republika nënkupton para së gjithash elementet konstituive (ushtrinë, policinë, mbrojtjen popullore, shërbimet shtetërore etj). Ndërkaq personalisht besoj se milicia e Serbisë së shpejti do të terhiqet definitivisht nga Kosova.

Si e vlerësoni Ju Opozitën Kosovare (nëse mundemi kështu ta quajmë) dhe aktivitetin e saj politik lidhur më të ardhmen e afërt të Shqiptarëve?

Opozita Kosovare është e re dhe ende nuk është kristalizuar si opozitë, nga se në opozitë është i tërë populli. Situata ashtu deshti që mbar populata shqiptare e Kosovës të kalojë në anën e Lidhjës Demokratike të Kosovës të cilen siç e dini po e udheheq »Haveli i Kosovës« dr. Ibrahim Rugova, që është fat i madh, jo vetëm për këtë parti por edhe për mbar Kosovën. sa i përket aktivitetit politik më duket se veprojnë aq sa munden dhe i lejojnë, sigurisht LDK-ja është partia më e përsekutuar që është regjistruar (nuk i lejojnë të hapin as xhiro-llogarinë) ndërkaq partitë tjera mendoj në social-demokratët dhe partinë fshatare të Kosovës, ndonëse me programe tërheqëse mbetën nën hijen e LDK, por besoj se së shpejti situata do të ndryshojë. Në skenë ditëve të fundit u paraqit edhe partia demokrishtere shqiptare edhe programi i tyre është mjaft »politikisht« i angazhuar dhe premton shumë, premtojnë para së gjithash Evropën. Por më duket se as njëra parti ende nuk kanë program të qartë lidhur me ardhmërinë e afërt të shqiptarëve.

Jeni njohës i mirë i proceseve politike të cilat u zhvilluan në vendet socialiste, a mund të krahasohen ato me atë që po ndodhë në Kosovë dhe Jugosllavi?

Në shumë aspekte po, në mënyrën e organizimit të opozitës, shtresave të cilat e udheheqnin rrezistencën etj. por përgjithësisht jo ngase esenca e levizjeve në ish vendet socialiste kishte në fillim karakter social. Në vendet e lindjës të udhëhequar nga Polonia u luajt një lojë e përsosur, por në këto vende kemi të bëjmë me popuj »politik« me traditë politike. Tek ata, edhe pse sllav, vepronin dhe jetonin nën diktatin e kishës e cila tradicionalisht mbronte interesat e popullit nga mafia komuniste. Po e përdori këtë nocion duke u kërkuar falje pjesëtarëve të mafisë nga se mund te hidhërohen që po i përziej me komunistët.

Si e perjetuat lajmin e azilantit më të ri nga Parisi për të cilin mësuat

përderisa ishe në Tiranë. Çfarë ishin reagimet në Shqipëri dhe si e komentoni JU një gjest të këtillë të një intelektuali siç është Kadare i famshëm?

Kadareja veproi si është më mirë. Jemi ne njerëz të vegjël që të gjykojmë për veprimet e madhshtisë së Tij. Ai ka vepruar në të mirë të të gjithë Shqiptarëve. Sigurisht se nuk ka pasur para vedit interesat personale.

Si kaluat me policinë serbe në fshatin Doganaj?

Si po kalojnë të tjerët, ne kaluam mirë! Ata na ndalen më qëllime tjera, në ndërkohë diçka u ndryshua. Lidhur më këtë kolegu im më të cilin sëbashku patem afërsinë e takimit më policinë serbe, ka shkruar një ese të mirë për *Vjesnik,* sigurisht e keni lexuar. Por edhe pse s'pati maltretim fizik, »loja psikike« ishte e ndyër.

A e dini Ju himnin Shqiptarë, po, po himnin Shqiptarë?

Patjetër, babai im për himnin shqiptar vuajti 6 vjet burg.

Biseden e zhvilluan: **Gani Buçinca** e **Abedin Maliqi**

Letër e mbyllur Ismail Kadaresë

Dosja K.

VETËM I TYRE DESHËN TË ISHE MARROÇËT DUARPËRGJAKURIT E KOMBIT – suita e vërbëruar nga sadomazohizmi krenar-krekosës dhe lakmia për sundim; komunistët narcisoidë dhe ROJËT e NATËS SË PUSHTETIT. Por, tashmë ishe bërë i *njerëzimit*...

Vetëm i tyre deshën të ishe kimilsungëtmaocedunëtstalinëttitistëtenverianëtzhdanovistëtkosovarleninistëtsecuritateistëtateistët... i tyre dhe i NANËS PARTI! I tyre dhe i Kumunizmit! Të ofruan në Oborr, rojët e kafazit shqiptarë, por ai që tepër i ngushtë për shqiponja, andaj flut'rove në BOTËN E LIRË. KAFAZI NUK ËSHTË PËR SHQIPONJA O ZOT, a ka zot në këtë SHTEPI TË MALLKUAR? Adem Demaçi ka të drejtë! Por kafazi nuk është i denjë as për njeriun e vogël që kishte lënë dhjetë lëkura »kolhozeve« me origjinë ruso-shqiptare nën tingujt e verdhë e të frikshëm të emblemave njerëzngrënëse komuniste, parollave të kuqe sa Kështjella e Krujës. Mjaftë rrëfenin ato fytyra të verdha atë ditë në Brindiz, ato flatra të cfilitura shqiponjash të çartura e të uritura, shqiponjash me ckinla e zhele. Sa shpejt e kishte harruar gjuhën e dhunës bolshevike të Stara Gradishkës Baca Adem, o zot, e pse o zoti im i zi, Bacës nuk i ra ndër mend t'i mbrojë të cfiliturit, që me disciplinë të rreptë komuniste thyjnë gurë, kazamateve shqiptare, po merret me aq pasion dhe me aq sentiment me një shkrimtar!?

Asnjë pushtet nuk vlenë sa buzëgazi i prerë me rafale i Ylfete Humollit, as sa ëndrrat e secilit martir të Kosovës. E po të ishte marksizëm-leninizmi pararojë e popullit, Ylfetja s'do të hante dhè por do të lexonte romanin më të ri të I. K., do të shkonte në kino, teatër, operë, rok koncerte të »Pink Floyd-ve«... E ç'bëri marksizëm-leninizmi dhe krejt çifutorusizmi për Ylfeten, pos që i veshur me rroba kombëtare me gajtanë të zi-futë, mërgimtarëve të këputur nga malli, të rraskapitur nga ethet e ATDHEUT, u shet postere të saj kolor I. K. i dhe fund në poezi Betejës së Kosovës, asaj GUERNIKE të pambarim, të drejtën për flamur ngadhnjimtarë askujt nuk ia dhe! I. K. se Beteja ishte e askujt. Po jeta e censuruar e Jusuf Gërvallës ç'do të thotë vallë për komunistin e mundshëm shqiptar? PRERJET çka? Erdhën pastaj marroçë të padijshëm e të frikësuar nga emblemat e kuqe bolshevike-fobike dhe nisën te të gjuajnë me gurë I. K. me sadomazohistët që pushtetin e dinë për të vetmin zot të vrasin...

I. K. se hymni për Nânën Partin për dyzet e sa vjet nuk të ngrehu në qiellin e Ilirisë; Ta them troç: I URREJ SHKRIMTARËT OBORRTARË! Pak para se të te urrej i the vetës I. K. se u bëmë horë! Dhe tashti e kam përballë frymënshiunbaltën dhe Tokën e Shqipes që kërkon AZIL, MUNDËSI TË REJA PËR FLUTURIM – nga kjo SHTËPI E MALLKUAR! Po, Blerim Shala ka të drejtë! E admiroj se e ka tejkaluar paranojën dhe nuk i ha palla për gjuhën e hekurtpancirtë, nëse në çdo çast i vie nga deranga- dritaret. I mallkuar është në atë shtëpi në të cilën bie shi e vetmi. Të mallkuar jemi o zot! TË RRETHUAR!

Me 24 tetor u bë revolucioni i Madh PANSLLAV kundër Folesë së Shqipes, duke e shndërruar atë në Fole të Qyqes, medet, Ti I. K. me 24 tetor-merr udhë tjetër-me 24 tetor jam lindur unë Halil Matoshi në Shtëpinë e mallkuar jam ngjitur në Majë të Zhgënjimit. Majë Dallgorës. Pikërisht sot kur Ti I. K., unë ik nga vetja nga zhgënjimi, nga ditëlindja nga paranoja ik nga POLICIA E MENDIMIT... Sot zhdanovianët e Kosovës përbetohen në Republikë, argatët e deridjeshëm të LK-së e të pushtetit, flasin me

patetikë për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, Censorët që vetëm para dy vjetësh (kur K.-ja ishte ende oborrtar), nga shkrimet e mia bënin dosje dhe i çonin në policinë lokale të përforcuar me spiunë të Beogradit. Ti sot I. K. e ata ma kalojnë mua trefishë kur shkruajnë e shqirren për demokraci... O cili është fati im në këtë kaos zotëri??? Prendaj të shkruaj këtë letër të mbyllur mërzitshëm, të pagëzuar »*Dosja K.*«, ç'koinçidencë? Dosje H. Dosjës K. Pa autocensurë.

Mund të them se të gjithë të ndjekurit politikë në Folenë e Qyqeve të urrejnë I. K.

A mos nuk ishe (sëpaku formalisht) në anën e atyre që u bënin gjygj dhe i dënonin shqiptarët pa të drejtë mbrojtjeje, për nacionalizëm shqiptarë për prejardhje balliste për agjitacion fetar, liberalizëm dhe për teza borgjeze-demokratike ect. ect. Të ka vajtur mendja gjithsesi se burgu është i rëndë?! I kam shijuar vetëm dy javë krismat e hekurta të ngjyrës metalike të dyerve të çelikut, dy javë gjuhë prangash dhe trokëllimë çizmesh korridoreve të asaj skëterre të Prishtinës dhe nëpër qafën time të enjtur... TE MOS FLASIM PËR 28 VJETËT E ADEM DEMAÇIT!

BURGU ËSHTË FERR I. K. Për secilin njeri; po a të ka vajtur mendja vallë se njeriu mund të dënohet vetëm pse mendon. Dhe mendon ndryshe natyrisht nga ata dhe nga Ti!? Sidoqoftë, tashmë i di të gjitha I. K. E di se kosovarët e kaluan rininë skëterrave komuniste, po gjithashtu e di se shteti shqiptarë dhjetë vjet me radhë ka cituar Tanjugun- Fabrikën më të madhe të rrenave erëgjaku të Evropës, për t'i informuar anëtarët e Byros politike dhe barinjtë e Kooperativave-kolhoze, se ç'po ndodhte vërtet në Kosovë!? Dhe atëherë kur në Kosovë vriteshin fëmijë, ti dhe kolegët Tuaj, çobanë të »socializmit të vërtet« nga Kooperativa e Shkrimtarëve të Shqipërisë, në Bor keni pi raki me Komneniqët, Bullatoviqët, Drashkoviqët, Qosiqët, Maksimoviqët... dhe jeni përgëzuar me shlivovicë, me të cilën xhandarët serbë festojnë vrasjen e shqiptarëve!? DHE JENI PAJTUAR SE POEZIA NUK NJEH KUFIJ. Por plumbat e serbëve njohin kufij-hanë mishin e fëmijëve shqiptarë, heu, po dhembja e nânës a njeh kufij, zoti im? POEZIA ËSHTË VUAJTJE, nuk është parajsë kumuniste dhe lumturi e masave?

Mbi të gjitha je shkrimtar, SHKRIMTAR MBI TË GJITHA, më i madhi i tokës sonë. Ta ka dhanë zoti-thonë të mitë, DHUNTI NATYRE-thonë të tjerët. Thuaj pra, i ke folur ndonjëherë Enverit tonë dhe Nânës Parti: Doni socializëm apo Kosovë!? Nejse, asgjë nuk bëre më shumë, pos një embleme të ndërgjegjëshme dhe obligim qytetar. Kjo padëgjushmëri qytetare në Kosovë kaherë zuri fill, por ne nuk ishim të gjithë shkrimtarë as Kadare nuk ishim; e na ndiqnin si qentë, me qenë na ndiqnin kufijve, kur niseshim për azil: jugosllavëtaustriakëtitalianëtgjermanëtzvicëranët dhe frencezët na ndiqnin... Këtë fat e kishim se ushtarë të gjeneralit të vdekur ishim-ne të gjallët e vdekur e të pavarrosur – BANORË TË KOSOVËS – VARRIT DHE BURGUT KONSTANT!

Më në fund je Shkrimtar dhe Njeri, më ndjej, fare nuk jam sentimental e Ti je aq i madh sa e ke tejkaluar nacionin e ngushtë kombëtar, I. K. se i takon QYTETËRIMIT-LIBRIT ABSOLUT TË BORHESIT dhe do të

jesh i çmuar përjetë të admiroj I. K., ARTIST dhe NJERI. Urdhëro e shkruaj! FATI YNË ËSHTË KY!

Halil Matoshi
Lubjanë, tetor 24. Vetëm NJË nga
Vitet e Mbrapshta, vetëm NJË NGA
Orët e Liga . . . Në ikje!

Mednarodni sejem knjig v Frankfurtu

Ismail Kadare

1
Z vlaki, avioni, knjigovbusi prihajajo knjige,
Na veliki svetovni sejem,
Na Dhaskal Todhra,
Z vrečo črk v predvečerju,
Se spomnim ko avion vidim.

Šovinisti so ga neke noči ustrelili,
Ko je na hrbtu nosil albanske črke,
Njegova kri zlita po njih bila je
Prva tipografska barva.

Na tisoče knjig prihaja na Sejem,
S štirih straneh globusa,
V Albanskih knjigah
Gutemberg, poglej,
Kapljica krvi Dhaskala Todhrija.

Sramuj se,
Brezčastna strupena knjiga
Sramuj se,
Komercialni best-seler!
Ponavadi so narodi svoje
Velike knjige s krvjo prali.

3
Od vseh štandov je samo eden drugačen,
Kosovski štand je prazen,

Sovinisti gredo mimo,
Smehljajo se hinavsko,
Brez dvoma jih prizor veseli.

Da vidijo Kosovo takšno – so njihove sanje,
Brez knjig, brez umetnosti, brez duše,
Hitro in naveliko so poročevalci prišli,
Da bi to pustoš posneli.

Tri dni je bil takšen štand,
Četrti dan,
Ob polnoči,
So iz Beograda na hitro knjige poslali
Da bi škandal prikrili.

Z vlaki, avioni, knjigobusi?
Kako prihajajo ni važno.
Brez dvoma se j Dhaskal Todhra,
Pred njimi z vrečo na hrbtu odpravil.

Prevod: Abedin Maliqi

Azili historik dhe shtëpia e mallkuar

Blerim Shala

KADAREJA nuk banon më në TIRANË. Tani, diku në ndonjë paralagje të PARISIT, ky mbahet i izoluar nga policia frënge. KADARENË e mbrojnë dhe e ruajnë. Mbase edhe nga shqiptarët... KADAREJA nuk është më shtetas i regjimit të TIRANËS. Nuk është më INSTITUCION ZYRTAR, një njëmendësim metaforik-letrar i një realiteti politik. KADAREJA nuk braktisi SHQIPËRINË, KADAREJA i tha lamtumirë një pushteti dhe një ideologjie. KADAREJA e di se nuk mundet që *Vetëm ai të jetë i lirë.* Prandaj zgjodhi syrgjynosjen dhe izolimin. NOLI vdiq e u varros në mërgim. KADARENË e mban shpresa që do të vdesë dhe do të varroset në ATDHE. Në një Shqipëri të re.

KADAREJA nuk mund të bëhet HAVEL. Dihet pse. Megjithatë, ishte princ oborrtar. Të gjitha po, por edhe princ.

Në letrën-ndërgjegje të shpaluar para vetëdijes së kombit, para kohës, e cila matet me ORËT E LIGA dhe VITET E MBRAPSHTA, KADA-

REJA përmend tragjedinë, katastofën. KADAREJA përshkruan aktin historik të një kombi të përmbledhur në një vonesë, e cila pjell përçarje, kufi, vdekje, kufoma, mallëngjim, elegji. KADAREJA këtu shkruan me lëkurë, me asht, me rrënjë, me dhe. E pra, mbase të gjithë ne dalim si banor të një SHTËPIE TË MALLKUAR. E KADAREJA mallkon këtë shtëpi dhe këtë fat. KADAREJA më parë *azilin* e kërkonte dhe e gjente në letërsi, në ëndërr, në PALLATIN E ËNDRRAVE. Azilin e kërkone në fjalë. E aty mund të këtë vend vetëm për një njeri dhe për një kohë të shkurtër. Një komb i tërë nuk mund të strehohet në letërsi, në fjalë, në ëndërr.

● *KADARE MË PARË AZILIN E KËRKONTE DHE E GJENTE NË SHKRIM, NË LETËRSI, NË ËNDËRR, NË PALLATIN E DHËNDRRAVE. AZILIN E KËRKONTE NË FJALË. E ATY MUND TË KETË VEND VETËM PËR NJË NJERI DHE PËR NJË KOHË TË SHKURTËR. NJË KOMB I TËRË NUK MUND TË STREHOHET NË LETËRSI, NË FJALË, NË ËNDËRR. PRANDAJ, KADAREJA SOT GJENDET NË PARIS E JO NË TIRANË...*

Prandaj, KADAREJA sot gjendet në PARIS e jo në TIRANË... Prandaj KADAREJA përmend dhe shruan për tragjedinë kombëtare, për katastrofën kolektive, për mallkimin historik të fatit nacional. KADAREJA gjendet në PARIS për këto shkaqe. Kjo është një METAFORË e një AZILI HISTORIK, të cilin sot e kërkon kombi shqiptar. AZILI HISTORIK nga SHTËPIA E MALLKUAR.

KADAREJA shpreson. Shpreson se nuk do të vonehemi më. në të dy anët e BJESHKËVE TË NËMUNA, ky shpreson se nuk do të jemi më të nemur, të vdekur, të syrgjynosur. E di ai, e dimë të gjithë ne sa jemi të lodhur, të munduar, të rraskapitur...

KADAREJA nuk braktisi ATDHEUN. KADAREJA shpreson. KADAREJA e di se LIRIA ËSHTË ËNDRRA E ATDHEUT.

LIRIA ËSHTË VEND-LINDJA E ATDHEUT.

E KADAREJA është shrimtar i lirisë.

Albanski Havel?

Azil u Francuskoj za najpoznatijeg albanskog književnika Ismaila Kadarea

Mirko Galić

Najveći albanski pisac Ismail Kadare napisao je – u predgovoru francuskom izdanju romana svoga sunarodnjaka Migjenia – rečenicu kojoj se svi vraćaju kao svojevrsnom ključu za razumijevanje njegove odluke da napusti svoju zemlju i zatraži politički azil u Francuskoj: »Pod tiranskim režimom, veliki osamljeni pisac je kao stablo koje je obilježeno za sječu-. Je

li time opisao vlastitu sudbinu u zemlji koja važi za »posljednji bastion ortodoksnog komunizma u Evropi«?

Francuska se lako i brzo odlučila da Albancu dade traženi azil (od Milana Kundere »zemlja azila« nije imala tako slavnog azilanta), i da ga smjesti – zajedno sa suprugom, i sa obje kćerke – na neko »nepoznato mjesto«, toliko barem dok se sredi šok u redovima albanskih diplomata. Iako je bio kritičar režima u Tirani, Ismail Kadare je bio i njegov »službeni pisac«, neki kažu – »izlog u svijet«.

Za politički azil trebaju politički motivi, koje u slučaju pisca »Velike zime«, »Generala mrtve vojske«, »Kronike iz kamena grada«, »Palače snova«... ne treba ni izmišljati, ni zamišljati. Iako je u »zemlji orlova« imao golf na raspolaganju i posebni studio za pisanje, uživao »male privilegije« praveći »sitne kompromise«, kako s nešto zlobe pišu pariške novine, Ismail Kadare živio je u atmosferi i okolnostima »nepodnošljive opresije«. Kad su se pojavili demokratski signali s Istoka, njemu se Ramiz Alija ukazao kao – nada. »Vjerovao sam da je mogao postati albanski Gorbačov«, veli u »Le Mondeu«. Njegova »obećanja o demokratizaciji« ostala su, međutim, »mrtva«. »Izgubio sam svaku nadu da ću, iznutra, doprinijeti ublažavanju režima«. Zbog toga je odlučio napustiti zemlju, uvjeren, s jedne strane, da je »gubitak iluzija nepodnošljiviji od pritiska«, a s druge, da je »odsustvo plodno, ponekad jače od prususstva«. Uostalom, veli, ostavio je u Albaniji knjige koje će »bolje raditi za slobodu« od njega.

Možda je svoju odluku sam najbolje objasnio u pismu Aliji – kao »logični nastavak svega onoga što brani u djelima«. Pismo Ramizu Aliji je politički manifest koji završava slojevito sastavljenom nadom da će se »jednog dana« vratiti u zemlju. »Kad to kažem, ne mislim na povratak iza katastrofe, nego na povratak poslije istinske demokratizacije«.

Može li Ismail Kadare ponoviti slučaj Vaclava Havela? Neki na to svode njegovu novu misiju. On sam, pak, veli da mu takve usporedbe samo »kompliciraju život«. Albanska emigracija već ističe spremnost da ga vidi kao svoga šefa. Neki i kao »dobrog predsjednika«.

Glas savjesti pisca

Dr. Ibrahim Rugova, predsjednik društva književnika Kosova i prvak demokratskog saveza

»Zahtjev Kadarea, mog i našeg prijatelja, kao i velikog albanskog pisca za politički azil u Francuskoj doživio sam kao jedan glas savjesti pisca i kao intelektualni gest za brže demokratske i mirne procese u Albaniji i njegove zabrinutosti za Albance na Kosovu, kao i cjelokupnog albanskog naroda u svijetu. Preporučujem sadašnjoj albanskoj vladi da taj gest Kadarea ne treba uzeti kao neprijateljstvo, nego kao ozbiljnu opomenu za dobrobit albanskog naroda i kao izjavu najboljih namjera da albanski narod živi u demokraciji i da bude u evropskoj obitelji naroda u budućoj integraciji Evrope«, rekao je dr. Ibrahim Rugova.

»Zhgënjimi ishte më i madh se dhuna!«

A. Maliqi

Të vlerësosh veprimet e një intelektuali çfarë është Ismail Kadare, don të thotë të marrësh përsipër një përgjegjësi shumë të madhe.

Njëri nga personalitetet demokratike e revolucionare të Rrafshit të Dukagjinit, të cilin e kishte nxirosur qëllimisht OZN-a dhe për të cilin nuk guxohej të shkruhej asnjë fjalë e mirë ishte edhe Emrush Myftari. Disa nga udhëheqësitsë si dhe historianët servilë, që u bënin temena organeve të pushtetit represiv, asnjëherë s'guxuan ta nxirrnin në shesh të vërtetën, të shkruanin e ta trajtonin objektivisht jetën dhe veprimtarinë e këtij trimi shqiptar, me shpresë se do ta mbulonte pluhuri i harresës. Mirëpo populli kurrë nuk e harroi kapiten Emrush Myftarin, luftëtarin vullnetar të brigadave ndërkombëtare në Luftën Civile të Spanjës (1936–1939), kundër zogistin e kundërfashistin që mori pjesë edhe në LNÇ në Kosovë e Shqipëri, duke qëlluar përmes atentatesh spiunët dhe tradhtarët e popullit. Gjatë hetimit shumëvjeçar të jetës e të veprimtarisë së luftëtarëve të Spanjës, të Asim Vokshit, të Xhemal Kadës e të militantit Ali Kelmendi, është shqyrtuar edhe çështja e Emrush Myftarit. Shumica e luftëtarëve flisnin për veprimtarinë e tij politike dhe ushtarake, por disa sosh, sidomos Justina Shkupi, përmendin Emrushin jo vetëm si njeri të gishtit, por edhe të pendës. Ajo dhe një shok tjetër i tij ishin këmbëngulës në veprimtarinë e tij letrare, gjë që, pas një hulumtimi të durimshëm dhe afatgjatë, u vërtetua dhe ne tani kemi në dorë një pjesë të krijimtarisë së tij letrare, vjersha e artikuj të përgatitur për shtyp, vrojtime të tij nga aspekti moralo- etik për »Të mirin e të keqin«, për bashkimësinë e kombit shqiptar dhe të trojeve të tij mbi bazën e gjuhës e të gjakut të përbashkët. Gjatë hetimit të këtyre shkrimeve kërkimtari gjen se ka të bëj me një atdhetar të flaktë shqiptar, me një revolucionar të mirëfilltë, që gjërat dëshiron t'i qesë në një vijë të drejtë, që lufton për çlirimin dhe bashkimin e shqiptarëve, me një revolucionar të mirëfilltë, që gjërat dëshiron t'i qesë në një vijë të trojeve të tyre, por që u del zot e lufton edhe për lirinë e popujve, të luftonte rebelionin frankist e për shpëtimin e popullit spanjoll nga një e keqe që kërcënonte mbarë njerëzimin. Për krah Asim Vokshit, Xhemal Kadës e të tjerëve, Emrushi, qe ndër oficerët e parë shqiptarë, që mori këtë udhë nderi, krah për krah njerëzve nga të katër anët e botës, pa dalllim race a kombi.

Veç shumë dokumenteve zyrtare shqiptare e jugosllave, mbi fytyrën e tij hedhin dritë edhe kujtimet e – Justina Shkupit, korrespondenca e pasur e Emrushit në shqip, serbokroatisht, turqisht, frëngjisht, italisht etj.; përkthimet e tij nga turqishtja e frëngjishtja, një pjesë e madhe e të cilave ka humbur bashkë me përkthimet nga serbokroatishtja, sajimet e tij letrare artistike dhe krijimtaria poetike. Në Kujtimet e Justina Shkupit (në dorëshkrim), të nxjerra nga inçizimet magnetofonike, të bëra nga autori i këtyre rreshtave, del në pah edhe fakti se Emrushi është marrë edhe me mbledhjen e folklorit, sidomos të krijimtarisë së pasur shpirtërore të Rugovës së Pejës. Ajo përmend se Emrushi kishte të gatshme dy përmbledhje: »Këngë popullore të trimërisë« dhe »Këngë popullore të dashurisë«, mbled-



hur në Rugovë, të cilat i kishte thënë se pas çlirimit nga nazifashistët do t'i botonte si libra më vete. Mirëpo, ndonëse arriti ta shihte Kosovën të çliruar nga njësitë e UNÇ të Shqipërisë e të brigadave kosovare, jeta nuk i dha afat, sepse siç pohojnë shokët e tij të luftës, njësitë e Truparmatës së Mbrojtjes Popullore të UNÇ të Jugosllavisë, që vërshuan Kosovën dhe e futën atë nën »Administrimin Ushtarak«, përmes agjentëve të OZN-ës e të Brigadës Bokele, e arrestuan, e cilësuan si armik të popullit dhe oficer të okupatorit. Ky ishte poshtërimi më i madh që mund t'i bëhej një atdhetari shqiptar, një luftëtari të Spanjës dhe partizani të Aradhës »Bajram Curri«. »Krimi« i tij ishte fakti se kishte qenë një nga oficerët shqiptarë më trima, njeri i autoritetshëm që nuk u nënshtrohej urdhërave të krerëve udhëheqës serbë e malazezë, të cilët në emër të bashkëpunimit me Partinë dhe UNÇ të Shqipërisë donin nënshtrimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare edhe nën Jugosllavinë »e Re«. Nga Milladin Popoviçi e Boro Vukmiroviçi Emrushi kishte kërkuar që gjërat t'i sqaronin me kohë e të zotoheshin haptas, nëse njëmend ishin komunistë, se Kosova dhe viset e tjera shqiptare këndej kufirit shtetëror do të bashkoheshin me vendin amë, që në këto vise të mos vendosej pushteti sllav që të vetmin mjet sundimi kishte pasur shtypjen e shfrytëzimin, persekutimin dhe vrasjen e shqiptarëve. Qëndrimin e këtillë të papërkulshëm Emrush Myftari e pagoi me kokën e tij.

Ne do të bëjmë përpjekje edhe krijimtarinë e pakët letrare, të cilën e kemi sot për sot në dorë nga Emrushi, ta shqyrtojmë krahas disa të dhënave për jetën e tij.

Emrush Myftari u lind në qytetin e Pejës. Për ditëlindjen e tij kemi dy palë të dhënash, të cilat s'përputhen ndërmjet veti. në një dokument serb të 25 shkurtit 1927 shkruan se »Emrush Myftaroviqi u lind më 10 gusht 1909 në Pejë, në krahinën e Zetës«, ndërsa në shkresën e Kuesturës Mbretërore (Shqiptare) të Pejës, Nr. 0712/Div. I, dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Tiranë, më 11. VIII. 1943, shkruan se Emrush Myftari u lind më 1907 në Pejë.

Kapiteni i brigadave internacionale të Spanjës, Emrush Myftari, doli nga gjiu i një familjeje me tradita atdhedashurie. Gjyshi i babës së Emrushit, haxhi Hyseini, ka zbritur në Pejë nga fshati Lutovë i Rugovës. Ai quhej Myftar dhe mandej e tërë kjo familje si mbiemër e mori emrin e tij. ndonëse plak e në moshë të thyer, kishte marrë pjesë në luftimet për mbrojtjen e Plavës e të Gusisë, në mënyrë që të mos i dorëzoheshin knjazit të Malit të Zi, sipas vendimit të Kongresit të Berlinit më 1878. Si luftëtar i –lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ai mori pjesë edhe në luftimet e tjera për ruajtjen e tërësisë tokësore të të katër vilajeteve të Perandorisë Osmane, në të cilat shtriheshin viset shqiptare.

Emrush Myftari është djali i tretë me radhë i haxhi Hyseinit Myftarit dhe i Gjyle Balës nga Peja. Ai ishte afër 15 vite më i ri se vëllau i madh Sherifi e nja 10 vite më i ri se Xheladini, vëllau i dytë me radhë. Meqenëse mbeti jetim qysh në fëmijëri, vëllezërit u kujdesën që ai të shkollohej, ndonëse në gjuhe të huaj për të, gjë që impononin rrethanat nën pushtetin e pushtuesve sllavë.

Shkollën fillore e kreu, pra, në gjuhën serbishte, në vendlindjen e tij,



në Pejë, më 1920. Po këtë vit u regjistrua në Shkollën Zejtaro-Tregtare të Pejës. Me lejimin e Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë së SKS, nr. 13821 të datës 20. XII. 1926 Emrush Myftari i dha privatisht provimet e kl. II të Gjimnazit të Pejës. Pas dy vitesh, së bashku me shokun e tij Veli Jasharin (Dedin), i cili tani është gjeneral në pension në RPS të Shqipërisë, shkoi në Beligrad, ku përpiqet të japë provimet pranuese për Akademinë Mbretërore Ushtarake. Siç duket përpjekjet e tilla shkuan huq dhe, në bazë të letrave e të telegrameve që këmben me të vëllezërit, kthehet i dëshpëruar në vendlindjen e tij. Po atë vit shkollor 1929/30 e gjejmë të japë privatisht provimet e kl. III në Lyceun Kombëtar të Korçës, pasi kishte kaluar ilegalisht kufirin shtetëror jugosllavo-shqiptar, në mënyrë që mund të ndiqte Shkollën Mbretërore Ushtarake të Tiranës. Në këtë periudhë të jetës së tij, Emrush Myftari shkruan poezinë e parë të tij që njohim deri më sot, me titullin »Të gjithë shqiptarëve«, shkruar më 3. II. 1932 në Tiranë, në të cilën ua qan hallin të gjorëve kosovarë dhe në fund, përmes dy vargjeve të mbrama, i thërret për bashkim gjithkombëtar:

O vëllezër shqipëtarë
e ju të gjorë kosovarë!
Të bashkohemi sa më parë!
Deri kur më kështu të ndarë?!

Më 22. II. 1932, po në Tiranë shkruan poezinë tjetër të shkurtë me titull »Kosovës«, të cilën e cilëson me përcaktorët »e shkretë« dhe »e mjerë«:

Oh, Kosovë, Kosovë e shkretë!
Oh, Kosovë, Kosovë e mjerë!
S'ka shumë kohë, ke qenë plot jetë,
Porse sot? . . . ndryshue ke krejt.

Duke i lexuar me vëmendje poezitë në dorëshkrim, të daktilografuara nga vetë Emrushi, njeriu vëren se në ato poezi ka një përzierje të lehtë të dy kryedialekteve të shqipes, një përpjekje për t'i thurë në një gjuhë të njësuar shqipe. Në një fletore të atyre ditëve shkruan: »Ne shqiptarët tani më jemi formuar si një komb modern evropian. Sot është e papranueshme që disa prej nesh të quhen toskë e disa të tjerë gegë. Është koha që të gjithë ne të kemi një bindje, të shkruajmë njëlloj, të flasim njëlloj, tamam si vëllezër të një gjuhe e të një gjaku, dhe të gjithë ne të kemi një kulturë kombëtare, që do të na nxjerrë faqebardhë karshi popujve të tjerë të Evropës. Të jemi të gjithë të bashkuar pranë njëj qëllimi, si në kohëne fatosit tonë kombëtar Skenderbeut. Nëse nuk bashkohemi si atëherë, në vitet e Skenderbeut, na përbin Këmishëzeza Itali, na fshin faqenxiri Benito Musolini . . .«. I lindur në gjiun e atdhedashurisë, si Asim Vokshi, Xhemal Kada, Musa Fratari, Riza Cerova etj., shpreh urrejtjen dhe përbuzjen e tij ndaj fashizmit e Musollinit, gjë që vërehet edhe në disa shkrime të tij humoristike, për të cilat ende nuk mund të themi a janë krijime të Emrush Myftarit, apo përkthime a përshtatje nga ndonjë gjuhë tjetër. Megjithkëtë, pasi që është mjaft e shkurtë. po e shënojmë në tërësi:

Kola, si turist, viziton antikitetet e Romës. Udhëheqësi i tregon Koloseumin dhe e pyet:

– *Ç'thoni për këtë?*

– *Unë them – u përgjegj Kola, – kur Musolini s'kishte pare me e krye ndërtimin e këtij, atëherë s'duhesh as t'ia kishte fillue!*

Në mbështetje të atyre pak vjershave dhe shrimeve të tij, që kanë shpëtuar pas bastisjes që njësitë e Truparmatës së Mbrojtjes Populllore të UNÇ të Jugosllavisë i bënë shtëpisë dhe librarisë së tij në fillim të vitit 1945, del se poezia e tij ishte atdhetare, sociale dhe erotike. Në krijimtarinë e tij poetike vend qendror zë poezia atdhetare, vargjet »dedikuar Kosovës së shumëvuajtur, e cila po qëndron heroikisht në luftën fyt-a-fyt me xhandarët dhe ushtarët e kralit«. Autorin më së shumti e pengon përçarja, mungesa e bashkimësisë ndër shqiptarë. Këtë dukuri negative, përveç të huajve, e kanë ndihmuar edhe shpifësit e ngatërrestarët. Për këtë arsye Emrush Myftari ua jep anatemën në poezinë e shkruar në Fier të Myzeqesë më 24. IX. 1932 me titulin »Mallkim i shpifësit«:

Mallkue qoftë, o, pesëqind herë!
Mallkue qoftë, o, dimën e verë!
Njaj që shtjen fitne ndër shqiptarë,
fara iu shoftë e të tanë mbarë
dhe kurrë ai mos pastë ngushëllim,
në të dy jetët (?) mos pastë shpëtim!

Edhe këtë Emrushi e nënshkroi me pseudonimin E. Rugova. Ai mundohet të jetë i përmbledhtë, atë që i flë në zemër e në mendje ta thotë me sa më pak fjalë. Duket se mësimet ushtarake që ka marrë, kanë ndikuar edhe në shprehjen e tij. Mbase nga dashuria dhe malli që do ta ketë kapluar për vendlindjen e tij dhe Kosovën, më nuk e cilëson me përcaktorët »e shkretë« dhe »e mjerë«. Aty, në Fier të Myzeqesë, ku i ka shkruar edhe dy vjersha të tjera, sigurisht do të ketë takuar mjaft bashkëvendës të tij kosovarë. E shkruar më 7. II. 1932, e para mban titullin »Kosovë, Ti je nji lule fort e bukur« dhe fillon me strofën:

Kosovë, Ti je nji lule fort e bukur
me rrâjë t'thella n'zemër toke ngulë,
serbi t'ndjek si t' ishe Ti nji flutur,
krah' e rrâjë gjithmonë me t'i shkulë.

Në strofën e dytë Kosovën e quan nënë dhe shpreh bindjen e thellë se për të do të vinë ditë më të mira, kur »do t'jipet haku«. Në vargun e fundit të kësaj strofe, thua se bëin betimin, i zotohet »Nënës« se djemtë kurrë s'do ta lënë nën pushtuesin e huaj:

Toka yte plot me lule gjaku,
ujitun nga zemrat e derdhun si gurrë.
Do t'vij dita dhe Ty do t'jipet haku,
nën serbin djemtë, nëno, s'të lanë kurrë!

Vjersha tjetër, që është shkruar po atë ditë dhe në të njëjtin vend, në Fier të Myzeqesë, është një tabllo tmerri, e paraqitur me vërtetësi artistike, për terrorin e pushtetit serbomadh në Kosovën e martirizuar. Kur e lexon njeriu atë, ndonëse është shkruar para pesëdhjetë e tetë vjetësh, të duket se para syve po të shpalohet kosova e këtyre ditëve, nën të njëjtin pushtues serbomadh, që sulmon natën e ditën, shtëpia e fshatra të tëra në krahinën

heroike të Llapit, që vret pa hak e pa shkak të rinj e të reja shqiptare, që helmon në masë nxënësit tonë të shkollave fillore e të mesme. Vjersha mban titullin »Katundi i djegur«, vepër e xhandarëve dhe çetnikëve të kralit, të cilët, kur sulmojnë fshatrat e vendbanimet shqiptare, s'kursejnë asgjë: shtëpiat e konaqet, mullarët e sanës, ahrin e kafshëve, plemen dhe shelgun. Me një fjalë, djegin tërë atë që nënkupton jetën e shqiptarit, lidhmërinë e pashkëputshme midis tokës e bimëve, njerëzve e kafshëve. Meqë vjersha »Katundi i djegur« ka vetëm dy strofa, po e japim në tërësi, që të shihet se Emrush Myftarit nuk i mungon talenti dhe aftësia që faktin historik, të përjetuar e të nxjerrë nga njëmendësia objektive shqiptare, ta shndërroj në një fakt artistik, duke e paraqitur me vërtetësi artistike:

Xhandarët e kralit erdhën,
zjarr i madh shpërthei n'katund,
n'konaqe flakën e derdhën,
shtëpi n'këmbë s'mbeti kund.

Dogjën mullarët e shelgun,
ahrin e plemen deri te pragu.
Flaka e shtëpisë së djegur,
si qiri duket së largu.

Emrush Myftari ka lënë edhe disa poezi erotike, të cilat deri në ditët e sotme i ka ruajtur një shok i tij nga Gjilani, i cili edhe më tutje dëshiron të mbetet anonim. njëra prej tyre me titullin »Nimfa e Adriatikut« është dëmtuar aq shumë sa teksti muk mund të nxirret kurrsesi. në të mund të lexohej vetëm titulli dhe vendi me datën e krijimit: Durrës, 5. IV. 1935, nënshkruar: E. Myftari (Pseudonimi: E. Rugova). Poezia tjetër erotike mban titullin »Beatriçes shqiptare«:

Unë po të isha bletë,
do fluturojsha me krah' t'lehtë,
n'vetmi, moj, me t'gjetë!
Para teje tuj u përulë,
buzëve t'kuqe me t'u ngulë,
me të thithë e me të puthë,
tuj kujtue se je lulë...

Këtë poezi Emrushi e nënshkruan me pseudonimin »Qytelija e Kosovës«, Rugovë, IX. 1940. Po këtë muaj shruan edhe poezinë tjetër erotike me titullin »Lulja e Rugovës«, thuajse në stil popullor:

– Ti moj lule, lule mali,
çoje kryet se t'ka ardhë djali,
fort për ty e ka marrë malli!

– Dert i madh, le ta merr!
Ai ka ardhë veç për sherr,
me m'pas dashtë,
kish ardhë n'zabel.

Vjersha është shkruar në formë dialogu dhe paraqet ojnat e vashës së dashuruar, e cila pret të dashurin, por shtyn inat me të për shkak se s'i ka shkuar në zabel, ku do ta ketë pritur. Bandilli që i vardiset, i flet në veten e tretë dhe ia thot haptas qëllimin, gati si në formë urdhëri:

– *Banu gati, mori çikë,*
se ai ka ardhë me t'grabitë!

Atëherë vashës i zgjohet krenaria, dinjiteti i saj njerëzor gjen shprehje për të dëshmuar se ajo nuk lejon të trajtohet si objekt i thjeshtë

– *S'më grabitë kush,*
për krye t'lokes,
se jam Lulja e Rugovës,
tym e flakë t'i jap Kosovës!

Po kur djali e urdhëron në formë lutjeje, ajo shdërrohet në një zogë të urtë e të butë:

– *Çoje kryet e m'këqyr nji herë!*
– *M'prij, bandill, se vetë t'vij n'derë!*

Nuk i dimë arsyet për të cilat këtë vjershë e nënshkruan me pseudonimin Dyç Muslia, me të cilin i nënshkruan edhe disa »Këngë popullore të Kosovës«, të cilat siç duket i mblidhte për t'i botuar si libër më vete, apo për t'i shumëzuar në një kopisteri, të cilën e kishte sajuar në Librarinë »Vëllaznit Myftari« të tij në Pejë. Sipas disa shënimeve, që kanë shpëtuar, këto këngë i mblidhte në Rugovë të Pejës. Se Emrushi sajonte proklamata kundërfashiste e ftesa për të ndihmuar luftëtarët shqiptarë të Spanjës dhe se shumëzonte këto në kopisteri, këtë e pohojnë edhe Pavle Joviçeviçi e Mita Milkoviçi në librin e tyre »Lufta e komunistëve të Pejës midis dy luftërave (1918– 1941). Ata shënojnë se Emrush Myftari nuk ishte anëtar i PKJ e as i PK të vendeve ku qendroi (Shqipëri, Itali, Spanjë, Francë) dhe, megjithëse pa kurrfarë rekomandimesh, organizata e PKJ në Pejë e pranoi si antifashist e luftëtar të Spanjës dhe bashkëpunoi me të. Sipas tyre, Emrushi i informoi komunistët e kundërfashistët e Pejës lidhur me pjesëmarrjen e luftëtarëve shqiptarë në brigadat ndërkombëtare, kërkoh dhe ata pranuan që të shtypej e të shpërdndahej trakti me të cilin ftohej populli për të ndihmuar luftëtarët e Spanjës, që kishin mbetur akoma ndër kampe të Evropës, shqip e serbisht, jo në emër të PKJ, por me »Komunistët shqiptarë«, se përmendja e Jugosllavisë i largonte shqiptarët nga lufta. Ai u kishte folur edhe për vrasjen e Xhamal Kadës dhe kishte përkthyer në gjuhën shqipe Proklamatën e KQ të PKJ të 7 nëntorit 1940 etj., që e kishte sjellur nga udhëheqësit, përmes Beogradit, ushtari Ramiz Sadiku që po kthente për pushim në Pejë. Se Emrush Myftari ishte luftëtar i Aradhës Partizane »Bajram Curri« në Malësi të Gjakovës dëshmon edhe vetë Komandanti i Shtabit Kryesor të UNÇ dhe AP të Jugosllavisë për Kosovën. Madje në bisedën dyorëshe që kishte pasur me të në Gri e kishte përshëndetur ardhjen e tij partizan e si luftëtar i Spanjës, me përvojë, të qëndronte pranë Shtabit të Aradhës e mandej të kthehej në Pejë ku ishte zotuar të formojë një grup partizanësh shqiptarë.

Këto të dhëna dëshmojnë se sa të paqëndrueshme janë pohimet në Vendimin e Gjykatës së Pejës KK. Nr. 56/45 të 21 dhjetorit 1945, ku Emrushi cilësohet armik i popullit dhe oficer okupatori! Me shtrembërimin e vrazhdë të së vërtetës OZN-a e Spasoje Gjakoviçit e arrestoi, e torturoi me shpresë ta nënshtronte, por kur e pa se ishte i pathyeshëm, pas mundimesh çnjerëzore të stilit mesjetar, e pushkatoi.

Emrushi ishte antizogist i përbetuar. Me shkresën e 5 tetorit 1935, Drejtori i Depove të P. Ushtarake, majori Ibrahim Mandija, njofton

Komandën e Mbrojtjes Kombëtare në Tiranë për hetimet që oficeri i Gjindarmërisë Jan Nosi, kishte bërë kundër nëntoger Emrush Myftarit lidhur me kontaktet e tij me të burgosur politikë në korçë. Me aktin Nr. Pr. 19 Reservat, të 13 majit 1936 të të njëjtit organ, Emrushi dënohet me burg për kontaktet që mbante me »lloj lloj njerëzish« nga Kapiteni i kl. I, Salami Çela. Për fat të Emrushit Gjindarmëria nuk arriti të provonte kontaktet e tij me Ali Kelmendin, bashkëqytetarin e tij në Korçë, e as me oficerët e Kryengritjes së Fierit, kështu që Emrushi nuk pësoi si Asim Vokshi e shokë të tjerë besnikë, të cilët nuk ia përmendën emrin.

Sipas dëshmive të Justina Shkupit apo Ana Shllakut, siç quhej në filllim, Emrush Myftari edhe në Spanjë pësoi për shkak të një intrige. Disa vullnetarë jugosllavë kishin ndërhyrë që kosovarët të regjistroheshin si jugosllavë, gjë të cilën Emrushi e kishte kundërshtuar, duke i kritikuar si njerëz që ende nuk ishin shkundur nga shovinizmi dhe paragjykimet panslaviste. Ai kishte këmbëngulur që ai dhe shokët e tij kosovarë të regjistroheshin si vullnetarë shqiptarë. Kohë më pas Emrushi ishte arrestuar dhe mbajtur një muaj në burg, por me ndërhyrjen e Xhemal Kadës e të Asim Vokshit, shokëve të tij që e njihnin mirë, Emrushi jo vetëm u lirua, por iu dha edhe grada e kapitenit dhe Justina në Valencia e kishte takuar në detyrën e komisarit politik të një çete të Batalionit ballkanik.

Pas thyerjes së Armadës së Spanjës Republikane, bashkë me shumë vullnetarë të brigadave ndërkombëtare kapercen Pirinejet dhe strehohet në Francë, në një kamp afër Parisit, Atje nga Legata Shqiptare kërkon riatdhesim, por Qeveria zogiste refuzonte vazhdimisht. Atëherë Emrushi rrëmben fotografinë e madhe të Ahmet Zogut dhe në sytë e njëfarë zoti Ibrahimit të Legatës i hip shqelma duke thënë: »Ky salep sulltan, që ia shiti Atdheun Musolinit, do të më lërë mua pa Atdhe? Tash ia tregoj unë qejfin!... Shqipëria së shpejti do të pushtohet, por ne luftëtarët e lirisë do të vimë e do ta çlirojmë përgjithmonë. Aty mandej s'do të ketë vend për tradhtarët«.

Emrush Myftarit prijësit e Organizatës së PKJ në Pejë ia kanë parë për të madhe që ka kryer atentatin në Zhivko dhe Gavrillo Rajeviçin më 8 tetor 1943 në Rrugën e Kavajës, te Shtëpia e Oficerëve në Tiranë. Mirëpo burimet tona tregojnë se Zhivko Rajaviçi me të vëllain ishin gjakpirës të shqiptarëve të Kosovës, që u kishin rrëmbyer shtëpia e dyqane pejanëve me anën e »kredive« të »Metohijska Bankës« drejtor i së cilës ishte. Madje Komanda e njësive guerile të kryeqytetit të Shqipërisë përmes shtypit njofton se ky atentat është kryer për shkak se këta ishin agjentë të rrezikshëm të Drazha Mihajloviçit, që bënin propagandë shoviniste serbomadhe dhe luftonin LNÇ në Shqlpëri e Jugosllavi. Me kërkesën e Tefik Çangës e të organizatës së PKJ të Ferizajit Emrush Myftari kishte kryer bashkë me një shok të tij atentatin në agjentin tjetër të fashistëve Ilia Çirko në Gjilan. Një nga »mëkatet« e tij ishte edhe dërguarja e dy vozgave me koka e gjymtyrë të sakatosura të bihorasve, për të protestuar në Tiranë te F. Jakomoni për krimin e përbindshëm që kishin bërë çetnikët malazezë mbi shqiptarë e muslimanë, para këtyre atentateve të suksesshme të Emrushit. I shihej për të madhe sidomos për shkak se, për ta shpëtuar pppullin e Pejës nga masakrimi, kishte biseduar frëngjisht me komandantin gjerman dhe i kishte

thënë se Peja do të dorëzohet si një qytet i okupuar shqiptar e jo jugosllav, në ditën kur hynë në Pejë trupat e Rajhut të Tretë. »Mëkati« më i rëndë ishte pse paskësh marrë nga anglezët ndihmë në para për të organizuar luftën kundër pushtuesve nazifashistë, gjë që e përmendin në raportet e tyre të fshehta Miladin Popoviçi e Boro Vukmiroviçi. Mirëpo, për çudi, këta nuk reagojnë fare kur Pavle Joviçeviçi në Malësinë e Gjakovës merr prej komisarit politik të aradhës partizane një shumë të madhe lirash në flori prej anglezëve, duke i shpenzuar ato si të ishin të tij, siç del nga shumë dokumente të publikuara e të papublikuara. Emrush Myftari ishte njëmend një oficer trim shqiptar, të cilit i flinte në zemër lufta kundër fashiste për çlirimin e –Jugosllavisë e të Shqipërisë. Por, për hir të së vërtetës, duhet të themi patjetër se në bazë të dokumentacionit tek ai njëmend vërehet një luhatje që t'i bashkohëj garniturës udhëhaqëse, të përbërë në shumicë nga elementi sllav malazezo-serb. Në kontaktet me Milladin Popoviçin dhe Boro Vukmiroviçin Emrushi kishte kërkuar që ata të deklaroheshin haptas para popullit së nuk do të kthehej e vjetra dhe se Kosova me viset e tjera shqiptare nën Jugosllavinë do t'i bashkohej shtetit amë, duke krijuar kështu një nga urat më të forta lidhëse midis dy vendeve fqinje. Sipas Emrush Myftarit kjo ishte rruga e vetme për zgjidhjen e konfliktit shumëvjeçar midis popullit shqiptar dhe popujve sllavë të Jugut, në mënyrë që ata të jetonin në paqe e të bashkëpunonin mbi bazën e fqinjësisë së mirë e të bashkëpunimit të ngushtë politik e ushtarak gjatë LNÇ në të dy vendet. Këto pikëpamje janë shprehur me një qartësi kristalore në disa shënime të vetë Emrushit, të cilat autori i këtyre rreshtave do t'i japë në një studim monografik, tani më të përgatitur si një fryt i një pune të gjatë e të durueshme studimore.

Për »mëkatet« e përmendura Emrush Myftari, luftëtar i aradhës partizane »Bajram Curri« dhe vullnetari e kapiteni i brigadave ndërkombëtare të Spanjës, siç pohojnë dëshmitarët e gjallë dhe disa dokumente zyrtare, pas hyrjes së njësive të UNÇ të Jugosllavisë në Pejë u arrestua, nëpër Gjakovë, Prizren e Carralevë u soll në Burgun e Prishtinës, u torturua nga organet e OZN-ës se Spasoje Gjakoviçit dhe, meqë s'mundën kurrsesi ta përvetësojnë, e pushkatuan në Tauk Bahçe të Prishtinës. Si kuadër ushtarak i formuar e me ngritje të duhur politike, me kapital të lakmueshëm të luftëtarit kundërfashist të Spanjës e të LNÇ, ai paraqiste rrezik për pushtuesit e rinj serbomëdhenj të Kosovës dhe shërbyesit e tyre, prandaj shkuan në krim dhe e likuiduan edhe fizikisht. Kjo çështje ndriçohet edhe më mirë, kur të përmendet fakti tjetër i rëndësishëm se AVNOJ-i, veç vendimeve të njohura më vonë botërisht kishte marrë edhe vendimin për amnestinë e çetnikëve serbo- malazezë që mandej mbushën disa prej njësive »partizane« që vërshuan Kosovën, duke e larë në gjak me petkun e »çlirimtarëve«. Duhet domosdo të përmendet edhe fakti se Spasoje Gjakoviçi me shtabin e tij kundërshqiptar të OZN-ës, mjerisht, gëzoi edhe ndihmën e disa udhëheqësve shqiptarë, të përfshirë nga karrierizmi e oportunizmi, për likuidimin fizik të kapitenit dhe poetit Emrush Myftari.

Korrespondenca e vëllimshme midis Qamil Çelës, udhëheqësit të Grupit të komunistëve shqiptarë të Lionit dhe redaktorit të organit të tyre, gazetës »Sazani«, me Emrush Myftarin në Paris, shkrimet dhe artikujt e Emrushit për këtë gazetë dhe demaskimi parimor që u bën disa tradhta-

rëve të Luftës Qytetare të Spanjës nga radhët e ca shqiptarëve, tregojnë për një luftëtar konsekuent antifashist dhe për një atdhetar të mirëfillt. Shkrimet e fshehta të B. Vukmiroviçit e të M. Popoviçit, si konstatime të tyre arbitrare, kur analizohen me vëmendje dhe krahasohen me fakte të tjera, dalin të kundërthënshme e krejtësisht subjektive, pa mbështetje në fakte. Njerëz që çdo shqiptar të ngritur intelektualisht e sidomos oficer të shkolluar e shikonin me dyshim, prijësit e përmendur të organizatës si PKJ në Pejë, vraponin të rrëmihin në zorrët e tyre dhe, përmes intrigave, merrnin »informata« herë prej njërit e herë prej tjetrit, duke u treguar »në besim« se çka ka thënë shoku i tij më i ngushtë për të, dhe kështu shumë sish i cilësonin »të dyshimtë«. Kështu u jepej anatema njerëzve si Emrushi më shokë dhë përfundimi i tyre dihej mirë.

Në këtë shqyrtim konstatimet tona bien ndesh me vlerësimet »zyrtare« të PKJ e të disa udhëheqësve, por e vërteta dhe zbërthimi objektiv shkencor na obligon që njëmendësinë e kaluar ta rindërtojmë vetëm ashtu siç ka qenë, ndryshe u mbesim borxh breznive që vinë dhe do të skuqemi para tyre e para historisë, e cila gjyqin e ka të rreptë, por të drejtë. Në këtë vështrim, ne u kufizuam vetëm në disa të dhëna të reja, duke pasur për qëllim që të hedhim dritë në personalitetin e Emrush Myftarit pikë së pari si krijues letrar e poet e, pjesërisht, për të ndrequr edhe shtrembërimet e qëllimshme, për të mos thënë falsifikimet, si ato të Vendimit të Gjykatës »Popullore« të rrethit të Pejës më 21. XII. 1945 e në mbështetje të shënimeve të KP Nr. 1729/45, ku cilësohet si tradhtar i popullit e oficer i okupatorit, si edhe në Vendimin K. K. Nr. 56/45 më 21 dhjetor 1945.

Në mbështetje të atyre pak poezive të Emrush Myftarit, që kemi në dorë, del se ai ishte një poet luftëtar, që përmes shkrimeve të tij, deri më tash të panjohura, u këndoi vuajtjeve të popullit të tij dhe e trimëroi atë të qëndronte i pathyeshëm deri në fitoren përfundimtare. Fryma e poezive të tij tregon se ai i takon plejadës së shkrimtarëve shqiptarë të viteve ”30, me të cilët në historinë e letërsisë shqiptare hapet një faqe e re dhe fillon ralizmi kritik. Sa të mblidhen edhe shkrimet e tjera të tij Emrush Myftari, besojmë, do të radhitet menjëherë përkrah Migjenit, Nonda Bulkës, Andrea Varfit e të tjerëve. Këto të dhëna të reja, shënime të shkurtëra për jetën dhe veprimtarinë e tij, le të jenë një thirrje vëllazërore për të gjithë shokët, miqtë dhe dashamirët e tij, me shpresë se do t’i paraqesin poezitë a shkrimet e tjera të tij, në mënyrë që të fitojmë një pasqyrë sa më të plotë për jetën dhe krijumtarinë e Emrush Myftarit, njërit nga martirët e parë shqiptarë të Kosovës, pas ikjes së nazistëve nga këto troje.


Historia që përseritet
Shqiptarët dhe mbrojtja e paqës 1912–1990




Shkruan: Halil Matoshi

Si ilustrim të politikës serbomadhe ndaj shqiptarëve po sjellim më poshtë disa rreshta të gazetës »Naša pravda« e cila i referohej gazetës »Radikal«, me 26. 11.. 1921: ». . . derisa të ketë sjellje të tillë ndaj shqiptarëve, derisa të mos u jepen tri gjëra-drejtësia, barazia dhe liria, nuk mund të ketë qetësi. Pa i hequr nga koka qëllimet e këqija ndaj atij populli nuk do të zhdukën kaçakët. Nëse këto gjëra do t'u jepen, atëherë në vend të kaçalëve dhe ankesave do të mbretërojë qetësia . . .«

Më 23 qershor të vitit 1921 në Gjenevë kishte arritur një letër që e kishin nënshkruar tre intelektualë kosovarë, të prirë nga profesor *Bedri Pejani* (për veprimtarinë e tij patriotike patëm rastin të lexojmë kohë më parë në revistën shqiptare »Fjala«, shkruar nga Dr. Hakif Bajrami). Ndërkaq, faksimilin e kësaj latre po e sjellim më poshtë.)[1]





Excellence,

Les soussignés, représentants des Comités unis des Albanais irrédeņts des régions du Nord de la Province de Scutari, des Provinces de Kossowo et de Monastir, et des Provinces de Tchameria et de Janina, ont l'honneur de présenter à Votre Excellence la brochure " LES DROITS DE L'ALBANIE A SES FRONTIERES NATURELLES ".

Dans cette publication, nous avons réuni, par mandat précis de nos Comités, les données sur la population de nos pays, et un aperçu tout à fait sommaire et incomplet des atrocités, des massacres, des pillages, des incendies, des dévastations, dont nos régions natales sont victimes par le fait des occupations slave et grecque.

Ces documents sont précèdés d'un exposé de nos droits historiques, ethniques et stratégiques.

Nous avons pleine confiance que Votre Excellence voudra bien prendre connaissance de cette publication, et voudra employer toute Sa Haute influence auprès de la Ligue des Nations, pour que, les Nations qui en font partie décident de prendre acte de nos justes réclamations nationales.

13516 (2

Dans cette attente, Excellence, qui est l'espoir d'un Peuple trop longtemps oppressé et martyrisé, nous prions Votre Excellence d'agréer, les sentiments de notre plus haute considération et de notre plus profond dévouement.

Délégués des Comités Unis des Albanais irrédents.

P/ Person Bedr Pejani

Dr Hil Batri

Dr Ismail Cekami

Hon. Sir Eric Drummond,
Secrétaire Général de la Société des Nations.
Palais des Nations.

Sikur atëbotë, para më së 70 vjetësh, ashtu edhe sot, shqiptarët nuk kërkojnë asgjë më shumë, por as më pak se DREJTËSI, BARAZI dhe LIRI. Pikërisht në ato vite vritet Azem Bejta-Galica. Lufta kaçake vazhdon: Serbia intensifikon politikën e vet brutale ndaj shqiptarëve; popullsia rreziston qetë, padëgjueshmëria qyterate ndaj shtetit aneksionist serb vazhdon . . . (Ky shtet nga shqipatrët nuk njihet as sot, në Kosovë, me 1990, kur Kosova ka shpallur Republikën e vet!)

Më 29. 6. 1921 Lidhjës së Kombeve i drejtohet me një telegram prej Vlore, Hoxhë Kadria, i cili kërkon që Lidhja e Kombeve t'i bëjë demarsh Beogradit për brutalitetin e politikës serbe ndaj shqiptarëve:[2]

PRESIDENTIT TË LIDHJËS SË KOMBEVE
GJENEVË

29 qershor, 1921

IEAU DES TELEGRAPHES
29 VI 21
GENÈVE

Genève 29 JUN 1921

Schweiz. Telegraphen- und Telephonverwaltung. — Administration des télégraphes et des téléphones suisses. — Amministrazione dei telegrafi e dei telefoni svizzeri. No 2

Telegramm — Télégramme — Telegramma

Wörter. — Mots. — Parole: .....

Valona 460 80 28 16

№ .....

Der Telegraphist: - Le télégraphiste: Il telegrafista:

Aufgegeben den — Consigné le — Consegnato il ..... 192 .. um — à — alle .. Uhr — heures — ore .. min. ....

Erhalten von — Reçu de — Ricevuto da ..... den — le — il 29/6 192 .. um — à — alle 11/2 Uhr — heures — ore 7 min. .....

Contr. № 8525

Event. Angaben / Indications event. / Indicazioni event. 13665

Indirizzo .....

: presidenta dell ligues nations geneve

parlement albanais ayant pleince confiances dans sentyments humanitaires des honorables representants des peuples se permet attyrer leur bienveillance attention sur massacre persecutions et violations depuis huit annees poursuivent avec une ferocite gravissante contre albanais de kosovo et les prie d interesser leur gouvernement pour qui il fasse demarches necessaires aupres du gouvernement de belgrade dans but de faire cesser actes d oppression qui deshonorerent la civilisation du 20 eme siecle president parlement albanais ~~hoska~~ kadri

97

PARLAMENTI SHQIPTAR DUKE PASUR BESIM TË PLOTË NË NDJENJAT HUMANITARE TË PERFAQËSUESËVE TË NDERUAR TË POPUJVE, MERR GUXIM TË IA TËRHEQ VËMENDJEN E KUJDESËSHME NË MASAKRAT, NDJEKJET DHE DHUNËN, TË CILAT QË TETË VJET VAZHDOHEN MË NJË VRAZHDËSI ARROGANTE KUNDËR SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DHE I LUTET QE T'I INTERESOJNË QEVERITË E TYRE QË T'I BËJNË HAPAT E NEVOJSHËM TË QEVERIA E BEOGRADIT ME QËLLIM QË T'I JEPET FUND AKTEVE TË REPRESIONIT TË CILAT E TURPËROJNË QYTETËRIMIN E SHEKULLIT NJËZET.

KRYETARI I PARLAMENTIT SHQIPTAR,
HOXHË KADRIA PRISHTINA

Është mjaftë me rëndësi telegrami që e nis nga Roma, Plaku i Maleve, *Bajram Curri,* më 23. 9. 1924, drejtuar *Luigj Gurakuqit,* që asokohe gjendej në Gjenevë, si delegat shqiptar në Lidhjën e Kombeve. Ky telegram ka këtë përmbajtje: »Monsieur Luigi Gurakuqi, delegat albanais che la conference de la Ligue des Nations pour Bajram Curri«. Pastaj, Luigj Gurakuqin e porositë që të protestojë edhe për dhunën që kishte pasuar, ndaj të drejtave kombëtare dhe njerëzore, kundër këtyre padrejtësive që u bëheshin shqiptarëve, siç ishte zënia dhe internimi i Sinan Ferizit, Zenun Bardhit, Hamid Fetiut, Hamdi Zajmit dhe Halim S. »... *për të vetmin shkak qi ndodhena ne shqipenie të lirë...*« (më poshtë sjellim faksimilin e këtij telegrami)[3]

8. FAKSIMILI 3.

Schweiz. Telegraphen- und Telephonverwaltung. — Administration des télégraphes et des téléphones suisses. — Amministrazione dei telegrafi e dei telefoni svizzeri. No. 2.

Telegramm — Télégramme — Telegramma

Wörter — Mots — Parole

von — de — da

Aufgegeben den — Consigné le — Consegnato il 192 um — à — alle

Erhalten von — Reçu de — Ricevuto da ROME den — le — il 24/9 192 um — à — alle 1

Uhr — heures — pre[illegible] 1924 Min.

23. 20h30 =

Telegraphist: - Le télégraphiste. - Il telegrafista:

Contr. № 4385

monsieur luigi gurakugi delegui albanais che la conference de la ligue des nations pour m.bairam tzouri — geneve. =

rim vesht se autoritaten jugosllav te gjakovts ne keto dit r fare fajit wan scané e internue familjet tona te siman rizit e shume kosovarve tjere per te vetemin shwaw qi ndodhena shqipenie te lire stop mbasi na per vec qi nuw jena te akuzu ndonji faj ordinare per gezime edhe oren shtetin shqipter temi qi n mtn te drejtave wombtare e njerzore te protestoni sht nevoja per mbi weto dhune e pa drejtesina qi bahen shqip e kosoves tue kerku vecanerisht edhe lirimin e familjave tq pafajsheme = zenen burdhi hamid fetin hamdi zaimi halim s.

Me 15 janar 1931 *Hasan Prishtina* ia dërgon një Memorandum të tillë Lidhjes së Kombeve, të cilin të përkthyer nga frengjishtja, po e japim në tërësi, sëbashku me faksimilin dhe firmën e Hasanit.[4]

HASAN PRISHTINA
ish Kryetar i Këshillit të Shqipërisë –
WIEN

EKSELENCËS SË TIJ,
Zotëri Erik Drymon, skretar i përgjithëshëm i Lidhjës së Kombeve – Gjenevë.

EKSELENCË

Gjendja e mjerueshme e shqiptarëve të cilët jetojnë në Jugosllavi më detyron që përseri t'ia dërgoi Lidhjës së Kombeve lutjen që t'i ndihmojë një populli tejet të shtypur dhe të torturuar.

Faktet mbi të cilat është bazuar apeli im kanë qenë shpesh të komunikuara Lidhjes së Kombeve, dua t'i prezentoj edhe detajet: Kryesisht janë këto: 1. Gati një milion shqiptarë të cilët jetojnë në Kosovë dhe në Maqedoni nuk e kanë asnjë shkollë në gjuhen e tyre amtare. U është ndaluar të ndërtjonë shkolla edhe me mjete private.

2. Qeveria e Mbretërisë së Jugosllavisë përdor të gjitha masat e mundshme për t'i shfarosur shqiptarët në Kosovë dhe në Maqedoni. Është fakt, është e njohur dhe e qartë që masakra, zhdukje të katundeve të tëra kanë ndodhur, që janë bërë vrasje mbi shqiptarët, që shtëpitë e tyre janë plaçkitur me urdhërin e agjentëve të autoriteteve të larta.

3. Me konfiskim, pa kompenzim të pronave të fshatarëve shqiptarë, të cilat u ndahen Serbëve dhe Malazezëve, shqiptarët janë të detyruar ta braktisin masovikisht vendin e tyre, tokën e baballarëve të tyre. Shqiptarët mohamedan dhe katolik duhet të paguajnë tatime mësë 60 për qind më të larta, masë kjo e përdorur për t'i shkatërruar ekonomikisht dhe kështu t'i detyrojnë të shpërngulen.

Si rezultat i mënyrës së tillë të sjelljes me shqiptarët është që popullata serbe e rrethit të Gjakovës, e cila që dhjetë vjet nuk formonte as një përqind të popullsisë, tash ka njëzet përqind, përkundrazi, njëzet për qind të popullatës autoktone shqiptare janë dëbuar nga trojet e tyre.

4. Qeveria e përmendur persekuton shqiptarët katolik për shkak të fesë së tyre. I obligojnë këta shqiptarë ta mohojnë besimin e tyre dhe kombin e tyre. Nëqoftë se nuk pranojnë, u paraqiten kanosje për persekutime të tmerrshme ose për vdekje. Për këtë arsye janë vrarë edhe disa priftërinjë. Qeveria i konfiskon edhe të mirat materiale të bashkësive fetare. Këto janë vetëm disa nga veprimet e Mbretërisë së Jugosllavisë, veprime kundër të Drejtave të Njeriut.

Artikulli i dytë i Traktatit mbi minoritetet thotë: Shteti i SKS angazhohet t'u sjellë të gjithë banorëve mbrojtje të plotë të jetës dhe lirisë së tyre, pa dallim lindjeje, kombi, gjuhe, race apo feje.

Mënyra se si trajtohen shqiptarët që jetojnë brenda kufijve të Mbretërisë së Jugosllavisë është në kundërthënie jo vetëm me secilen fjalë të këtij traktati por ta përkujton mënyren se si janë trajtuar bujkrobërit në mesjetë. Për këtë arsye në emër te të gjithë bashkatdhetarëve të mi, shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë, e lus Lidhjën e lartë të Kombeve ta ndihmojë një popull të torturuar pa të drejtë.

Qeveria e Jugosllavisë ka zgjedhur metodën e mohimit absolut e të gjitha ankimeve të bëra kundër saj. E njëjta qeveri mohon edhe faktin e qartë që një milion shqiptarë në Jugosllavi nuk e kanë asnjë shkollë në gjuhën shqipe.

Për shkak të kësaj taktike, e përseris lutjen time të bërë pak më parë: Që Lidhja e Kombeve ta emërojë një Komision neutral që do të shkojë në Jugosllavi dhe ta ekzaminojë në vend situatën e pakicës shqiptare në Jugosllavi dhe ta dërgojë një raport Lidhjës së Kombeve.

HASAN PRISHTINA
ish kryetar i Këshillit shqiptar

Gjenevë, 4 tetor, 1921

PRISHTINA 4.

4. A.[illegible] 25360

RECEIVED IN REGISTRY
17 JAN 1931

Hassan Frishtina
Ancien Président du Conseil
d' Albanie
Vienne IV.Schaumburgergasse 13./5.

A Son Excellence
Sir Eric Drummond,
Secretaire Général de la Société des Nations
Genève.

Excellence !

L'état désespéré des Albanais vivánt en Yougoslavie me force de nouveau à adresser à la Société des Nations la prière de secourir un peuple opprimé et torturé outre mesure.

Les faits sur lequels sont basés mon appel ont été souvent,avec citation de détails,communiqués à la Société des Nations.Ce sont principalement les suivants:

1.) Environ un Million d'Albanais habitant Kossowo et la Macédoine ne possèdent pas une seule école dans leur langue maternelle.Il leur a été interdit de fonder des écoles par leurs moyens privés.

2.) Le gouvernement du Royaume de Yougoslavie emploie toutes les mesures possibles pour exterminer les Albanais à Kossowo et en Macédoine.Il est de fait,il est connu et évident que des massacres,que l'anéantissement de villages entières ont eu lieu,que des meurtres ont été commis sur des Albanais,que leurs maisons ont été livrées au pillage sur l'ordre d'agents des autorités supérieurs.

3.) Par la confiscation sans indemnité de propriétés de cultivateurs albanais,lesquels sont réparties à des Serbes et à des Monténégrins,les Albanais se voient forcés de quitter en masse leur pays,la terre de leurs pères.Les Albanais mahométanes et catholiques doivent payer des impôts de 60 % plus élévées,mesure employée pour les ruiner économiquement et,de cette manière,les forcer à l'émigration.

Un résultat de cette manière de traiter les Albanais est que la population serbe de l'arrondissement de Djakowa,laquelle,il y a dix ans,ne formait pas même un pourcent de la population,en forme à présent vingt pourcent,tandis que vingt pourcent de la population autochtone albanaise fut chassé de son sol.

4.) Le gouvernement mentionné persécute les Albanais catholiques pour leur religion.On contraint ces Albanais à abjurer leur foi et leur nationalité.Refusent-ils,la menace d'affreuses persécutions ou de mort se dresse devant eux.Des prêtres ont même été assassinés pour cette raison.Le gouvernement confisque les biens des communautés religieuses.

Ce ne sont que quelques uns des actes du Royaume de Yougoslavie ; actes contre le droit des hommes.

L'article 2 du Traité des Minorités dit : " L'Etat de S.C.S.s'engage à accorder à tous les habitants pleine et entière protection de leur vie et de leur liberté,sans distinction de naissance,de nationalité,de langage,de race ou de religion."

La manière dont sont traités les Albanais vivant dans les frontières du Royaume de Yougoslavie,est en contradiction non seulement avec chaque mot de ce traité,mais elle rappelle la manière dont furent traités les serfs du moyen-âge.C'est pourquoi,au nom de mes compatriotes,les Albanais de Kossowo et de la Macédoine,je supplie la Haute Société des Nations de venir au secours d'un peuple aussi injustement torturé.

Le gouvernement de Yougoslavie a choisi la méthode de la dénégation absolue quant à toutes les plaintes et à tous les griefs formulés contre lui.Le même gouvernement nie encore le fait évident qu'un million d'Albanais,en Yougoslavie, n'ont pas une seule école albanaise.

En présence de cette publique,je réitère la prière précédement faite :

Que la Société des Nations veuille nommer une commission impartiale ayant la tâche de se rendre en Yougoslavie et d'y examiner sur les lieux mêmes la situation de la Minorité albanaise en Yougoslavie et d'en adresser un rapport à la Société des Nations.

Je prie Votre Excellence d'agréer l'expression de la haute considération de son dévoué

Hassan Prishtina

Ancien Président du Conseil
Albanais.

J. 41 | 39301 | 11379 -

Schweiz. Telegraphen- und Telephonverwaltung. — Administration des télégraphes et des téléphones suisses. — Amministrazione dei telegrafi e dei telefoni svizzeri. No. 2.

Telegramm — Télégramme — Telegramma

Wörter — Mots / Parole 127

Genève 27 IX 24 BUREAU DES TÉLÉGRAPHES GENÈVE SEH

von — de / da Kruja № 15

Der Telegraphist: - Le télégraphiste: / Il telegrafista: Reimer

Aufgegeben den — Consigné le / Consegnato il 26 IX 192 4m — à alle 16 Uhr — heures ore — min.

Erhalten von — Reçu de / Ricevuto da Milano. den — le / il 27 IX 192 4m — à alle 16 Uhr — heures ore 25 min.

Event. Angaben / Indications event. / Indicazioni event.

RECEIVED IN REGISTRY 28 SEP 1924

Adresse - Indirizzo

Al Hangrabt

Conferente de la société des

nations à

Genève.

Contr. № 6849

Ala population de la prefecture de krouma et de sa village dans un muting tenus aujourdhui a decidée de faire son protesta antons energique ches ehonorable conferences de la societé des nations sur les persecutions et les mesures barbare que le gouvernament serbe a reconnecer de prendres ces jours ne contre l'element albanais sous la Jougoslavia plusieurs famille sont internée saas un cause beaucoup des autres sont à prisons comme les eclares nous demandons justice de la haute conference pour notre frères malheureux pour la population des notables:

Mepmed Ali Bar Ibrahim Dida Islam Spahia Radaman Cika Emin

Xhona Maksud Palustri Salhiman Bajrakqrb Shpend Balla Bajram

Elenani Brah Alia Isuf Groshi Gjelosh Raga.

Übertelegraphiert an — Réexpédié à / Ritrasmesso a ..... den — le / il ..... um — à / alle ..... Uhr — heures / ore ..... min. ..... Der Telegraphist: — Le télégraphiste: / Il telegrafista: .....

103

Më 5 maj, një vit më parë, një memorandum të tillë në Lidhjen e Kombeve e kishin dërguar tre priftërinjë shqiptarë, Dom Gjon Bisaku, Dom Shtjefën Kurti dhe Dom Luigj Gashi. (Pas plot 60 vjetësh patëm fatin që këtë memorandum ta lexojmë në »Rilindja« vetëm disa ditë para se qeveria shoveniste serbe ta ndalojë). Ç'koinçidence!? Këtu në Gjenevë na erdhi lajmi se »Rilindja« e fundit doli në dritë me 7 gusht, 1990; ndërkaq shërbimi i shenjtë në atdheun e tyre iu pamundësua shumë shqiptarëve katolikë, pas sulmit barbar në kishën katolike të Binçës dhe në atë të Ferizajt, sikur atëbotë, më 1930.

Hasan Prishtina, bashkë me Bajram Currin është nënshkrues edhe i Memorandumit të Komiteteve të bashkuara të shqiptarëve, dërguar Kryesisë së Këshillit të Lidhjës së kombeve mbi masakrat serbe ndaj shqiptarëve, me 26 shtator, 1924, (shih: Hasan Prishtina, dokumente, botuar nëTiranë më 1983. fq. 162.)

Më 4 tetor 1921 Fan S. Noli iu kishte drejtuar me një apel Lidhjes së Kombeve, me dorën e tij, duke i lutur që telegramin e Arqipeshkopisë së Shkodrës ta paraqesin në Gazetën Zyrtare të Lidhjes së Kombeve. Në shkresën e Nolit thuhet:[5]

FAC-SIMILE: 5-

Délégation Albanaise
auprès de la Société des Nations

Genève le 4 Octobre 1921

Monsieur le Directeur,

J'ai l'honneur de vous communiquer ci-inclus, copie du télégramme, que je viens de recevoir de l'archevêque de Scutari d'Albanie, Monseigneur Jacques Serreqi.

Je vous prie de bien vouloir le faire paraître dans le journal officiel de la Société des Nations.

Veuillez agréer, Monsieur le Directeur, l'assurance de ma considération très distinguée

Le Président de la Délégation
F. S. Noli

A Monsieur le Directeur
du Journal Officiel
Genève

DELEGACIONI SHQIPTAR NË LIDHJËNE KOMBEVE

ZOTI DREJTOR, KAM NDERIN T'JU KOMUNIKOJ, KËTU BRENDA, KOPJËN E TELEGRAMIT QË E MORA NGA ARQIPESH-KOPIA E SHKODRËS SË SHQIPËRISË, NGA IMZOT ZHAK SEGER. JU LUTËM QË TA PARAQITNI NË GAZETËN ZYRTARE TË LIDHJËS SË KOMBEVE; PRANONI ZOTI DREJTOR, SIGURINË E KONSIDERATAVE TË MIA.

Zoti drejtorit të Gazetës Zyrtare
Gjenevë

Fan. S. Noli

Duhet zënë n'gojë me këtë rast, ndër shumë apele e memorandume, peticione e shkresa tjera, edhe telegramin e datës 27. 9. 1924, pra vetëm tri ditë pas telegramit që e nisi Bajram Curri, të cilin nga Milano e nisin për Gjenevë Mehmed Ali Bari, Ibrahim Dida, Islam Spahia, Ramadan Ceka, Emin Xhoni, Maksud Palustri, Salhiman Bajraktari, Shpend Balla, Bajram Elenani, Brah Alia, Iusuf Groshi dhe Gjelosh Raga. edhe në këtë telegram, Lidhjes së Kombeve i bëhet e ditur se Serbia kishte ndërmarr masa barbare për pacifikimin e shqiptarëve.[6]

Në këtë kohën tonë pos shumë letrave që shqiptarët i kanë dërguar Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duhet veçuar raportin e Komitetit të Kosovës për informimin e opinionit botëror (Raport sur la situation du peuple albanais en Yougoslavie), komisionit për të Drejtat e Njeriut, me 25.2.1988. Ky raport i ka 30 faqe shtypi dhe është shkruar në gjuhët kryesore.

Në Gjenevë, më 6.8.1990, ishte delegacioni kosovar për të Drejtat e Njeriut, të prirë nga *Veton Surroi* dhe *Avni Spahiu.* Po këtë ditë delegacioni i RTP-së i udhëhequr nga drejtori *Agim Mala* dhe redaktorët *Sali Kelmendi* e *Llukman Halili,* dorëzoi një Memorandum në të cilin jepen të dhëna se 1300 punëtorë të RTV të Prishtinës janë hedhur nga puna, ndërkaq programi shqip është ndaluar.

Përpjekjet për LIRI, BARAZI, DREJTESI dhe DEMOKRACI, ndër shqiptarët nuk janë të sotit, ato zënë fill në shpirtin liridashës të këtij populli fatkeq. Se vërtet shqiptarët apelonin parreshtur për paqe në këto hapësira, dëshmojnë edhe këto të dhëna, ngase edhe para 70 vjetësh ata nuk e pranonin opcionin e luftës, dhunën dhe konfliktin e hapur me fqinjët, por apelonin që Evropa dhe Lidhja e Kombeve të ndërrmarrin masa për sigurimin e të drejtave kombëtare dhe njerëzore të shqiptarëve e më këtë edhe sigurimin e paqes së përhershme në truall të Evropës. Evropa para 70 vjetësh ishte tjetër, shqiptarët dhe serbët po këta, me të njejtat armiqësi. Pasionet gllabëruese dhe shfarosëse ndaj shqiptarëve, të çdo qeverie serbosllave, mbetën të njejta. Këto që tash e dhjetë vjet ndodhin në Kosovë nuk janë rastësi... Rrënuesit e bustit të Hasan Prishtinës, ndërruesit me dhunë të emrit të Shkollës fillore të Klinës (Luigj Gurakuqi), sulmuesit e kishës katolike të Binçes dhe Ferizajt, shkatërruesit e ekonomisë kosovare, duke mos i numëruar varret dhe plagët politike, janë po ata xhandarë që vrasin dhe përdhosin çdo gjë shqiptare. Evropa, megjithatë më nuk po mashtrohet, ajo i di mirë të gjitha veprimet barbare të serbëve në Kosovë, por a do ta përmirësojë Evropa gabimin e bërë ndaj shqiptarëve? Si dukët, Evropa ende nuk është e gatshme për një revidim të tillë, këtë e dëshmoi edhe Konferenca e fundit e Parisit, por ç'e do kur disa shqiptarë ulën si vëzhgues (përfaqësues të shtetit shqiptarë) e të tjerët i »përfaqëson« xhandari Borisav Joviq! Historia, vërtet përseritet, e ne, sa po mësojmë nga ajo?

P. S.

Ky shkrim është botuar edhe më parë, por dokumentet e paraqitura, këtë herë na u dha mundësia që për lexuesit e »Alternativës« t'i sigurojmë përkthimet nga frëngjishtja, që i bëri zonjusha Neriman Kamberi dhe faksimilet e këtyre dokumenteve.

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA
HAVIER PERES DE CUELAR
NEW YORK

Gjendja e rendë në Krahinën Autonome të Kosovës vazhdon qe plot dhjetë vjet duke kulminuar këto ditë me okupimin e saj nga ana e Serbisë dhe marrjen e çdo të drejte qytetare dhe kolektive shqiptarëve që jetojnë në të.

Gjatë këtyre vjetëve ndaj popullit shqiptar në Kosovë u ushtruan të gjitha masat represive të njohura deri më tani, duke filluar me burgosjet masovike, suspendimet nga puna, maltretimet në formë të izolimit fizik, vrasjet, lëndimet, helmimet dhe represione të tjera në forma dhe nivele të ndryshme.

Ndër pikat më kyçe të shkeljes së të drejtave kolektive është aprovimi i amandamenteve në kushtetuten e Serbisë në kushte të jashtëzakonshme me 23 mars të vitit 1989 që u përcoll me vrasjen e rreth 30 qytetarëve, si dhe me aprovimin e një sërë ligjeve me të cilat mohohen të drejtat qytetare dhe kolektive të shqiptarëve.

Duke konsideruar se ne shqiptarëve, si populli i tretë për nga numri në Jugosllavi na takojnë të gjitha të drejtat si edhe popujve të tjerë, ne të 114 delegatët e Kuvendit të Kosovës, aprovuam me 2 korrik 1990 Deklaratën Kushtetuese me të cilën shprehëm deshirën e shumicës absolute të popullsisë së Kosovës dhe e shpallëm Kosovën njësi të pavarur dhe të barabartë me njësitë e tjera në federatën (konfederatën) jugosllave.

Më 5 korrik 1990 Kuvendi i Serbisë nxorri ligjin për suspendimin e Kuvendit të Kosovës dhe e realizoi atë me dhunë. Me realizimin e këtij ligji, i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e Jugosllavisë, të Serbisë dhe të Kosovës, Serbia pushtoi Parlamentin e Kosovës, Këshillin Ekzekutiv të Kosovës duke vazhdaur edhe pushtimin e organeve ekzekutive të instancave më të ulëta pushtetit civil si dhe të Radios, Televizionit dhe mjeteve të tjera të informimit.

Këto masa, me të cilat shqiptarëve në Jugosllavi iu morën të gjitha të drejtat shkaktuan tensione edhe më të mëdha politike e sociale.

Këto masa e pengojnë Kuvendin legjitim të Kosovës në punën e tij, sidomos aprovimin e ngutshëm të Ligjit mbi partitë politike dhe shpalljen e zgjedhjeve të lira në Kosovë.

Masat e ndërmarra nga Serbia si dhe përdorja e përditshme e dhunës ndaj popullit shqiptar në Jugosllavi mund të shkaktojnë çdo ditë luftën civile në Kosovë me pasoja të paparashikuara për popullin shqiptar, Jugosllavinë, Ballkanin dhe Evropën.

Ne delegatët e Kuvendit të Kosovës Ju lusim që të merrni masa urgjente paraprake për pengimin e shpërthimit të luftës civile në Kosovë, për mundësimin e punës normale të Kuvendit legjitim të Kosovës dhe zgjidhjen paqësore të çështjes shqiptare në Jugosllavi në përputhmëri me të

arriturat demokratike në Jugosllavi dhe në Evropë si dhe me Kushtetutën ekztistuese të Jugosllavisë.

Mendojmë se, për ta arritur këtë, duhet të dërgoni urgjentisht në Kosovë organet përkatëse për mbikqyrje dhe ndihmë për zgjidhjen e kësaj çështje dhe situate shumë të rëndë.

Vjenë, 17.07.1990

Me nderime:
Dr. Skënder Skënderi
Muharrem Shabani iur.
Bujar Gjurgjeala dipl. ing.
në emër të delegatëve të
Kuvendit të Kosovë

KUR NA BRAKTIS NJERIU...

(Me 9 Nëntor 1990 u ndërpre mendimi i mprehtë dhe largpamës i intelektualit Bajram KRASNIQI, vdekja e rrëmbeu në moshën më të mirë, kur ishte në vlugun e krijimtarisë dhe synonte zenitet e dijës dhe urtisë...)

Në shenjë nderimi kujtimi, për Bajram KRASNIQIN, për lexuesit tanë po sjellim pjesë nga një intervistë e tij në »FJALA«, botuar me 1 Qërshor 1990.



Guximi qytetar i shkrimtarit është njëri ndër parakushtet themelore që ai të jetë shkrimtar i angazhuar dhe i pranuar prej lexuesve të shtresave të ndryshme shoqërore. Në të vërtet, vetëm atëherë kur shkrimtari me guximin qytetar i kritikon rrjedhat aktuale të jetës, vetëm atëherë kur e shfaq mendimin kundërvënës ndaj realitetit ekzistues, shkrimtari, nga një vëzhgues indiferent nga një njeri i zanatit, bëhet shkrimtar-intelektual, të cilin nuk e lë të qetë e keqja, e shëmtuara, e padrejta, për ç'arsye, në emër të një bote më të mirë, e ngre zërin kundër tyre, pavarësisht se ato mund t'ia rrezikojnë qenien, statusin shoqëror, madje edhe kokën. Të kujtojmë në këtë kontekst të vështrimit shkrimtarin e njohur frëng Emil Zolanë, i cili kur shkroi J'accusen e tij të famshme që t'i dalë krah Drajfusit, u bë shkrimtar-intelektual, kritik i kohës së tij, që e shpëtoi Francën me faqe të bardhë nga filistinët e saj. Zakonisht nga shkrimtarët e tillë, që nuk janë të kënaqur vetëm me fushëveprimin brenda përbrenda zanatit të cilëve nuk është vetëm fjalë, por edhe veprim, bile në radhë të parë, veprim. Ata me veprën, me gjestet dhe me sjelljet e tyre i zgjerojnë kufijtë e lirisë së krijimtarisë, pushtojnë hapësira të reja të saj, e ngrejnë moralin shoqëror e tjera.

Megjithatë, nuk dua të kuptohem keq. Unë nuk e propagoj vetëm tipin e letërsisë së angazhuar në kuptimin e parë të fjalës, sepse letërsia si art i fjalës, qoftë edhe atëherë kur nuk shihet mirfilli amgazhimi i saj për një qëllim, për një ideal shoqëror, edhe atëherë kur synimi i saj duket se është artizmi, vetvetiu angazhohet për një botë të caktuar, rrah një cak të vetin. Mirëpo, në jetën historike të popujve ekzistojnë disa periudha, të cilat kërkojnë nga shkrimtarët që të mos jenë vetëm shkrimtarë, njerëz të zanatit, por, në radhë të parë, intelektual, që dinë çka duan dhe rrahin ku duhet. E këtille është koha në të cilen ne po jetojmë, në të cilen shqiptarët, edhe si njerëz, edhe si kolektivitet kombëtar, gjëllojnë brenda përbrenda dilemës hamletiane: të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja.

Roli i intelektualit në jetën e popujve të vegjël, e veçanërisht në periudhat e dilemës hamletiane, është i madh, dhe i pazëvendësueshëm. Për shkak të rrezikimit nga më të mëdhenjtë, apo madje për shkak se kurrë s'kanë dalë nga tutela e tjetrit, është fare e kuptueshme përse popujt e vegjël, siç janë shqiptarët në Jugosllavi, kurrë nuk do të kenë mundur t'i çlirojnë energijtë e tyre kriujese, të bëjnë jetë kombëtare, po të kënaqen më pak, çdo gjë ta lënë në gjysmë të rrugës, pabarazinë më të tjerët ta përjetojnë si fatkeqësi historike, apo në raste deshpërimi kolektiv, edhe si fatkeqësi prej Hyut të madh. Çfarë duhet të jetë, prandaj, roli i intelektualit në kushte të këtilla, në rrethanat e çpushtetëzimit të plotë të atyre pak institucioneve politike, shtetërore e kulturore që kishim, të rivënies së tutelës së plotë të Serbisë mbi Kosovën, dhe për shkak të terrorit shtetëror të saj mbi shqiptarët të shtypjes kombëtare të tyre, të frustracioneve nacionale. Ky rol gjithsesi duhet të jetë i madh, edhe për një arsye tjetër: kur byrokracia politike kosovare tashmë hapur doli në anëntjetër, populli gjithsesi sytë do t'i ketë drejtuar në intelektualët e vët, në ata intelektualë që sipas tij nuk do ta lënë në gjysmë të rrugës. Paradoksalisht, prandaj, populli ka kuptim elitist për intelektualët. Atyre ai shpesh, natyrisht gabamisht, duke nënçmuar vetëveten, u vesh rolin mesianist, duke lënë anash se vetëm ai është gjykatësi suprem historik.

Veçse, intelektualët që kanë dalë nga gjiri i popullit, që nuk flasin në stilin unë dhe populli, për shkak se e ndiejnë frymëmarrjen e tij dhe i kuptojnë drejt proceset historike, as nuk do ta shtynë popullin në avanturizëm politik, as nuk do ta lënë në gjysmë të rrugës, as nuk do t'i bëjnë lajka, as nuk do t'i premtojne parajsën. Duke ia shkurtuar dhe duke ia bërë të rrafshtë rrugën deri te liria, në të vërtet, ata e gënjejnë, e mashtrojnë popullin, ia fshenin rrezikun. Kam frikë se nuk e kemi parasysh sa duhet Nolin në këtë fushë, por po e bëjmë më të rrafshtë rrugën sesa që është, dhe po kënaqemi me një shkarkim kolektiv emocional në formë folklorike: po i këndojmë në bishtat e gjatë të çiftelisë disa nga figurat tona të ndritura historike, në kohën kur edhe programet shkollore të gjuhës dhe të letërsisë shqipe bëhen në Beograd, kur në programet shkollore të kulturës muzikore nuk parashihet qoftë edhe një valle shqiptare, me një fjalë kur nga autonomia e Kosovës s'ka mbetur asgjë as nga autonomia kulturore. Ky shkarkim emocional kolektiv në formë folklorike më kujton Hajd-Parkun anglez në të cilin të papunët të pakënaqurit, të zhgënjyerit shajnë mbretëreshën, qeverinë e tjera pa ua var veshin askush. Kështu ata e krijojnë iluzion se janë të lirë, duke harruar se, *robëria fillon kur i robëruari ka iluzionin se është i lirë.*

DHE PËR FUNDIN...

Na kanë rënë shumë halle mbi krye. Jetojmë në një kohë të vështirë, në të cilen jeta e shqipëtarit s'e ka vlerën e këmishës së leckosur. Për këtë arsye, krijimtaria artistike, letrare e kulturore ka mbetur në margjina të interesemit, të kërshërisë së lexuesve. Jetojmë në kohën kur intervistat e ministrave të policisë lexohen para bisedave të shkrimtarëve, në kohën kur në gazeta po shtohen faqet e kronikës së zezë. Do të doja që një gjendje e tillë e jona, individule e kolektive, të kalojë sa më shpejt, t'i takojë historisë, kurse ne, si gjithë popujt e qytetëruar, të merremi me jetën e jo me vdekjen.

Megjithë frikën që kam se kjo s'do të vijë lehtë, se ende kërkon mund të madh, djersë e madje, edhe lotë, megjithatë, jam i bindur se ajo një ditë jo të largët do të vijë. *Kush e pret fundin e bizantinizmit, përballë Evropës së* qytetëruar ka çka të presë, do të jetë i lumtur. Qoftë lumturi e të gjithëve.

Sali BASHOTA

Me historianin dhe kritikun e letërsisë dhe intelektualin mendjemprehtë, Bajram KRASNIQIN, gjithnjë njeriu kishte për çka të fliste. Ishte i matur, i urtë dhe i qetë. U takuam rastësisht në Dardani në korrik të këtij viti, dhe na mori në veturë deri te Pallati i Shtypit. Sëmundja e kishte rënduar por nuk ipej. Ishte optimist se një ditë, një ditë e bukur do të agojë edhe në Kosovë, megjithëse ai këtë nuk e priti; por vepra e tij (edhe pse mendim i prerë në kohën kur ngjitej zeniteve) është këtu me ne, shtigjeve të lirisë. Po, do të ketë shumë mundime e lotë, madje edhe gjak, por shpirti i ndritur i popullit,gjithsesi do të shëndrisë patjetër... Sidoqoftë, Bajram Krasniqi e kreu klasën me sukses shembullor, dhe dha frymë ballëhapur, *me e në popullin e tij i cili e lëshoi në tokën e Ât*dheut në dheun e shkriftë të Llapit, ngase obligimin e vet qytetar dhe kombëtar e mbaroi me nderë, deri aty ku arriti forca e tij fizike dhe shpirtërore. Lamtumirë njeri!


Halil MATOSHI

DUKE SHPALUAR KUJTIMET E JUSTINA SHKUPIT, INFERMIERËS SË VETME SHQIPTARE NË LUFTËN QYTETARE TË SPANJES (1936–1939)

Dr Shevqet S. Canhasi

Për motrën Justina Shkupi deri më sot nuk është shkruar asnjë fjalë në shtypin tonë kosovar, ndonëse ajo ishte shoqe e Asim Vokshit, e Xhemal Kadës, e Teni Konomit dhe e shumë luftëtarëve internacionalistë. Për më tepër, madje, ajo është e vetmja luftëtare shqiptare e brigadave ndërkombëtare, e cila mori pjesë në luftën civile të Spanjës. Meqenëse më tepër shërbei në Spitalin e Murcias së Spanjës, luftën qytetare dhe pasojat e saj tragjike i pau përmes pacientëve të saj, luftëtarëve të plagosur në frontin e luftës kundërfashiste. Pasi që jeta dhe veprimtaria e saj është thuaja se krejtësisht e panjohur për lexuesit shqiptarë këndej kufirit shtetëror, është e udhës që për të të japim disa të dhëne elementare. Shumica e të dhënave janë nxjerrë nga goja e saj përmes inçizimeve magnetofonike dhe shënimet që kisha mundur të marr gjatë kohës sa ishte musafire imja në Kosovë më 1972. Ato janë një pjesë e dhembjes së madhe, siç shprehej ajo vetë, janë fragmente nga jeta e një femreje shqiptare që herët mbeti bonjake, pa babë, pa nënë, pa motër as vëlla. Ajo u rrit në gjirin e popullit të saj të shumëvuajtur dhe, duke u përplasur në valët e një jete të stuhishme, fitoi plot vëllezër e motra, në fillim ndër shqiptarë e mandej edhe ndër luftëtarët internacinalistë, që kishin shkuar të luftonin fashizmin në Spanjë e kishin ardhur aty nga të katër anët e botës, pjesëtarë të 53 kombeve e racash të ndryshme. Jeta e saj është fragment i një poeme për ecjen krenare të njeriut nëpër rrugën e mundimeve, nëpër shtegun e vuajtjeve nga më të ndryshmet, poemë për qëndresën e njeriut, për qëndresën e femrës shqiptare që kishte vendosur të ngadhënjente mbi vdekjen.

Duke shfletuar Dosjen e Justina Shkupit, duke shpaluar kujtimet e saj, njeriu e ndjen veten si ai që është nisur të mbledhë një grusht dhembjesh e vuajtjesh, por që nuk e jep frymën e fundit pa arritur në cakun që i ka caktuar vetes. Kështu edhe unë po përmbush një pjesë të detyrimit moral e njerëzor që kisha marrë mbi vete për ndriçimin e personaliteteve të ndritshme të historisë së vonshme shqiptare, për luftëtarët internacionalistë nga radhët e kosovarëve, që patën marrë pjesë në Luftën Qytetare të Spanjës. *Në atë plejadë fytyrash të ndritshme bën pjesë edhe motra jonë shqiptare, kosovarja Justina Shkupi. Ajo u lind në kryeqytetin e atëhershëm të Vilajetit të Kosovës, në Shkup, më 26 shkurt 1909. Ajo u u lind atë vit kur arsimit kombëtar shqiptar po i vëheshin themele të shëndosha me Shkollën Normale të Elbasanit. Motra Justinë është e bija e Andrea Shllakut dhe e Marijes. Babai i saj ishte me origjinë nga Shkodra dhe njëri nga tregtarët e fortë të Shkupit, prej nga me vonë e mori edhe mbiemrin. Merrej kryesisht me tregtinë e leshit e të pambukut. Me së shumti tregtone me Selanikun, Kajron e Stambollin. Andrea u martua vonë. Ai kishte mbushur 50 vjet kur e mori për nuse Marijen, nënën e Justinës, e cila atëbotë ishte 14-vjeçare. Për shumë vjet me radhë Andrea dhe Marije Shllakut nuk u lindën fëmijë. Kur*



u lindi vajza, fëmija i parë dhe i vetëm i tyre, në shtëpinë e Andrea Shllakut (Shkupit) u bë gëzim i madh, ndonëse vëtë Andrea ishte i sëmurë. Fatlum që pas aq vjetësh arriti të bëhej prind, ai urdhëroi që lindja e vajzës së tij të shndërrohej në një festë familjare. Ai kërkoi që për këtë gëzim të familjes së tij të ftohesin gjithë të afërmit, miqtë dhe dashamirët e tij. Andrea Shllaku kërkoi që vajza e tij të pagëzohej me emrin Ana. Po Ana Shllaku lindi e vockël dhe e hafiftë, taman fëmijë pleqërie. Ishte shëndetligë dhe heqimi, mjeku turk, që shpesh e vizitonte Andrean, i paskësh thënë se Ana e vogël do të ketë shumë telashe derisa të rritet. Megjithëkëtë, në saje të kujdesit të Nënë Maries dhe të pasurisë që kishte, zuri të rritet mirë. Mirëpo, tre muaj pas lindjes së Anës që e gëzoi aq shumë. Andrea Shllaku vdiq, duke lënë të bijën mituri. Po Marie Shllaku ndonëse nënë e dhemshur dhe e pasur, s'kishte pasur fatin e mirë që, të paktën pas vdekjes së burrit të saj, vajzën ta rriste sipas dëshirës. Mbretëritë e vogla ballkanike kishin lidhur një aleancë të fortë ndërmjet veti që, në emër të përzënies së Perandorisë Osmane prej Ballkanit, të pamundësonin krijimin e Shtetit autonom apo të pavarur shqiptar, në mënyrë që kështu të mund t'i ndanin midis tyre viset shqiptare e maqedone. Kur kryengritja e fuqishme shqiptare në Kosovë me çlirimin e Shkupit e detyroi Qeverinë turke të hynte në bisedime me Hasan Prishtinën, aleatet ballkanike përfituan nga rasti dhe e sulmuan nga të gjitha anët. Ushtria serbe, pas premtimesh që u bëri shqiptarëve se nuk do t'i tranzote në vatrat e tyre, e pushtoi Shkupin dhe filloi masakrat mbi shqiptarë. Veç vrasjes ushtria serbe bëri edhe plaçkitje të paparë deri atëherë. Dyqanet e Andrea Shllakut të ndjerë, si edhe magazinat e tij plot mallra u plaçkitën pa meshirë. Pra qysh në fëmijërinë e hershme, pa i mbushur ende katër vjet, Ana Shllaku i përjetoi tmerret e pushtuesve serbomëdhenj. Një togë ushtarësh në krye me një oficer disa herë ia bastisën dhe ia plaçkitën shtëpinë. Me pretekst se po kërkonin »banditët arnautë«, ata i maltretuan në mënyra të ndryshme duke ia marrë Maries madje edhe dhuratat e nusërisë: qafore me margaritarë nga ata të lindjes, karfica e flokëve floriri me diamante të vogla, unaza Damasku me elmaze e xhevahire, medaljone të ndryshme me zinxhirë ari, shumë bylyzykë të ndryshëm, dymbëdhjetë hanhalla floriri dhe tri palë vëthësh me gurë të kushtueshëm diamanti, të sjellur nga India a Irani. Kur ia morën të gjitha këto Nënë Maries desh i kishte plasur zemra. Kishte vendosur me çdo kusht të kthehej në Shkodër, por rruga ishte krejtësisht e pasigurtë. Në kushte të tilla, që u ndërlikuan akoma më tepër me plasjen e Luftës së Parë botërore, Maria u sëmur dhe së shpejti vdiq, duke e lënë Anën krejtësisht jetime e në moshën gjashtë vjeçare.

Duke shfletuar Kujtimet e motrës Justinë njeriut i ngjethet mishi nga tmerret që ka përjetuar me hyrjen e ushtrisë serbe në Shkup. Ajo tregon: »Oficeri që erdhi me një togë ushtarësh ishte një xhelat i pacipë. Ai sulmoi me grushta e shqelma nënën time, e cila u detyrua »t'u dhuronte« shumë stoli ari e argjendi... Mandej u sëmu dhe para se të vdiste nëna më porositi të shkoja domosdo në Shkodër, se vetëm atje do të mund të shpëtoja kokën.«

Mandej Justina rrëfen se si janë larguar prej Shkupit, por pas largimit të serbëve, të cilët i ndiqte Austria. Nga Shkupi është nisur me pajton për Ferizaj e Prizren e prej atyhit për Shkodër. E përmalluar ajo vazhdon: »Memzi mbërritëm në Prizren, të cilin zura ta doja si vendlindjen time të

dytë. Aty pushuam dy ditë to don Lazër Mjedja, vëllai i don Ndre Mjedjes. Ai u kujdes për ne dhe mua më ledhatoi si një baba i dhemshur. Mbasi na i dha udhëzimet e nevojshme për udhëtimin drejt Shkodrës, në nisje na dha edhe qershia, bojlia të Prizrenit... Udhëtimi për Shkodër shkonte shumë ngadalë, sidomos nëpër Malësinë e Gjakovës, kah Nikaj-Merturi, dhe zgjati plot dhjetë ditë... Atje më vendosën në një azil, qendër për të varfër, ku sigurohej ushqimi, por jo edhe fjetja. Për fjetje më kishin marrë një burrë me gruan e tij, të dy farmacistë e njerëz zemërmirë. Atje deshën që të shkoja murgeshë, por farmacisti që ishte fanolist, e kundërshtoi dhe më 1922 më regjistroi në Shkollën e Infermiereve të Tiranës, që ishte trivjeçare«.

– Si e ndienit veten në Tiranë? – e pata pyetur atëherë.

»Fort mirë. Rinia ishte entuziaste dhe mësonte me zell. Aty iu qepa mësimit dhe ushtrimit praktik. Spitali i Tiranës ishte i organizuar në Hanin e Vjetër, pranë Sahat Kullës. Kryeinfermiere dhe drejtore ishte një femër e rrallë, që vështirë i gjeje shoqe. Ajo ishte e rreptë, kërkonte punë me përgjegjësi. Ajo ishte Katerina Cilka, gruaja e atdhetarit të ndjerë, Grigor *Cilkës, në të cilin ishte dashuruar qysh kur studjonin së bashku mjekësinë në Universitetin e Njujorkut. Për këtë grua të shenjtë ruaj aq shumë* kujtime të dashura, se e kisha si nënën time të dytë. Katerinën e stoliste humanizmi i thellë, dashuria e madhe për të sëmurët dhe guximi i rrallë. Trimëria e saj u pa më 23 dhjetor 1924, kur e pranoi në spital kapitenin trim, Ahmet Demin, i cili ishte plagosur rëndë në luftën e pabarabartë me bandat zogiste që, të ndihmuara nga repartet e ushtrisë jugosllave po marshonin drejt Tiranës për të rrëzuar Qeverinë demokratike të Fan Nolit. Disa i thanë të mos e pranonte se nesër do të kishte telashe me zogistët. »Jam gruaja e trimit dhe e atdhetarit Grigor Cilka unë«, ua kthei ajo me mburrje për të shoqin e ndjerë. Ahmet Demi, duke i qëndruar besnik Qeverisë demokratike të Fan Nolit, kishte mbrojtur Gurin e Bardhë përkrye një lufte heroike në krye të togës së tij. Dhe njëmend, të nesërmen mercenarët dhe bashibozukët zogistë e sulmuan me armë Spitalin e Tiranës dhe deshtën ta marrin me forcë Ahmet Demin e plagosur rëndë. Zonja Katerina Cilka vrapoi dhe me jetën e saj e mbrojti dhe nuk e lëshoi në duart e zogistëve oficerin e Qeverisë demokratike, Ahmet Demin. Madje ajo bëri një protestë energjike dhe ia doli t'i përzënte zogistët, që u detyruan të zbrapsen para guximit të një gruaje.«

Deri atëherë quheshit Ana SHLLAKU, prej kur zunë t'Ju quajnë Justina SHKUPI? – e pata pyetur më tutje.

MOTRA JUSTINË: Mbiemrin ma ndërruan qysh kur u regjistrova në Shkollën e Infermiereve të Tiranës. Prej atëherë isha Ana Shkupi. Shkollën e kreva më 1926. Prej kësaj shkolle shkova ta përkryej profesionin tim human në Bari e Napoli të Italisë. Më 1928 u ktheva sërish në Shqipëri dhe, meqë isha dalluar në punë e mësime, Kryqi i Kuq Internacional më dha një bursë për të vazhduar mësimet në Francë. Tre muaj para se të fillonin studimet më çuan në një kuvend murgeshash, ku duhej ta mësoja frëngjishten. Aty më pagëzuan me emrin Justinë dhe prej asaj kohe njerëzit zunë të më quajnë motra Justinë. Në Francë qëndrova tri vjet e gjusmë dhe pasi i kreva studimet më dhanë »Diplôme d'Etat« (Diplomën e Shtetit) të Francës. Aty më donin dhe më çmonin, madje edhe më lutën të qëndroja

në Francë me shërbim. Po s'munda të pranoj se Shqipëria ishte nevojtare për kuadro të profilit tim, kështu që vendosa të kthehem në atdheun tim të dashur.

Kur u kthyet në Shqipëri dhe me ç'punë u morët atje?

MOTRA JUSTINË: Në Shqipëri u ktheva më 1931, në një kohë kur vendi kishte hyrë në krizë të thellë. Për pesë vite me radhë punova si infermiere instruktore në Shkollën e Infermierve të Tiranës, aty ku i kisha kaluar 3– 4 vite të stinës më të mirë të jetës sime. Më 1936, kur plasi Lufta Civile e Spanjës, duke qenë me shpirt demokrate dhe kundërfashiste, rinia shqiptare kërkonte rrugët si t'ia vënte digën fashizmit sa më larg sepse e dinte fort mirë që ai po depërtonte qetas në Shqipëri. Urrejtja kundër Zogut arriti kulmin qysh kur i kisha ende gjashtëmbëdhjetë vjet. Siç thash pak më parë, atëherë qëllova në Bari të Italisë, kur më 2 mars 1925, Balto Stambolla vrau zotni Luigj Gurakuqin, të cilin vite më parë e kisha parë *në Shkodër e në Tiranë. E kam sa të gjallë parasysh, edhe pse kanë kaluar aq vjet. Ishte tamam ashtu siç e paraqet Noli, gojëmjaltë e zemërhekur. Ende më ther në zemër se atë mbrëmje, që do ta vriste krimineli posa kisha biseduar me të. Restoranti »Cavur« (Kavur) i Barit ishte shëndrruar ato ditë në një qendër tubimi të emigrantëve shqiptarë të Italisë. I doja e i nderoja ata burra trima, po më së shumti gojëmjaltin Luigj Gurakuqi. Ne vajzat e dinim mirë se ai ishte një luftëtar i çlirimit dhe i shkollimit të femrës, prandaj edhe unë ndjeja një nderim të veçantë për të. Doja t'ia puthja dorën si babait tim atë mbrëmje që do ta vrisnin, por ai s'më la. M'i lëmoi flokët dhe më porositi të mësoja me zell, se Shqipëria kishte nevojë më shumë se asnjë vend tjetër për femra të shkolluara... Ja, të tillë njeri kishte dhënë urdhër ta vrisnin dhe ec e mos e urrej Zogun me tërë shpirtin! Ec e mos e urrej njeriun që vret bijtë më të mirë të popullit! Zogu kishte vrarë edhe shumë të tjerë, por vrasjen e zotni Luigjit e kisha parë me sytë e mi*

E marr me mend se, veç të tjerash, edhe kjo urrejtje e madhe ka mundur t'Ju çojë në Spanjë, por si e morët »Lidhjen« për të shkuar atje, mendoj përmes cilit shok?

MOTRA JUSTINË: »Lidhjen« e mora përmes studentit të Liceut të Korçës, Hajdar Delvinës, i cili kishte një farmaci në Durrës. Në këtë mënyrë mora »lidhjen« edhe me djem të tjerë që do të shkonin në Spanjë. Më mbante gëzimi se edhe të plagosej ndonjë shqiptar e të thërriste si të tjerët; ah, nënë! – një motër shqiptare do t'i gjendej pranë e do t'i jepte ndihmën e duhur duke ia mjekuar plagët. Si farmacist që ishte, Hajdarin e njihja edhe më parë, prandaj shkova më të në Durrës ta merrja adresën. Ai më shpjegoi edhe se ku duhej të shkoja e me kë të shkoja në Francë, prej nga mandej do të shkonim në Spanjë. Në kujtesë më ka mbetur, si çast *i paharruar, edhe takimi me Teni Konomin e Korçës, shok i ngushtë me* Asim Vokshin e Gjakovës. Teni ka qenë i lidhur me Internacionalen Komuniste, mbase përmes Ali Kelmendit apo ndoshta edhe drejtpërdrejt. Ai *ishte një njeri shumë i ngritur në pikëpamje intelekruale dhe shumë i dashur e i dhemshur si njeri, punëtor që s'ia gjeje shokun. Ai duhej të punonte* për të mbajtur gjallë nënën e motren e tij. Teni u la pak para nënës e motrës në Korçë, që të mos i vdisnin urie e mandej shkuam në Elbasan të merrnim kontakt edhe me disa shokë e mandej sërish u kthyem në Korçë.

Pas kësaj kaluam tranzit në Selanik që të rregullonim pasaportat në legatën frënge. Mirëpo atje mundi na shkoi kot se përfaqësia diplomatike e Francës s'na kreu punë. U detyrova të kthehem ilegalisht në Shqipëri dhe një natë fjeta ne hotel në Durrës. Filip Koço Teodosi më mbajti një muaj të plotë.

A keni menduar se ndonjëherë do t'Ju vijë rasti ta vizitoni Kosovën dhe t'i njihni për së afërmi kosovarët?

MOTRA JUSTINË: Thonë ari në zjarr e njeriu në luftë provohet. Edhe unë kosovarët i njoha mirë në luftë dhe i deshta me zemër, se ishin lulja e djalërisë shqiptare. Nuk e kam ditur se a do të më bëhet e mundur ta vizitoj Kosovën, por atë dëshirë të zjarrtë e kisha dhe shpesh e ëndërroja.

Çfarë ju ka mbetur merak në Kosovë?

MOTRA JUSTINË: Që s'pata fatin e mirë të më lejohej të vija më heret në Kosovë t'ia puthja dorën Nënë Qazimes, që e lindi trimin Asim Vokshi. Besoj se tani do të çmallem me Bijen duke e vizituar edhe kullën e Vokshëve në Gjakovë.

– Motra Justinë i kujtonte me mall e nderim shokët e saj internacionalistë, por mbi të gjithë Emrush Myftarin e Pejës.

»Emrushi kishte shpirt demokrati e revolucionari. Pikëpamjet i ka shprehur në letrat dhe punimet që ia çonte Qamil Çelës, redaktorit të gazetës »SAZANI«, organ i Grupit të komunistëve shqiptarë të Lionit. Mbante kontakte edhe me ZEKERIA REXHËN, me të cilin është takuar në Monpelje të Francës Jugore. E di mirë se edhe atij i ka treguar poezi të ndryshme, që i shkruante herë pas herë, që nga viti 1930... Si sot më kujtohet kur u nisa nga Durrësi pasi që i pagova 3 napolona Konsullatës së Francës për udhëtimin me vapor, ushqim e pije. Vijova për Itali, Zvicër e Francë, prej nga sipas udhëzimeve të Ali Kelmendit dolëm në Spanjë, në Port Bu, me një barkë kitarë e fizarmonikë. Roja spanjolle na çoi sëpari në Figueras e mandej në Albacete, ku ishte Shtabi i Brigadave Internacionale. Ata më caktuan të shkoja si një nga infermieret kryesore në Spitalin e Murcias, që ishte i vendosur në katër hotele luksoze. Fashistët nuk e bombardonin Murcian, se aty banonte motra e Frankos, kështu që dy vjet i mjekonim të plagosurit pa pengim. Aty kam takuar edhe Emrushin e mandej edhe Zef Prelën e plagosur rëndë. Aty sollën ndihma djemtë e gjatë të Prezidentit amerikan, Ruzveltit. Kur u detyruam të tërhiqeshim, në rrugë për Barcelonë, në Valencia e takova prapë Emrush Myftarin, i cili më tregoi se ishte në Batalionin e Ballkanit, si kapiten artilerie. Ishte i dëshpëruar se Spanja Republikane po thyhej me ndihmat e mëdha të Hitlerit e të Musolinit...«

Motra Justinë përshkruan mandej golgotën spanjole, luftën për shpëtimin e të plagosurve, kalimin në Francë, vuajtjet në kampin afër Parisit, përpjekjet për riatdhesim dhe kthimin në Shqipëri. Takimet me Emrush Myftarin në Tiranë dhe atentatin që bëri ai në Zhivko e Gavrillo Rajeviqin më 8 tetor 1943, te Shtëpia e Oficierëve në rrugën e Kavajës. Këtë atentat në agjentët e Drazha Mihajloviçit e bëri me kërkesen e Komandës së Njësiteve Guerile të Kryeqytetit. Emrushi e kishte bërë me dije se do të bënte atentat edhe në Ilia Qirkon e në Xhafer Devën, sa ishte te Justina e cila punonte si arsimtare instruktore në Shkollën e Infermiereve të Tiranës. Deri me 1966 Motra Justinë punoi aty, kur edhe u pensionua.

Kujtimet e saj u shënuan me 1972 gjatë vizitës që i bëri Kosovës si mysafire. Dy vjet më vonë vdiq në Spitalin Infektiv numër 4 të Tiranës.

Motra Justinë vdiq me dëshirën e pasendërtuar për ta vizituar sërish Kosovën, të cilen e Quante Atdhe të saj, me që edhe ishte e lindur në Kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, në Shkup.

OSE ↗ REPUBLIKA E KOSOVËS
↘ PALESTINA E EVROPËS

Shkruan: Dr. Sadri FETIU

Vizita e nënkryetariat të qeverisë, Pregël, është shenjë se ka filluar dicka të lëvizë në relacionin Kosovë–Jugosllavi. Mirëpo, fill pas kësaj kryesia e shtetit jugosllav u kërcnua se problemet e Kosovës nuk do të zgjidhen po që se ajo nuk i nënshtrohet plotësisht Serbisë. Kështu u tha në kumtesën nga mbledhja e kryesisë. Kështu tha edhe Joviqi, që pretendon të jetë vetë kryesi në saje të përkrahjes së parezervë të dy ose tre vazalëve të tij të bindur.

Tashmë flitet haptas se nuk ekziston Jugosllavia e AVNOJ-it. Në qoftë se kjo është e vërtetë, atëhere si mund të ekzistojë kryesia si kokë që nuk mund ta kontrollojë trupin e vet. Për ne shqiptarët e Kosovës ka bukur shumë kohë që nuk ekziston më as koka. Ne nuk mund t'i pranojmë si tonat të gjitha ato organizma shtetërore që nuk çajnë kokën kur vriten fëmijët tanë të pafajshëm, kur derdhet gjaku ynë vetëm pse dëshirojmë të jemi të barabartë me te tjeret. Për ne nuk ekzistion tashmë asnjë organ shtetëror, i cili nuk do të respektojë vullnetin e një populli, që nuk do të njohë REPUBLIKËN E KOSOVËS.

1. Republika vetëm minimum i doemosdoshëm

Në këto kushte, kur të gjithë e pranojmë se nuk ekziston më Jugosllavia e AVNOJ-it, të gjithë popujt, që e përbënin atë, angazhohen që brenda ndryshimeve që do të bëhen në rrethana të reja të sistemit shumëpartiak ta përcáktojnë sa më qartë pozitën e vet në konfederatën ose, eventualisht edhe në federatën e re jugosllave. Edhe shqiptarët, që janë populli i tretë përkah numri, në mënyrë plotësisht legjitime e shpallën Republikën e Kosovës dhe e miratuan Kushtetutën e saj. Përfaqësuesit e zgjedhur legalisht nga populli në këtë mënyrë e shprehen vullnetin e tij, që ishte ndrydhur gati një shekull, sepse liria dhe pavarësia ishin dhe mbeten shpresa të vazhdueshme të Kosovës që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Për vehtësinë e Kosovës qe deklaruar edhe Konferenca e Bujanit në nismë të vitit 1944. Për Republikën e Kosovës është derdhur gjaku i shqiptarit qysh më 1968, kurse nga 1981 ajo për çdo ditë është gatuar në vetëdijën e për gjithshme të shqiptarëve të Jugosllavisë. Dhe sot ajo është realitet që nuk guxon të mohohet. Në këto rrethana shqiptari nuk është në

gjendje të pranojë kurrëfarë jugosllavie pa Republikën e Kosovës. Ajo tashmë edhe pse nuk ka mundësi të funksionojë, është bërë pjesë e pandashme e jetës së tij.

Republika e Kosovës shikuar realisht është kërkesë minimale. Në kushtet kur Jugosllavia edhe mund të dekompozohet plotësisht dhe çdo popull të marrë rrugën e vet të pavarur në bazë të njësive të tashme federale, shqiptarët do të detyrohen ta përbijnë edhe një »tabletë të hidhur«, ta përjetojnë një padrjtësi që u është bërë më heret: gjysma e viseve shqiptare të pushtuara nga sllavët në Luftën Ballkanike (1912) do të mbesin jashtë Republikës së Kosovës. Prandaj, pa hyrë më thellë në trajtimin e çështjeve të kësaj natyre, të cilat mund të jerë thjesht hipotetike, duhet ta themi haptazi se çështja e shqiptarëve në Jugosllavi është shumë më e gjerë dhe më komplekse se sa Republika e Kosovës. Mu për këtë në krahasim me zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve, shpallja e Kosovës Republikë është realizimi i një minimumi të të drejtave të shqiptarëvë të Jugosllavisë si popull i barabartë me të tjerët. Këtë duhet ta kenë parasysh të gjithë ata që do të vendosin për fatin e Jugosllavisë së ardhshme, në qoftë se do të mund të konstituohet Jugosllavia si konfederatë. Këtë të vërtetë duhet ta dijnë edhe subjektet ndërkombëtare që janë të interesuara për ruajtjen e paqes në Ballkan e, në radhë të parë, KBS-i që do të zhvillojë punimet sivjet në Paris.

2. Cila do të ishte zgjidhja e plotë e çështjes shqiptare në Ballkan

Kosova është viktimë e ekspansionit serb të projektuar në *»Naçertanien«* e I. Garashaninit, që edhe sot ishte bazë për hartimin e *»Memorandumit«* të Akademisë Serbe. Mbi këtë bazë ekspansioniste më 1876–78 Serbia i ka pushtuar viset e Toplicës, të Jabllanicës, të Pusta Rekës etj. dhe me dhunë e ka shpërngulur popullsinë shqiptare, muhaxhirët, (rreth 200 mijë njerëz) e në vend të tyre e vendosi popullsine sllave. Europa e atehershme e pat miratuar dhunën e këtillë e, madje, Kongresi i Berlinit u pat dhuruar serbomalaziasve edhe vise të tjera thjesht shqiptare. Në Luftën Ballkanike (1912) Serbia dhe Mali i Zi e pushtuan Kosovën dhe viset e tjera shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi dhe Europa e atëhershme në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913) i pat caktuar kufijt e sotëm. Kështu shqiptarët mbeten në Jugosllavi, jo si pakicë kombëtare, por duke qenë gjysma e kombit në troje të veta kompakte. Sipas statistikave të atëhershme në viset e pushtuara të Kosovës e të Maqedonisë Perëndimore popullsia sllave përbente diku rreth 7 përqind dhe ishte minoritet me plotë kuptimin e fjalës.

Nuk është aspak e nevojshme të merremi me përrallat për kohën kur Kosova është pushtuar nga Nemanjiqët e, as me legjendat për Betejën e Kosovës të vitit 1389, sepse mitet e këtilla, ashtu si edhe e drejta historike e Serbisë (?) nuk do të na shpienin askund. E vërteta është gjetiu: Kosova kur u pushtua më 1912 ishte takë shqiptare. Ajo mbeti e këtillë edhe sot e kësaj dite, ndonëse shqiptarët e saj për këto 78 vjet kaluan nëpër të nëntë rrathët e ferrit. Kështu ishte në Jugosllavinë e Vjetër, por aspak më mirë edhe në atë që u quajt e Re e pastaj edhe *Demokratike* (?!) E vetmja

periudhë që mund të këtë parashenjën pozitive është ajo e viteve 1968– 81, kur Kosova gëzonte një gjysmë autonomie dhe shënonte rezultate pozitive në zhvillimin e arsimit, të kulturës dhe të ekonimisë. Zhvillimi i saj edhe në këtë periudhë ishte përgjysmë më i vogël se ai i mesatares së viseve të tjera të Jugosllavisë.

Shqiptarët në Kosovë janë popull autokton që me shekuj jeton në troje të veta. Edhe në territore të tjera jashtë Kosovës ata përbëjnë popullin kompakt që gjithmonë ka jetuar në ato vise. Shqiptarët në Jugosllavi paraqesin tërësi territoriale dhe etnokulturore që është vazhdimësi e pashkëputur nga vendi amë – Shqipëria. Si popull me shkallë të caktuar të zhvillimit të vet të përgjithshëm, ata kurrë nuk do të pranojnë statusin e pakicës kombëtare në Jugosllavi e mu për këtë nuk do të këtë forcë në këtë botë që do të mund t'i shkoqë nga trojet e veta. Kosova kurrë nuk mund të bëhet Serbi, ashtu siç pretendon politika ekspansioniste serbomadhe, e cilla tash vonë e ka gjetur »akrançin« e vet – Izraelin, ku do t'i patentojë licencat e veçanta për kolonizimin modern të Kosovës, meqë të gjitha kolonizimet e deritashme kanë dështuar plotësisht. Kjo do të ishte historia më e shkurtër e shqiptarëve të Jugosllavisë dhe e vërteta për ta se janë popull i pushtuar dhe i robëruar.

Shqiptarët janë sot të vetëdijshëm se historia nuk mund të përmbyset përnjëherë. Ajo që është bërë më 1912 nuk ka qenë e mundshmë të zhbëhet deri sot. Por, që nga viti i pushtimit të Kosovës gjenerata të tëra kanë jetuar, kanë vuajtur dhe kanë vdekur me shpresë se një ditë do të vijë koha kur padrejtësitë historike ndaj shqiptarëve do të korrigjohen. Kjo shpresë i pat frymëzuar edhe antifashistët shqiptarë të Kosovës që besuan në parimet e të drejtës ndërkombëtare për vetëvendosjen e popujve pas Luftës së Dytë Botërore dhe, mu për këtë, e sanksionuan këtë të drejtë të Kosovës në Konferenën e Bujanit, duke u mbështetur në alenacat e përgjithshme ndërkombëtare të Fuqive të Mëdha. Dhe në vend që e drejta të vihej në vendin e vet edhe më 1945 në Kosovë u zbatua ligji i dhunës. Ajo u la me gjak dhe mbeti nën zgjedhë si rajon autonom i Serbisë. E aleatët e koalicionit të madh antifashist, emrat e të cilëve ishin shënuar me respekt të veçantë në preambulën e Rezolutës së Konferencës së Bujanit, nuk e thanë të paktën një fjalë ngushlluese për të drejtat e popullit, që regjimi i ri jugosllav i mori nëpërkëmbë, për plojën e tmerrshme të Tivarit, të cilen e panë me sy të vet (madje edhe e fotografuan) përfaqësuesit e aleatëve të kualicionit antihitlerian, si edhe për shumë krime të tjera që u bënë në të gjitha viset shqiptare në Jugosllavi.

Shqiptarët në Jugosllavi janë komb. Ata ishin pjesa më vitale e kombit shqiptar në shekullin XIX dhe në fillim të këtij shekulli, pra gjatë gjithë periudhave të luftrave për çlirim kombëtar nga zgjedha turke deri me 1912. Shqiptarët pra, dëshirojnë të jenë të barabartë me të tjerët Jugosllavi, të vendosin vetë për fatin e tyre. Kosova që nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimatre e ka të drejtën për vetëvendosje në bazë të parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe Kartës së Kombeve të Bashkuara. Të gjithë ata popuj që dëshirojnë të jetojnë në miqësi e paqe me shqiptarët duhet të ulen e të bisedojnë me ta si me partnerë të barabartë. Shqiptarët vetëm si të barabartë mund të deklarohen për Jugosllavi, sepse janë zot të trojeve të veta.

Barazinë dhe sovraniteten e tyre mund t'ua garantojë vetëm Republika e Kosovës, me të drejtat dhe obligimet, qoftë brenda konfederatës jugosllava, qoftë edhe si subjekt që do të përfshihet në raportet më të gjera të sigurisë dhe bashkëpunimit europian.

Me Republikën e Kosovës, me demokratizimin e përgjithshëm të jetës shoqërore, me krijimin e pushtetit lokal demokratik të popullit shumicë në viset shqiptare jashtë Kosovës, me veprimin e lirë të ligjeve të tregut në marrëdhëniet prodhuese, me këmbimin e lirë të ideve dhe vlerave kulturore në tërë hapësirën e shtrirjes etnike të shqiptarëve, jo vetëm brenda Jugosllavisë, por edne në hapesirën më të gjerë ballkanike (në radhë të parë më Shqipërinë), do të krijohen të gjitha kushtet e domosdoshme për integrimin e shqiptarëve brenda një tërësie etnokulturore dhe ekonomiko-shoqërore. Brenda kësaj tërësie, ashtu si edhe brenda Europës së Bashkuar, shqiptarët do të qarkullonin lirisht pa pasur nevojë për kurrfarë pasaportash, vizash e lejash të veçanta. Në këso kushtesh do të korrigjohej ajo që është prishur më 1912, do të realizohej endrra e bukur e rilindësve tanë, sidomos ajo e poetit dhe mendimtarit madh, Naim Frashërit, e shprehur në poemën *»Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve«* për jetën e përbashkët e vëllazërore me popujt fqinj të Ballkanit.

Duke i krijuar kushtet e plota demokratike për funksionimin e Republikës së Kosovës në Jugosllavi, në Ballkan dhe Evropën e bashkuar, asnjë populli (kombi) nuk do t'i cenohej e drejtja për të jetuar i lirë në trollin e vet, për t'i poseduar të mirat materiale e të tjera që dë t'i krijojë me punën e vet, për të komunikuar lirisht brenda kombit të vet, për t'i shfrytëzuar të gjitha vlerat kulturore dhe tërë visarin që e përbën begatinë shpirtërore në jetën e tij. E krejt kjo do të arrijeh duke u siguruar të gjithë popujve të drejtën për të marrë pjesë në jetën publike e politike në pajtim me parimet themelore të demokracisë, e cila e ka pikënisje lirinë e individit për të arritur tek liria e të gjitha kolektiviteteve nacionale si në strukturat lokale të shoqërisë ashtu edhe në ato që përbëjnë strukturat më të organizuara shtetërore, ose të bashkësive më të gjëra rajonale, që do ta përbënin tërësinë e Evropës së bashkuar.

Pra, ky është synimi i shqiptarëve të Jugosllavisë, i të gjithë atyre që janë përcaktuar për demokraci e kundër dhunës, i të gjithë atyre që e mbështesin fort Republikën e Kosovës. Ky është synim real i kësaj gjenerate që tashmë ka krijuar një përvojë bukur të mirë në luftën politike. Gjeneratat që vijnë më vonë, me siguri do të kujdesën vetë që sipas standardeve të kohës ta rregullojnë jetën e tyre të përbashkët me popujt e tjerë të Ballkanit. Atëherë shqiptarët nuk do të ketë mundësi t'i akuzojë më askush për *irridentizëm,* për *nacionalizëm,* për *secesionizëm,* për *separatizëm* e *terrorizëm* e as për *Shqipëri të Madhe,* sepse edhe Shqipëria, ashtu si edhe shtetet e tjera të Ballkanit, nuk do të jetë më as e madhe e as e vogël, por mu aq sa është në të vërtetë. Ky, pra, është synimi, kjo është ëndrra e bukur. Po realiteti?!

3. Ose Palestina e Evropës

Realiteti i sotëm i Kosovës është shumë i vrazhdë. Në Kosovë vriten

njerëzit e pafajshëm, vetëm pse duan liri e demokraci. Në Kosovë derdhet gjaku i rinisë. Me plotë kuptimin e fjalës Kosova sot është në gjendje okupimi. Serbia, duke zbatuar aparthejdin dhe gjenocidin, dëshiron ta mbajë Kosovën koloni të vetën. Serbia mbështetet vetëm, në ligjin e të fortit, në dhunën shtetërore. Ajo synon që ta serbizojë Kosovën, ta bëjë kolonizimin e saj me dhunë, prandaj i përdor të gjitha mjetet që t'i shpërngulë shqiptarët nga toka e vet. Jugosllavia (në radhë të parë, kryesia e saj, e z. Joviqit e pastaj edhe organet e tjera të federatës) nuk është e gatshme ta pranojnë popullin shqiptarë si të barabartë me të tjerët, nuk është e gatshme ta njohë Republikën e Kosovës. Kosova sot nuk gjendet fare as në konceptin federativ e as në atë konfederativ për rregullimin e Jugosllavisë së ardhëshme(!). Kur është fjala për shkeljën e të drejtave të shqiptarëve, për shkeljen e Kushtetutës së Jugosllavisë, organet federative asnjëherë nuk patën guxim t'i thonë Serbisë: JO! Ato nuk patën guxim t'i thonë Serbisë që të ndalet, në kohën kur ajo kurdiste plane e trillonte dokumente për ta aneksuar me gjak Kosovën. Për ta gjaku i rinisë kosovare nuk përfaqësonte asgjë, prandaj krimet e udhëheqjes moniste serbojugosllave nuk mund të shlyhen për shumë kohë nga kujtesa e popullit. Populli shqiptar nuk mund të harrojë kurrë se në kohën kur derdhej gjaku në Kosovë, në Beograd kremtohej fitorja, pihej vera e përgjakur e Kosovës. Në këtë të kremte të turpit ishte i buzëqeshur edhe kryetari i qeverisë së tashme federative. Ai dhe të ngjashmit nuk mund ta gëzojnë kurrë besimin e popullit shqiptar. Mu për këtë edhe deklaratat e nënkryetarit Pregël në Vjenë, në të cilat ai i përmend edhe shqiptarët si pjesmarrës në bisedime për të ardhmën e Jugosllavisë, janë pritur me dyshim, si perde të tymit të propogandës komuniste.

Në këtë kohë kur janë hapur të gjitha opcionet për të ardhmen e Jugosllavisë, bota duhet të dijë se shqiptarët dhe Kosova nuk mund të përjashtohen nga tryeza e bisedimeve. Ata aty do të jenë partnerë të barabartë sepse Kosova sipas Kushtetutës jugosllave në fuqi është pjesë konstituitive e Jugosllavisë së AVNOJ-it që nga dita e parë e ekzistimit të saj. Kosova kurrë muk ka qenë e as që mund të jetë Serbi. Për ta mbrojtur vetën nga ekspansioni hegjemonist-kolonialist i Serbisë populli shumicë i Kosovës, thjeshtë, si masë të fundit të mbrojtjes së vet, e shpalli Kosovën Republikë. Ky popull nuk do të pajtohet kurrë që të bëjë jetë koloniale nën sundimin e Serbisë. Këtë të vërtetë duhet ta dinë që të gjithë në Jugosllavi, sepse pa Republikën e Kosovës, shqiptarët nuk mund ta pranojnë as konfederatën e as federatën jugosllave.

Të vërtetën për Republikën e Kosovës dhe për shqiptarët në Jugosllavi duhet ta njohë Evropa e sotme, e cila ka obligime historike ndaj popullit shqiptar. Si faktor shumë i rëndësishëm ndërkombëtar, që synon ta ruaj paqen e stabilitetin e vet, Evropa nuk guxon t'i përserisë gabimet që i ka bërë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër me 1913, kur vendosi në dëm të popullit shqiptar në dëm të Kosovës. Prandaj, nëqoftë se çështja e shqiptarëve në Jugosllavi, ajo e Republikës së Kosovës, nuk shtrohet për t'i gjetur zgjidhjen e përshtatshme në mbledhjen e ardhëshme të Parisit, Konferenca për Bashkëpunimin dhe Sigurinë Evropiane duhet ta dijë sa Kosova do të shëndërrohet në Palestinë të Evropës. E, për të kaluarën e të sotmen e Palestinës është e tepërt të flasim . . .

Në numrin gjashtë të »Alternativës« lexova artikullin »Slobodan o Slobodan nuk ke vend as në Kalimegdan« të nënshkruar nga Hajdin Abazi Është fjala për një gabim të redaksisë sepse autor i këtij artikulli nuk është i lartpërmenduri. Për këtë redaksia e »Alternativës« posedon me kopjen e artikullit dhe emrin e mbiemrin e artikullshkruersit.

NAIM MALAJ

Historia e folkloristikës dhe e etnografisë shqiptare

Mahir Domi – Gjovalin Shkurtaj

BOTIME E NJOHURI TË REJA PËR ARBËRESHËT E GREQISË, PËR KULTURËN DHE GJUHËN E TYRE

Këto vitet e fundit ka dalë një numër botimesh të reja, që japin njohuri e materiale të shumta përmbi arbëreshët e greqisë, për historinë dhe traditat e tyre, për gjuhën dhe folklorin dhe përgjithësisht për këtë diasporë. Vendin më të gjerë në këto botime e zënë ato të studiuesve arbëreshë të Greqisë. Në mënyrë të veçantë për t'u përmendur shkrimet dhe materialet me interes të botuara në revistat »Dialogoi« dhe »Besa«, si dhe një numër i mirë veprash e përmbledhjesh folkorike etj. të studiuesve arbëreshë të Greqisë. Kështu »Symvoili stin erevna tis istorias ton Arvaniton – To Martino (Mouzak) kai ta proerhomena ap'antó Larymna (Kastri) – Loutsi – Pyrgos – Synoptili istoria Opountion Lokron kai Minyeion Orhomenou II, Loutsi 1980 (175 faqe), shruar nga Georgiou K. Miha arbëresh nga Martino. Vëllimi është ndarë në disa sythe kushtuar pozicionit gjeografik, banorëve të parë, beotëve, qytetave të lashta të territorit, epokës romake, bizantine, turke, Martino në vitin 1821. Në sythe të veçanta e relativisht të gjera flitet për gjuhën, traditat arbëreshë të Martinos, Larimnës, Loutsit, Pirgos. Në libër motivohet historikisht përse në Marino vijon të flitet edhe sot gjuha shqipe, duke mëtuar që kjo t'i vlejë brezit të ri si nxitje për t'i dashur e vlerësuar gjuhën dhe rrënjë e tyre arbëreshë. Libri është vlerësuar me të drejtë nga studiuesit si një brumi i çmuar të dhënash për njohjen e historisë, zakoneve, veshjeve, jetës, karakterit dhe toponomastikës e gjuhës së arbëreshëve të Lokridës dhe përgjithësisht të Beocisë. Më 1980 u botua në Athinë përmbledhja »Ta Bilia tou Kithairona kai ta arvantika tragoudia tous«, (154 faqe), shkruar nga Gjona Mike Paidousi, studiuese arbëreshe nga Didhimai. Në këtë vëllim jepen këngë popullore të ngulimit arbëresh Vilia të Beocisë, të cilat janë regjistruar mjaft besnikërisht në alfabetin e sotëm të shqipes e me përkthimin në greqishten e re. Përdorimi i alfabetit të shqipes e bën përmbledhjen folklorike të Paidousit shumë të kërkuar e të vlefhsme sidomos për studiusit që duan të njohin mirë fonetikën e të folmeve arbëreshe të Greqisë, sepse tejshkrimi me alfabetin grek nuk i përmbush mirë kërkesat për një paraqitje të saktë të fonemave të shqipes.

Po në këtë vit, 1980, në Athinë u botua edhe libri i Vangjel Lapit *O Arvanitkos gamos – O Kontourghiótikos* (Dasma arvanite) – kundoriote). Në këtë libër përshkruhet me saktësi dasma e arbëreshëve të Greqisë

të quajtur »kundurtiotë«, banorë të ngulimeve Elefsinë, Mandra, Magulë dhe Maz të Atikës. Duke përshkruar praktikat e ndryshme të dasmës citohen mjaft këngë popullore që i shoqërojnë këto praktika, të cilat japin mundësi për njohjn e së folmes arbëreshe të këtyre ngulimeve. (Shih më gjerë recensionin e J. Panajotit në »Kultura popollore«, 2, 1981, f. 190). Më 1984 u botua në Athinë përmbledhja e Geogiou K. Kollias me mbi 500 fraza e thënie idiomatike nga Leontari (Çaçkavelli), të shkruara me alfabetin grek (74 faqe). Me interes janë gjithashtu një varg botimesh të Tito Johalist[1], G. P. Gjikës[2], K. Birit[3] etj., në të cilat trajtohen çështje të historisë, traditave, onomastikës etj. të arbëreshëve të Greqisë. Gjithashtu për t'u vënë re janë artikujt dhe materialet e shumta, me interes për njohjen e historisë, folklorit, dokeve e zakoneve të arberëshëve të Greqisë që botohen në revistat »Dialogoi«[4], dhe »Besa«[5], organ i Rrethit Kulturor Arbëresh »M. Boçari«. Studimet e mirëfillta gjuhësore për të folmet arbëreshe të Greqisë, me sa dimë, kanë qene të pakta dhe nga albanologë të huaj, siç janë ato të Heblerit për të folmen arbëreshe të Salaminës[6], të Sases, nga Universiteti i Monakos, i cili më 1982 botoi një artikull për të folmen e ishullit Andros[6/1] dhe më 1983 një studim përmbi sistemin fojor të së folmes arbëreshe të Vurkotit[7].

Na duket me interes që në këtë artikull të njihen lexuesit e revistës sonë me disa nga këto botime e në radhë të parë me ato të studiusit arbëresh Antonio Belushi, i cili, prej shumë vitesh, krahas kërkimeve dhe botimeve shume interesante përmbi traditat, doket, zakonet, veshjet, besimet e ritet popullore të arbëreshëve të Italisë, ka ndërmarrë edhe shumë udhëtime studimi tek arbëreshët e Greqisë[8]. Kërmiket e Belushit lidhen me interesa të gjera shkencore dhe synojnë të hedhin dritë mbi probleme të ndryshme të gjenezës dhe të njësisë së përbashkët të kulturës popullore arbëreshe me atdheun e origjinës. Në katundin e tij Frasnitë dhe në ngulimet të tjera arbëreshe të Kalabrisë, si dhe gjatë udhëtimeve që ka ndërmarrë tek arbëreshët e Greqisë, autori ka qëmtuar me zell për të zbuluar sa më mirë botën kulturore të arbëreshëve duke sjellë të dhëna e materiale burimore të pasura e shënime krahasimtare që synojnë për të rrokur gjithë problematikën dhe vlerat etnologjike e folklorike të tyre. Një meritë të veçantë kanë shkrimet e Belushit për vërtësinë e të dhënave dhe për pasurinë e gjerësinë e shprehjeve e fjalëve popullore të arbërishtes, që vijnë nga një traditë e hershme e kutlurës arbërore. Kjo duket edhe në botimet e tij të këtyre viteve të fundit me titull »Dosje studim përmbi arbëreshët e Greqisë«. Që nga viti 1965 kur botoi artikullin e parë me titull »Viaggio tra gli Albanesi di Grecia« (Udhëtim tek arbëreshët e Greqisë) »Zgjimi« 7–9, pp. 18–20), Belushi ka botuar në organe të ndryshme arbëreshe rreth 20 artikuj, në të cilët jepen njohuri e të dhëna për ruajtjen e gjuhës shqipe e të kulturës arbërore në ngulimet arbëreshe të Greqisë.

Në shkrimet e para[9] Belushi përshkruan takimet e tij me arbëreshët e rreth krahinave të Atikës: *Maratona, Spata, Luca, Koropi,* duke dhënë aty listën e toponomastikës së tyre, si dhe frazeologji, fjalë të urta e këngë popullore arbëreshe.

Për Spatën shënohet se është një qytezë e bukur me rreth 7.000 banorë. »Në pjesën e epërme të Spatës banojnë arbëreshët të cilët flasin

gjuhën shqipe dhe ruajnë mirë traditat e tyre. Në pjesën e poshmte banojnë grekë të ardhur nga Trikala e nga Glidoniku«. Luca është një fraksion i Spatës me rreth 50 shtëpiza, të cilat banohen kryesisht gjatë verës nga spatanjotë. Në bisedat me spatanjotë, që sillen si material burimor për të njohur edhe gjuhën e tyre, lexojmë: »Lucasjotët janë tuti nga Spata e flasen arvanisht. Këtu kemi vreshta shumë e bëmi verë. Pak grurë, vet për t'hami.

Janë shumë vet ç'kan dhen e këta nëk dinë t'flasen arvanisht. Ata janë t'huaj. Kan ardhur nga Trikalla e nga Lidhoniqi e nëk flasen gluhën. Këtu arvanidhi njihet ka trajashka ç'ka ndë krie. Kjo e dhënë ka shumë rëndësi si për gjendjen gjuhësore ashtu edhe për studimet etnografike, sepse ve ne dukje që, deri në ditët tona, arbëreshët e ngulimeve të Spatës e të Lucës mbajnë në kokë një trajashkë »kësulë« të ndryshme nga ajo e grekëve me të cilët bashkëjetojnë në të njëtat qyteza.

Edhe për Koropin, ngulim me rreth 12.000 banorë, Belushi shkruan se shumica e tyre flasin shqip. Jep toponomastikën arbëreshe si dhe disa këngë popullore, nepermjet te cilave studiuesit e interesuar mund të nxjerrin shumë dukuri interesante të së folmes, siç janë ruajtja e grupeve bashkëtingëllore **kl, gl** *(klisha, gluha),* shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës *(i math),* ruajtja e **I** në raste ku shqipja e sotme ka **j** *(kultoj)* etj.

Në Maratonë, ngulim i vogël rreth 40 km. larg Athinës, brezi i ri nuk flet më shqip. Në një tekst të sjellë për ilustrim thuhet: »Ketu nuk flasën mër arbërisht. Fllasën vet pleqëtë«.

Në artikullin e dytë[10] të Belushit jepen edhe disa fraza nga e folmja e Krandhit (Peloponez), mirëpo ato nuk janë mbledhur në vend, por nga një kranidhiot që banon në Selanik. Sidoqoftë, aty është me interes të veçantë fjala *shkllerisht (Ata flasen shkllerisht),* e cila sipas shpjegimeve të Belushit, ashtu si tek arbëreshët e Italisë përdoret për të shënuar një gjuhë të huaj, joarbëreshe. (Në Shën Kostantino Albanese *ai nomre shklerisht* do të thotë »ai flet në gjuhë të huaj«; po kështu edhe në Frasnitë (Frascineto) të Kozencës për të thuhet: *ai folen sqarisht (A. Bellusci, Rilievi sulle comunità Albanesi di Grecia), (1967), f. 350, shënimi nr. 41).*

Në vitet 1969–1970 artikujt e Belushit u kushtohen ngulimeve arbëreshe të Moresë, ku përshkruhen edhe pikat e përbashkëta historike, etnokulturore e gjuhësore midis Koronës së Greqisë dhe koronejve të shumtë në ngulimet arbëreshe të Italisë. Jepen aty shënime nga ditari i qëndirmit në qytezën e Koronës si dhe një shtojcë me patronimet e toponimet e Koronës, shoqëruar me shumë shënime e krahasime historiko-gjuhësore me interes.

Gjatë udhëtimeve e vizitave të tij në More si në Koronë, Milo, Korint etj, autori ka shfrytëzuar mirë çdo rast për të regjistruar në magnetofon (dhe së andejmi në shkrimet e veta) thënie, biseda, këngë e gjithfarë materialesh nga goja e arbëreshëve të Greqisë.

Shumë nga shkrimet e Belushit përmbi arbëreshët e Greqisë kanë formën e shënimeve të udhëtimit, ku jepene përshtypjet e takimet e shumta të tij nëpër ato vise të bukura edhe mikpritëse, por kurdoherë të pajisura me të dhëna të vlefshme për njohjen e historikut dhe të gjëndjes së sotme gjuhësore dhe përgjithësisht etnokulturore të tyre. Për çdo ngulim arbëreshe, krahas materialeve nga goja e popullit, jepene edhe shënime të

shumta shpjeguese e krahasime me arbëreshët e Italisë, për gjuhën, folklorin dhe historinë e tyre, të cilat Belushi, gjithashtu, i njeh mirë dhe i ka studiuar për kohë të gjatë. (Ai është autor i librave *»Argalia«* dhe »Mite e besime popullore të arbëreshëve të Italisë« s dhe i shumë artikujve e materialeve folklorike me vlerë, të botuar në organet e ndryshme të shtypit arbëresh dhe këto vitet e fundit tek »Lidhja« që drejtohet prej tij.).

Në gusht të vitit 1984 Belushi ndërmori një udhëtim tjetër në ngulimet arbëreshe të Greqisë, duke mbledhur përsëri materiale të shumta gjuhësore e folklorike, të cilat, i botoi në faqet e revistës *»Lidhja« (nr. 10 dhe 11, 1984),* si dhe në formë fashikujsh të veçantë nën titullin *»Studio dossier sugli albanesi di Grecia«* Në fasnikullin e parë *»De radici arbëreshe a matrici arbërore«, Lidhja 1, 1984, (40 faqe)* jepen të dhëna historike për arbëreshët e Greqisë, lista e ngulimeve albanofone të Atikës, të Beocisë, të Eubesë dhe të Peloponezit, si dhe këngë popullore e biseda të lira të autorit me një arbëresh nga Moreja, Jepet edhe një fjalorth me fjalë dhe onomastikë nga të folmet arbëreshe të Greqisë, krysisht për të shpjeguar kuptuar materialet e pranishme në fashikull.

Në fashikullin e dytë *»Schegge di vita arbërore«, Lidhja 1, 1984 (16 faqe)* jepen të plota disa biseda të autorit me arbëreshë të Mavromationit (Tebë), e Erithrait (Kriekuq – Tebë), të Kaçkavelit (Tebë), të Kastri-ut, të Athinës etj. si dhe letra të arbëreshëve të Greqisë drejtuar Belushit.

Mund të tuhet se me këtë botim të fundit si dhe me shkrimet e tij të mparshme përmbi arbëreshët e Greqisë, Antonio Belushi ka dhënë një ndihmesë të mirë për njohjen e kësaj diaspore, duke hetuar me dashuri e zelle e duke shkelur me këmbë pothuajse të gjitha viset ku vijon të flitet shqipja në Greqi. vlen të theksohet se të dhënat e materialet e mbledhura janë gjitnjë të shqoqëruara më shënime e shqyrtime historiko-kulturore e gjuhësore, me krahasime të hapëta si dhe me një njohje e saktësi që buron, ndër të tjera, nga përditësimi shumë i mirë me letërsine shkencore, të vjetër e të re, që ekziston përmbi arbëreshët e Greqisë. Bie në sy veçanërisht njohja e gjërë që ka Belushi për studimet dhe studiuesit e rinj arbëreshë, për botimet e shumta të tyre përmbi historinë, gjuhën dhe kulturën popullore e traditat e bukura të arbëreshëve të Greqisë.

»Studio-dossier sugli albanesi di Grecia« (»Lidhja« 1, 1984) fillon me një hyrje përfshirëse, ku autori vë në dukje ruajtjen e mirë të thamirt etnolinguistik, arbëresh tek arbëreshët e Greqisë, të cilët, ashtu si arbëreshët e Italisë, edhe pas kaq shekujsh vijojnë të mbahen si të tillë, në gjuhë, zakone e doke dhe në mendësi. »Është fakt – shruan Belushi – se arbëreshët edhe sot flasin gjuhën shqipe, bidesojnë, kuptohen dhe nxënë vetë alfabetin e shqipes, kodifikojnë ligjërimin e vet, duke lënë kështu gjurmët dhe shenjat e kulturës së tyre të veçantë«.

Duke folur për historinë e arbëreshëve të Greqisë, Belushi thekson se janë dalluar »si protagonistë të shënuar në luftërat kundër osmanëve për pavarësinë e Greqisë«. Ai përmend me admirim heronjtë arbëreshë e shqiptarë si Marko Boçar Kiços Zavellas, Xhorxho Karaiskaris, Atanasio Skurtagotes, Odiseas Andrucos, Nikolas Kriezotis, Teodoro Kallokotronis, Dimitrio Plaputas, Laskarina, Bubulina, Todoro Gribas, Andreas Miaullis, Kostantino Kanaris etj., tër cilët qenë farkëtues të rilindjes hellenike.

Pjesa hyrëse, duke përmendur sasinë e madhe dhe peshën që historikisht ka pasur elementi arbëresh në Greqi, si dhe përpjekjet e tij për ruajtjen e shqipes, mbyllet me vargjet e një kënge popullore arbërore kushtuar gjuhës së tyre:

»Këjo gluha arbërishte
ishtë gluhë trimërishte
E flit navarko Miaulli,
Boçari edhe gjith Suli!«

Trajtesa vijon me »Të dhëna historike për arbëreshët e Greqisë«, ku, së pari Belushi thekson se krahas termit »arvanit« që përdoret më dendur, nëpër ngulimet arbëreshte të Greqisë, bujqit dhe blegtorët e quanin veten arbërorë: »Neve thuhemi arbërorë«. Sipas Belushit *avanit* apo *arvanidh* është një term që përdoret më tëpër nga grekët për t×e shënuar arbëreshin, kurse vetë popullsia arbëreshe përdor *arbëror,* ashtu si arbëreshë e Italisë veten e quajnë *arbëreshë,* kursë italianët i quajnë ata *gjegji.*

Me interes për t'u shënuar na duket pohimi i Belushit se gjatë udhëtimeve të tij katund për katund ka gjetur edhe një numër të mirë librash monografikë të ngulimeve arbëreshe albanofone. Autori thotë gjithashtu se atje janë edhe një numër shumë i madh visesh arbëreshe si dhe disa qindra mijëra albanofonë, për të cilët dihet pak ose asgjë. »Arbëreshët – përfundon Belushi – krahas maqedonëve, turqve, ebrejve dhe vllehëve janë pakica gjuhësore më e konsiderueshme në Greqi«. Në kreun e parë të studimit jepet lista e ngulimeve albanofone të Greqisë, duke shënuar se »janë mbi 400 ngulime arbëreshe në Greqi«. Burimet për materialet dhe shënimet e tij kanë qenë dy: informatorët arbëreshë që i rrëfenin për ngulimet e afërta fqinje si dhe disa libra historikë ekzistues. Në mënyë të veçantë autori përmend ndihmën e veprimtarit të dalluar arbëresh Jorgo Marugas, ish-drejtor përgjegjës i revistës »Dialogoi« që ka dalë në Greqi. Këtë revistë të arbëreshëve të Greqisë që ka filluar të dalë që më 1976, Belushi e quan »minierë të dhënash e kërkimesh në terren, përmbi historinë, gjuhën, etnografinë dhe letërsinë e arbëreshevë të Greqisë«. Në shumë nga numrat e kësaj reviste Belushi ka gjetur shënime e të dhëna përmbi ngulimet albanofone të Greqisë, si dhe të dhëna për numrin e banorëve sipas regjistrimeve zyrtare të viteve 1951, 1961, 1971. Lista e ngulimeve arbëreshe të Greqisë i vlen mjaft edhe historisë se ngulimeve arbëreshe të italisë, sepse, nëpërmjet krahasimit del se shumë prej këtyre të fundit përkojnë me emrat dhe toponimet e ngulimeve arbëreshe të Greqisë. Kështu, *Ungra* (it. Lungro) është ngulim arbëresh në kalabri, po këtë emër e ka edhe një katund arbëresh në Beoci. Shumë mbiemra të përhapur nëpër ngulimet arbëreshe të Italisë si *Parapunja, Kaparelli, Muriqi, Mazi, Belushi, Bafa, Manesi, Dara, Varibobi, Spata, Kriekuqi* etj. dalin edhe ndër arbëreshët e Greqisë. Belushi jep në këtë studim edhe listat e ngulimeve arbëreshe të Greqisë si dhe sasinë e banorëve albanofonë të tyre, sipas ndarjes në krahinat përkatëse: të Atikës, të Beocisë, të Eubesë, të Moresë (Peloponesit). Po japim me poshtë një paraqitje të shkurtër të tyre, sipas ndarjes që bën vetë autori:

a) **Ngulimet arbëreshe në Atikë.** Belushi tekson se në Atikë ka bërë hulumtime e regjistrime në magnetofon në këto ngulime albanofone: *Aspròprigos, Villia, Erithres, Kuvards, Laívia, keratéa, Koropia, Losja, Luca, Mundra, Marathòna, Markòpoulas, Peanias, Lopësi, Spata.* Për të pasur një pamje sa më të gjerë autori mbështetet edhe në të dhënat e revistës »Dialogoi«, e cila, që nga numri 26 (1979) ka nisur të bëjë inventarin e ngulimeve arbëreshe në Elladë, si dhe një regjistrim fillestar të popullsisë arvanite. Deri në vitin 1961 arbëreshët e Atikës, pa përfshirë ata të Athinës arrinin rreth 15.000 banorë« (»Dialogoi«, 26. (1979) f. 33).

Pastaj jepet lista e ngulimeve albanofone dhe pas çdo emërtimi jepet edhe numri i banorëve. Gjithsej në Atikë Belushi përmend 73 ngulime arbëreshe. (Për disa syresh, krahas emrit të sotëm, në kllapa jepet edhe emri i vjetër, p.sh., Inoi (Mazi), Pallini (Harváti), Fili (hasia) etj.).

b) **Nguilimet arbëreshe në Beoci.** Në krye shënohet se »e gjithë Beocia është e njohur për ndjenja të forta arbëreshësie«, dhe se »në të gjithë territorin flitet shqip«. Ka aty një pakicë vllehë. Në qytetin e Tebës, rajoni i quajtur *Agioi Theodoroi* është i banuar nga arbëreshë, të cilët arrijnë në 100.000 veta, (»Da radici . . . pp. 11).

Belushi thekson se ka bërë hulumtine në vend në këto lokalitete: Asopia, Dafni, Kaparelli i Tëbës, Mellisohori, Muriqi, Villia Eritres, Platees. (Në Dafni Belushi) thotë sa »ka gjetur edhe një poet popullor arbëresh, i cili kompozon himne patriotike në gjuhën shqipë«: ai është Konstantino Grigoriu Farmakis, bujk 80-vjeçar«). Lista përmban emrat e 108 ngulimeve albanofone; nxjerre nga »Dialogoi« nr. 27 (1980) f. 19–21.

c) **Ngulimet arbëreshe të Eubesë.** Vetë Belushi ka regjistruar materiale etnografike në Nea Stira, Polipotamos Mesochoria, Zarka, Vira, Kòskina, Bellushi, Gliepura, Kriezà. Sipas disa të dhënave nga libri i Janni P. Gjikës (»Oi Arvanites kai to arvanitiko tragoudi stin Ellada«, Atene 1978, f. 28–30, të ribotuar edhe në »Dialogoi nr. 37 (1983) f. 12– 13) rezulton se albanofonët e Eubëse më 1951 arrinin në 15.279 veta nga 56.880 banorë që ka gjithsej; më 1961 ishin 14.444 kurse më 1971 ishin 12878 veta.

Gjithsej Belushi përmend 49 ngulime të ndara në katër grupe sipas krahinave përkatëse: 15 në bashkinë e Karistia (Kavantoros), 16 në atë të Stiros, 14 në komunën e Tamineon-it (Aliverin) dhe 3 në komunën e Avlonos (Avlonariu).

d) **Ngulimet arbëreshe të Peloponezit.** Zonën e gjerë të Moresë, Belushi (ashtu si çdo arbëreshe i Italisë), e ka shumë për zemër, sepse, së andejmi, në vitet 1520–1530 morën udhën për në Itali shumë arbëreshë të Greqisë. Me këtë shpjegohet edhe toponomastika që përmend Morenë, p.sh.: *Kroi i Moroitit* në Shën-Sofi të Kalabrisë dhe, mbi të gjitha, kënga më e përhapur e arbëreshëve të Italisë »Moj e bukura More«. Listën e ngulimeve të Moresë Belushi e jep sipas revistës »Dialogoi«, nr. 29 (1980) f. 13–17, porse thekson se vetë ai ka bërë regjistrime në magnetofon në *Psari, Furrthi, Sqino, Sofiko, Bishia, Perahora, Portohejl, Loutarqi, Lucaiti, Llimnes, Kopanachion, Cocla, Qiladha, Kramidhi, Qesari, Klimendi, Ermjon, Didima, Dorjon, Athichia, Agioi, Theodoroi, Vernaiika, Hrisohorjon.*

Autori thotë se sipas dokujmenteve të vitit 1969 del se »shumica

e banorëve të Morosë janë shqiptarë« (»Dialogoi«, nr. 29 (1980), f. 16). Gjithsej në More (Peloponez) sipas Belushit janë 92 ngulime albanofone.

Në pjesën e dytë fashikullit të parë botohen këngë popullore të arbëreshëve të ngulimeve të Beocisë. Belushi shkruan se atja »këngët arbëreshe mund të këndohesin e të dëgjoheshin me volum të plotë në festat popullore, në udhët, në sheshet«. Livadja (Beocia) është kryeqendra e përhapjes së kësaj kulture arbëreshe nëpërmjet këngës. Belushi në këtë fashikull u jep vend pikërisht 211 këngëve që këndohen nga grupi folklori i Beocisë, dhe shenon se »tekstet janë riprodhuar ashtu siç janë në muzikë-kasetat«.

Për vlerat folklorike, natyrisht, duke mos njohur melodinë përkatëse, mund të flitet vetëm duke gjykuar mbi tematikën dhe figuracionin poetik gojor. Aty zotëron tema e dashurisë, e fejesës dhe e martesës (këngët 1, 2, 3, 7, 11, 14, 16, 19, 21) por nuk mungon aty edhe tematika e punës, që jepet me idilin e vajzës që shkon në krua (6, 12, 13), të gruas që punon në argali natë e ditë pa u lodhur kurrë, prandaj edhe është e denjë të marrë një burrë të mirë (kënga 9) etj. Në njërën nga këngët (18) përshkruhet zhvillimi i një dasme, me të shtëna armësh, me urime të bukura: »Të rrojnën dhe të mblakenë. Të zbardhenë sa malet me borë«.

Në disa këngë lëvdohen virtytet dhe bukuria e vajzave arbëreshe:

»Ipirotetë janë të mira
Moroitetë kanë lliria
Të bukuratë Fivjotetë
Edhe Livadhjotetë«.

Edhe nëpërmjet këngëve arbëreshët përcjellin porosinë e përjetshme të tyre për ruajtjen e gjuhës shqipe:

»Arvanitetë të këndomi
gluhënë të mos harromi«.

Një velrë të mirë kanë këto këngë (bashkë me bisedat me nje arbëresh nga Moreja, që jepen në fund të fashkullit të parë si dhe ne gjithë fashikullin e dytë) në planin gjuhësor. Nëpërmjet tyre studiuesi fiton një pamje pak a shumë të gjerë për gjendjen gjuhësore të së folmes moroite. Nëpërmjet shqyrtimeve paraprake të këtij materiali, gjuhëtari mund të nxjerrë disa nga dukuritë më tipike të të folmeve arbëreshe të Greqisë, të cilat janë njëherazi njësoj me ato të të folmeve arbëreshe të Italisë si dhe me disa nga të folmet e shqipes të skajit më jugor. Psh. mungesa e fonomës **y** dhe zëvendësimi i saj me **i**: di »dy«; *brima* »bryma«, ruajtja e grupeve të vjetra bashkëtingëllore *kl, gl: klanj, klisha, gluha, i glat* »i gjatë«, ruajtja e bashkëtingëllores **l** në disa raste ku në shqipen e sotme ajo ka kaluar në **j**: *bilë, val »vaj«;* shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicion fundor ashtu si në mbarë toskërishten *(i math);* apokimi **ë** *eshtë,* ashtu si në të folmen arbëreshe të Italisë dhe në ndonjë nga të folmet veriore (**â** *asht*); kalimi i **e** në **ë** para baskëtingëlloreve jundore: zëmër, fëmër etj.

Me mjaft interes është në këtë mes edhe ndjekja e trajtave morfologjike, çka, gjithashtu nëpërmjet krahasimeve më të folmet (arbëreshe të

Italisë dhe me dialektet e shqipen e sotme letrare, ndihmon për të arritur në disa përfundime më të sigurta. Kështu, në të folmet arbëreshe të Greqisë përdoret dendur e ardhmja e tipo **do** + lidhore, me – ose pa pjesëzën **të** *do t' mbetem, do t'i presmi* dhe nuk del trajta **kam** + lidhore që kanë arbëreshët e Italisë, çka dëshmon se ajo është një trajtë më e re ndoshta e pëfituar në mjedisin latin, nën ndikimin e futurit *ho da fare* të italishtes.

Për t'u vënë re është këtu edhe denduria e aoristit sigmatik: *u lesh* »leva«, *u martueça* »u martova«, *u bësha* »u bëra«.

Nga fusha e morfosintaksës tërheq vëmendjen ndërtimi i tipi **për** + lidhore, afërsisht me vlerat e paskajores së tipit **për + të** = pjesore, psh., *M'thojne* **për tvej** *nd Athinë, e nuk ika.* Këtë ndërtim e ndeshim dendur edhe ndër arbëreshët e Italisë, por ai nuk na është dëshmuar deri sot askund nëpër të folmet e shqipes apo në dokumentet e shkruara të saj, të jetë ndonjë trajtë hibride, edhe nën ndikimin e greqishtes dhe të italishtes.

Prekëm këtu vetëm ndonjë nga dukuritë gjuhësore që nden materiali i dhënë nga Belushi, sa për të tërhequr vëmendjen e studiuesve, të cilët do të gjejnë aty të dhëna të vlefshme për shumë dukuri e çështje gjuhësore.

Në mbyllje po japim disa këngë popullore të arbëreshëve të Greqisë të mbledhura nga A. Belushi:

Vajza e trimi

Vajza: U jam nj' vllahe e bukur
Një vlhahe penemene[1]
Që kam një mil dhen
Dhe pesdhjetë dhi.
Trimi: Ulku të haj dhentë
Edhe çakallo dhitë
Te mbetë vllaha e bukur;
Vllaha penemene
Edhe u ik, edhe të lë të bukurën.
ja, vllaho pulla, dhe vetë.
Vajza: U jam një vëllahe e bukur . . .
Një vllahe penemene
Që kam një mil dhen
dhe peshdjetë dhi
Trimi: Ulku të haj dhent
Edhe çakallo të haj dhitë
Edhe një të madhe sëmunde
Të bjerë te çopani
Të mbetet vllahe e vetme
Edhe vllahe mavromate
Le të lë të bukurën
Edhe ja (su) vllaho pulla, dhe vete.

Regjistruar në Koskina (Eube)

Kush e shkundi dardhënë

Kush e shkundi dardhënë?
Rusha me të bardhenë.
Kush e shkundi midhalenë[1]?
Rusha me mavriderenë[2].

Mesori (Eube)

Do ta pres kocidhetë

Do ta pres kocidhetë[1]
Të t'arrivinj ka Sqindetë
Moj kocidhe trash e glatë,
Ç'e s'ndrisem[2] ka it' atë

Argiro (Eube)

Moj gjitone e djegurë

– Moj gjitone e djegurë[1]
  Ç'ke majerepsurë?[2]
– Kam fazulezë me faqi[3]
  Qasu të të zë një cimb[4]
– Kam fasule me sfak
  Qasu të të zë një dhak[5]

Belushi (Eube)

[1] penemene = e pasur.

[1] Bajame
[2] brune, e zeshkët.

[1] gërshetat
[2] s'kam frikë' nuk tremben.

[1] dorshtërnguar
[2] ka gatuar, ke përgatitur
[3] tjerëza
[4] piskim, çimbisje
[5] kafshim.

[1] Jochalas, Titos, P., *Considerazioni sull'onomastica e toponomastica albanese in Grecia* – Offprint from »Balkan Studies«, 17, 2, Thessolaniki, 1977, f. 313–329; *Über die Einwanderung der albaner in Griecheland* (Eine zusammenfassende Betrachtung), Sonderdruck »Dissertationes Abanicae«, XIII Band, München 1971), S. 89–106.

[2] Gjika Gj. P., *Arvanitika tragudhja tu Kavo d'Oro,* Athina, 1962, 27 faqe.

[3] Biri, K.I., *Arvanites i Dhoriis tu neoteru elinismu. Istoria ton Ellinon arvaniton,* Athinë, 1960, f. 377 faqe.

[4] Dialogoi, Politiki epitheorisi, Nikaia – Atene-Grecia, drejtor: Jorgo Marugas.

[5] Besa, Istoria laografia Logoteknia, Atene-Grecia, drejtor Aristide P. Kollias.

[6] Haebler C., *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis,* Wiessbaden, 1965.

[6/1] Hans J. Sasse, (1982), *Ein archaicher albanishcer Dialekt auf der Insel Andros,* në »Zeitschrift für Balkanologie«, 18, 61–69.

[7] Hans J. Sasse, *Das verbalsystem der arvanitischen Mundart von Vurkoti (Andros),* në »Etnia albanese e minoranze linguistiche. Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi«, Palermo 25–28 Novembre 1981, Palermo 1983, pp. 335–358.

[8] Nga shënimet e tij në artikujt e botuar përmbi arbëreshët e Greqisë del se Belushi ka vajtur në ngulime të sh umta arvanite në vitet 1965, 1969, 1970, 1983 dhe më 1984.

[9] Shih, A. Belushi, *Viaggio tra gli Albanesi di Grecia,* në »Zgjimi« 7–9 (1965) pp. 18–20; *Rilievi sulle comunità albanesi di Grecia* (Ekstrakt) Romë 1967, pp. 334– 350.

[10] A. Belushi, *Rilievi sulle comunità Albanesi di Grecia* (Ekstrakt), 1967, pp. 345.

(Marrë nga »Kultura Popullore«,
Tiranë, nr. 2. 1986, faqe 181–189)

Rrënimi i Jugosllavisë së KAÇKJ-së

Mr. Hasan Mujaj
Mr. Adem Hajdaraj

Sikundër është e njohur, përpjekjet e qarqeve reaksionare serbe për rrënimin e Jugosllavisë së KAÇKJ-së dhe për formimin e Serbisë së madhe u intensifikuan dhe dolën në skenë të hapur veprimi në vitet e tetëdhjeta e sidomos në dy vitet e fundit. Ato filluan të veprojnë përmes formës së mitingjeve të ashtuquajtura të solidaritetit kinse për mbrojtjen e të drejtave ne do të thoshim të privilegjevetë serbëve dhe të malazezëve të Kosovës; ato u drejtuan dhe po drejtohen nga klani serbomadh ne krye me liderin shovinist S. Milosheviqin gjithnjë sipas programit memorandumian të ASSHA. Në këtë mënyrë publikisht dhe konkretisht filloi lufta speciale për asgjësimin e Jugosllavisë së KAÇKJ-së, për mbizotërimin e politikës autokratike serbe në tërë vendin dhe për formimin e Serbisë së madhe që ishte pikësynim i qëmotshëm i saj. Ky programim politik shovenist filloi të sendërtohej me sukses me metoda presionesh e demagogjish duke e përmbysur qeverinë legjitime të Vojvodinës, duke e përmbysur qeverinë legjitime të Malit të Zi, u provua të ndiqej kjo rrugë edhe në Slloveni, porse atje, siç dihet, dolën pengesa të pakapërcyeshme; vazhdon lufta speciale për realizimin e këtij skenari edhe në Kroaci . . . etj.

Mirëpo, për arsye se në ballë kishte njerëz apolitikë dhe tradhtarë, për arsye se në ballë kishte njerëz servilë dhe snobë, viktima më e madhe e kësaj lufte speciale për pushtet dhe për zhdukje popujsh do të bjerë Kosova, e cila u mor si shkas për zgjimin dhe për shpërthimin eksploziv të ndjenjave nacionaliste dhe shoviniste serbe. Sipas maksimës kush nuk është me mua është kundër meje, filloi edhe likuidimi politik i kuadrove të verifikuara për ruajtjen e themeleve të Jugosllavisë madje me akuza të rënda si autonomistë (Kruniq, Matiq), tradhtarë (Orlandiq, Stamboliq, Markoviq), u kërkua ndjekja dhe mënjanimi nga skena politike të revolucionarëve dhe internacionalistëve të njohur që publikisht çjerrën maskën e hipokrizisë së politikës primitive të klikës serbe si p.sh. Dragosavac, Verhovec, Shetinc, etj.

Megjithëkëtë, me metodën e dhunës policore ndesh demokracisë, që nga pesë korriku e këndej, kur u bë pushtimi me tyta armësh i Parlamentit të Kosovës dhe i Qeverisë së saj nga organet republikane serbe, faktikisht nuk ekziston Jugosllavia e KAÇKJ- së si shtet i përbërë nga tetë njësi federale që përbënin Federatën jugosllave të përcaktuar me Kushtetutën e RSFJ-së. Ajo u rrënua me agresivitet të paparë nga pushtetmbajtësit serbë. Ky akt okupues dhe antikushtetues shënoi kulminacionin e shovinizmit të udhëheqjes serbe që me vite të tëra bën diskriminim kombëtar, ekonomik, kulturor, arsimor dhe më në fund njerëzor ndaj një populli liridashës që gjithnjë e deshi paqen, por u mbrojt heroikisht kur iu iponua lufta- ndaj popullit shqiptar, i cili, në Luftën Nacionalçlirimtare, krahas popujsh të tjerë, lau me gjak të heronjve dhe të dëshmorëve trojet në të cilat rron me shekuj për ti shijuar rrezet e ngrohta të lirisë dhe të barazisë që, me gjithë propagandën e bërë përmes frazash shterpe, objektivisht nuk

i pati asnjëherë, kurse për lirinë e shqiptarëve të Jugosllavisë sot, siç e ka kuptuar dhe e ka parë bota, nuk mund të bëhet fjalë, sepse ajo nuk ekziston. Të dhënat flasin se populli shqiptar në Jugosllavi, që nga çlirimi, shumë herë u vërshua nga lumenj të rrëmbyeshëm padrejtësish e administrimesh të dhunshme, burgosjesh e vrasjesh, shfrytëzimesh e shpërnguljesh... etj. etj. Këto forma të diktaturës serbe mbi popullin shqiptar sot janë më intensive se kurrë më parë. Kurorëzim i tërë kësaj fushate antishqiptare është aneksimi i Kosovës nga ana e regjimit stalinist-dogmatik serb që u bë me shtetrrethim policor duke i suprimuar organet legale të Kosovës dhe duke e rrëmbyer kështu autonominë e të gjitha fushave veprimore si në informimin masiv, në Universitet, në shëndetësi, në sigurimin shtetëror, në judikaturë e ku jo tjetër. Në këtë mënyrë një njësi federale (Kosova) u gëlltit me forcë nga një simotër tjetër (Serbia) duke e shndërruar atë, për nga kompetencat, në nivel të një zyre administrative të bashkësive lokale.

Synimet shfarosjes të politikës shoviniste të udhëheqjes serbe, që ngërthejnë në vete një konglomerat të tërë veprimesh barbare mbi shqiptarët, kohën e fundit filluan të ndërrojnë apriori edhe terminologjinë kushtetuese juridike sipas secilës shqiptarët sot quhen »pakicë kombëtare« e nesër, po të vazhdonte kjo politikë, do të provohej të asimiloheshin dhe të zhdukeshin fare. Kjo do të thotë zbatim i elaborateve të Andriqit, të Çubriloviqit dhe të trashëgimtarëve të devotshëm të tyre të Rankoviqit, të Milosheviqit, të Morinës... etj.

Tash sa kohë me gjendje të jashtëzakonshme, herë të nivelit federativ, herë të nivelit repulikan, popullit shqiptar të Kosovës i privohen të drejtat elementare qytetare dhe kombëtare që ia garanton Kushtetuta sikundër janë: informimi objektiv në gjuhën amtare, e drejta e punës, e drejta e shprehjes së mendimit të lirë, qetësia familjare, qarkullimi i lirë etj., por, ç'është tragjike, tash sa kohë populli shqiptar i Kosovës, në veçanti këtë vit, përjeton format më drastike të dhunës dhe të gjenocidit deri te viktimat e shumta dhe të pafajshme të terrorit shtetëror që me të drejtë kërkojnë demokraci dhe barazi me popujt e tjerë. Mbyllja e institucioneve informative në gjuhën shqipe që u bë me diktaturë policore është dëshmia më e mirë e vazdimësisë dhe e ashpërsimit të represionist serb ndaj shqiptarëve, qëllimi i secilës është që opinionit të vendit dhe të huaj të mos i pasqyrohet e vërteta për Kosovën. Pra, represion në konspiracion.

S'ka dyshim se dhuna policore që u zbatua ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe që vazhdon të zbatohet edhe sot tronditi dhe brengosi thellë Evropën e qytetëruar dhe botën përparimtare nga reagohet ashpër me rezoluta të ndryshme ndërkombëtare, por është habi e madhe dhe shumë e pakuptueshme se si mund të jetë kaq indiferente ndaj tëre kësaj Kryesia e shtetit madje ka arsye të thuhet se ajo nuk po e kryen funksionin kushtetues të Kushtetutës së RSFJ-së sipas secilës garantohet paprekshmëria e njësive federale. Nga kjo del e qarë se me suprimimin e organeve legjitime të Kosovës u shkel edhe Kushtetuta e RSFJ-së sikundër pohonte edhe S. Shuvar në intervisën në »Borba«. Për këtë arsye shefi kolektiv i shetit mban përgjegjësi të madhe, ngase, me heshtje, sikunër u pajtua të rrënohen themelet e Jugosllavisë. Në çdo vend të botës ku zbatohet dhe ku mbrohet kushtetuta e shtetit kjo do të quhej *kapitullim*. Në Jugosllavi mund të

ndodhë edhe kjo!? Kryesia e shtetit është bërë vështrues pasiv i rrjedhave të rrethanave kosovare. Ajo nuk duhet të heshtë, sepse tashmë u tejkalua çdo durim dhe gjendja politike është shqetësuese; ajo nuk bën të mjaftohet me përshkrimin e situatës së tendosur përmes mjetesh informative, porse duhet të ndërmarrë aksion konkret . . ., t'u thuhet »stop« atyre që po shkaktojnë gjakderdhje në paqe, atyre që, të prirë nga pretendimet centraliste, unitariste dhe ekstrakonservatore, për sendërtimin e aspiratave okupuese, Jugosllavinë e kompromituan në përmasa ndërkomëtare si zonë të rrezikshme konfliktesh jo vetëm për stabilitetin e Ballkanit, por edhe për stabilitetin e Evropës. Po kështu brengos edhe heshtja e organeve të tjera federative si e Kuvendit të Jugosllavisë, e KEF-it etj., legjitimiteti i të cilave është vënë në dyshim ngase iu mungon përbërja e plotë-prania e përfaqësuesve të një njësie federale, Kosovës, e cila u përmbys me forca policore vetëm pse tumiri proceset demokratike dhe kërkesat gjithëpopullore për vetëvendosje dhe për rregullim të brendshëm të statusit të Kosovës brenda shtetit jugosllav. Domethënë nuk është fjala as për nacionalizëm, as për demokraci dhe për vetëpërcaktim, porse është fjala për sendërtimin e vullnetit të popullit shumicë të Kosovës në frymën e pluralizmit politik qe është miratuar në nivel të vendit, i cili popull dëshiron të jetojë në paqe dhe në harmoni me të gjithë popujt e tjerë jugosllavë. Të gjitha konstatimet sipas të cilave kërkesat e lëvizjes masive të shqiptarëve pandehen si nacionaliste në kuptimin negativ të këtij termi dhe separatiste janë trillime të zbehta të një politike të dështuar që në vend të demokracisë ofron diktaturë me kamxhik, në vend të dialogut, ofron diktatin, në vend të barazisë, ofron privilegjën, në vend të afirmimit kombëtar, ofron shkombëtarizimin, në vend të paqes, ofron luftën . . . etj., të cilën politikë po e gjykon bota e civilizuar.

1. Rreth termit nacionalizëm

Eshtë e vërtetë e pamohueshme se tash dhjetë vjet, nga një vistër termash fyes që pa të drejtë shkencore u referohen shqiptarëve, termi me përdorim më të dendur në të gjitha trajtimet rreth situatës politike në Kosovë, qoftë me gojë, qoftë me shkrim është termi nacionalizëm, por edhe është e vërtetë se tash dhjetë vjet termi më frekuentues i përdorur gabimisht në shkrimet dhe në shqyrtimet rreth Kosovës gjithashtu është termi nacionalizëm. Ky term, si shumë e shumë të tjerë, në të gjitha vështrimet për Kosovën dhe për shqiptarët është përdorur dhe vazhdon të përdoret me semantikë të njëanshme, të prerë, pa i vënë re mundësitë semiotike dhe polisemike të kuptimit të tij leksikor. Prandaj, si edhe te përdorimi i çdo termi tjetër, do pasur parasysh mbështetja kuptimore e termit në përqasje me realitetin objektiv, të cilin don ta emërtojë. Vështruar çështja nga ky kënd, që është i domosdoshëm për të vënë termin në funksion të emërtimit adekuat semantik, do thënë se termi nacionalizëm është ngërthyer në konstrukte gjuhësore antonimike d.m.th. është përdorur në kuptimin negativ, kurse, sipas shtysës motivore të realitetit, ka qenë kuptim pozitiv. Kjo dëshmohet edhe nga kuptimi i këtij termi: nacionalizëm (fr. nationalisme, lat. natio) 1. Lëvizje shoqërore-politike dhe kulturore, e cila lufton për mbrojtjen e të drejtave nacionale, për pavarësi dhe kulturë në shtetin

imperialist shumënacional; 2. dhënie epërsi kombit të vet mbi kombe të tjera, nënçmim dhe mohim vlerash të krijimtarisë kulturore të kombeve të tjara, përpjekje për të mbajtur kombet e tjera nën zgjedhë, në shtypje dhe në eksploatim (dr. R. Aleksiq, Rečnik stranih reči i izraza, Beograd, 1978, g. 514, përkthimi ynë). Shpjegim më të gjerë rreth termit nacionalizëm jep R. Tubiq duke e zbërthyer semantikën e tij në gjashtë pika që rrahin aspekte të ndryshme të veprimit të tij në rregullime të nduarnduarta shoqërore-historike në raport me synimet e lëvizjeve ideologjike. Autori vë në dukje se themeli ideor i teorive të ndryshme nacionaliste është aktualizimi i vazhdueshëm i përparësisë së nacionalitetit të vet në sfera të rëndësishme si në atë ekonomike, politike, kulturore ose ushtarake mbi nacionalitete të tjera madje edhe me nënçmim të tyre (R. Tubiq, Enciklopedijski rječnik marksističkih pojmova, Sarajevo, 1974, f. 283). Në rrethanat shoqërore politike të vendit tonë vë re Tubiq-termi nacionalizëm nënkupton veprimet dhe botëkuptimet që kundërshtojnë barazinë, zhvillimin e lirë vetëqeverisës, bashkimin dhe vëllezërimin e popujve tanë si dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre etj. (vep. e cit., f. 284).

Nga kjo që u shtrua më sipër, del plotësisht e qartë se, heq ndonjë eksponim me elemente nacionaliste të individëve ose të grupeve ose edhe ndonjë montim, termi nacionalizëm pa arsye shkencore ka vërshuar publicistikën e vendit në shkrimet rreth lëvizjes së shqiptarëve të Kosovës.

Do vënë në dukje fakti se kërkesat e shqiptarëve të Kosovës nuk qenë as nuk janë nacionaliste sikundër u shpallën në vlerësime të ndryshme, porse ato janë kërkesa gjithëpopullore shqiptare për barazi kombëtare dhe për demokraci. Ky konstatim mbështetet në të dhënën se në lëvizjen demokratike të shqiptarëve askund nuk u kërkua t'i jepej epërsi kombit shqiptar mbi kombe të tjera, askund nuk u nënçmuan vlerat kulturore të kombeve të tjera aq më pak as që u provua për ta nënshtruar ndonjë popull as tash, as ndonjëherë në historinë shqiptare që do të mund të quheshin veprime nacionaliste. Për ta hetuar aspektin polisemik të termit nacionalizëm, atë do parë në dritën e rrethanave shoqërore të kohës, në dritën e lëvizjeve popullore për t'u çliruar nga zgjedha imperialiste. Një lëvizje e këtillë, përkatësisht një nacionalizëm i këtillë, është i mbëhishëm dhe pozitiv, sepse nuk synon robërimin e asnjë populli, por synon lirinë dhe barazinë e popullit të robëruar me popuj të tjerë të lirë. Pasi është kështu, ne mendojmë se mund të bëhet fjalë për nacionalizmin në kuptimin progresiv dhe, në rrethana të caktuara, sipas formave të manifestimit të tij, për nacionalizmin në kuptimin regresiv.

Nacionalizmi shqiptar, si lëvizje kulturore e çlirimtare për të drejta kombëtare dhe për mposhtjen e zgjedhës së huaj, pra në kuptimin »ekspertët« e panjohur B. Pllana dhe Zh. Igiq, veçse shumë më herët në mënyrë të vazhdueshme nga gjysma e parë e shekullit XIX nga veprimtaria kulturore dhe politike e kolonive shqiptare, të cilat përgatitën organizatën e parë politike »me karakter të përgjithshëm kombëtar« si lëvizje çlirimtare dhe kulturore për liri – Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878 (R. Qosja, Histo. e let. shqipe, roman. I, Prishtinë, 1984, f. 44). Naum Veqilharxhi në vitin 1846 shkruan letërqarkoren në të cilën jep programin politik në shkallë kombëtare për mbëhinë e ngutshme të njësimit të lëvizjes çlirimtare. Kjo

lëvizje nuk rrezikonte askë, por ishte lëvizje për çlirim kombëtar nga perandoria turke, pra ishte nacionalizëm në kuptimin progresiv.

Prandaj, shihet qartazi se janë të pambështetura pohimet sipas të cilave lëvizja shqiptare për demokraci dhe për pavarësi quhet nacionalizëm në kuptimin regresiv të këtij termi. Përdorimi i këtij termi ka si qëllim ta arsyetojë represionin policor që po bëhet mbi një popull paqedashës-mbi popullin shqiptar.

Dhe, po të mbahet parasysh tash sqarimi i termit nacionalizëm, thëniet: »Kosova është tokë serbe, asnjëherë s'ka qenë shqiptare, as që do të jetë«, »Këto janë troje serbe«, »Këtu (për Kosovën) në zemër të Serbisë« etj. të ngjashme që po shprehen publikisht madje nga organet zyrtare të politikës serbe, janë thënie të vrazhda nacionaliste, sepse të mohosh praninë e një populli që me shekuj të tërë, që nga Teuta, Genci e Bardhyli është i ngulitur në këto anë, është veprim tipik shovenist.

2. Ndarja e Kosovës nga Serbia nuk është separatizëm

Eshtë e ditur se termi separatizëm do të thotë shkëputje, ndarje nga një bashkësi, shtet, por në rastin tonë, përdorimi i termit separatizëm nuk ka mbështetje logjike objektive për arsye se Kosova, në vitin 1945, në përbërje të Sebisë nuk hyri me deklarimin vullnetar të popullit që do të mund të quhej pastaj pjesë e pandarë e saj dhe shkëputja do të quhej me arsye separatizëm. Mirëpo, sikundër është e mirëditur, në vitin 1945 Kosova hyri në Serbi nën presionin e administrimit ushtarak dhe tash dyzet e pesë vjet mbahet dhe shfrytëzohet me dhunë. Prandaj, për këtë, me të drejtë mund të thuhet se shkëputja e Kosovës nga Serbia nuk është separatizëm, porse është përmirësim i një rrëmbimi të dhunshëm që pati pasoja të mëdha. Pra, as ky term, në këtë kontekst, nuk ka shtysë motivore semantike dhe si i tillë nuk mund të pranohet. Dihet mirëfilli se Kosova u mor dhe u mbajt me dhunë në kthetrat serbe deri më tash.

3. Nga Dy Korriku historik Kosova është Republikë

Do vënë në dukje se Deklarata e Kuvendit të Kosovës e datës 2 korrik nuk qe »e ashtuquajtura Deklaratë e një grupi separatisësh«, siç u quajt nga kreu politik serb, porse qe Deklaratë kushtetuese legjitime e organit më të lartë ligjdhënës – e Kuvendit të Kosovës, Deklaratë e plotfuqishme e delegatëve të zgjedhur në mënyrë legale, e përfaqësuesve të denjë të popullit, e cila përmbledh në vete kërkesat reale të popullit e që është e drejtë sovrane e tij për vetëvendosje. Andaj, ata (delegatët) mund të quhen separatistë vetëm nga radhët e qarqeve shoviniste që synojnë pushtimin jo vetëm të Kosovës, por edhe pushtimin e Jugosllavisë.

Nisma e marrë kohë më parë për avancimin e statusit të Kosovës nga Krahina në Republikë në kuadër të Jugosllavisë, që u konkretizua dhe u shpall legale nga organi kompetent dhe plotësisht legjitim – Kuvendi i Kosovës më 2 korrik 1990, me miratimin e njëzëshëm të Deklaratës kushtetuese, nuk është cenim i integritetit as të Sebisë, as të Jugosllavisë, sikundër u vlerësua nga politika autokratike e udhëheqjes serbe, veçse,

përkundrazi, është dëshmi e begatimit dhe e zhvillimit shoqëror – politik të Serbisë dhe të Jugosllavisë; është dëshmi se, Jugosllavia, me gjithë vështirësitë që i ka, po shkon përpara me hapa evropianë drejt demokratizimit në vepër. Propaganda serbe se Kosova synon shkëputje nga Jugosllavia është vetëm një farsë politike me anë të së cilës provohet të arsyetohet okupimi serb tash në një shtet sovran siç është Republika e Kosovës. Jo. Nuk kërkohet ndarje nga Jugosllavia, por u kërkua ajo qëu shpall në mënyrë legjitime-Republika e Kosovës në të cilën, siç thuhet edhe në Kushtetutën e saj të shpallur më 7 shtator 1990 me të cilin akt Republikës së Kosovës iu vu themeli juridik, do të rrojnë në barazi të plotë të gjitha nacionalitetet e kësaj Republike. Kjo është e vetmja rrugë e tejkalimit paqësor të problemit të Kosovës. Sepse, tashmë është parë se populli shqiptar është thellësisht i ngulitur dhe i vendosur për realizimin e të drejtave të veta sovrane. Nuk ka kthim pas. Data 2 Korrik 1990 do të radhitet ndër datat më të rëndësishme të historisë shqiptare. Pa dyshim, ajo do të hapë një rrugë të re për prosperitetin e të gjithë popujve që jetojnë në Kosovë.

4. Njohja e Kosovës Republikë-obligim i ngutshëm i Evropës dhe i Senatit amerikan

Pas shpalljes së Kosovës Republikë, dhuna serbe sa vjen e shtohet. Vazhdojnë të bien viktima të reja të pafajshme nga represioni policor serb. Për këtë arsye lrimi i Kosovës nga okupimi serb është obligim parësor i të gjitha forcave paqësore dhe liridashëse të vendit dhe te jashtme. Hapin e Sllovenisë për njohjen e Kosovës Republikë duhet ta ndjekin edhe njësitë e tjera federale. Këtë duhet ta mundësojë Jugosllavia, diplomacia e së cilës torikisht kudo deklarohet si zëdhënëse e paqes dhe e bashkpunumit, mirëpo fatkeqësisht kjo mungon në praktikë. Deklarimin e lirë të popullit shqiptar të Jugosllavisë për vetëvendosje më në fund duhet ta mundësojë edhe Bashkësia Evropiane duke e njohur Republikën e Kosovës ngase Evropa nuk mund të quhet e lirë e demokratike derisa në një pjesë të saj mbretëron dhuna mbi një popull sovran.

Republikën e Kosovës pritet ta njohë sa më parë edhe Senati amerikan, por edhe OKB anëtare e së cilës është Jugosllavia madje me ratifikim (teorik) të të gjitha konventave ndërkombëtare për të drejtat njerëzore.

Pasi që Qeveria jugosllave është e paralizuar nga hegjemonizmi serb që të veprojë për çështje të Kosovës, është detyrë e ngutshme e OKB që t'i dërgojë forcat paqësore në Republikën e Kosovës, ta ndërprejë gjakderdhjen dhe ta detyrojë Serbinë të tërhiqet nga vendi i okupuar.

Mr. Hasan MUJAJ
Mr. Adem HAJDARAJ

Ndërprerja e një uragani

Migjeni nuk është një Rambo shqiptar, siç është shkruar diku, e aq më pak një Lermontov apo një Klajst i maleve tona. Ai është thjesht Migjeni, i vetëmjaftueshëm për të qenë shkrimtar i madh shqiptar, një ndër më të shqetësuarit shkrimtarë evropianë të viteve '30, që jetoi dhe punoi në një vend e në një kohë të vështirë tragjizmi i së cilës vulosi veprën e tij. Ajo është e pakët si vëllim, por me një tension të brendshëm të pazakonshëm. Në të, ashtu si në veprat e vërteta të artit, ndodh ajo dukuri e mrekullueshme kur biografia e shkrimtarit përzihet, mpikset e shumohet nga mijëra e mijëra biografi të tjera njerëzish anonimë, dëshmia dhe drama e të cilëve nuk figuron në asnjë kronikë, enciklopedi apo histori të shtetit.

Për të dhënë gjithë këtë rrëmet, i cili disa herë është në lëvizje të ethshme e disa herë në gjendje të ngrirë, Migjenit iu desh të krijojë një gjeografi të gjerë, që shtrihet nga fushat kontinentale ku enden popuj të tërë gjer te kullat malësore ku jeta duket se është ngurtësuar përgjithmonë. Atij iu desh të përdorë forma e teknika të ndryshme të shkruari, të gërshetojë lirizmin me epizmin, komiken me tragjiken, sarkazmën me groteskun. Atij iu desh t'u referohet viteve të vjetra e të reja të njerëzimit, nga krijimet parabiblike te personazhet e kohës, artistët e kinemasë, boksierët e politikanët. Gjithmonë për të realizuar një vizion global të botës, çka do t'i siguronte veprës kumbimin universal, ai herë do të hiqej mënjanë, për të dëshmuar nga larg, si një kronist epik. Shpesh në prozat e tij të shkurtra ndihet romani, që është ndryrë e kalcifikuar, në pritje për t'u zhvilluar më tej.

Kudo në veprën e tij ndihet ndalimi i parakohshëm, ndërprerja. Ai vetë mund të mendohet si i tillë, i ndërprerë. Por ndërprerja e tij nuk qe e zakonshme, përderisa ajo është ndërprerja e një uragani.

Ismail Kadare

* * *

Migjeni shkroj pak, po veprat e tij janë të një cilësie të lartë artistike. Fuqia e tij e fjalës, saktësia e përshkrimit, njohja e jetës, e çuan përpara realizmin kritik në letërsinë tonë dhe e bënë, në të njëjtën kohë, një realizëm militant. Lufta e tij me regjimin feudoborgjez e me imperializmin, besimi në një të ardhme më të mirë, pikërisht socialiste, u dhanë shkrimeve të Migjenit një hov të madh romantik.

Dh. S. Shuteriqi

* * *

Shumë shpirta preku dhe i shkundi nga lethargjia ky zë. Migjeni nuk fliste për bajraqe glorioze, për idhuj pa krena, për zana e shtojzavalle, për faqekuqe flokëzeza, po për barkun bosh, për varfërinë mendore dhe trupore. Ky zë bëri që të shkumbëzojnë nga inati sundimtarët dhe kalemxhinjtë reaksionarë të kohës, të cilët pandehnin se një shkrimtar as mund, as duhet t'i mbërthejë sytë mbi tokë, mbi jetën e përditshme, por mbi re, mbi



mjegullën e metafizikës, ose të shikojë prapa nga e kaluara, por kurrën e kurrës nga e tanishmja dhe e ardhmja.

...Migjeni është përkthyer në 14 gjuhë. Veprat e tij lexohen edhe në vende ku sot e kësaj dite njeriu vazhdon të rripet prej njeriut. Prandaj, pa rënë në megallomani, mund të themi pa frikë se Migjeni i përket edhe njerëzimit.

Nonda Bulka

* * *

Sa herë kemi rilexuar veprën e Migjenit na ka dhembur thellë në shpirt vdekja e tij e parakohshme. Sa herë jam ulur në klubin e Lidhjes së Shkrimtarëve me shokët e mi të penës, kam përfytyruar Migjenin të ulur diku në njërën nga tavolinat në një moshë tashmë të thyer, të nderuar mes kolegëve. Atë, më tepër se sa bacili i tuberkulozit, e theri për vdekje superndjeshmëria, e cila është pasojë e prirjes së natyrshme të poetëve të mëdhenj për t'i parë jetën dhe njerëzit gjer në palcë, për të vuajtur edhe vetë e për të protestuar pastaj për vuajtjet e tyre, në një shoqëri të ndërtuar së prapthi nga ligjet e të »plotfuqishmëve« me bark shekullor gjithmonë të pangishëm.

Në dy vargje të një poezie të tij Migjeni rrëfen: »Përditë shoh qartë e ma qartë e vuej thellë e ma thellë«. Ja, kjo ia ka shkurtuar jetën poetit dhe i ka zgjatur namin e poetit të madh.

Të shohësh qartë e më qartë e të ndiesh thellë e më thellë realitetin, njeriun, shqetësimet e tij! Ky është poeti i vërtetë i të gjitha kohërave. Pa këtë veti thelbësore në rastin më të mirë mundesh vetëm të vargëzosh, të vetëkënaqesh e ta pësosh si narcisi. Poezia nuk është lojë e formave, as amotorizëm i një intelektuali të ngeshëm, por krijesë e të parit qartë e më qartë dhe e të ndjerit thellë e më thellë. Migjeni është etalon për të matur temperaturën e gjendjes poetike: sa e ndiejmë atë për të cilën shkruajmë vargje.

Ndoc Gjetja

* * *

Sidomos për shkrimtarët dhe poetët tanë që janë në kërkim e në afirmim të personalitetit të tyre në fushën e letërsisë, vepra e Migjenit përbën një nga lëndët e domosdoshme për formimin e tyre. Jeta e tij prej shkrimtari përbën një model të spikatur në historinë e letërsisë sonë për mënyrën e perceptimit të thellë të realitetit, gjë që e shprehte në orientimin e saktë e të shpejtë drejt fenomeneve më thelbësore të shoqërisë së kohës, në kuptimin e drejtë mbi rëndësinë e barazvlefshme të formës e të përmbajtjes të çdo krijimi, i çfarëdo gjinie qoftë, të vogël apo të madhe, në kërkimin e pareshtur për t'u thelluar e përsosur në të dy drejtimet, mprehjen a të vëzhguarit të realitetit e njëkohësisht pasurimin e përfytyrimit, si dhe në shkrirjen në një të spontaneitetit me analizën gjakftohtë gjatë aktit të krijimit. Pra, duke ruajtur qenësinë e vet prej poeti e prozatori të mirëfilltë, të dijë t'i vëre në shërbim të tij edhe filozofin e sociologun. Në

sajë të këtyre cilësive jo të zakonshme, që nuk mund të jenë asnjëherë vetëm dhuratë e gjenialitetit të lindur, por edhe produkt i një pune tepër këmbëngulëse, ai arriti të lërë gjurmën e vet të pashlyeshme te të gjithë brezat e rinj të shkrimtarëve që i erdhën Shqipërisë pas vdekjes së tij dhe jetëgjatësa t'i matet vetëm me moshën e veprës që na la trashëgim.

Besnik Mustafaj

Nderim

Agim Isaku

Ne që ia kemi zbërthyer të gjitha figurat Migjenit,
që kemi analizuar kompozicionin dhe strukturën e vargut,
ne që kemi zbuluar hollësisht idetë dhe problemet,
që para realizmit të tij rrëqethës kemi shtangur;

Të heshtim një çast,
të mendojmë erërat me borë të Pukës,
privacionet, jetën private, brutalitetin e zyrtarëve,
rrugën e Vrakës në një pasdite me shi, ndanë liqenit,
të pimë nga një kafe të hidhur me pak
dhe të heshtim një çast
në nderim të Migjenit.

Zgjimi

Migjeni

O vullnete të ndrydhuna ndër grushta të çelikta
të shekujve të kaluem!
O vullnete të shtypuna me themra të ngurta të titajve të
tërbuem!
Të cilët n'udhë për në theqafje këtej-pari i ranë
dhe vatrat tona në mjerim i përlanë . . .
O vullnete të ndrydhuna!
O vullnete të shtypuna!
Shkundëni prangat të mbrapshta! E me britmë ngadhnjyese,
me hove viganash, dëshirash flatruese,
turrnju në të gjitha anët dhe poshtë në dhe zbritni.
– Ndosht' aty keni për të gjetë fillin e një hymni,
që Illyri e vjetër ndër kremtime këndonte,
ndërsa zemra e kombit në liri kumbonte.

O vullnete të ndrydhuna!
O vullnete të shtypuna!
Tash shigjetat e flakta të shprehjes suej zharitse
drejtoni kah qiella në ball të hyut a të dreqit,
i cili fatin tonë mbytte në mnijë të vetë përpisë –
ta dijë se të Birt' e Shqipes folen' ja ngrehën vetvetit.

Qe fjala të jetë në burimin e vet etimologjik

Rudolf Marku

– Në vend të esesë –

Ndër hendeqet më të mëdha, më të thella për njeriun, e veçanërisht për intelektualin, duket se është ai që ndan fjalën nga vepra. Përfytyroñi një djalosh të zbehtë, me sy ëndërrues, me një pamje romantike. Të duket e natyrshme që ai të thotë se është duke punuar një disertacion me temë mbi sentimentalizmin apo mbi poezinë e Serembes, të La Martinit a të Alfred de Mysesë. Por, kur ti befas zbulon se djaloshi me fytyrë të zbehtë, që di vargje të tëra përmendësh, ka dhe një zyrë të vetën, e brenda asaj zyre ai ka një shkathtësi të habitshme për të marrë dyzet herë në ditë në telefon eprorët e tij, duke u bërë lajka nga më elokuentet, atëherë ti dashje pa dashje pëson një si thyerje të lehtë, duke mos dashur ta pranosh këtë kundërvënie.

Atëherë si ka mundësi që dy pasione të kundërta të qëndrojnë harmonikisht brenda të njëtit njeri? Udhëtoj me tren, është mëngjes herët, më mirë është të thuhet se janë orët e fundit të natës një vajzë, studente filozofie, flet me pasion dhe respekt për pedagogun e saj Nënvizon veçanërisht natyrën njerëzore të tij. Oh, ç'shpirt të mrekullueshëm që ka! Sa xhentil, sa i butë, sa njerëzor që është! Bisedën e ndërpret një plakë fshatare, e cila është e veshur jo dhe aq mirë, sidomos po ta mendosh se do të ecë nëpër rrugët e Tiranës. (Vetë veshja disi froteske e plakës i duket një stonaturë e papranueshme studentes, sidomos kur ajo mendon shokët dhe shoqet në oborrin e fakultetit intimisht studentja fillon ta përyasë plakën me prindërit e vet pleq. Një inkomoditet i lehtë ndjehet brenda studentes). Plaka pyet nëse mund të ulet në njërën nga dy vendet bosh. Studendja e filozofisë që duket përnjëherë se revoltohet nga ky guxim i tepruar, përgjigjet me një »Janë të zëna« e, kthen kokën nga bashkëbiseduesi i saj, një student i vitit të tretë të fiskulturës dhe fillon të shpjegojë humanizmin e Volterit e të Rusoit. Dhe unë, vëzhguesi i heshtur i kësaj skene, marr me mend se me sa pasion studentja e filozofisë do t'i flasë pedagogut të saj të nderuar për shpirtin e madh të popullit, për domosdoshmërinë e njohjes së jetës së njeriut të thjeshtë, pa i shkuar ndërmend për hendekun mes fjalëve të saj dhe veprimit, të cilin, për fat të keq do ta harrojë përnjëherë.

Natyrisht, natyra njerëzore është e ndërlikuar, ajo kurrë nuk është e rrafshët, e sheshtë, njëdimensionale. Brenda natyrës njerëzore përfshihet

universi, me pafundësinë e vet, me dritat dhe blekhoullsat e veta, me vezullimin dhe errësirën. Dhe pikërisht këndej vjen dhe bukuria e njeriut. Brenda këtij ndërlikimi, një njeri mund të flasë keq, pa elokuencë, me një stonaturë vokale, dhe po ky njeri mund të bëjë veprime të mrekullueshme. Njeriu, brenda kësaj mospërputhje është i bukur, sepse bën veprime të natyrshme, shprehëse, pa stonaturë. E keqja është tek pozimi, tek mungesa e sinqeriteti. Aq më tepër amplifikohet problemi, kur ndarja e fjalës me veprën merr ngjyrime sociale. Demokratizimi i vendit, për të cilin është aq e interesuar shoqëria shqiptare, krijon hapësira të gjëra. Por, ndërsa disa njerëz, tamam si ata arkitektët e zot, e shfrytëzojnë hapësirën për të ndërtuar vepra të vlefshme, të mira, në përputhje me progresin dhe njerëzoren, ca të tjerë, me logjikën e qenieve të natës, të trembur nga hapësira e ndritshme e demokracisë, ndërtojnë kulla fjalësh, si e si për t'u ndodhur »brenda« . . . Në asnjë kohë tjetër nuk duket më e padenjë ndarja e fjalëve nga veprat se sa në kohën tonë të shundërrimeve demokratike. Në këso lloj kohërash shfaqen dhe kamelenët e fjalëve. Në mënyrë paradoksale, pikërisht tani që koha është kundër tyre, ata shumohen më tepër se kurrë.

Askujt nuk i pëlqen të luaj më tepër me fjalët, se sa burokratëve. Termin dhe fjalën e përdorur burokrati kurrë nuk i merr në format e veta burimore, etimologjike në të cilat ato funksionojnë. P.sh. koncepti i fjalës »demokraci« për burokratin nuk përputhet kurrë me përcaktimet leksikore dhe etimologjike që japin fjalorët, qofshin dhe ato më akademikët e shkencorët. Njerëz ë tillë të burokratizuar, konservatorë dhe konformistë, nga njëra anë, tregohen parimorë, nëpër mbledhje flasin me elokuencë, duke përsëritur fraza dhe citate të tëra, kurse nga ana tjetër, kur mblidhen nëpër tavolina, shoqërisht, shprehin keqardhjen se demokracia po keqkuptohet, duke mendaur se bota fillon dhe mbaron atje ku janë ata vetë. Demokracia, mendon një burokrat, është ajo çfarë quaj unë demokraci. Dhe kështu nis loja me fjalët. Nga një anë të shirurit me fjalë, euforiza, frazat e fryra, pompoziteti, nga ana tjetër këmbëngulja e verbër në metodat e vjetra, kapja si pas një direku të një anijeje që mbytet tek prepotenca, megalomania, sloganet. Të kthehemi në botën tonë letrare dhe artistike. Konformisti dhe xhongleri i fjalëve, mund ta shajë një piktor nëpër leksione e mund ta mburrë si snob në një bisedë: shkruan një artikull kundër një shkrimtari e më vonë në një rreth të ngushtë të të ankohet përse ne nuk e botojmë veprën e tij. Më i trishtuar është dyzimi i shkrimtarëve dhe autorëve mediokër. Dukej se pikërisht atëhere kur autori mendonte ta çonte personazhin e vet në fshat, duke e përcjellë me një monolog lumturie, pikërisht dhe atëhere autori fitonte sigurinë se pikërisht atij vetë (autorit, pra) nuk do t'i takonte të shkonte në fshat. letërsia dhe arti mediokër krijonte atë paradoks tëtrishtuar hendekndarës, që mund të karakterizehej sipas devizës »realizëm, por me një kusht, të mos flasesh për realitetin«. Asgjë nuk do t'i pëlqente më shumë një njeriu të tillë, se sa euforia sociale. Sa më tepër që do të thellohej distanca mes fjalës dhe veprës, aq më tepër do t'i nevojitej atij euforia, tamam siç do t'i duhej ngushticës La Manshit mjegulla për të mos u dukur hapësira e frikshme. Lodrat e natyrës së xhonglerit me fjalët janë shenjë e depersonalizimit të njeriut, janë një nevojë maske, janë shenja të jetërsimit. Kam lexuar diku se një diktatori latino-amerikan i pëlqente të

paraqitej paradite me rroba femrash, e pasdite me rroba prifti. Atë ditë që vishej si maniak seksual, të nesërmen e ndjente të nevojshme pët t'u maskuar si murgeshë . . .

Le të qëndrojmë tek një fakt që mund ta ketë vërejtur kushdo që banon në Tiranë: askush nuk mund ta mohojë arritjen e shoqërisë shqiptare në drejtim të emancipimit të gruas. Por, secili nga ne është i vetëdijshëm se euforia, qoftë dhe kur bie fjala për emancipimin e gruas do të ishte naive dhe, pse jo, frenuese. Bashkimi i Grave të Shqipërisë, por edhe radio-televizioni, përmendin gra që shkojnë nga Veriu në Jug dhe anasjelltas. Flitet për çrrënjosje paragjykimesh, për një kulturë të re jetese në fshat. Dhe këto janë nisma shumë të mira, ndërsa arritje me të vërtetë të mëdha. Por po atë ditë ose të nesërmen që ke ndjekur kronikën televizive shikon gra fshatare të Tiranës që zbresin në treg, ditën e dielë. Pamja të jep një ndjesi zori: fshatare të veshura gati në formë uniforme (as praktike, as higjenike, as ekonomike, as kombëtare, s'është veshja e tyre) e që ecin me një bindje të ligësht pas burrave, vetëm për të shitur atë pak mall që kanë marrë me vete. E kjo ndodh në kryeqytet, kushdo e shikon çdo ditë e veçanërisht të djelave. A s'duhej të mendohej më tepët për këtë kur flasim për emancipimin dhe kulturën e jetës?

Flasim për edukimin patriotik, dhe duhet të themi se ka plot njerëz që ende nuk e dinë se kush janë Dardani, Kukuzeli, Biçikemi dhe Bogdani. Ka shumë njerëz që nuk e dinë se ku qëndron veçoria e gjuhës shqipe dhe origjinaliteti i saj, ashtu mund të jetë ndonjë që vihet në pozitë të vështirë po t'i thuash të këndojë me fjalë të plota himnin e flamurit. Si? Mund të pyes i nxehur ndonjë mendje burokrate. Guxon të thuash se ka njerëz që nuk dinë Himnin e Flamurit? Dhe po këtij njeriu, që kjo e vërtetë e hidhur nuk i pëlqen, po t'i futesh në shtëpi, mund t'i gjesh kaseta me këngë të Madonës e »Hevi Metal«, por asnjë të krahinës së te parëve të tij.

Ecën në qytetin e Tiranës. Parku i madh do të ishte një vend i përshtatshëm për të ngritur një varg monumentesh të heronjve kombëtarë. E pra, kemi folur shumë për edukimin patriotik dhe për internacionalizmi proletar, por, në fakt, del se pikërisht në bulevardin »Dëshmorët e kombit« heronjtë kombëtarë i takon shumë rrallë nëpër buste a monumente, ndërsa përgjithësisht në Tiranë i sheh të vendosur pa ndonjë kriter të studiuar mirë dhe, nganjëherë (sidomos në disa tabela rrugësh) në vende jo shumë të përshtatshme. Nxënësit nëpër shkolla kanë mësuar për Jan Husin e Jan Zhishkën, për luftën e boerëve dhe kryengritjen e këmbëzbathurve të Pekinit, por, po t'i pyesësh për luftën e Deçiqit, ndodh t'i vësh në pozitë të vështirë. Askujt nuk i vjen mirë kur bëhen pohime të tilla. As artikullshkruesit. Por fakti është se ne, veçanërisht në kushtet e sotme na duhet të bëjmë shumë më tepër për edukimin e njëmend, jo frazist, të ndjenjave patriotike e për ngritjen dhe vlerësimin e mëtejshëm e serioz të vlerave kombëtare. Frazistëve u pëlqen të thonë se ja, ne jemi patriotë, duke mos ditur asnjë varg nga Naim Frashëri, e duke mos patur as idenë më të thjeshtë për historikun aq të dhëmbshëm të alfabetit shqip . . . Sheshit para Universitetit do t'i shkonte busti i Çabeit a i Bogdanit, ashtu siç do të ishte në natyrën e Bulevardit të Dëshmorëve të Kombit vendosja e monumenteve të heronjve kombëtarë të të gjithë historisë sonë, siç e ka dhe emrin bulevardi

Duhet ta themi se është gjë e mirë që në qytetin e Shkodrës, vit për vit, festohet përvjetori i festës së Reçit, por nuk është normale që punonjësit e drejtorive, ndërmarrjeve t'u marrin firmat punonjësve të tyre, për të shkuar në Reç. Nuk është normale, sepse festa e Reçit është përkujtimore e luftës së popullit, dhe adminisratori burokrat nuk ka përse të marrë pozën e një përkujdesësi të tepruar mbipopullor, që vetëm atij i dhemb që të shkojë sa më mirë festa! . . .

Do të ishte e tepërt të kujtonim se kulti i fjalës në historinë e shqiptarëve është monumental, i pashembullt Duket se fjala tek shqiptarët deri vonë ka ruajtur atë freskinë magjike të krijimit të parë (kjo është dhe njëra ndër arsyet përse shumë linguistë në botë e mësuan me qejf gjuhën tonë). Maksima të tilla si »burri lidhet nga fjalët« kanë diçka nga urtësitë e Solomonit. Prandaj askund gjetkë nuk do të dukej më e stërmadhe hapësira që ndan fjalën nga veprimi njerëzor, se sa këtu.

21. tetor 1990

Fati i atdhetarit

Kadri Rexha

(Me rastin e 45-vjetorit të lindjes së Jusuf Gërvallës)

. . . J. G., emigrant politik shqiptar arratisur nga Jugosllavia, me nënshtetësi gjermane, gazetar, poet dhe muzikant vdiq më 17 januar 1982, në orën 3.15, pas mesnate, gjatë operacionit . . .


. . . Teksti i mbishkrimit u zgjodh më në fund prej njërës prej baladave të tij, por drejtoria e varrezës nguli këmbë që të bëhej një ndryshim në të. Ishte prerja, ose për të përdorur një fjalë më të kohës, censurimi i fundit që iu bë J. G. në jetën e të cilit kishte patur disa herë ndërhyrje të til'a, duke përfshirë edhe vdekjën, e tij, e cila në fund të fundit s'ishte veçse një p r e r j e .

Fund

(Baladë për vdekjen e J. G.)

Ismail Kadare

Në plejadën e njerëzve të kulturës, të njerëzve të mendimit dhe të veprimit revolucionar, të lindur në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, Jusuf Gërvalla zë njërin ndër vendet më të ndritura. Jeta dhe vepra e këtij atdhetari të flaktë, poeti të shkëlqyer dhe revolucionari të paepur është shume e pasur dhe e thellë, ajo është dëshmi e ngjarjeve të rëndomta të jetës dhe e ngjarjeve të mëdha të kohës, ku ai vetë ishte pjesëmarrës. E përjetuar thellë në qenien e tij, e shkruar në gjuhën e pastër të popullit, vepra e tij është shumë e pasur me ide të guximshme dhe përparimtare, me vlera të larta estetike, me figura të pasura e plot mendim. Talenti i tij i mrekullueshëm dhe aftësitë e tij të pashterrshme erdhen në shprehje në



gazetari, në publicistikë, në komponim, në interpretim, në pikturë, në poezi, në prozë, në dramë, në kritikë letrare, në kritikë muzikore, në kritikë filmi, në shkencë, në politikë, etj. Megjithatë, gjenialiteti i tij krijues mbeti i parealizuar, mbeti i pashprehur deri në fund, u këput në nismën e tij të mbarë. Jusuf Gërvellën e përcolli fati i luleve të secilit popull, e përcolli fati i gjenive, e pësoi ashtu siç e kanë pësuar gjatë shekujve mendjet e mëdha e të urta, të cilat digjen për të tjerët, të cilat qenien e tyre e shkrijnë për t'ua ndritur mendjen të paditurëve, për t'ua treguar të verbërve rrugën drejt dritës, drejt progresit, drejt lirisë . . .

Personaliteti i shquar i Jusuf Gërvallës, gjenia e mendimtarit dhe e veprimtarit, erdhi në shprehje në mënyrë të veçantë brenda viteve 1968–1981, vite këto të cilat i karakterizon dhuna e paparë që pushteti jugosllav e ushtroi ndaj popullit tonë martir si dhe presioni i fuqishëm që këtij pushteti i bëhet nga forcat përparimtare të këtij populli për të drejta nacionale, ekonomike, politike, kulturore dhe arsimore, për liri më të mëdha dhe për barazi me kombet tjera dhe, më në fund, detyrimi i pushtetit jugoslav që përpara realitetit të krijuar të lëshojë pe në favor të ndonjë kërkese të popullit tonë. Këto vite, ngjajshëm me një Hyriet të dytë, i shoqëron hapja e shkol'ave shqipe, botimi i librit shqip, njohja më e madhe e kulturës dhe e historisë kombëtare shqiptare, zgjimi i gjithanshëm i popullit, zgjërimi dhe thellimi i ndërgjegjes së mirëfilltë kombëtare. Aktiviteti

Halle për rrodhindën

Ëmë vina e fundit ä halle më vetën,
pa kurrgjë emnë s'e shoqën mbarë,
kurrgjë për ty, rrodhindje =
kurrnji i botës të t'ë shtrëgtë!

Lotët pa fëmijënë kurgjën Hme rrëmbave,
derisa imë shkyç zjarrmin që ghuhet ngadalë;
dhjetnet javë të kaluta, si gjumaçë
më dielltin e kurrizit halle... Hmue do t'i thojmë?

Ëdhe botën e gjuajtë fëmij kam me dendë,
Nji dritë ndroftë ka me rrojtë brenë;
Inej kurrgjë nu të mujta 'i bardhë kam me mbarue,
kur kundrej gjithë... t'ë mjerë mbarojë,
ka me të shumbue, me kënduë mjë sorrë,
të mëmën time gruan,
mjerën i Zotëm me mallë kam me ghjet
për ty- mallkim e kam të dashtun!

i Jusuf Gërvallës do të shkallëzohet, në sasi dhe në cilësi, si pjesemarrës aktiv në demonstratat e vitit 1968 dhe ngjarjeve që i pasuan ato, si pjesëmarrës i debateve të reformës kushtetutare që u kurorëzuan me Kushtetutën e vitit 1974, si ithtarë i flaktë i unifikimit të gjuhës shqipe në shkallë kombëtare, si aktivist i palodhshëm gjatë vitit jubilar të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren, etj. Thënë shkurt, aktiviteti i Jusuf Gërvallës i përfshinë vitet që e përgatitën popullin shqiptar të shpërthejë si vullkan kundër dhunës dhe robërisë me anë të demonstratave masive në pranverën e kuqe të vitit 1981. Vlen të theksohet këtu se një veprimtari të këtillë Jusuf Gërvalla e zhvilloi edhe në ciësinë e njërit ndër anëtarët dhe udhëheqësit më të shquar të organizatës ilegale të quajtur Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe e Viseve Shqiptare në Jugosllavi. Gjatë dy viteve të fundit të jetës së tij, edhe pse larg atdheut, në arrati, ai angazhohet me tërë qenien e tij, e fut në lëvizje gjithë potencialin krijues, punon pandërprerë. Me fjalën e gjallë në mesin e mërgimtarëve tanë ekonomikë ashtu si edhe me fjalën e shkruar në organet *Bashkimi, Lajmëtari i lirisë, Liria* dhe *Zëri i Kosovës* Jusuf Gërvalla angazhohet për kristalizimin dhe për orientimin e drejtë të kërkesave, të cilat, në rrethana kohore dhe hapësinore, i shtroi populli i Kosovës nëpërmjet të demonstratave paqësore. Po ashtu ai u angazhua edhe për organizmin dhe për kanalizimin e patriotizmit të shtresave të gjëra popullore si dhe të luftës së drejë të popullit tonë. Në mënyrë të veçantë, aftësitë e veta Jusuf Gërvalla i orienton në përhapjen e së vërtetës në botë mbi tragjedinë më të re të Kosovës, mbi masakrat në masë, mbi kryqëzatën më të re serbe kundër popullit shqiptar, kundër kultuës dhe historisë kombëtare të tij. Njëkohësisht, Kosovën dhe kërkesat e drejta të popullit shqiptar ai arriti t'i bëjë ato çështje ndërkomëtare. Dhe, në hovin më të madh të punës, në vitet kur do të vijë në shprehje gjithë vitaliteti dhe e gjithë forca e tij krijuese, patriotike dhe revolucionare, në kohën kur po bëhëshim përpjekjet e fundit për konsolidimin e të gjitha forcave të organizuara patriotike dhe revolucionare, si brenda në Kosovë ashtu edhe jashta saj, në kohën kur të gjitha organizatat ilegale, nën këshillat dhe nën kujdesin e tij të urtë, po bënin përpjekjet e fundit që të shkrihen në një front të përbashkët të Lëvizjes së rezistencës dhe të aksionit të organizuar, më 17 janar të vitit 1982, e rrëzuan për tokë plumbat serbë, dora e armikut tonë shekullor, duke e ndërprerë kështu në gjysmën e rrugës së saj njërën ndër kaptinat më të rëndësishme, më origjinale dhe njëherit më të dhimbshme e më tragjike të kulturës dhe të historisë sonë komëtare, e cila po shkruhej me mund e me sakrifica mbinjerëzore.

Të gjithë ata që e kanë përpara veprën madhore të Jusuf Gërvallës do të ndahen prej saj të entusiazmuar deri në admirim. Me ndjenjë e valë që të prshkon fund e krye, me arsyen e kthjelltë të lexuesit të njerëzishëm, askush nuk mund të largohet prej veprës së tij pa ia shtruar vetëvetës një seri pyetjesh nga më të ndryshmet. Ku e gjeti ai gjithë atë forcë? Ku e muar ai gjithë atë kohë? Ku e ka burimin vitaliteti, guximi, humanizmi dhe vizionariteti i tij profetik? A ishte Jusuf Gërvalla edhe në jetë mishërim i madhështisë njerëzore apo i tillë shfaqet vetëm në veprën e tij? Kush dhe çka ndikoi në shpirtin e tij që të gjitha dashuritë, gjithçka pati të çmuar e të

shenjte të lirisë në kuptimin e gjërë të kësaj fjale... Dhe vargu i pyetjeve në këtë rast nuk ka të sosur...

Si çdo njeri edhe Jusuf Gërvalla është personalitet në vete, por që e shquajnë të gjitha vetitë dhe tiparet e gjenive. Në jetë dhe në vepër ai është origjinal, autokton, është zë i zgjuar i popullit të vet, është vetëdije e ndërgjegjshme e kohës në të cilën jetoi dhe veproi. Ai jetoi në të sotmen duke u kthyer në të djeshmën dhe në të njëjtën kohë duke shikuar larg në të nesërmen: kush nuk e parashikon të nesërmen as që duhet ta presë atë ditë, theksonte ai vazhdimisht. Ai i ndjeu thellë dhe fuqishëm baticat dhe zbaticat e njeriut tonë në veçanti si dhe ato të të gjithë popujve të tjerë. Fatin, vuajtjet, brengat dhe gëzimin e çastit të njerëzve të atdheut të tij asnjëherë nuk i kundroi si të huajat. Nuk u pajtua kurrë me lajkat, kurrnitë dhe me obskurantizmin e kohës. Nuk e hutuan e as e firkësuan premtimet, provokimet, shantazhet dhe kërcënimet që aludonin ta largojnë atë nga rruga e nisur. Kishte besim të patundur në njeriun, në ardhmërinë e bukur, në progresin historik e shoqërorë. Lajtmotivi i gjithë jetës dhe veprës së tij mund të përkufizohet në vargun e një poezie të shkruar nga ai: *Ta duam njeriun, njeriun, njeriun...* edhe pse thellësisht ishte i bindur se: *ka varre për këta njrëz në tokën e shkelur të Kilit.* Besim të cilin Jusuf Gërvalla e shkroi dhe e vulosi edhe me gjakun e tij të derdhur në dhe të huaj, edhe me mbylljen tragjike të aktit të fundit të jetës së tij...

Jeta dhe vepra e Jusuf Gërvallës nuk janë dy fenomene që e kundërshtojnë njëra tjetrën, ashtu siç ka ditur të ngjajë shpesh në kohëra dhe në mjedise të caktuara. Ato shkojnë dhe shkrihen në një fokus duke e dhënë kështu sintezën e njeriut me të gjithë urtësinë, njerëzinë, bukurinë dhe madhështinë e tij. Megjithatë, me emrin e Jusuf Gërvallës nuk mund të përafrohet asgjë që e karakterizon e mbinatyrëshmja, irealja, mitologjia apo ndonjë fenomen tjetër i mrekullueshëm që si vel shpeshherë i ka mbuluar njerëzit e mëdhenj dhe heronjt në të kaluarën e largët dhe në atë të afërt. Lidhur me këtë ai as vetë nuk besonte se njerëzit në këtë botë zbresin me ndonjë mision të paracaktuar për t'i shërbyer ndonjë çështjeje apo mbarë njerëzimit, siç thotë Bibla për Jezu Krishtin apo mitologjia për heroinën franceze Zhan Darkë. Një mendim të këtillë, deri diku, Jusuf Gërvalla e mbante edhe rreth çështjes së lidhjes së fatit të njeriut në jetë me poziten e yjeve në Yllësinë e pakufishme. Para se gjithash, Jusuf Gërvalla besonte se njeriu në jetën e tij është farkëtues i fatit të vet.

Vetë lindja e Jusuf Gërvallës është një akt i thjeshtë lindjeje, shëmbëllyes me të gjitha lindjet e tjera të zakonshme, pa paraprirjen e ndonjë ëndërre apo profetizimi tjetër se Kosovës martire po i lind një prijës, i cili në jetën e tij të shkurtë do të bëjë mrekullira. Të paktën, kushtëzuar nga rrethanat tejet të rënda të kohës, lindjen e tij nuk e shoqëroi as krisma e pushkës, traditë kjo shekullore e popullit tonë për dhënien e lajmit të gëzuar se vatanit po i shtohet edhe një jetë, edhe një krah pune, edhe një pushkë më shumë. Jusuf Gërvalla u lind në Dubrovnik, në një fshat të pasur dhe njëkohësisht të varfër të Kosovës së masakruar, në një kohë mjegullash të mbarsura me tradhëti dhe me tragjedi të shumëfishta, në një kohë kur toka e katundeve dhe e qyteteve tona po lahej me gjak më shumë se me shi. Jusuf Gërvalla u lind në një familje tejet të varfër dhe të plaçkitur pamëshirë, rrjedh nga prindët analfabetë, i ati bujk i pa tokë, kaçak i dety-



ruar nga situata shoqërore historike, dhe e ëma amvise, ndërsa u rrit kryesisht larg gjirit dhe ngrohtësisë familjare.

Edhe shkollimi i Jusuf Gërvallës ishte po ai i mocave të tij, kryesisht në gjuhën dhe në edukatën e pushtuesit, duke i munguar edhe mjetet më të domosdoshmę për shkollë. Në mungesë të kushteve ekonomike dhe të mundësive të tjera, këmbët e tij nuk arritën të shkelin në asnjërin nga universitetet e lashta e në zë të metropoleve të Evropës, dora e tij nuk e pati fatin e njerëzve të shquar të shekujve të kulturës dhe të shkencës që t'ua fshijë pluhurin monumenteve të rralla të diturisë dhe të kulturës së përbotëshme që gjenden nëpër bibliotekat e njohura të planetit tonë, syri i tij asnjëherë nuk ka mundur të depërtojë në arkivat e botës, të cilat me gjelozi të madhe ende i mbajnë të fshehura dëshmitë e historisë sa të lavdishme po aq edhe tragjike të popullit tonë. Mësimet e para Jusuf Gërvalla i fillon në një shkollë fshati, në Prapaqan, që t'i vazdhdojë më vonë në Pejë, ku edhe e mbaron shkollën e mesme – gjimnazin, ndërsa fakultetin dhe studimet pasuniversitare i mbaron në Universitetin e Kosovës në Prishtinë. Gjatë tërë shkollimit të tij ai e përdori librin në gjuhën amtare, qoftë në orgjinal e qoftë edhe të përkthyer. Pastaj i futi në përdorim gjuhët e pushtuesit sllav: serbokroatishten sllovenishten dhe maqedonishten si dhe gjuhën botërore frengjishten për të mësuar gjithë çka mungonte në gjuhën e tij. Duke hyrë kështu në botën e diturisë, ai thëthiti si bleta punëtore gjithçka që ishte përparimtare në letërsi, në filozofi, në shkencat shoqërore dhe në shkencat natyrore duke filluar që nga antika e deri te rrymat dhe drejtimet e shumta të shekullit tonë. Kësisoji, Jusuf Gërvalla, u mbath, u brumos, u pajis me një dituri të gjërë prej enciklopedisti dhe tërë këtë bagazh njohurishë pastaj e zbatoi në punën e tij të vazhdueshme në shërbim të çështjes së shenjë të lirisë, të përparimit dhe të emancipimit të popullit dhe të atdheut të tij.

Sekretin e gjenialitetit të Jusuf Gërvallës sëpari duhet kërkuar në shpirtin e tij të madh, të shqetësuar e krijues, pastaj në aftësitë e holla vrojtuese të tij, në ndjenjat e zjarrta dhe në etikën e pastër të tij, në vullnetin e tij të fortë dhe në durimin e tij të jashtzakonshëm për të nxënë sa më shumë, për t'i zgjeruar dhe për t'i thelluar dituritë, në aftësitë e tij për t'i parë dhe pët t'i dëgjuar edhe fenomenet më të rëndomta të natyrës dhe të shoqërisë njerëzore që shprehia e perditshmerisë sonë shpeshherë do t'i bëjë memece, në guximin e tij të arsyeshëm dhe real për t'iu përgjigjur imperativit të kohës, etj. Nëna natyrë e kishte begatuar me këto dhunti, të cilat tek ai u shfaqen që në fëmijërinë e hershme, qysh në moshën kur personaliteti i njeriut i formon vijat e trasha të karakterit. Sipas kujtimeve të të afërmeve të tij si dhe të shokëve të tij të fëmijërisë rezulton se Jusuf Gërvalla kishte një kurreshtje të jashtzakonshme për të nxënë dhe një aftësi të hollë për të gjykuar, interesime këto të papara për moshën e tij. Në mënyrë të posaçme interesimi i tij do të orientohet në njohjen e fenomeneve të natyrës dhe të shoqërisë me të gjitha sekretet dhe madhështitë që ngërthejnë ato në vetëvete. Qysh në moshë fare të njomë, duke hyrë në botën e përrallave dhe të legjendave, Jusuf Gërvalla i bën pronë të vetën rrëfimet për të kaluarën dhe për mrekullitë e një bote të krijuar në imagjinatën e gjeniut popullor, gjithë çka thuhet për dejtësinë dhe për padrejtë-

sinë, për të mirën dhe për të ligën, për të bukurën dhe për të shëmtuarën, për tmerret e së kaluarës dhe për shpresat që i suhqen e ardhmja. Fantazia e harlisur e djaloshit, ujëvarë e ylbertë, fluturon në krahët e këngës te përcjellë me tingujt vajtus të lahutës dhe të çiftelisë. Logjika fëmijënore e Jusuf Gërvallës i bashkohet gjykimit të shëndoshë e të drejë të popullit që si lumë gurgullues buron nga goja e rapsodit. Djaloshi përherë gjendet në anën e heroit të këngës, në çdo situatë është shoqëruesi më besnik i tij, vuan me të, provon t'i ndihmojë sa herë që ai ndodhet në ngushticë, denesë me ngashërim dhe qanë zëshëm pas aktit të lartë të heroit që zakonisht e mbyllë jetën tragjikisht. Në anën tjetër armikun dhe tradhtarin e përbuzë, e urren dhe e gjykon për vdekje. Në këtë vazhdë, duke dëgjuar rrëfimet e të atit lidhur me dëbimin e tij nga shtëpia, lidhur me plaçkitjen e tokës dhe të të gjithë pasurisë nga ardhësit malazezë, lidhur me të gjitha vuajtjet dhe tmerret që ai i kishte përjetuar dhe i kishte parë me sytë e tij, lidhur me rezistencën e popullit kundër zullumeve të pushtuesëve, Jusuf Gërvalla, ende çunak të atin e identifikon me heroin e këngës, ndërsa popullin me fuqinë e furtunës dhe qysh aso kohe në shpirtin e tij të brishtë e të pafajshëm nis të lindë urrejtja për të gjitha normat morale dhe shoqërore të jetës nën pushtetin gjakpirës serb, i cili popullin tonë e kishte katandisë në mjerim dhe në vuajtje të pandërprerë. Nga ajo kohë e pastaj gjatë gjithë jetës së tij Jusuf Gërvalla do të merrë anën e të vogëlit, e të varfërit, e të përbuzurit, e të robëruarit, e të shtypurit, e të shfrytëzuarit . . .

Dëshira për të mësuar sa më shumë tek Jusuf Gërvalla nuk do të bie e as do të zbehet kurrënjëherë. Përkundrazi, si gjatë fëmijërisë, si gjatë shkollimit, ashtu edhe më vonë, gjatë tërë jetës, ajo do të shtohet, siç shtohet etja e bimëve në verë. Dhe, ndoshta askund më shumë se tek ai nuk do të realizohet në praktikë porosia e Naim Frashërit: »Punë, runë, natë e ditë, që të shohim pakëz dritë«, porosi kjo që ishte moto e jetës së Jusuf Gërvallës.

I ngjeshur me trashigiminë materiale dhe shpirtërore të traditës sonë kombëtare, i pajisur me një kulturë të gjërë klasike dhe bashkëkohore, i mbështetur në vegjelinë që e lindi dhe që e rriti, në saje të shpirtit të tij krijues si dhe të vullnetit të tij titanik, Jusuf Gërvalla do të angazhohet në të gjitha fushat e jetës dhe do të luftojë vazhdimisht për triumfin e dritës mbi terrin, e lirisë mbi robërinë, e barazisë mbi pabarazinë, ideale këto të shenjta gjithënjerëzore. Fjala e tij e urtë do t'i këndellë, do t'i mbushë me guxim, me kurajo dhe me shpresë të gjithë bashkëbiseduesit dhe bashkëkohësit e tij, qoftë në shtëpi, goftë në rrugë, qoftë në punë e kudo që ai do të gjendet. Me shembullin e tij në jetë, me qëndrimin e tij ndaj fenomeneve, ndaj normave dhe ndaj moralit të shoqërisë, me shembullin e shpirtit të tij flijues, Jusuf Gërvalla do të ndikojë fuqimisht tek shokët dhe tek miqtë e tij të shumtë, të cilët nga ai do të mësojnë dhe do të inspirohen për vepra të mëdha e të dobishme që shkojnë në shërbim të popullit dhe të atdheut.

Në jetën dhe në veprën e Jusuf Gërvallës nuk gjendet asnjë shenjë që flet se ai punoi dhe luftoi për emër, për nam, për lavd. Jo. Të gjitha këto ai i kishte në jetën e tij, që heret dhe me bollëk, krejtësisht në saje të punës së vet të ndershme.

Edhe pse qendronte në majat e letërsisë, të gazetarisë, të muzikës dhe të kulturës përgjithësisht, ai nuk u luhat për asnjë çast nga mendjemadhësia, nuk u përgjum për asnjë çast nga mendjemadhësia, nuk u përgjum për asnjë moment nën kurorën e dafinave. Jusuf Gërvalla asnjëherë nuk u dobësua nga lajkat, asnjëherë nuk u mashtrua nga premtimet dhe asnjëherë nuk u frikësua nga kërcënimet që kishin për qëllim ta ndajnë nga populli dhe nga përpjekjet e tij shekullore për dritë dhe për liri. Përkundrazi. Jusuf Gërvalla jetoi me popullin dhe u rrit me të. Jusuf Gërvalla me vetëdije të plotë u përpoq, punoi pa pushim, luftoi dhe u vra pse diti të dëgjojë klithmën e popullit, gjëmën e Kosovës, zërin e Atdheut...

Thonë: personalitetet e shquara të dijes e të kulturës së një populli, figurat e shquara të historisë, i përgatitë koha, rrethanat shoqërore, ndërsa në skenën e historisë dalin vetëm atëherë kur për ta lind nevoja, vetëm atëherë kur i kërkon zëri i popullit të vet dhe zëri i tokës nënë.

Vetëdija e lartë e Jusuf Gërvallës, e shprehur me jetën dhe me veprën e tij, gatshmëria e tij për flijim, për të paguar tagër edhe për të tjerët, si dhe akti i lartë i vetëmohimit në mbylljen finale të jetës së tij, këtë burrë, këtë viga, këtë pirg të lartë, këtë lule të trimërisë, këtë kambanë të Kosovës, e bëjnë njërën nga figurat dhe personalitet më të shquara, më origjinale, më të dashura, më tragjike dhe më të dhimbshme të kulturës dhe të historisë sonë të lashtë dhe të re.

Jusuf Gërvalla jetoi pak, por e fitoi pavdekësinë.

Me rastin e një vjetorit të rënies heroike të dy të rinjve

Afrim Zhitisë (1965–1989) dhe Fahri Fazliut (1963–1989)

Vështirë por krenari është të shkruash për dëshmorët e rënë për liri. Vështirë se ata më nuk janë në mesin tonë, ndërsa krenari ngase kemi përse shkruajmë dhe përkujtojmë heroizmat dhe trimëritë e tyre.

Afrim Zhitia 1965–1989. Dëshmor.

Në varrezat e fshatit Llugë, (më 2 nëntor) bëhet një vit që kur pushon trupi i njërit prej bijve të Kosovës, dëshmorit Afrim Zhitisë.


Afrim Zhitia u lind më 16. 01. 1965 në fshatin Llugë të Podujevës. Rrjedh nga një familje patriotike, e cila qysh herët kishte ra në kundërshtim me politikën shtypëse të Beogradit. Gjyshin e tij Sylën, e kishin vrarë para shumë e shumë vitesh gjandarmëria serbe. I ati, Osmani shpeshëherë i fliste të birit, për të kaluarën historike të popullit tonë dhe për gjyshin e tij. Dhe kështu Afrimi i ri frymëzohej nga të parët e vet për patriotizëm. Si fëmijë mjaft i zgjuar që ishte, prindërit atë e regjistrojnë në shkollë që në moshën gjasht vjeqare. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesmën në Prishtinë.

Ngjarjet e mëdhe dhe historike të vitit 1981 atë e gjetën si nxënës të vitit të dytë të QAMO »19 Nëntori« në Prishtinë. Më 1 e 2 prill të vitit 81 demonstratat u përhapën në të katër anët e Kosovës. Në ballë të të gjitha

këtyre ishte edhe Afrimi, i cili tani më ishte i ushqyer me ide përparimtare. E mundonte fort në shpirt fati i pazgjidhur dhe padrejtësitë që i bëheshin popullit tonë. Viti 1981 ishte kthesë në jetën e Afrimit. Ai si edhe shumë të rinjë tjerë të cilët ishin te rinjë pa rini, vetës i vunë për detyrë të shenjtë për të luftuar deri në fund për çështjen tonë kombëtare.

Afrimi lexonte pa ndërperë klasikët tanë dhe literaturë botërore. Për moshatarët e tij ai, atë kohë u bë simbol i guximit. Ashtu si ishte i dashur dhe i afërt me të gjithë, ai i frymëzonte dhe ndezte zemrat e shqiptarëve për





ideale të larta. Kishte zotëruar sa s'ka më mirë gjuhën dhe historinë e popullit tonë. Si nxënës i vitit të tretë bëhet pjesëtar i organizatës ilegale FNÇK (Fronti Nacional Çlirimtar i Kosovës), ku mbas dy vitësh, në shkurtin e vitit 1984 së bashku me shokë të tjerë qe arrestuar, (Në shërbim ushtarak) dhe dënuar me tetë vite burg, të cilin dënim më vonë shkalla e dytë e zbret në katër vite. Burgun e mbajti në kampin famëkeq të Pozharevcit. Ai atje pati fatin të takohet me shumë shokë me përvojë më të madhe. Sadistët që e dërguan Afrimin e ri atje, mendonin se për një kohë të shkurtër do të mundin të shlyjnë dëshirën e tij për liri dhe demokraci. Por Afrimi burgun e shfrytëzonte si shkollë për të ardhmën. Ai me ëndja dëgjonte nga shokët të cilët i flisnin për jetën revolucionare të heroit të popullit QEMAL STAFËS. Ai lexoi poemën e QEMALIT me titull »Hijës së vëllait tim« dhe aty për aty në errësirën e një dhome të errët të burgut të Pozharevcit u betua se: DO TE ECË RRUGËS SE QEMAL STAFES!

Në shkurt të vitit 1988 Afrimi doli nga burgu, dhe më të drejtë konstatonte se: gjendja në Kosovë ishte më e vështirë se që kishte qenë disa vite më parë, dhe menjënerë u hodhë në radhët e organizuara të ilegales si pjesëtar i LPRK. Si krijues dhe analitik që ishte ai bëri studimin e librit të *B. Horvatit »Çështja e Kosovës«* – ku ky studim u bart dorë më dorë brenda vendit. Shkruante edhe për dy revistat që nxirrte organi i tyre redaktues në »RRUGËN E LIRISË« dhe »ZËRI I KOSOVËS« – ku dalloheshin shkrimet e tij si ai (në numrin tre, RRUGA E LIRISË) me titull »Manifestimi serbomadh me rastin e 600 vjetorit të betejës së Kosovës-është turpi i Jugosllavisë«, ai (në nr. 4) me titull »Shfuqizimi i ligjit për kolonistët – fuqizim i rikolonizimit« dhe artikulli tjetër me titull« Asnjë gram xehe – Asnjë kilovat rrymë pushtuesit«. Ai ishte kudo i pari. Udhëhoqi me protestat e nëntorit ku ishte mjaftë aktiv, si dhe në grevën gjenerale të shkurtit të punëtorisë dhe popullit. Në demonstratat e Pranverës, të marsit '89, në Prishtinë (njëra ndër demonstratat më të fuqishme kundër politikës aneksioniste të Beogradit). Afrim Zhitia mbanë një fjalim të zjarrtë para mase. Kosova atë pranverë edhe një herë u ujit me gjakun e dëshmorëve. Për dëshmorët e asaj pranvere Afrim Zhitia patë thënë: GJAKU I KËTYRE DESHMOREVE I UJITI LULET E KESAJ PRANVERE? KY GJAK DO TI USHQEJË ZEMRAT E SHQIPËTARËVE PËR RREZISTENCË EDHE MË TE MADHE NDAJ PUSHTUESIT – PRANDAJ POPULLI LË T'U NGRITË PERMENDORE!

Kështu tha Afrimi ndërsa pas vetëm gjashtë muajsh edhe vetë do të bie në fushën e nderit, e populli do t'i ngritë përmendorën pas një viti.

Në qershor të vitit 1989, Afrimin e thërasin në shërbim ushtarak, dhe duke mos mundur tu bëjë ballë provokimeve të agjentëve të sigurimit ushtarak, dhe se e pritnin shumë punë në Kosovë, kësaj radhe vendosi të ikë dhe u hodhë në ilegalitet. Afrim Zhitia gjatë kohës si veprimtar ilegal nuk bëntë më shumë se tri katër orë gjumë. Me rastin e gjykimit në Mitrovicë Afrim Zhitia me të drejtë konstatonte se tani ishte momenti më i përshtatshëm që populli të hidhet në demonstratë. Për këtë ai kishte hartuar tekstin e traktit të natës së 28 tetorit që u shpërnda në të katër anët e Kosovës. Më 30 tetor populli u ngrit në demonstratë ku nga të gjitha anët gjëmonte nga brohoritjet »Kosova Republike«! UDB-a ishte tërbuar se nuk

mundë t'i binte në gjurmë këtij militanti të shquar. Ato ditë nuk flinte e tërë Prishtina nga demonstratat e fuqishme. Ato ditë nuk flinte as Afrimi, por nuk flinin as spiunët. Më 2 nëntor Afrim Zhitia gjendet i rrethuar së bashku me shokun e tij *Fahri Fazliun,* në një podrum të një banese në lagjen »Kodra e Diellit«. Ishin të rrethuar nga një ushtri e tërë, e cila ishte e armatosur deri në dhëmbë dhe e pregatitur për të rrëzuar një qytet të tërë, por shovenistët nuk e dinin se »TERMETI LEKUND MALET POR JO SHQIPTARIN«! Në njërën anë ishin dy të rinj guximtarë, e në anën tjetër kordoni i vdekjës. Bëhej një luftë e pabarabartë. Ushtonte Maja e kodrës së diellit, ata nuk dorëzoheshin! Po atë ditë më 2 nëntor të vitit 1989 bie heorikisht në fushën e nderit Afrim Zhitia së bashku me shokun e tij Fahriun. Për heorizmin e tyre do të flitet në shekuj.

Me jetën dhe veprën e Afrim Zhitisë në të ardhmën do të mirret historia, do të merren poetët që do të shkruajnë poemën më të bukur, do të jetë vepra e këngëtarit, që ka me këndue këngën më të bukur; Së mbrami do të jetë tërë populli shqiptarë që do ta kujtojë emrin e këtij dëshmori të shquar të lëvizjes sonë kombëtare deri sa të shëndrisin rrezet e diellit. Si thotë simboli i rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaqi: edhe i vdekuri i shërben atdheut – sot Afrim Zhitia edhe për së vdekuri po i shërben atdheut!.

Afrim Zhitia me punën e vet ilegale me vetëmohimin e vet për lirinë e popullit të arratisur dhe syrgjynosur, doli nga errësira shekullore dhe hyri nën flamurin e lirisë, nëpërmjet RRUGES SE LIRISE dhe ZERIT TE KOSOVES duke pasur në zemër synime të larta. Afrim Zhitia ecte krahas me kohën dhe me vizionin e ndritshëm të ardhmërisë. Ai ishte shembull i një gjenerate që kaloi nëpër burgje, burgje të cilat Afrimin e kalitën. Flaka e madhe e lirisë Afrimin e përfshiu që nga lindja dhe ai kësaj lufte të shenjtë ia fali edhe atomin e fundit të jetës së tij.

LAVDI!

Yll i Pashuar i lirise

Fahri Fazliu 1963–1989

Fahri Fazliu (FATMIRI) – u lind më 24. 02. 1963 në fshatin Llaushë të Podujevës, rjedh nga një familje punëtore dhe patriotike. I ati i tij Rrahmani me profesion minator, njihej në tërë territorin e Llapit për shpirtin e tijër patriotik dhe mikëpritës. Për Fahriun oda tradicionale fshatare ishte shkollë e madhe. Fahriu me ëndje dëgjonte rrëfimet e më të vjetërve për të kaluarën e hidhur të popullit shqipëtar nën sundimin e mbretërisë së vjetër serbe. Interesohej sidomos të dëgjonte për stergjyshin e tij të cilin ushtria shoveniste serbe e kishte vrarë në vitin 1918 dhe nga heorizmat e pashoq të të parëve, Fahriu frymëzohej dhe mendonte për idealin e lirisë.

Shkollën fillore Fahriu e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesmën në QEAPT »M. Popoviq« në Prishtinë. Në shkollë Fahriu ishte i dashur nga të gjithë. Ai u shpjegonte shokëve se gjendja e popullit shqiptar nën sundimin serb ishte bërë e padurushme dhe se është e nevojshme që në mënyrë të ndryshme të demaskohet politika shtypëse e qeverisë së Beogradit dhe shërbëtorëve të tyre në Kosovë.

Në pranverën e vitit 1981 fryma liridashëse ndihej dukshëm edhe në shkollën ku Fahriu vijonte mësimin. Atë frymë të ndjeshme në një masë e kishte sjellur edhe Fahriu, duke u shpjeguar shokëve domosdoshmërinë që edhe ata, nxënësit tu bashkangjitën studenëve në kërkesat e tyre të drejta dhe të ligjshme për KOSOVEN REPUBLIKË. Kjo frymë u ndje sidomos më fuqishëm pas demonstratave të 26 marsit të po atij viti. Në saje të kontributit të Fahriut e tërë shkolla »M. Popoviq« iu bashkangjit lumit të madhë të studentëve. Po ashtu të nesërmen më 2 prill ato vazduan me të njëjtin intensitet (Ku aty në mes të Fakultetit Teknik dhe atij Juridik qenë vrarë dy nxënësit e QEAPT »m. Popoviq«, dëshmorët *Naser Hajrizi* dhe *Asllan Pireva* ku gjithnjë në ballë të tyre ishte Fahriu. Fahri Fazliun e thërrasin ushtarë në vitin 1981 në Banja Llukë, ku falë vigjilencës së tij shpëton nga provokimet e eprorëve shovenist, të cilët ashtu të uritur për të mbytë shqiptarë kishin vendusur ta likuidonin edhe Fahriun (si shumë të tjerë). Mbas kryrjes së shërbimit ushtarak Fahriu regjistron Fakultetin e Ndërtimtarisë. Mbasi punësohet në OPZ »Prishtina« detyrohet t'i lë studimet. Aty ndezte zemrat e shqiptarëve për ideale të larta. Pushtuesit e kishin halë në sy. Fahriu ishte aktiv sidomos gjate grevave të Shkurtit dhe demonstratave të marsit të vitit 1989. Mbas aprovimit të »Kushtetutës së tankeve«, më 23 mars, Fahriu me tërë qeniën e tij prej patrioti u vu në shërbim të popullit. Ai gjendej kudo. Ishte në mesin e popullit dhe i fliste për domosdoshmërinë që të shtohet edhe më rrezistenca paqësore ndaj politikës ekspansioniste të Beogradit. Ai ishte si era. Sa gjendej në Podujevë, sa në Prishtinë, sa në Obiliq sa në Lipjan, ishte i shkathët në organizimin e punëve praktike (strehimin e atyre që ndiqeshin nga UDB-a).

1 nëntor 1989. Dita e tretë e demonstrative të tetor- nëntorit. Atë natë edhe Fahriu iu bashkua lumit të madh të popullit, që kishte vërshuar Prishtinën nga të gjitha anët, Rrugët dhe sheshet e Prishtinës ishin fare të vogla për të zënë atë masë të madhe të demonstruesve. Po atë natë UDB-a kishte përcjellur Fahriun dhe te stacioni hekurudhor i Prishtinës, kishin tentuar ta arrestojnë, por ai si vigjilent dhe i shkathet që ishte, kishte shpëtuar nga kthetrat e tyre. Por spiunët kishin përcjellur Fahriun dhe kështu të nesërmen gjendet i rrethuar nga forca të mëdha të policisë së bashku me të riun Afrim Zhitinë. Barrikadohen në një podrum, ne lagjen »Bregu i Diellit.« Forcat e mëdha ushtarako-policore shtinin pa ndërprerë në drejtim të tyre. Kordoni i vdekjës hapte zjarrë në drejtim të dy martirëve të lirisë të cilët më 2 nëntor kishin veshur xhamadanin e trimërisë. Edhe pse sadistët thirrnin Fahriun të dorëzohet, ai kishte vendosur të vdesë për lirinë e Kosovës.

Më 2 nëntor të vitit 1989 (Kur ishte afër diplomimit në Shkollëne Lartë të komunikacionit në Zagreb) Fahri Fazliu bie heorikisht së bashku me Afrim Zhitinë.

LAVDI!

Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu ishin kalitur në betejat demokratike. Ata i mbante të fortë ideali i lartë në luftë për Repulikën e Kosovës. Këta dy martirë të kombit tonë edhe sot janë kudo me ne, janë në zemrat tona, në frymëzimet tona në Kosovën tonë. Dhe sa herë të vijë nëntori, mbi

varret e tyre do të qëndrojnë lulekuqet e Kosovës, të ujitura me gjak të popullit tonë, që u derdhë nëpër shekuj për lirinë, që patjetër do të vie.

Fatmir Brajshori

Hunda »atdhetare«

Nonda Bulka

Si gjithë bota, mbolla dhe unë një pemë javën e drurit.[1] Dhe e vadita me gjak, ndonëse në këtë stinë të lagët s'ka nevojë as për ujë. Dhe ja me pak fjalë historia e gjakut që vaditi pemën.

Tek po rrëmoja tokën, ngrita kazmën më tepër nga ç'duhej dhe e përpoqa në hundë. Hunda qau, dhe lotët që derdhi ishin prej gjaku.

Dikush pranë meje tha:

– Re viktimë e detyrës!

Të flasim shqip, rashë vërtet viktimë e detyrës. U plagosa në luftë e sipër. Nuk dua të them se lufta që bëra i përqrgjigjet luftës së vërtetë. Nuk kam pretencionin që gruas sime t'i lidhet pension, meqë burri i saj luftoi me kazmë dhe u plagos në hundë. As që besoj se brezi i ardhmë do të më quanë veteran të vjetër, pse një ditë nëntori shtrembërova hundën në detyrë e sipër. Megjithatë, ka mjaft njerëz që dikur u ka shpuar ndonjë gjemb gishtin e vogël të dorës së mëngjër dhe e kanë shpallur veten veteranë, viktimë të atdhetarizmës.

Sikur të dal dhe unë nesër pasnesër dhe të bertas: »Kam plagosur hundën për atdhe; jam atdhetar; nëmni kulltuk dhe para«! atëhere ç'bëhet?

Ç'bëhet sikur gjithë bota që vrasin hundën dıten e drurıt, te shıten si viktima të detyrës, d.m.th. të dashurisë ndaj Atdheut?

Ka mënyra që ta nderosh atdhenë; një mënyrë e keqe është ajo që t'i kërkosh shpërblim kur nuk e meriton.

Ka shqiptarë që janë vrarë e prerë për Shqipërinë; ka që s'kanë bërë asgjë, veçse kanë vrarë (si unë) majën e hundës javën e drurit; ka nga të parët që nuk nderohen aq sa duhet me anën e pensioneve që u ka lidhur shteti. Nuk do të ish më mirë të veprohesh »en sens inverse«.[2]

GAzeta e Korçës, 1. X. 1933.

[1] Në shkolla ish zakon java e drurit.
[2] (Fr.) në drejtim të kundërt.

Testament za Petrita

Ali Podrimja

In prišel je dan otrok moj
ko boš besede: Mati Oče Domovina Svoboda
pisal s strahom
ko boš vse začel od začetka

In oprosti mi otrok moj
če ne bom ohranil hladno kri
če me ne boš videl nasmejanega
če ne bomo imeli kruh sol in svetlobo
če se bo tvoje otroštvo grozotno streslo
po temnih ulicah

Divji časi trkajo nad našimi grbastimi strehami
Oprosti mi otrok moj
če te ne bom mogel spremlati
do praga
če bo kak dum-dum metek
priletel proti tebi
in tanki razmetavali tvoje igrače

Glej dan prepoln s potresi otrok moj
kdaj se boš naučil da je človek lepa žival
in povej mi kdaj bom
tvojo usodo narisal v nebo.

prevod: Abedin Maliqi

Moda

Neriman Kamberi

Kisha lidhur një shall
Si Ibrahim Rugova
Të mos ma shihni
Fytin e enjtur
Nga bërtimat
Të mos i shihni
Gjurmët e lëna
Nga kafshimet
E gjarpinjve gjakpirës
Dhe vijat e kuqe
Të dy duarve
Që deshnin të më furnin
Kisha lidhur nje shall
Me ngjyra folklorike – etnike
E cila i përshtatet
Fytyrës sime engjëllore
Te një pseudo-intelekualje
Plot trauma

GËRSHËRËT

Dikur
Preja fotografitë
Nga revista të shumta
Bëhesha frizere
Flokë kukullash
Preja

Sot
Shumëkund prehën flokë
Të njerëzëve kukulla
E mua
M'i prenë fjalët
M'i shkurtuan shkrimët

E thyen atë maje-pene timen
Një ditë gjuhën a thua do ta kem
Për kokën asgjë s'thëm.

TRILLIM

Nuk është e vërtet
Se i kam këputur trëndafilat
Në kopshtin tuaj
Ngjyra e tyre nuk më pëlqente
dhe kishin gjemba shumë
më pëlqejnë më shumë lulkuqet
e arave me grurë
janë të egra
jo si trëndafilat tuaj
tekanjoze
nuk është e vërtet se më ka zënë gjumi
në një karrige kashte
duke lexuar një libër dashurie
nuk i dua romanet sentimentale
e pra?
më mirë është të më zërë gjumi
ne një karrige kashte
dhe t'i lë të tjerët të zgjuar
sesa të gozhdohem në një kolltuk lëkure
dhe të mos leviz

MBRETËRIA IME

Oborri im
Nuk është oborr mbretëror
francez
austro-hungarez
aty nuk ec Katarina e Madhe
me fustan të gjatë kadifeje
në oborrin tim ka lula ka pula
e unë shëtis
në freskinë e mëngjesit
me pizhama të bardha

Shenime per autoren:

Neriman KAMBERI është lindur në Preshevë me 1965. U rrit me prindërit kurbetçarë në Namyr të Belgjikës ku edhe mbaroi mësimet në fillore dhe shkollë të mesme. U kthye te burimi me dy libra të botuar në sqetull. Ajo si katërmbëdhjetë vjeqare (senzacion për Evropën!) botoi

romanin e saj të parë për fëmijë: »Anjesa dhe doktor Simoni« i cili bëri bujë të madhe jo vetëm në Belgjikë. Pastaj botoi edhe romanin e dytë »Anjesa dhe shtatë pikturat«, kurse këto poezi janë marr nga dorëshkrimi që sëshpejti e boton »Rilindja« me titull »Farinerkat e grisura blu«. Neriman Kamberi eshtë studente e vitit të IV të Fakultetit Juridik dhe vitit të III të Gjuhës Frenge. Merret me publicistikë. Në poezi është shumë sensibile, vargu i saj edhe pse ndonjëherë na duket i rebeluar, është si një puhizë e lehtë në artin letrar. Kjo është çapkënia e letrave shqipe...

H. M.

Kaçaku dhe nëna e tij.

Maro Pashaj

Kur të mos dëgjosh më, nënë,
Krismat e dyfekut tim,
mos kujto, se më kanë zënë,
po freskohem në burim.

Kur të mos dëgjosh më, nënë,
krismat e dyfekut tim,
mos kujto se unë kam rënë,
po mbledh shpatit trëndelinë.

Maleve ka gërxhe shumë,
mbushur janë me turkoshakë,
unë e mali s'kemi gjumë,
që të dy jemi kaçakë.

Dëgjon nëna, luftë e rreptë
Eshtë dyfek 'ldjalit tim,
do të sjell nëna fishekë,
ndize qiellin vetëtimë.

Po gjithë shtigjet i kanë zënë,
Ku ta gjej rrugën tek ti,
e dëgjon, biro, nënën?
Lidhur m'kanë e s'mund të vij.

Atëherë nëna zë thëret,
sa gjithë mali po buçet:
»Hiqja sumbullat jelekut

dhe vurja plumba dyfekut,
bir o bir i nënëso,
trim i nënëso«!

NATË PRANVERE

Natë pranvere përmbi male,
zgjuar janë stanarë e stane.

Bien zile e këmborë,
cepi i hënës pjatë me borë.

Cepi syrit s'mbyllet dot
pik' e vesës një pikë lot.

Trëndelina vargje – vargje,
si të flihet kësaj nate?

O moj, lule trëndeline,
s'i dëgjon këmbor' e zile?

Ato s'janë këmbor' zile,
po është vet zemra ime.

NË DET

Valët e detit
vijnë si kuaj,
jelebardhë,
jelelëshuar,
shkumbëzojnë edhe përplasen
përmbi bregun e latuar.
Si fëmijë i hap krahët,
t'u ndal vrapin e harbuar,
po ç'e do, se dallg'e tyre
më rrëmben në kraharor...

Edhe unë kaluar mbi kuaj,
si mbi ëndërrat fëmijërore,
kapur jelesh zë e luaj
hapësirash kaltërore . . .

TRIPTIK

Shteri lotët, o ti motr'e Gjergjit,
se u kalbën nëntë trarët e shtëpisë,
gjak pikojnë nëntë plagët e vëllajt . . .
Pret balozi në fushën e mejdanit,
pret balozi fshehur prapa gardhit,
po nuk jepet motr' e Gjergj Elez Alisë . . .

Gjogu mbathur tek probatini, rend . . .

Rend e trimen Norë gjen në Kelmend.
Pret balozi në çadrën e pashajt,
trokon gjogu maleve të Kelmendit,
zbraz një yll nga qielli i mërzisë,
ndrit një thikë fshehur brenda gjirit,
derdhet gjaku i pashës i zi, pisë . . .

Hingëllin, trokon gjogu kohëve . . .

Maro Kondën e gjen në bregdet:
»Arnautkë, hyri xheneti je,
na trego burimin, se u thamë . . .«
Poshtë humera nxin e ulërin,
lidhur me litarë dyzet balogë,
prapa Maros, deti i përpin . . .

DETI NDRIN . . .

Deti ndrin si shpinë peshku,
me njëmijë reflekse ngjyre,
o ti, det, më mbajte rob,
që nga lindja e nëpër vite.

Nis të shkruaj e më del ti,
më hedh kripë e më hedh jod,
më mbulon me shkumë të bardhë

dhe nga ty s'u ndakam dot

Herë m'i mbyt vargjet fare,
je i madh e ke furtunë,
po në mes atyre dallgësh,
do të mbetem edhe unë!

GU-GU-GU

Gu-gu-guu, ç'bën ashtu,
kë thërret me gu-gu-gu?

Qindra vjet që thërret,
degë më degë e fletë më fletë.

Kërkon degën më të lartë,
kërkon qiellin më të qartë.

Ç'dhimbje thellë të mundon,
shpirtin copë ta dërmon?

Mos je nënë e thërret djalin,
ndaj më shpesh shikon malin?

Mos je motër, do vëllanë,
që pas shpine keq ta vranë?

Mos je vajz'e dashuruar,
A i ikur e mërguar?

Gu-gu-gu – ja shekullore
njëmijë dhëmbje njerëzore.

Vlorë, 1990

Asnjëherë

Asnjëherë nuk kam qenë
    në Prizren

Elida Buçpapaj

Nga qyteti ku jetoj
    Prizrenin e kam më pranë
    se Sarandën
Nga Gjalica është
    sikurse nga Valbona-Gjakova
    sikurse nga Valbona-Dragobia
Unë edhe në Valbonë
    kam qenë
        edhe në Gjalicë,
            Dragobi.
Ndërsa në Gjakovë,
    në Prizren,
        asnjëherë nuk kam qenë
Por kam beben time, një djalkë
        7 muajsh
që emrin e ka Prizren.
Tani ai ende nuk flet,
    vetëm guget, balbet,
bën gu-gu, ba-ba, blë, gë, klë-
Por natyrisht nesër-
        Ai nesër për të parën gjë
        do të më pyes për Prizrenin-
dhe unë . . .
do t'i flas për rrugët e Prizrenit
asnjëherë pa qenë aty
sikurse për shtëpinë e Ymer Prizrenit,
            tespiet e tij,
për fëmijët, Pagurushën, zambakët e bardhë,
            bunarët-
Do t'i flas
    pa pra,
        me mall

sikurse të kem jetuar gjatë atje.
Pastaj
Prizreni i vogël
do më thotë:
Eja të shkojmë në Prizren
Më ço në Prizren
Po unë . . .
unë si do t'ia bëj?!

SHEVQET SAHIT CANHASI u lind në Gjakovë më 11 shkurt 1940. Shkollën fillore dhe Gjimnazin e Lartë Shqiptar i kreu në vendlindje. Rrënimi ekonomik që iu bë familjes së tij në luftërat ballkanike e botërore e detyroi të bënte jetën e vështirë të shegertit dhe të argatit. Gjatë studimeve në Fakultetin Filozofik të Prishtinës punoi gazetar në Radio-Prishtinë dhe arsimtar në Gjakovë e mandej lektor në Entin e Teksteve.

Pas diplomimi në Degën e gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare në Fakultetin Filozofik të Prishtinës u emërua redaktor përgjegjës dhe kryeredaktor i Buletinit »Libri shkollor« në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore.

Më 1968 qe zgjedhur pedagog i historisë së letërsisë shqiptare në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, ndërsa më 1976 e tutje ishte profesor i gjuhës së sotme shqipe (i sintaksës) në Shkollën e Lartë Pedagjike të Prishtinës, ndërsa më 1976 e tutje ishte profesor i gjuhës së sotme shqipe (i sintaksës) në Shkollën e lartë pedagjike »Bajram Curri« të Gjakovës. Pas kërkesës që shtroi për njohjen e shqiptarëve komb i barabartë me të tjerët në Jugosllavi dhe të Kosovës Republikë e pavarur në gjiun e saj, në praninë e përfaësuesit të KEF dhe të Këshillit të profesorëve, u përjashtua nga LKJ dhe detyra e profesorit të SHLP. Pas shumë pengimesh, bastisjesh, persekutimesh e burgosjes më 1981–1983, i kreu studimet postdiplomike dhe më 1986 magjistroi në histori me temën »Sulejman Vokshi«, ndërsa më 1989 mbrojti tezën e doktoratës »Haxhi Zeka (1832–1902), Kontributi tij në Lëvizjen Komëtare Shqiptare« dhe mori gradën e doktorit të shkencave historike.

Me shkrime u mor që nga viti 1954, kur botoi vjershën e parë në »Pionieri«. Bashkë me Ali Podrimjen e shokë të tjerë formoi Grupin Letrar të Gjakovës në lokalet e gjimnazit, ku patën ftuar të lexojnë punimete tyre edhe Adem Demaçin, Agim Gjakovën e studentë të tjerë nga Beogradi, gjimnazistët e pejës Enver Hadrin, Ekrem Kryeziun etj. Shkroi tregime, poema, drama e romane. Në »Rilindja«, »Jeta e re«, »Fjala«, »Jehona«, »Zëri i rinisë«, »Shkëndija« etj. botoi më të rrallë ndonjë prej tyre, si fragmente të romaneve »Nata në zemër« e »Në altarin e lirisë« dhe fejtonet historike për Asim Vokshin, Xhemal Kadën, Ali Kelmendin, Hajdar Dushin etj. Dramën që shkroi qysh sa ishte gjimnazist ia pranuan në konkursin e BKA të Kosovës më 1964 me titullin »Fitorja është jona«, e cila u shfaq

në disa teatra amatore. Gjatë bastisjeve iu mcrër dorëshkrimet e shumë punimeve e veprave. Me 1972–74 memzi arriti të botonte romanin »Një grimcë jete« (Shkup 1974), librat e leximit për kl. IV, V e VI në Entin e Teksteve të Kosovë me titujt: »Shtegu i dritës« e »Ditët e bardha« (koautor) dhe »Një tufë lulesh«. Më 1990 në botimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës »Konferenca shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit« pau dritën, pas dymbëdhjetë vjetësh pritjeje, punimi i tij »Sulejman Vokshi në poezinë dhe traditën popullore shqiptare«.

Me emrin tënd qëndroja, kosovë

Shevqet S. Canhasi


Në cilindo nga burgjet, ku m'fërfllluan larot:
në Gjurakoc, Prishtinë, në Pejë a n'Gjakovë,
me gjakun Tënd zemrën e kisha plot
dhe me emrin Tënd qëndroja, Kosovë!

Në myk bodrumesh, të cfilitur,
kur n'terr më mbanin lidhur
në tokën plot lagështi,
mendja te Ti me vrap më ikte
se atë, së paku, e kisha n'liri.

Në flamosjet e netve,
kur tinza më vinte
shtriga reumë me ftohtësi,
në mishin tim shafran
ngulte dhëmbët e mprehtë
dhe m'hafshonte eshtrat
prore e pangopshme, si lubi.

Me emrin Tënd qëndroja, Kosovë,
se për mua Ti më e shtrenjta ishe,
po edhe Ti n'ankth i kërkoje djemtë dhe vajzat tua,
që prapa grilash, ndër bodrume i kishe.

Aty gjallë e t'fortë më mbanit
Ti dhe Besa (ah, kujtim i vagëlluar!),
isha zog stuhie e ju krah më jepnit
në bindje i patundur për të qëndruar.



Kurrë për jetë s'do ta harroj atë natë,
kur vonë dhe i lodhur aty e bëra gjumin,
pas kuvendimesh për këtë grimcë atdhe,
për ditët e bardha, lulet, fushën e lumin.

Nata e kaluar në një shtrat vajzërie,
me Hënën n'dritare seç m'u duk krejt e re,
i përkundur plot ëndrra nanurie,
fjeta e mendjes s'munda t'i vëj fre.

Kahdo që sytë nëpër atë dhomë lëshova,
ngrohtësinë Tënde në çdo skutë e gjeta,
sa herë na rrah zemra, aty merr frymë Kosova
dhe për ne pa Të, pikë kuptimi s'ka jeta.

ESAT PASHË TOPTANI

I mjeri ti, i mjeri,
O Esat pashë Toptani,
ku u trete?
Gjyq të rëndë historia t'bëri
e ti n'plehun e saj mbete.

Vetë fajin e pate
pse natën e deshte
përherë në Shqipëri,
me milet të fjetur
të mbretërojë pa bezdi.
Nata sterrë emrin
me errësirë ta veshi
e i bardhë mbet veç qefini.
Turpin tënd s'do ta lajnë kurrë
Erzeni as Shkumbini.

Nën qiellin që ia terrove,
në Atdheun e cunguar,
shqiptarin që e tradhtove,
u ngrit ngadalë kaluar,
u ngrit nën qiellin gri,
me grykëhollën n'dorë,
ai mileti që përbuze ti.

Me të huaj dhe e more,
ti i Babë-Dovletit gjeneral,
për të huajt gjithëherë punove,
tokën tënde e shkele,
medet e bëre me hall!
Gjuhë e gjak harrove
pa hak, pa u dhënë derman,
në dhe të huaj ç'u trete,
humbe pa nishan.
Oi! Me temena i pranoje
peshqeshet dhe gradat
e të ziut sulltan!

Mbi krye Gjysmë-Hënën
e doje kurorë,
të të bënte pak dritë
mbi Mëmën e gjorë.
Po ajo s'ishte e sëmurë,
e kishe sakatosur ti,djali i prapë plangprishës,
që jashtë bëje krushqi.

Të treti Gjysmë-Hëna,
t'verboi ai Kryq i Zi,
o si s'tu dhimbt Nëna,
që të mbajti n'gji?!
Ti po i hapje varrin
tinza, o babëzi,
ia nxirrje jashtë kamjen,
bobo! në fshehtësi!

Harbutërit që përbuze,
me ankth që i kujtoje
tani të përmendin
me një thartim goje.
– Shikoni, u thonë breznive,
mallkimi i gjakut si të tretë,
përbuzja e tokës-Mëmë,
damkë e turpit për jetë!

Harbutërit që i dogje
e i shkele pa mëshirë,
kujtojnë Libohovën,
Avni trimin zemërdhirë.
E këndojnë të vjetrën,
thurin një këngë të re,
i nderojnë patllaken,
që të shtriu për dhe.

Medet, natën si e dëshirove
përherë ta keshë në Shqipëri,
miletin të përgjumur,
harbutërit në kllapi.
Me kamxhik në dorë,
si bagëtinë, t'i çoje,
merak kishe çiflligun
me ta ta lëroja...

Çelësin e Kalasë së Shkodrës,
të derës së shtëpisë,
dhuratë ti ia dhe krajlit,
o pjellë e djallëzisë!

Si ta bajti zemra,
Nënë-Rozafën pse e dhunove?
Me atë thikë tradhtie
më zemër ç'e qëllove!

S'të fali, jo toka-Mëmë,
por polli n'Libohovë
trimin përmbi shokë,
Avniun me nam,
që n'Paris të shtriu
gojëhapur për tokë.

Ah, si e durove katilin,
o truall i komunarëve?!
Nxirre përjashta horin,
oj tokë e proletarëve!

Ndonëse nga re të përgjakura
tokës arbërore Dielli po i buzëqesh,
kah e sheh drejt shtigjeve të reja
kulshedrën e mesjetës si e qëllon e zhvesh.

Shih me ç'guxim i bëri hapat e parë
mileti yt i dikurshëm,
tani djalë vigan,
me grushtin shtrënguar e muskujt çelik,
shkëmb i patundur n'tufan,
këngë e gdhendur në granit!

Ëndrrën që ka parë –
krahëhaptën Liri,
me bashkimin në prag
zgjëndërr do ta bëjë
në dritën pa kufi.

TE VARRET E MARTIRËVE

Gjumin si të mos e bëni t'qetë
ju bijtë dhe bija te Lokes
n'tokën tuaj stërgjyshore
kryelartë ne qëndrojmë pranë jush
e bjeshkëve madhështore

gënjeshtra e mashtrime
me neveri i pështyet
për ju ishin veç besa dhe e vërteta
ju mirëfilli e ditët ku nis
po kurrë s'pyetët ku soset jeta

varret tuaja si djepa për t'ardhmen
mbesin nëpër brezat e kësaj toke
këtu do t'pushojnë kujtimet tona
dhe ndër betime ndonjë motër a loke

për ju pikëllimi vërshoi tokën
e qielli lotoi në netët e vona
as ne kurrë s'do ta ulim kokën
se tash dielli ndriçon shtigjet tona

ne s'ju përcollëm me heshtje
as me lot plakash vajtimtare
por me grushtin shtrënguar
iu betuam Kosovës krenare

me dy gishta lart ngritur
zogj t'shqiponjës dykrenore
si brirë capi n'përkrenare t'Skënderbeut
nga fitorja në fitore

»Ich bin weit fort von denen die reden wie ich«
Gedichte

Martin Camaj

Vetmija ka thithë erën e bjeshkës
dhe fije bari as fletë nuk lòt.

GJAKMARRJA

Të mnershëm janë korbat e zez
në pushim mbi qarrat e vjetër

Mendja e njeriut nën hije shestòn
udhë gjaku
e sosjen e pagjës në mal e vrrî.

BLUTRACHE

Die Einsamkeit hat den Wind des Hochlandes aufgesogen
und es rührt sich kein Grashalm kein Blatt.

Schrecklich sind die schwarzen Raben
still über den alten Eichen
auf der Spitze des Berges in der Mittaggsglut.

Das Hirn des Menschen tief im Schatten ersinnt
Blutbahnen
und das Ende des Friedens landauf landab.

LARG ATYNE QË FLASIN SI UNË

Fishkllim ere ndër shelqe të ngime
me ujna prrojesh-
veshroi. te zanafillja, truemje
se si i falen dreqit shpirt e korp,
be të forta
mbi gurë, qiell e dhé.

Jam larg atyne që flasin si unë
sa hana që bie prej rrezje në rreze
e pi qumësht n'vedra lanun jashtë
për me vu mazë.

Hutini i shkambit n'agim
dhe guri n'ujë përpijnë tingullin
e kuvendit të keq: n'agim
njeriu bekon diellin si unë!

WEIT FORT VON IHNEN

Wiz Zischen des Windes zwischen den Weiden
die satt sind vom Wasser der Bäche
höre ich, vor Zeiten, Verwünscungen
wie sie dem Teufel Leib und Seele vermachen
schauerliche schwüre
beim Stein, Himmel und der Erde.

Ich bin weit fort von denen die reden wie ich
so weit wie der Mond der von Strahl zu Strahl Fällt
und aus Steintrëgen Milch trinkt
die draußen steht.

Der Steinkauz im Morgengrauen
und der Stein im Wasser schluckt den Klang
der Verdammung: im Morgengrauen
segnet der Mensch die Sonne wie ich!

DITË SHIU NË MERTURIN E GURIT

Bariu krah-thatë te ura e zjarmit lodhet
ndërmend
për dhitë damatare përjashta:

në gotën e çveshun drite grigeh syzit
e hardhiave nën gurë e unurë.

Dhe tret ndër andrra të përhime:
mbi rrasat e gurit në Mertur
plasin sytë e sqepve grimë-grimë
nën dhambët e ujqve,
kokrra groshe e drithi në palaré.

Gjeli këndoi në tra
e u zgjuen prej gacash ndër unë
pendlat – bletë e gretha bashkë:
mija zane plasën në trutë e bariut.
Dhe u çue krejt dheu në kambë
me lata e topra edhe armë të vjetra
e u lëshuen ndër ujq.

Mejti shiu në Merturin e Gurit
dhe dielli u ndejt në perëndim
me rreze të lodhuna
në mishin e ujqve mbi dhambët e majeve
ortarë-kortarë.

REGENTAG IN MERTUR

Der arme Teufel von Hirt an der Feuerstelle grübelt sich müde
er denkt
an das Unheil der Ziegen draußen:
im trüben Glas erstarren die Knospen
der Weinstöcke gewetzt wie Stahl am Feuerstein.

Und er verliert sich in aschgrauen Träumen:
auf den Steinplatten in Mertur
brechen die Augen der Ziegenböcke in tausend Scherben
unter den Zähnen der Wölfe
weiße Bohnen und Mais in der Kupferpfanne.

Der Hahn krähte auf dem Balken
und die Federn
von glühenden Kohlen und Scheiten
wachgerüttelt – Bienen und Hornissen! Und

abertausend Klänge barsten im Hirn des Hirten.
Und alle Leute sprangen auf
mit Äxten und Beilen und alten Waffen
und stürzten sich auf die Wölfe.

Kein Regen mehr in Mertur
und die Sonne sank
mit matten Strahlen
auf das Fleisch der Wölfe über den Zacken der Berge
in Fetzen zerstückt
Scheibe um Scheibe.

Këngë lirie

Xhevahir Spahiu

Toka-qëngj i therur,
nën kthetrat e tankeve përpëlitet.
Ditët drithma dheu,
netët thikë pas shpine.

Pyet bari: ç'do të thotë jetë?
Pyet i vrari: Hyj a dal në Mesjetë?
Si lumenj të turbullt
nga zemërimi flasin përçart
poetët.

Plumbin ua vodhën,
me plumb i goditën,
gotat delirante kryeqyteteve ngritën.
Po foshnja i mbytur në gjak.
po plaku i këputur në prag
edhe të vdekur
shpallin shpagë e fjalë zgjimi:
Bashkim-vëllazërimi-perdekrimi.

Po këngët,
këngët a do të zgjohen pa pranga?
A do t'ia shkulë jeta me dorën e vet
atë thikë të ngulur mbi shpinë?

Kosova është në muajin e nëntë
dhe do të pjellë lirinë.

Dhe flej po munde

Adem Istrefi

Bëje veshin shurdh e asgjë mos dëgjo,
bëje syrin qorr e mos shih,
asgjë mos kujto ç'ka ngjarë në këtë nënqiell,
si e kanë rrëmihur tokën tanket,
e si i kanë pështyrë me plumba gjinjtë e
grave milicët
dhe harroji ata të mjerë buzë – e vesh – e
hundëprerë,
asgjë mos fol dhe mos shih asgjë,
mos shih as në ëndërr fëmijë të therur në fyt,
as fëmijë... dhe vetëm shtatë mijë, oj nënë të
helmuar
në këtë ditë-natë barbarish e të mbrapshtë,
prandaj mbyll sytë e flej, po munde
zgjohu po munde, në daç vdis prej frike
në këtë ditë-natë të harbuar ballkanike,
në këtë tollovi ethesh çmenduri,
në këto mrizime mërish, murgjëri-bizanteri,
kur varrmihësi bërtet – po ta shtroj sofrën
e dasmës,
kur vajatorja të shan të gjallë e të vdekur,
kur hajni ngashërehet në vaj se ia vodhën
këpucët
e vjedhura
në tokën e zbritur nga qielli me litarë
e nga vetë zoti të premtuar
dhe dhunuesi vetë dhunën mallkon
dhe gjakësor-vrasësi vetë të vrarët fajëson,
fajëson vetveten tirani pse u bë demokrat,
e me kaq tepri të tjerëve ua dha lirinë,
lirinë e të drejtën për ta mbajtur në fyt litarin,
e vetëm nyjën pakëz për ta shtrënguar – tirani

(shih sa pak kërkohet – sa pak mirënjohje!)
sa pak therori për gjumë të amshuar
u dashka të kesh për paqën tënde
e ti, Kosovë, s'dashke të dëgjosh!!!.
Apo si i thonë asaj: Hyp se të vrava, zbrit se
të vrava?

Memento Kosovare

Vlora Jonuzi

Duke ruajtur dikë nga dikush lëshuan gazin që sjell
lot.
Duke bërë drekë griu qepë e lotët i rodhën prapë.
Në mbrëmje shikoi lajmet në TV dhe lotoi kur fëmi-
jën e pa të vrarë nga policët.
Të nesërmen derdhi lot gëzimi që erdhi liria.
Tërë jeta i shkoi – në lot.

Ylli i ri

Fazli Greiçevci

Dikund, në harrnat e horizontit-
rrinë i zhytun në pellgun e vetmis
nji yll i ri qe pa pra
gjemonë...
gjemonë...

Se,
drita qe dikurë
me gjuhën e zjarrtë lëpinte shpresat...
u tretë deshprueshëm
nën hijen e krahëve të natës verbët.

Në barkun e errët... mundohet me i qelë,
dritarët e zemërgjansis me çelsat e kohës,
qe në hapsinën e pakufishme të dëshirave
ndoshta...
ndoshta...

ndizet ndoj yll dëbues i errsines verbuese,
tue ndriçue thellsin e shpirtit mistikë
e përpara hapat flakërohen
në shigjetat e rrezeve bleroshe-
mbrapa gjurmat e mykuna
le ti përbijë terri i shekujve dërmues.

E nesërmja e eqtueme në vapën përvluese
le të pret pa meni-
si vjollcat e njoma që presin
stinën e buzëqeshun,
Se,
Po ndizen . . .
Po ndizen . . .
me mija Yj te Rijë-
me vrull të kangëve tue përtrijë . . .

DIKUR

Kulçedra e tmerrshme me shpata t'përgjakuna
nga muskujt e fuqishëm u nda,
Diellin ndër këto male kush s'e pa-
qelesha e përbuzun kur u la n'djersë t'mykuna.

DJE

Edhe kanga u shafit n'përleshjen
e rrakatun t'stuhive t'kobit vërrshuem-
qenjet e stërmundueme notuen,
n'liqejt e gjakut t'vllaznive t'shkurmuem . . .

SOT

Parzmat shkrepin, si rreze radiumi-
n'jehona t'agueme t'dëshirave shigjetuese,
gjoksi i maleve kreshnike buzëqesh e kunorizon
dufin e kërthijve që po lindin, si hana ndriquese
në trollin e zemráve tona, ku kalli i art po gufon.

NESER

Me deshprim dërmues t'mallit shtangues
do tua tregojë prrallën e bishave të tërbueme,
lindjeve t'ardhshme që do të vallzojnë
nën ritmin e joneve të kohës . . .

Sarajevë, 1960

FLAKË DASHNIJE

Mos paça kangë ma të dashtun se Ty . . .
Jetë e jetnave nëpër brezni e kohna
Te filizat je ba flakë realiteti e sy
E mrekullueshme, e stolisun me cohna . . .

Mos paça kurr dashni tjetër
Përveç lulishtës sate
Me të idealizue me vargje n'letër
Nëpër brigje e shpate . . .

Mos paça çaste lumnije
Jetën nëse e kursej për Ty . . .
Rrugën e kemi legjendë trimnije
E besën n'zemër ndry . . .

Mbetësha pa sy, duar, kambë e veshë
Tradhëtarin në çmofsha . . .
Plumbat e urrejtjes kam me ia reshë,
As n'mirësi, mos i buzëqeshësha! . . .

Kushdo që n'mashtrim, trollin shikon
Mallkue i qoftë dheu nën kambë,
Me lajka jeta kujt i perëndon-
Ardhëmenisë i lenë mësim e damkë . . .

18. 12. 1963
Dobroshevc-Drenicë

NJERIU

Njeriu asht shigjetë helmuese,
Krahnorin e jetës që etjerrë,
Njeriu asht flakë piklluese-
Kangë e vaje n'furtuna tjerrë . . .

Njeriu asht dhe gëzim ndër troje-
Kallin e gëzimit n'dashni mbështjellë,
Njeriu a dhe, thnegël ndër hoje-
Brenga e vuetje në krahnor e mbiellë . . .

Njeriu pra, asht mrekulli e natyrës
Me gjak t'idhtë, e t'ambel ndër dej,
O, njeriu a je malli n'vargoj t'urës
Që pasmën e shpresës e gjen nëpër dej . . .

18. 2. 1962
Prishtinë

Poezitë i zgjodhi:
Blerim GREIÇEVCI

FLUTUR ILIRE

Stërkalat e baticës së gjakut
s'të janë lot
për lot t'i marrin

Për vathët e çndukur ilir
Hënë eDiell t'i vejë
Flokët e shprishura
në bystek Shote t'i lidh

Në zemër Okarina e Artë
rapsodinë e fitores ta këndon

Kosovë
Flutur ilire
Gravurë ilire

Afrim DEMIRI

Xhuzepe Skiro' Di Maxhio

. . . 38

Përpoqa këtu një vajzë spixaniote
që mburrej për rrënjët e saj

përpara meje që ushqhesha
me fjalët që i dilnin nga goja.
E i thamë së bashku arbërisht
shprehjet e zakonshme
se gjaku nuk bëhet ujë
se gjaku ynë është i shprishur
se jemi gjithë të një gjaku!
Por unë dëshiroja të flisja
për buzët e saj arbëreshe
për sytë e saj arbëresh
për shtatin e saj të hijshëm arbëresh
për ecjen e saj arbëreshe
për mendjen për ëndrrat për dëshirat
për gjithçka që kish arbëreshe e jo vetëm
për gjakun tonë të përbashkët
që edhe nga afër
na mban njeri-tjerës larg!

Incontrai qui una giovane spezzanese
che vantava le sue radici
davanti a me che mi nutrivo
delle parole della sua bocca.
E insieme le dicammo in albanese
le solite espressioni
che il sangue non si fa acqua
che il sangue nostro è disperso
che siamo tutti di uno stesso sangue!
Ma io volevo parlare
delle sue labbra arbëreshe
dei suoi occhi arbëreshë
del suo fascino arbëresh
del suo incedere arbëresh
dei pensieri dei sogni dei desideri
di tutto quel che di arbëresh aveva e non solo
del nostro identico sangue
che anche da vicino
ci tiene lontani l'uno dall'altra!

Ngalibri: »Metaforë«

Nga zenitet e poezisë moderne evropiane

Nga se është bërë ai

Erih Frid

Vdekja ime është bërë prej monedhave
dhe prej kartëmonedhave

Vdekja ime është bërë nga rrugët
në shkollë dhe në punë

Vdekja ime është bërë nga një orë e ndalur
dhe nga detyrat

Vdekja ime është bërë nga gazetat
dhe milicët

nga cigaret dhe rakitë
nga sheqeri, buka dhe gjalpi

nga dashuria nga fati dhe nga fatkeqësia
nga zemërimi dhe durimi

Vdekja ime është bërë nga prindërit e mi
dhe nga fëmijët e mi

nga dështimet e mia
dhe nga sukseset e mia

nga skllavëria ime
dhe nga liria ime

nga shoqëria ime
dhe nga vetmia ime

nga mosbesim im
dhe nga besimi im

nga shpresa ime
dhe nga zhgënjimi

nga të menduarit tim
dhe nga harresa ime

Vdekja ime është bërë nga gjinia ime
dhe nga zemra ime

Vdekja ime është bërë nga netët e mia
dhe nga ditët e mia

Vdekja ime është bërë nga zgjuarjet e mia
dhe nga fjetjet e mia

Nga jeta ime
dhe nga jeta juaj dhe vdekja

MBI LIRINË E BRENDSHME

U përkula
për t'i puthur
çizmen e shëndritshme të zezë
zotëriut tonë
atëherë ai tha:
Më poshtë!

Kur u përkula edhe më
ndjeja në mua
madhërishëm
kundërshtimin
e shtyllës së kurrizit
që nuk donte të jetë e shtrembëruar

I gëzuar u hoqa zvarrë
mirënjohës ndaj zotëriut tonë
për këtë përjetim
në brendinë time
dinjitet
dhe fuqi

PËRSHTATJA

Dje fillova
të mësoj të flasë

Sot po mësoj heshtjen
nesër do të lë
mësimin

KËRKESË PËR TË HARRUAR

»Sikur të donin përfundimisht t'i harrojnë pretendimet e tyre të vjetra!«
Argument cionist

Mos u bëj i marrë
thot era
Bota sillet mëtej
Çdo gjë ndryshon
Të qenmen duhet harruar

Sikur të kishe mundur të harroje arën tënde
thot korrja e helmuar
dhe sikur të kishe mundur të harroje shtëpinë tënde të
bardhë
thot gërmadha
dhe sikur të kishe mundur ta harroje shtambën e madhe
thojnë copat e thyera
dhe sikur të kishe mundur ta harroje ullirin
thot cungu
dhe pemët e portokajve
thot korija e djegur

dhe sikur të kishe mundur t'i harroje dy motrat e tua
thot rruga që shpien te varret
dhe sikur të kishe mundur t'i harroje klithmat
thojnë veshët
atëherë do të kishe mundur të pushosh ta hedhish veten
në rrezik
pastaj mund të shkosh larg
si hurma në barkun e anijes
pastaj do të kishe mundur të jesh i lirë si një kokërr-
rëre
përfundimisht i lirë prej atdheut
që ti e ke humbur

Bota sillet më tej
Të qenmen duhet harruar patjetër
Mos u bëj i marrë
thot era
që fryen prej dëbuesve tu

DËGJO IZRAEL

Kur qemë të ndjekur
unë isha njëri prej jush
Si mund të mbetem i tillë
kur ju bëheni ndjekës?

Malli juaj ishte
të bëheni si popujt tjerë
që ju ju vranë
Tani jeni bërë si ata

Ju i keni mbijetuar
ata që qenë të egër ndaj jush
Vallë jetoni egërsinë e tyre
në ju akoma

Të rrahurit i keni urdhëruar:
»Zbathi kpëucët«
Si cjap të shushave i keni
dëbuar në shkretëtirë

Në xhaminë e madhe të vdekjes
sandalet e të cilëve janë rërë
po ata mëkatet nuk i pranuan
që ju deshët t'ia vini

Gjurma e këmbëve të zbathura
në rërën e shkretëtirës
do të qëndrojë më shumë se gjurmët
e bombave tuaja dhe tankeve

Ç 'ËSHTË JETA?

Jeta
është ngrohtësia

e ujit në banjën time

Jeta
është goja ime
në gjirin tënd të hapur

Jeta
është zemërimi
kundër padrejtësisë në vendet tona

Ngrohtësia e ujit
nuk mjafton
Unë duhet edhe të llokoçitem branda

Goja ime në gjirin tënd
nuk mjafton
Unë duhet edhe ta puthi

Zemërimi kundër padrejtësisë
nuk mjafton
Ne duhet atë edhe ta shqyrtojmë

dhe diçka
duhet bërë kundër kësaj
Kjo është jeta

NË KRYEQYTET

»Kush sundon këtu?«
pyeta unë
Ata thanë:
»Populli natyrisht«

Unë thash:
»Natyrisht populli
por kush
sundon përnjëmend?«

UDHËZIM PËR TË RUAJTUR FUQINË GODITËSE

shumë armiq, shumë nder!

Armiqtë
janë shumë larg të larguar
dhe shpesh
shumë mirë të siguruar

prandaj bëni miqtë
armiq
dhe goditi
në turi

Kështu i bën ata
me plot sukses
kundërshtarë
dhe mund të mburresh:

Unë isha i pari:
ai që u ngrit
dhe goditi
në luftë kundër tyre

I FSHEHURI

Unë duhet të mësoj të fshihem
prej ndjekësve
dhe kështu gjendem
në rrezik të dyfisht

Ndoshta ende jo mjaft mirë
i fshehur prej tyre
dhe ndoshta tanimë shumë mirë
i fshehur prej vetvetës

GATI GJITHÇKA

Kohën e të mësuarit e kam
pas meje
Mësova të dëgjojë dhe të shoh:
Gati gjithë njerëzit vepruan
gati gjithë njerëzve
gati gjithëçka
Dhe gati gjithë njerëzit
që gjithçka u ishte bërë

thanë
me zë gati të shterrur
»Do të vijë dita
Dita kur ne gati të gjithëve
gati gjithçka do t'ju bëjmë
çka ata na kanë bërë neve«
I dëgjova këtë vet duke e thënë
gati fjalëpërfjalë
Dhe derisa kjo
gati gjithëçka të jetë çka duan ata
apo gati gjithëçka
ç'dijnë nga ajo se ç'duan ata
kjo ditë
për të cilën gati të gjithë ëndërrojnë
përsëri vetëm gati do të vijë
kurrë krejt përnjëmend
Vërtetë
këtë e kam mësuar
dhe dua gati të them
aq mësuar
sa të dëgjuarit dhe të pamurit më ka lënë
Tani kohën time të të mësuarit e kam
gati pas meje

PËR NJOFTIM

A është demokraci
aty ku nuk guxon të thuhet
se ajo nuk
është demokraci e vërtetë
vërtetë një
demokraci e vërtetë

Marrë nga libri »Një qind poezi pa atdhe«. Me këtë përmbledhje ERIH FRID fitoi çmimin e »Botuesit Ndërkombtar« me 1 maj 1977. Poezitë e tija dokumentare, politike me plot ironi kanë vënë themele të reja poezisë së këtij lloji në përgijthësi. Përshkak të citateve të falsifikuara u denoncua në gazetat konservative dhe erdhi deri te eliminimi i poezive të tij nga librat shkollorë, prej ministrit të kulturës në Bavari, e gjithë kjo, përshkak të poezisë »Dëgjo Izrael«: Në poezinë »Liria për të hapur gojën«,

thot: »Nuk guxon kjo të shikohet njëanshëm, se liria për të hapur gojën është e drejtë e barabartë për të gjithë, për shembull edhe për autoritet«.

ERIH FRID u lind më 1921 në Vien; iku në Angli më 1938 pas pushtimit të Austrisë. Prej vitit 1946 shkrimtar i lirë. Përveç poezisë mirrej edhe me shkrimin e romaneve, dramës si dhe me përkthime. Përktheu nga anglishtja, hebraishtja dhe greqishtja, në mes të tjerash: Shekspirin, Dilanin, T. S. Eliotin etj.

nga gjermanishtja: Naser Aliu
Gjermani

Adem Demaçit

Agim Doçi

-kangë-
Thashë t'ia nisi sot nji kange
Po nuk di nga t'ia filloj.
Se nga malli digjen zemrat
Fjalët çdo zemre ja kerkoj!

Bjen sharkia e don t'plasi
Se çdo trim është pushkë-lirie
Po qai burrë Adem Demaçi
Qenka mal me palcë-Shqipnie!

. . . Katër mure, katër mbetën
30 vjet s'të qitën fàre
Për liri e për t'vërtetën
Bane qiell nji dritare.

Ti që mbete shkamb ndër male
E s'u sose 30 vjet.
Për Kosoven LIRINË fale!
E LIRINË lé amanet!

Morre formën e Flamurit
Yll i rrallë përmbi Shqipojë
Syrin prush e zemrën burrit
Te thotë bir nana Kosovë.


Kushtuar
Adem
Demaçit
14/4
90

Ban gajret Adem Demaçi!
Se për ne do jeshë pishtarë
Pasha besën s'mund t'a vrasi
Askërkush Kosovën mbarë!

Se nuk shterret ujët e Drinit
Nuk rrashohet Çiçavica!
Kosovari sapo t'lindi
Thotë: – Unë jam Azem Galica!

Kur i thanë kosovarit: – çohu burr a kap sharkinë!
M'ia kallzo botës dhe krajlit, qysh m'a ke ti historinë.
Kosovari hapi zemren e i buroj nji det me gjak.
I numroi emën për emën ato trima qe s'janë pak!

Kush e ka fjalën rrufe? Kush m'a fort hallet ti kjam?
Profesori Rexhep Qosja. Mal me mend e djalë Plevian!

Kush kall jetën për liri? Kush ma fort e don Kosovën?
Kush kërkon DMOKRACI?! Kush s'e njeh Ibrahim Rugovën.

Kush i del hasmit përballë se ja jep forcën LIRIA
Kush i thotë Kosovës Nanë? Ai asht baca Zekeria!

Kujt s'ju drodh nji herë qerpiku? 30 vjet burgu s'e plasi?
Asht USHTARI I LIRISË – Kosovari Adem Demaçi!!

Por nuk del as natë e gjatë, nuk mjafton as muaji as viti
Me i pru trimat nepër kangë, që Kosova-Nanë i rriti!

Dialogu '90

Guri Sylaj

POLICI: Kurt-Shkurt
NIKAD
DJALOSHI: Jo fort gjatë-fort ngat'

POLICI: Kosovë-Metohi
OVO JE SRBIJA

DJALOSHI: O burrë-Kurrë
SERBI
dhe pikë
KOSOVË PO-
REPUBLIKË!

Rab 1990

Fjala e kryetarit të ShKSh »Migjeni« të Lubjanës në Bazel

Gani Buçinca, kryetar i ri i ShKSh »Migjeni«.

Kam nderin të ju përshendes në emër të Shoqatës Kulturore Shqiptare »Migjeni« të Lubjanës, të cilën të gjithë shqiptarët kudo që janë e ngritën në këmbë dhe e mbajnë gjallë si një organizëm të fuqishëm të çështjës sonë kombëtare e kulturore.

Ju na ftuat, e ne erdhëm në këtë tubim tuaj, që dhimbjen krenare dhe shqetësimin ta ndajmë sëbashku në këto kohëra të stuhishme dhe çaste vendimtare për kombin tonë. Ne ishim shoqatë kulturore por rrethanat na detyruan që të inkuadrohemi në Lëvizjen gjithkombëtare për Liri, Barazi dhe Demokraci, intenca këto, universale të njerëzimit. Ne sot krenohemi që ishim ndër të parët që drejtpërsedrejti iu kundërvumë politikës antis-hqiptare të qarqeve serbosllave si dhe tradhëtarëve të kombit të cilët ishin vënë në shërbim të kësaj politike. Kurse ju, me letrat dhe thirrjet e juaja, thuaja të pandërprera, na nxitnit dhe na jepnit kurajo për punë edhe më me ngulm që njëherë e përgjithmonë t'i themi totalitarizmit serbosllav Jo, gjithashtu t'i themi cenzurës dhe autocenzurës Jo, sepse shqiptarët Evropa i njeh si liridashës dhe paqëdashës, megjithëse ajo me diplomacinë dhe strategjinë e vet politike e krijoi problemin shqiptar të cilin patjetër duhet ta zgjidhë drejt, me mjete politike, nëse don të jetë e qetë! Pas Luftës së Dytë Botërore dhe ndarjës gjeopolitike të Evropës dhe Ballkanit, shqiptarët pësuan keq, por sot shqiptarët janë vetëdijësuar dhe kanë dalur në skenen politike ndërkombetëtare si subjekt i fortë politik e civilizues duke e fituar kredibilitetin e nevojshëm për një veprim diplomatik për zgjidhen e çështjës së tyre. Shqiptarëve, qarqet nacionalsocialiste dhe çetniko- militariste ua imponojnë luftën qe dhjetë vjet, për qëllime të caktuara, por shqiptarët sot e dijnë se gjatë historië së vet kanë luftuar dhe derdhur gjak mjaft edhepse ata nuk i frikësohen luftës, duke qenë të vetëdijshëm se kurrë nuk kanë qenë më të fortë, por durimi shqiptar sot është në interes të paqes dhe sigurisë në Evropë, në kohën kur Luftat e ftohta në mes të superfuqive përfunduan pas bashkimit të dy Gjermanive.

Gjermanët arritën të bashkohen me urti dhe mençuri; të njejtën rrugë po e ndjekim edhe ne shqiptarët sot, mirëpo çështja e shqiptarëve, në këto rrethana mendojmë se do trajtim shkencor, gjakftohtësi dhe mirëkuptim të të gjitha palëve të interesuara. Për këtë qëllim, Sh. K. Sh. »Migjeni« do të organizojë sesion shkencor në temën *çështja nacionale shqiptare në Ballkan dhe Evropë,* si çështje integrale e jo parciale. Në sesionin që do ta organizojmë, do të ftojmë të gjitha Akademitë e Shkencave të Republikave Jugosllave, Akademinë e Shkencave të Republikës Popullore të Shqipërisë, atë të Rumanisë, Bullgarisë, Greqisë, dhe Italisë e njëkohësisht do të ftojmë vëzhgues nga Federata e Helsinkut për të Drejtat e Njeriut, pastaj Amnesti International, Parlamentin Evropian, Kongresin Amerikan etj., sepse Evropa po pëson ndryshime gjeopolitike, e në këto ndryshime duhet të zgjedhim çështjen tonë, kuptohet në mënyrë demokratike. Duke u mbështetur në të dhënat shkencore të këtij sesioni ne shqiptarët do ta hartojmë programin nacional, në platformën e të cilit besojmë, se do të angazhohen të gjitha Partitë Politike Shqiptare, Lëvizjet dhe Komitetet, asociacione e individë, kudo që veprojnë ata. Prandaj, ndonëse jemi vonuar rreth kësaj çështjeje, prap se prap me angazhimin e ne të gjithëve do t'ia dalim të organizojmë këtë tubim të domosdoshëm shkencor në Sllovenínë demokratike.

Për këtë qëllim, bashkombës të nderuar, ju ftojmë që të angazhoheni me ndihma dhe sygjerime si dhe pjesmarrje aktive në të, që ky të sëndertohet në të mirë të qenies sonë gjithkombëtare.

»Migjeni« jemi ne të gjithë. Atdheu mbi të gjitha, po e përsëris *atdheu mbi të gjitha, fitorja është e jona!*

Mirëupafshim në Trojet tona të lira e demokratike!

Bazel, 13. 10. 1990

Apel mladinskega parlamenta Kosova mednarodnem javnem mnjenju

Kosovo hoče v Evropo

Julij 1990 – Srbija je 5. julija uvedla »OBSEDNO STANJE«. Razpustila je Kosovski Parlament, vlado, radio in televizijo Priština pa je dobesedno okupirala policija. Tretjič v zadnjih devetih letih so se na Kosovu razglasile »izredne razmere«. V teh devetih letih je bilo ubitih več kot 100 Albancev, ranjenih najmanj 500, obsojenih na dolgoletne zapore kazni pa več kot 10000 ljudi. Najmanj 400 Albancev je bilo v »izolaciji« (zapor brez sodnega procesa, brez pravice do odvetnika), v policijski obdelavi (zasliševanja organov državne varnosti, posebni dosijei) pa celo 600000 Albancev. Vse te ukrepe je na Kosovu izvajala jugoslovenska in srbska država v borbi proti zahtevam absolutne večine albanskega prebivalstva, ki ima na Kosovu več kot 90 odstotni delež v celokupnem prebivalstvu pokrajine (na Kosovu živi okoli 1,8 milijona Albancev).

In kakšne so te zahteve, postavljene na legalen način (preko institucij, torej nenasilno, brez uporabe kakršnih koli sredstev zastraševanja)?

Kosovci zahtevajo svobodne volitve, večstrankarski parlament, državljanske in nacionalne pravice, kakršne uživajo vsi Evropejci. Toda na Kosovu še vlada komunistični režim (nobeno gibanje, ki nasprotuje ali kritizira sedanjo oblast ni dovoljeno), še živi komunistično nasilje, komunistični teror. Albanci zahtevajo politični pluralizem, pravno državo (vladavino prava) civilno družbo, dobivajo pa pluralizem policijskih metod nasilja, državo zatiranja in apartheida (za srbe na Kosovu obstojajo posebne šole, avtobusi, rudniki in tovarne) in družbo, v kateri policija in vojska uvaja »red in mir«. Albanci pa kaznujejo s po 60 dnevi zapora samo zato, ker so nekje dvignili dva prsta v znak zmage. Kosovo je danas območje teme, komunističnega brezumja in državnega terorja, kakršnega v zadnjem desetletju na evropskih tleh ni bilo. Proti tej temi Albanci prižigajo sveče in dvigujejo dva prsta v upanju, da Evropa ne bo dopustila da se na njenem območju tako drastično teptajo državljanske in nacionalne pravice.

Zadnji ukrepi srpsko-jugoslovenske države so Albancem odvzeli pravico da na legalen institucionalen način – preko svojega parlamenta, svoje vlade in svojih javnih občil – povedo kaj mislijo o razmerah na Kosovu.

Očitno je Srbija pripravljena na vojno s Albanci, na pacifikacijo Kosova. Očitno pa je tudi da okoli tri milijone Albancev, kolikor jih živi v Jugoslaviji, ne želi vojne, ne želi novih grobov, krvi, solz, smrti in tragedije v pokrajini.

Kosovska tragedija kaj hitro lahko preraste v nov spor evropskih razsežnosti, v spor, ki bo razbil na drobne koščke vsa prizadevanja, da v Evropi zaživi trajen mir, popuščanje napetosti in toleranca.

Zaradi tega mi, predstavniki Parlamenta mladih Kosova (del kosovske alternative, ki šteje več kot 130000 članov) s tem dopisom opozarjamo evropsko javnost, da na tem prostoru obstaja nevarnost izbruha vojne.

MI ŽELIMO MIR, TOLERANCO, RAZUMEVANJE, POPUŠČANJE NAPETOSTI, V EVROPI HOČEMO BITI POLITIČNO, PRAVNO, DUHOVNO IN MATERIALNO IN NE LE GEOGRAFSKO.

MENIMO, DA IMAMO PRAVICO ZAHTEVATI, DA SE EVROPA ZAVZEMA ZA TO, DA NA KOSOVU ZAVLADA MIR, POLITIČNI PLURALIZEM IN PRAVNA DRŽAVA. BREZ MIRU NA KOSOVU NE MORE BITI MIRU V EVROPI.

PARLAMENT MLADIH KOSOVA

Priština, 12 julija 1990

Kosovo pod obsedenim stanjem

Halil Matoshi

Zlorabljeno potrpljenje

MESČANSKA NEUBOGLJIVOST, NENASILNO NESODELOVANJE Z OKUPATORJEM IN MIROLJUBNI ODPOR ALBANCEV PREPLETEN V ENO, BI REKLI, BIBLIJSKO POTRPEŽLJIVOST, SE NESRAMNO ZLORABLJA PREDVSEM S STRANI SRBSKE POLICIJE, HKRATI PA SE IGNORIRA S STRANI ZVEZNIH ORGANOV JUGOSLAVIJE, KI KLJUB VOJNOPOSPEŠEVALNIM GROŽNJAM V SRBSKIH KROGIH, NE PREVZEMA POD ZAŠČITO ALBANCE, NAKAR JIH OBVEZUJE ŠE VELJAVNA USTAVA IN MEDNA-

SKUPŠČINA
REPUBLIKE SLOVENIJE

PREDSEDNIK

Ljubljana, 9.7.1990

KUD Migjeni in
DKZ Kosova
Parmova 43
61000 Ljubljana

Zahvaljujem se Vam za poslane čestitke ob razglasitvi Deklaracije o suverenosti države Republike Slovenije.

dr France Bučar

RODNE KONVENCIJE, KATERE JE TUDI SAMA PODPISALA... VSE DEMOKRATSKE SILE V JUGOSLAVIJI, EVROPI IN SVETU, VSE HUMANITARNE IN DRUGE ASOCIACIJE, KO ZAHTEVAJO POTRPLJENJE OD ALBANCEV IN OHRANITEV MIRU V RAJONU, MORAJO PODVZETI KONKRETNE MERE ZA PREPREČITEV BRUTALNEGA NASILJA, VSAKDANJIH ZLODEL IN GENOCIDA, KI JIH VOJAŠKO-POLICIJSKE SRBSKE SILE UVAJAJO NA KOSOVU.

Kosovo je pod divjim in jeklenim obsedenim stanjem s strani srbsko vojaško-policijske oblasti. Kosovo se dan in noč tepta in zlorablja s strani črnega okupatorskega škornja, ranjava in zatira se mali človek. Zastruplja in celo ubija se s streli – ta albanski človek, v sredini evropskega ozemlja. Biblijska strpnost Albancev je začudila tuje opazovalce, novinarje in tudi ameriške kongresmene in senatorje. To je enostranska vojna, toda vojna.

Evropa je v vojnem stanju! Res je, da v Evropi ni frontalne vojne, v kateri se srečata dve vojski, *zaradi česar so žrtve civili.* Na Kosovu je prisoten srbski militarizem, ki predstavlja arsenal oborožitve in pripravljenost policijskega kanibalizma. (ki na Kosovu igra vlogo tipične srbske nacionalne vojske) Bes in skrajno sovraštvo naspram mirnosti in potrpežljivosti, premišljenosti in modrosti Albancev, ki nadaljujejo s pozivi po ohranitvi osnovnih meščanskih vrednot, ker se zavedajo, da bi eventualna vojna v teh prostorih uničila te vrednote.

EVROPA JE V VOJNI – Sprehajanje *Voda smrti* po Kosovu, vdiranje v hiše meščanov sredi noči brez dovoljenja, brutalni pretepi in ropi, obkrožitev vasi in streljanje v množico z ognjenim orožjem, zapiranje brez razloga (če je sama prisotnost albanskega bitja vzrok, kar tudi je), v spremstvu z vrsto drugih glasnih tendenc za pacifikacijo in kolonizacijo Kosova, kot dolgi seznami zapiranja, izolacije in celo fizične likvidacije, ki jih sestavlja »Božur« v sodelovanju z »Jedinstvom« in državnimi varnostnimi inšpektorji; Ali Evropa ni dovolj obveščena, da vsaka kosovska noč lahko poraja novo katastrofo, nov masaker, ki ga ni doživel niti Čile s Pinochetom, niti Južna Afrika v času Pietra Botha. Čeprav v času diktatorske teme v teh dveh delih sveta, pa tudi drugje, v *Noči oblasti* sta bila Evropa in svet zelo prisotna in njune reakcije so bile številčne. Kosovo pa je v *Noči oblasti*, v *diktatorski temi*, mračna zona iz katere niti prvi niti zadnji S.O.S. ne pride do Evrope! Evropa se nahaja v vojni in se tega niti ne zaveda. Kako bo jutri imenovala masaker nad nezaščitenim albanskim narodom evropska diplomacija ali pa vesten evropski meščan.

EVROPA JE V VOJNI – Srbske oblasti so spravile ekonomsko bazo Kosova skoraj na kolena. Nasilni administrativni ukrepi v vitalnih gospodarskih točkah kot odpuščanje z dela ok. 15000 Albancev, vodijo k temu, da Albance spravijo ob skorjo kruha, da bi s tem povzročili takšne pogoje, kjer ne bi pomagala nikakršna politika. Z vsemi sredstvi skuša policija preprečiti solidarnost ljudi, ki pomagajo lačnim. Zaplenjujejo kamione z hrano, ki jih meščani na dobrovoljni osnovi (in obveznost meščana) pošiljajo na Kosovo.

Začelo se je ropati, ne le tovarniških dobičkov, strojev, temveč tudi ropanje kosovskih bank.

Paketi z hrano in oblačili, ki jih pošiljajo humanitarne in cerkvene organizacije, prištinska PTT služba, ki je tudi okupirana, vrača s podnapisom: *NE PRIMAMO!* Ni pomoči za »separatiste« in tiste, ki se podrejajo ukazom kosovkse Alternative! pravijo srbski ministri. Takšno usodo je doživelo tudi število paketov, ki jih je poslala znana mednarodna organizacija rdečega križa s sedežem v Zagrebu. Poslani paketi se vračajo nazaj, a tej organizaciji ne preostane nič drugega kot da poravna povratne poštne stroške! Kaj pa jutri? ali se Evropa zaveda, da se bodo tudi njej vrnile vse pošilke, ki jih bo eventualno namenila Kosovu? To se lahko zgodi tudi svetovnemu Rdečemu križu, kar se ni zgodilo niti z Etiopijo! Torej, Evropa ni pripravljena na vojno, medtem ko se vojna že odvija v njenem geografskem prostoru!

EVROPA JE V VOJNI – Dokler trajajo zapiranje velikega števila predstavnikov evropskih humanitarnih asociacij in njihovo zadrževanje na policiji za t. im. »informativne razgovore«, cele ure, kot se je to zgodilo številnim zdravnikom, ki so se zadrževali na Kosovu v času masovnih zastrupitev, zdravnikov društva »Zdravniki sveta«, znani mednarodni delavki za človeške pravice in svobode odvetnici angleškega rodu, ki živi in dela v ZDA, g. Evo Brandley, katero so zvezni inspektorji tudi užalili z najbolj prostaškimi kletvicami kot je »Drolja« (Kurba), hkrati pa so ji prepovedali bivanje in vstop v Jugoslavijo za tri leta, gospod Ante Markovič se še vedno drži evropskega koncepta »njegove« države. Isto se je zgodilo tudi z kongresmenom g. Gosef dioGuardi-jem kateremu je prepovedan vstop v Jugoslavijo za tri leta. VIšek vseh sramot pa je dosegla policijska država te dneve z aretacijo gospe *CHRISTINE VON KOHL*, članice delegacije mednarodne helsinške federacije (IHF), direktorice za JV Evropo s sedežem na Dunaju. Kaj bi se moralo še zgoditi reprezentativnim meščanom Evrope, da bi resno jemali takšno stanje, ko žandarji, ki ubijajo mirne meščane kateri so slučajno (tokrat) Albanci, jutri pa so lahko Nemci, Francozi ali pa Angleži, torej žandarji lahko ubijajo mar ne, vsakega, ne da bi poravnali račune za svoja zlodela.

Torej, Evropa je v vojni! Kako se bo zaščitila?

Potrpljenje Albancev se – ali noče razumeti ali pa se ga zelo zlorablja... Evropa bi morala biti bolj prisotna na Kosovu! Ljudstvo treba zaščititi!

Ljubljana, 7. 9. 1990
Prevod: Abedin MALIQI

Me rastin e DITËS SË TË VDEKURVE, Festës Shtetërore të Republikës së Slovenisë, ne qytetarët shqiptar, përfaqesues të

– SHKSH »MIGJENI«
– LD e Kosovës/dega në Lubjanë
– Partia Parlamentare e Kosovës
– PPD-me seli ne Tetovë/dega në Lubjanë

do t'i përkujtojmë të vdekurit më të dashurit tuaj. Qytetarët slloven, me kurora, karanfila te kuq dhe çirinj të ndezur, por me këtë rast i përkujtojmë edhe bashkombësit tanë të rënë nga dhuna politike-ushtarake e policore, që nga viti 1945 e deri ne ditën e sotme.

Të vdekurit le të kenë dheun e lehtë! Të flejnë të qetë në tokën e demokracisë, ndërkaq të gjallët ta kenë të freskët kujtimin për ta. Zoti qoftë me ta!

Me këtë rast, perfaqësuesit e SHKSH »MIGJENI« të Lubjanës, të LDK – dega e Lubjanës, të PPK dhe PPD – dega e Lubjanës leshojnë këtë komunikatë për opinion:

I propozojmë Kuvendit të Kosovës që të marr vendime për realizimin e këtyre kërkesave:

1. Të rehabilitohen të gjitha viktimat e dhunës politike policore, nga radhët e popullit shqiptarë në Jugosllavi, kështu qe sëpaku të vdekur të pushojnë të qetë.

2. Perkrahim propozimin e Parlamentit te Rinisë së Kosovës- Partia parlamentare e Kosovës, dhe i propozojmë Kuvendit të Kosovës që dita e 5 shkurtit të shpallet festë komotare e Kosovës – DITA E TË VDEKURVE!

3. Të rehabilitohen të gjithë qytetarët shqiptarë të vrarë nga organet e ndjekjes së Jugosllavisë e të varrosur në nerëndim dhe të mundësohet kthimi i eshtrave të tyre në vend lindje.

4. Rehabilitimin dhe riatdhesimin e të gjithë të ndjekurve politik shqiptarë të Jugosllavisë.

Nga presidenca e RSFJ – së dhe qeveria e saj kërkojmë:

– Lirimin dhe rehabilitimin e mënjëhershëm e të pakusht të te gjithë të burgosurve politikë shqiptarë të Jugosllavisë, të cilët nuk kanë përdorur dhe proklamuar mjete të dhunës në realizimin e qëllimeve politike.


– Lirimi i pakusht e të mënjëhershëm e të gjithë të burgosurve politik të Jugosllavisë, pa marr parasyshë përkatesinë e tyre nacionale dhe konfesionale.

– Nga Qeveria e RPS të Shqiperisë, kërkojmë dhe apelojmë:

– Amnesti të përgjithëshme e të mënjëhereshme dhe rehabilitim të të gjithë të burgosurve politikë të Shqipërisë.

– Kërkojmë që të ju mundësohet kthimi dhe riatdhesimi i të gjithë qytetarëve shqiptarë – të ndjekurve politikë të cilët nuk kanë përdorur apo proklamuar mjete të dhunës për relizimin e kërkesave politike.

– Ne, qytetarët shqiptarë të Jugosllavisë me vite të tëra e ndjejmë në kurriz peshën e dhunës politike-policore të shtetit dhe partisë bolshevike, e ndjejmë në qenien tonë peshën e rëndë të burgjeve, izolimeve, dënimeve drakonike,pa gjykimepatë drejtë mbrojtjeje; e dimë ç'është skèterra e çelive



të Goli Otokut, Lepogllavës, Stara Gradishkës, Nishit, Idrizovës, Lubjanës, Beogradit, Mitrovicës etj., prandaj kemi të drejtë morale që të kërkojmë lirimin dhe rehabilitimin e të gjithë të burgosurve politikë në Jugosllavi dhe më gjerë, prandaj edhe në Shqipëri, pa marr parasyshë qëllimet e tyre politike, përkatesinë nacionale e fetare. Konsiderojmë se pushteti i demokracisë parlamentare nuk mund të vendoset përderisa të jetë në burg, qoftë edhe vetëm një i burgosur politikë.

Në Ditën e të Vdekurve, ne, qytetarët shqiptarë do të vendosim kurora lulesh dhe qirinjë të ndezur në varrezat e qytetit të Lubjanës,

ndërkaq në Shtëpinë e Çankarit, për nderë të viktimave të dhunës politike ta shikojmë bashkërishtë versionin origjinal të filmit »Njeriu prej dheu« të regjisorit kosovarë Agim Sopi, si dhe do të organizojmë tryezë të rrumbullakët në temën: »Shqiptarët dhe dhuna komuniste«.

1. Nëntor, 1990

SHKSH »MIGJENI«
Kryetari: Gani BUÇINCA

LDK – Dega e Lubjanes
Kryetari: Martin Berishaj

Halil MATOSHI, gazetar

PPD – Dega e Lubjanës
Kryetari: Isak RAMADANI

ALTERNATIVA

Revistë e SHKSH MIGJENI - Lubjanë
Revija KDA MIGJENI v Lubljani

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës
Glalvni in odgovorni urednik

HALIL MATOSHI

Këshilli botues
Izdajateljski svet

Akademik prof. dr. REXHEP QOSJA
Prof. dr BEHLUL BRESTOVCI
Dr. ANTE KOVAÇEVIQ
SHKELZEN MALIQI, publicist
KALOSH ÇELIKU, shkrimtar-pisatelj

Redaktor teknik
Tehnični urednik

NAZMI KASUMI

Adresa-Naslov
SHKSH MIGJENI, Parmova 43, p.p. 48- 61116 Ljubljana
Telefon (telefax) 061 / 326-663

Llogaria rrjedhëse (din.): 50100-620-107 05 1010115-1664077
Llogaria devizore: 010-727001-100138/01

Çmimi 40 din. (për botën e jashtme 10 DM)
Cena: 40 din. ali 10 DM

Fotografia e faqes së parë: LALE MEREDITH – VULA